



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE**

# **SINTAGMA FOLJORE NË GJUHËN SHQIPE**

**Punoi**  
**Ma. Eljana MOSKO**

**Udhëhoqi**  
**Prof. Dr. Ludmila BUXHELI**

**TIRANË, 2015**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE**

**SINTAGMA FOLJORE NË GJUHËN SHQIPE**

Doktorant  
Ma. Eljana MOSKO

Udhëheqës shkencor  
Prof. Dr. Ludmila BUXHELI

TIRANË, 2015

# DISERTACION

Përgatitur nga:  
Për marrjen e gradës shkencore:  
Shkolla doktorale

**Eljana MOSKO**  
**“DOKTOR”**  
Kërkime Gjuhësore

## SINTAGMA FOLJORE NË GJUHËN SHQIPE

Udhëheqës shkencor:

**Prof. Dr. Ludmila BUXHELI**

Mbrohet në dt. \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2015 përpara jurisë së përbërë nga:

1. \_\_\_\_\_ **Kryetar**
2. \_\_\_\_\_ **Anëtar**
3. \_\_\_\_\_ **Anëtar (oponent)**
4. \_\_\_\_\_ **Anëtar (oponent)**
5. \_\_\_\_\_ **Anëtar**

TIRANË, 2015

*Dedikim*

---

*Nënës sime Eleni Mosko*

## PASQYRA E LËNDËS

<b>DEDIKIM.....</b>	<b>V</b>
<b>PARATHËNIE.....</b>	<b>VI</b>
<b>HYRJE.....</b>	<b>VII</b>
<b>SHKURTIME.....</b>	<b>XI</b>
<b>KREU I</b>	
<b>GJUHËSIA SI SHKENCË E NJOHJES NJERËZORE .....</b>	<b>1</b>
1.1 Studimi i gjuhës, preskriptiv vs. deskriptiv.....	3
1.2 Gramatika si sistem parimesh .....	5
1.3 Varfëria e stimulit.....	7
1.4 Gramatika Universale.....	8
1.4.1 Parametrat dhe Gramatika Universale.....	9
1.5 Mësimi i gjuhës dhe zotërimi i gjuhës.....	11
1.6 Elementë të zakonshëm formalë.....	12
1.6.1 Context-free grammar – Gramatika jo kontekstuale.....	13
1.6.2 Gramatika Transformuese.....	14
1.6.3 Programi Minimalist.....	14
1.7 E ardhmja e Gramatikës Gjenerative.....	15
<b>KREU II</b>	
<b>SINTAKSA – SHKENCA E NJOHJES NJERËZORE.....</b>	<b>17</b>
2.1 Sintaksa si shkencë e njohjes njerëzore të rregullave sintaksore.....	17
2.2 Leksikoni – fjala dhe konstituenti.....	18
2.3 Gramatika e strukturës së konstituentit.....	20
2.3.1 Gramatika e konstituentit vs. gramatika e varësisë.....	22
2.3.2 Mbi mënyrat për dallimin e konstituentëve.....	25
2.3.2.1 Testi i zhvendosjes.....	26
2.3.2.2 Testi i lidhjes (i pandashmërisë).....	27
2.3.2.3 Testi i fragmentit.....	27

2.3.2.4 Testi i zëvendësimit.....	28
2.3.2.5 Testi i mungesës.....	28
2.3.2.6 Testi i bashkërenditjes.....	28
2.4 Fjala dhe sintagma.....	30
2.5 Çështje të njësive sintaksore.....	31
2.5.1 Kriteret e dallimit të pjesëve të ligjëratës.....	31

### **KREU III**

#### **VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I STRUKTURËS SË SINTAGMËS..... 38**

3.1 Koncepti i sintagmës.....	38
3.2 Teoria X bar.....	42
3.2.1 Specifikuesi.....	44
3.2.2 Modifikuesi.....	47
3.2.3 Endocentriteti.....	48
3.2.3.1 Koka.....	50
3.3 Marrëdhëniet ndërmjet nyjeve të pemës strukturore.....	51
3.3.1 Dominimi.....	52
3.3.1.1 Dominimi i drejtpërdrejtë.....	53
3.3.2 Paraprirja.....	53
3.3.3 C-komand (komanda e konstituentit ose e përbërësit).....	56
3.3.4 Drejtimi.....	58
3.3.5 M-komanda dhe drejtimi.....	60
3.4 Marrëdhëniet gramatikore.....	64
3.5 Folja dhe argumentet.....	65
3.6 Nënkatëgorizimi dhe selektimi.....	65
3.7 Struktura kuptimore dhe struktura e argumentit.....	73
3.7.1 Struktura argumentore në gjuhët natyrore.....	74
3.8 Parimi i projeksionit.....	76

### **KREU IV**

#### **SINTAGMA FOLJORE NË GJUHËN SHQIPE..... 77**

4.1 Struktura e sintagmës foljore në gjuhën shqipe.....	77
4.1.1 Tradita gramatikore shqiptare; koncepti i sintagmës përkundrejt konceptit të togfjalëshit.....	77
4.2 Teoria X – bar për sintagmën foljore.....	83
4.3 Struktura argumentore e foljes.....	88
4.4 Struktura argumentore dhe pragmatika.....	92
4.4.1 Zhvillime semantike nën ndikimin e gjuhëve të huaja.....	94
4.4.1.1 Përdorimet e gabuara në shqipe nën ndikimin e greqishtes – rast studimor.....	95
4.5 Identifikimi i plotësorëve.....	98
4.6 Adjunktët.....	103

4.6.1 Identifikimi i Adjunktve.....	105
4.7 Rolet semantike të foljes.....	107
4.8 Valenca e foljes.....	109
4.9 Realizimi i rasës së SE në rolin e kryefjalës.....	113

## **KREU V**

### **SINTAGMA FOLJORE NË FJALITË ME FOLJE JOKALIMTARE..... 117**

5.1 Foljet joergative përkundrejt foljeve joakuzative.....	119
5.2 Karakteristikat e foljeve joergative .....	120
5.3 Karakteristikat e foljeve joakuzative.....	123
5.4 Dikotomia / dyanësia e foljeve joergative – joakuzative.....	130
5.5 Raste të diskutueshme me sintagmat e foljeve jokalmtare.....	132

## **KREU VI**

### **SINTAGMA FOLJORE NË FJALITË ME FOLJE KALIMTARE..... 135**

6.1 Kalimtarësia – karakteristika të përgjithshme.....	135
6.1.1 Shkalla e parametrave të kalimtarësisë.....	140
6.2 Foljet kalimtare me një kundrinë të shprehur me SE.....	142
6.3 Foljet kalimtare me plotësorë fjali të varur kundrinore.....	145
6.4 Foljet kalimtare me plotësorë fjali të varur kryefjalore.....	146
6.5 Foljet kalimtare me dy kundrina.....	147
6.5.1 Disa qasje të tjera të ndërtimeve të SF me dy kundrina.....	149

## **KREU VII**

### **SINTAGMA FOLJORE ME FOLJE QË PËRDOREN SI KALIMTARE**

#### **DHE JOKALIMTARE..... 154**

7.1 Klasat e foljeve dhe alternimet në kalimtarësi.....	158
7.1.1 Joakuzativet (Ergativet).....	158
7.1.2 Joergativet (Jokalmtare aktive).....	161
7.2 Ndërtimet me dy plotësorë.....	164

## **KREU VIII**

### **SINTAGMA FOLJORE ME KLITIKË..... 166**

8.1 Një vështrim i përgjithshëm i klitikëve në shqipe.....	166
8.2 Klitikët në sintagmën foljore.....	168
8.2.1 Ergativet dhe foljet që shprehin përjetim: roli i klitikut.....	171
8.2.2 Foljet joergative jokalmtare.....	173
8.3 Rimarrja e kundrinës së drejtë me klitikë.....	174
8.4 Rimarrja e kundrinës së zhdrejtë me klitikë.....	177

## **KREU IX**

### **SINTAGMA FOLJORE ME FOLJE MODALE..... 193**

*Pasqyra e lëndës*

---

9. Modaliteti në kuptimin e gjerë.....	193
9.1 Llojet e kuptimit modal.....	193
9.2 Varësia nga konteksti dhe specializimi leksikor.....	195
9.3 Sintagma modale në këndvështrimin gjenerativ.....	197
<b>PËRFUNDIME.....</b>	<b>203</b>
<b>PROPOZIME.....</b>	<b>207</b>
<b>BIBLIOGRAFI.....</b>	<b>208</b>



## **PARATHËNIE**

*Nga një pikëpamje, parimet gjuhësore të çdo gjuhe zhvillohen në mënyrë që t'i shërbejnë qëllimeve të përdoruesve të saj kur ata konceptojnë, komunikojnë ose bashkëpunojnë. Në ligjërim funksionet më të përdorshme luajnë rolin më kryesor duke formësuar në këtë mënyrë vetë gramatikat. Nga perspektiva e folësit strukturat gramatikore përfaqësojnë burime të mundshme, të gatshme për t'i dhënë mendim çdo veprimi të ndërmarrë nga gjuha. E kemi zgjedhur këtë temë duke qenë të ndërgjegjshëm se kërkimi studimor në brumin gjuhësor të shqipes, sipas modelit të gramatikës gjenerative, jep mundësi të gjera trajtimi dhe interpretimi.*

*Gjenerativizmi është tashmë rryma sunduese në gjuhësinë e sotme botërore. Përqasja e këndvështrimit tradicional dhe atij bashkëkohor është tashmë një praktikë që lind natyrshëm në kërkimin gjuhësor të shqipes. Ndaj dhe fryma përqasëse që karakterizon këtë punim në përshkrimin dhe analizën e sintagmës foljore në gjuhën shqipe, shërben për të zgjeruar dimensionin e foljes në gjuhën shqipe.*

*Në këtë ndërmarrje kemi pasur nxitjen, vlerësimin dhe përkrahjen e paçmueshme të udhëheqëses shkencore, Prof. Ludmila Buxheli, e cila me kurajën shkencore që e karakterizon nuk ka nguruar të mbështesë idenë tonë dhe të na ndihmojë me mendimet e saj si dhe me materiale shkrimore që përbëjnë një pjesë të bibliografisë sonë. Gjejmë këtu rastin ta falënderojmë për mbështetjen, besimin por edhe për durimin me të cilin na ka dëgjuar gjatë shpalosjes së ideve në lidhje me studimin e ndërmarrë.*

*Falënderojmë gjithashtu Prof. Thoma Dhimën për ndihmën e pakursyer e kujdesin e ofruar gjithë këto vite për realizimin e këtij punimi. Gjejmë rastin për të falënderuar edhe Prof. Anna Roussou, për mbështetjen e vazhdueshme me materiale shkrimore nga studimet e saj mbi gjenerativizmin, që janë bërë pjesë e bibliografisë së këtij punimi.*

*Falënderojmë gjithashtu gjithë kolegët dhe miqtë brenda dhe jashtë Shqipërisë, nëpër konferenca shkencore ose në biseda të lira dhe spontane, të cilët na kanë ndihmuar me materiale shkrimore, por edhe me vërejtjet e tyre të çmuara.*

## **HYRJE**

### ***Qëllimi i punimit***

Nëpërmjet punimit të ndërmarrë synojmë të paraqitim:

- rregullat e funksionimit të sintagmës foljore në gjuhën shqipe, strukturën e saj, rregulla të cilat folësi i shqipes si gjuhë amtare i njeh dhe i zbaton në mënyrë të pavetëdijshme.
- rolin e kuptimit të foljes si pjesë e sintagmës foljore për realizimin e lidhjeve të saj me konstituentët e tjerë të fjalisë.
- të ilustrojmë me shembuj praktikë gjetjet e ndryshme teorike për ta kthyer teorinë nga një qëllim në diçka që sjell ndikim praktik.

### ***Metodologjia e kërkimit***

Fillimisht studimi ynë mbështetet në një analizë përshkruese të gjuhës si shkencë e njohjes ku tregohet se përcaktimi i rregullave të funksionimit të sintagmës foljore SF në gjuhën shqipe njihet dhe zbatohet në mënyrë të pavetëdijshme nga folësi amtar i gjuhës shqipe. Për këtë është shfrytëzuar literatura nga gramatologjia shqiptare dhe e huaj për problemet e foljes e të sintagmës foljore. Pas grumbullimit të materialeve teorike procedojmë me zbatimin e tyre në vëllimin konkret të foljes në shqipe. Puna jonë konkrete konsiston në përzgjedhjen e grupeve të foljeve me karakteristika të ngjashme sintaksore e semantike. Më tej jepen tiparet e tyre duke bërë një kombinim të këndvështrimit tradicional me atë bashkëkohor gjenerativist.

### ***Literatura bazë shkencore***

Literatura shkencore në të cilën jemi mbështetur për trajtimin e çështjeve teorike që kanë të bëjnë me teorinë e drejtimit e të lidhjes, strukturën argumentore të foljeve, rolet semantike, foljen e sintagmën foljore lidhet kryesisht me arritjet e gramatologjisë shqiptare në studimin e gjuhës në mënyrë gjenerative; kjo literaturë përfshin autorë

shqiptarë dhe të huaj. Referencat e para mbi gjenerativizmin lidhen me autorë të huaj, themelues të gjenerativizmit si rrymë gjuhësore. Ndër ta duhet të përmendim themeluesin, Noam Chomsky me *Aspects of the Theory of Syntax* (1965), *Remarks on Nominalization* (1970), *Lectures on government and binding: The Pisa Lectures* (1981), të cilat shërbyen si gure themeli për shumë studiues të mëvonshëm të cilëve u jemi referuar si p.sh. Jackendoff (1977, 1983, 1996), Perlmutter (1978, 1984), Doëty (1979, 1991), Abney (1987, 1995), Baker (1988, 2008), Carnie (2006), Graffi (1994, 2008), Haegerman (1998), Haspelmath (1993, 2006), Kratzer (1991, 2004), Levin (1993, 1995, 2005, 2010), Radford (2004) etj.

Për sa u përket referencave në studimet mbi gjenerativizmin në gjuhën shqipe, një kontribut themelor jepet nga Buxheli (2007, 2011), Memushaj (2003, 2008), Dhima (2002, 2007, 2010), Kallulli (2001), Koleci – Turano (2011) etj.

Gjithashtu nuk mund të lemë pa përmendur kontributin e gjuhëtarëve që kanë ngritur traditën e gjuhësisë shqiptare, referencat nga studimet e tyre ishin të domosdoshme dhe shërbyen si bazë për këtë punim. Ndër ta mund të përmendim Agalliu (1972), Demiraj (1994), Floqi (1968), Përnaska (1972), Sheperi (ribotim 2011), Totoni (1994) etj.

Për grupimin e foljeve dhe vjeljen e shembujve është shfrytëzuar Fjalori i Gjuhës Shqipe (2006).

### ***Kontributi shkencor***

Ky punim është një kontribut në përshkrimin dhe analizën e sintagmës foljore në gjuhën shqipe dhe shërben për të zgjeruar dimensionin e foljes në gjuhën shqipe në bazë të kriterëve dhe kushteve më gjithëpërfshirëse siç është analiza e sintagmës, nën dritën e teorisë së drejtimit dhe lidhjes.

Ai ndihmon për të treguar vendin që duhet të zërë analiza gjuhësore nën këndvështrimin gjenerativist si dhe për të treguar praktikisht përcaktimin e grupimin e foljeve me karakteristika të ngjashme sintaksore e semantike. Punimi kontribuon edhe me përdorimin e disa nocioneve bashkëkohore në lidhje me kriteret gjuhësore, si p.sh., *folje joergative, folje joakuzative, jokalimtare me dy plotësorë, shkalla e parametrave të kalimtarësisë etj.*

Ai kontribuon gjithashtu në një vlerësim më real të përkimeve dhe dallimeve të këndvështrimit tradicional me atë bashkëkohor gjenerativist për sa i takon analizës së foljes në gjuhën shqipe.

### ***Struktura e punimit***

Ky punim kërkimor shkencor është ndarë në nëntë kapituj. Në çdo kapitull jemi përpjekur të vëmë në dukje problemet që lidhen me sintagmën foljore në gjuhën shqipe.

**Kreun e parë** e nisim me gjuhësinë si shkencë e njohjes njerëzore me të cilën kuptohet që gjuhësia studion gjuhën si një veçori specifike që e ka vetëm njeriu, kjo gjuhë karakterizohet nga rregulla të cilat zotërohen ose njihen nga njeriu në mënyrë të pavetëdijshme. Detyra e gjuhëtarit është t'i zbulojë këto rregulla që gjenerojnë fjali dhe t'i bëjë të vetëdijshëm folësit e një gjuhe për mënyrën sesi funksionon gjuha. Ky është edhe thelbi i gjenerativizmit, i rrymës sunduese në gjuhësinë e sotme botërore. Kjo rrymë u themelua nga Noam Chomsky nga mesi i viteve '50 të shekullit të kaluar. Chomsky ndërmerret një qasje kognitive/njohëse në studimin e gramatikës. Qëllimi i gjuhëtarit është të përcaktojë atë që di një folës për gjuhën e tij amtare, çfarë i mundëson atij të flasë dhe të kuptojë këtë gjuhë, si rrjedhim për Chomsky-n, studimi i gjuhës është pjesë e studimit të gjerë të njohjes (cognition).

Në këtë kuptim edhe sintaksa është shkencë e njohjes njerëzore, që është dhe thelbi i **kreut të dytë**, sepse njeriu zotëron/njeh në mënyrë të pavetëdijshme rregullat sintaksore të gjuhës së tij, kurse sintaksiologu i zbulon këto rregulla e i bën të vetëdijshëm folësit e një gjuhe për ekzistencën e këtyre rregullave. Ky është edhe thelbi i gramatikës gjenerative, pra tërësia e rregullave mbi të cilat funksionon gjuha. Në këtë kapitull trajtojmë gjithashtu edhe çështje të leksikut, të njësive sintaksore e të strukturës së fjalisë.

**Në kreun e tretë** i kushtojmë rëndësi strukturës së sintagmës në përgjithësi duke theksuar faktin se gjuhësia gjenerative është dominuar që prej gjysmës së shekullit të kaluar nga formalizmi gramatikor që bazohet në gramatikën e konstituentit. Në këtë kapitull përmendet edhe terminologjia bazë e teorisë së drejtimit dhe lidhjes duke trajtuar çështje si teoria X-bar, specifikuesi, koka, modifikuesi, marrëdhëniet strukturore e gramatikore.

**Në kreun e katërt** bëjmë një përshkrim të strukturës së sintagmës foljore në gjuhën shqipe duke nxjerrë në pah përkimet dhe dallimet me konceptin e togfjalëshit dhe përkatësisht të togfjalëshit foljor. Në këtë kapitull është analizuar struktura argumentore, plotësorët, adjunktët e teoria theta bazuar në materialin e gjuhës shqipe. Janë nxjerrë në pah karakteristikat e foljes në shqipe duke u mbështetur në teorinë e sintagmës dhe mundësinë për të përfshirë në sintagmën foljore të shqipes jo vetëm plotësorë emra, por edhe plotësorë fjali; në këtë mënyrë tregohet dhe natyra gjithëpërfshirëse e sintagmës. Duke u mbështetur në zhvillimet semantike nën ndikimin e gjuhëve të huaja, e përkatësisht në shumë përdorime të gabuara të strukturës argumentore në shqipe nën ndikimin e greqishtes, kemi ndërmarrë një rast studimor të realizimeve të gabuara të strukturës argumentore të foljes në të folmen e minoritetit grek në Gjirokastrë.

**Kreu i pestë** i kushtohet sintagmës foljore në fjalitë me folje jokalmimtare, të cilat ndahen në dy kategori, përkatësisht *joergative* dhe *joakuzative* sipas përcaktimit të dhënë në Gramatikën Relacionale, duke vendosur materialin e foljeve jokalmimtare të gjuhës shqipe në këtë kuadër. Në vijim është analizuar rasti i foljeve jokalmimtare me dy plotësorë.

**Kreu i gjashtë** i kushtohet kalimtarësisë duke bërë një analizë të sintagmës foljore në fjalitë me folje kalimtare të gjuhës shqipe, duke i mbështetur ato në literaturën

funkcionale – tipologjike, e përkatësisht sipas hipotezës së kalimtarësisë. Janë trajtuar foljet kalimtare me një kundrinë, foljet kalimtare me shumë plotësorë, e ndërtimet bikalimtare.

Në **kreun e shtatë** ndërmarrim një analizë të foljeve të cilat realizohen në të njëjtën kohë në fjali si folje kalimtare dhe jokalimtare. Nuk ka një kufi të prerë ndërmjet foljeve kalimtare dhe jokalimtare. Përkatësia e një foljeje në grupin e foljeve kalimtare dhe foljeve jokalimtare varet nga kuptimi i saj leksikor në kontekstin ku është përdorur. Duke qenë se shumë folje kanë më shumë se një kuptim, qëllon shpesh që e njëjta folje të përdoret herë si jokalimtare, herë si kalimtare, gjithnjë sipas kuptimit të saj leksikor në këtë ose atë kontekst. Vihet në dukje se folja si njësi leksikore nuk përfshin vetëm strukturën argumentore të saj, por gjithashtu edhe “strukturën leksikore konceptuale” (*lexical conceptual structure*) të saj, që ka të bëjë me tërësinë kuptimore të fjalës.

Në **kreun e tetë** e vendosim sintagmën foljore si komponent të sintagmës klitike. Një ndër problemet më të diskutueshme, që shfaqet edhe në gjuhën shqipe (ndër të tjera), është interpretimi i tyre ose si mjete përshtatjeje ose si sintagma determinative që përfaqësojnë një argument. Është analizuar roli sintaksor i klitikut në alternimet në kalimtarësi duke u përqëndruar kryesisht në format ergative. Duhet të kemi parasysh se në bazë të semantikës së ngjarjeve ka raste kur klitiku është i domosdoshëm dhe ka të tjera ku ai shërben si plotës për të përforcuar rolin e argumentit të brendshëm të shprehur me formë të plotë kundrinori.

Në **kreun e nëntë** ndërmarrim një analizë të sintagmës foljore si komponent të sintagmës modale. Flitet për modalitetin në kuptimin e gjerë, llojet e kuptimit modal e sintagma modale në këndvështrimin gjenerativ, ku jepen tipat e sintagmave modale SM në shqipe: *mund + lidhore, duhet + lidhore/folje e pashtjelluar, do + pjesore, kam/jam + formë e pashtjelluar*.

Në **mbyllje të punimit** jepen disa përfundime si dhe disa propozime për perspektivën e kërkimeve të mëtejshme në kuadër të gramatikës gjenerative, si shkencë e njohjes njerëzore, me rregulla të cilat folësi i shqipes (në rastin tonë) si gjuhë amtare i njeh dhe i zbaton në mënyrë të pavetëdijshme si dhe për perspektivën e përfshirjes së konceptit të sintagmës në gramatologjinë shqiptare me rregullat e strukturën e funksionimit të sintagmës në gjuhën shqipe.

**SHKURTIME**

krh.	krahaso
lit.	literal, literalisht, me kuptim të drejtpërdrejtë
p.sh.	për shembull
vs.	versus, kundrejt

## KREU I

### GJUHËSIA SI SHKENCË E NJOHJES NJERËZORE

Punimi i doktoraturës “Sintagma foljore në gjuhën shqipe” ka për qëllim të nxjerrë në pah veçoritë e sintagmës foljore në gjuhën shqipe duke u mbështetur në gramatikën gjenerative, pjesë e së cilës janë teoritë që gjejnë zbatim në të gjitha gjuhët natyrore.

Leonard Bloomfield<sup>1</sup> e përcaktoi gjuhësinë si shkenca e gjuhës (Bloomfield, 1933). Quhet ndryshe linguistikë (nga fjala latine lingua “gjuhë”). Si të gjithë shkencëtarët, edhe gjuhëtarët kanë për qëllim të formulojnë parimet kryesore, mbi bazën e të cilave zbatohet materiali gjuhësor në gjuhët natyrore.

Deri aty nga fillimi i shek. XIX, gjuhësia, ashtu si shumë disiplina të tjera, përfshihej në gjirin e filozofisë. Por edhe kur u bë disiplina e veçantë, ajo në fillim shihej si shkencë biologjike apo e si pjesë e psikologjisë<sup>2</sup>. Statusin e një disipline autonome gjuhësia arriti ta siguronte falë punës së një numri gjuhëtarësh të shquar, të cilët, duke zbatuar në kërkimet e tyre metoda të rrepta shkencore arritën të formulonin parime mbi të cilat, edhe sot, mbështeten shumë studiues për të përpiluar analizat gjuhësore, të cilat përpunohen, përshtaten e shpesh sfidojnë njëra tjetrën nga dekada në dekadë, duke zgjeruar dijen tonë mbi gjuhësinë si shkencë. Si çdo shkencë tjetër, edhe gjuhësia ndërtohet mbi të shkuarën; dhe këtë e bën jo vetëm duke vënë në dyshim dhe duke hedhur poshtë doktrinat tradicionale, por edhe duke i zhvilluar më tej dhe duke i formuluar rishtas. Njohja e historisë së objektit të studimit kërkon kuptimin e parimeve dhe të teorive bazë.

Gramatika tradicionale i ka fillimet e saj në Greqinë e shekullit të pestë para Krishtit. Për grekët “gramatika” konsiderohej që në fillim si pjesë e “filozofisë”. Bloomfield-i<sup>3</sup>, duke folur për logjikën e shëndoshë njerëzore, lidhur me çështje të gjuhësisë, thotë: “ajo që maskohet si logjike e shëndoshë njerëzore, si shumë të tjera, në

---

<sup>1</sup> Leonard Bloomfield, *Language*. New York: Henry Holt, Rinehart dhe Winston Inc. 1933, fq. 3

<sup>2</sup> Rami Memushaj, *Hyrje në Gjuhësi*, Botimet Toena, Tiranë 2008, fq. 12

<sup>3</sup> Bloomfield, *Po aty*, fq. 17

të vërtetë, është më e ndërlikuar dhe nuk qëndron aspak larg nga spekulimet e filozofëve antikë e mesjetarë”. Si shembull për teorinë e diktuar nga “logjika e shëndoshë njerëzore” mbi gjuhën mund të përmendet mendimi i përhapur përgjithësisht se të gjitha gjuhët kanë të njëjtat “pjesë ligjërate”<sup>4</sup>. Teoria tradicionale “e pjesëve të ligjëratës” dhe përkufizimi standard i gramatikës klasike pasqyrojnë përpjekjet e Antikitetit e të Mesjetës për t’i përfshirë në mënyrë të sforcuar kategoritë e gramatikës, të logjikës dhe të metafizikës në një sistem të vetëm.

Në fakt, mund të thuhet se gjuha përbën një sistem rregullash. Gjuha<sup>5</sup> përbëhet nga elemente të ndryshme, si fonemat, morfemat, fjalët etj. të cilat janë njësi të gjuhës. Të marra më vete, këto njësi nuk mund të shërbejnë për komunikim. Për të bërë të mundur përdorimin e gjuhës si mjet komunikimi, njësitë e saj duhet të hyjnë në lidhje e bashkëveprim midis tyre. Kështu, fonemat zanore e bashkëtingëllore bashkohen sipas rregullash të caktuara, duke formuar morfema dhe këto bashkohen për të formuar fjalë, pastaj fjalët lidhen me njëra tjetrën për të formuar grupe sintaksore etj. Tërësia e këtyre lidhjeve të ndërsjellta midis njësive të sistemit përbën strukturën e gjuhës, e cila duhet kuptuar si mënyra e organizimit të elementeve të sistemit gjuhësor.

“Shkencë e njohjes njerëzore”<sup>6</sup> është një term i cili përdoret për një grup disiplinash gjuhësore që kanë qëllim të njëjtë: të përshkruajnë dhe të shpjegojnë aftësinë e qenieve njerëzore për të menduar (ose e thënë më saktë, për të menduar për nocione abstrakte). Ajo që na dallon nga kafshët, është pikërisht aftësia jonë për të gjeneruar gjuhën. Kjo do të thotë se gjuha është aftësi njerëzore, specifike vetëm për njeriun.

Kur flitet për gjuhësinë si shkencë e njohjes njerëzore kuptohet që gjuhësia studion gjuhën si një veçori specifike që e ka vetëm njeriu, kjo gjuhë karakterizohet nga rregulla të cilat zotërohen ose njihen nga njeriu në mënyrë të pavetëdijshme. Detyra e gjuhëtarit është t’i zbulojë këto rregulla që gjenerojnë fjali dhe t’i bëjë të vetëdijshëm folësit e një gjuhe për mënyrën sesi funksionon gjuha. Ky është edhe thelbi i gjenerativizmit, i rrymës sunduese në gjuhësinë e sotme botërore. Kjo rrymë u themelua nga Noam Chomsky nga mesi i viteve ’50 të shekullit të kaluar. Chomsky<sup>7</sup> ndërmerret një qasje kognitive/njohëse në studimin e gramatikës. Ai shprehet se qëllimi i gjuhëtarit është të përcaktojë atë që di një folës për gjuhën e tij amtare, çfarë i mundëson atij të flasë dhe të kuptojë këtë gjuhë, si rrjedhim për Chomsky-n, studimi i gjuhës është pjesë e studimit të gjerë të njohjes (cognition).

Haegeman<sup>8</sup> (1998) duke iu referuar Chomsky-t shprehet se rregullat dhe parimet që formulohen për të përshkruar një gjuhë, ndërtojnë në vetvete gramatikën e kësaj gjuhe. Gjuhësia bashkëkohore, gjatë përpjekjeve për të ndërtuar një teori të përgjithshme të

---

<sup>4</sup> John Lyons, *Introduction to Theoretical Linguistics*, Botimi i parë në shqip – Dituria 2001, fq. 20-21

<sup>5</sup> Rami Memushaj, *Po aty*, fq. 45

<sup>6</sup> Andrew Carnie, *Syntax: a Generative Introduction, Second Edition*, Blackwell Publishers Ltd, 2006, fq. 4-5

<sup>7</sup> Noam Chomsky, *Aspects of the Theory of Syntax*. MIT Press, 1965, fq. 57

<sup>8</sup> Liliane Haegeman, *Introduction to Government and Binding Theory*, Second Edition, 1998, Blackwell Publishers Ltd, fq. 4-18



strukturës së gjuhës, e ka tejkaluar gramatikën tradicionale. Vetë gramatika është një sistem koherent rregullash dhe parimesh të pavetëdijshme që janë baza e ndërtimeve gramatikore të një gjuhe. Gramatika gjeneron fjalitë e një gjuhe. Ky është edhe kuptimi i termit *gramatikë gjenerative*.

“Gjenerativ” do të thotë që përshkrimi është rigoroz dhe eksplisit; “kur flitet për teorinë e gramatikës si “gramatikë gjenerative” vetëm synohet të tregohet që ajo është mjaftueshmërisht eksplicite për të përcaktuar në ç’mënyrë frazat e gjuhës karakterizohen nga gramatikaliteti. Dallimi bazë ndërmjet rregullave të gramatikës tradicionale dhe rregullave të gramatikës gjenerative qëndron kryesisht në përmbajtjen e tyre, duke qenë se rregullat e gramatikës gjenerative kanë si karakteristikë faktin që janë të eksperimentueshme në ligjërimin aktual, pra ato nuk përdorin në mënyrë të detyruar njohjen e lexuesit për një gjuhë të caktuar<sup>9</sup>.

Chomsky shprehet se ligjërimi në gjuhën amtare është pjesë e nënvetëdijes më shumë se pjesë e vetëdijes; pra, është e pavend të kërkojmë nga një folës i shqipes “Formo një fjali pyetëse”. Njerëzit veprojnë në mënyrë të pandërgjegjshme në procese që kanë të bëjnë me të folurin dhe të kuptuarit e gjuhës së tyre amtare. Për më tepër Chomsky<sup>10</sup> ka përdorur termin kompetencë gramatikore e folësve të gjuhës për të përdorur në mënyrë të pavetëdijshme gramatikën e gjuhës së tyre – p.sh. si formohen dhe interpretohen fjalët, shprehjet dhe fjalitë e një gjuhe.

### *1.1 Studimi i gjuhës, preskriptiv vs. deskriptiv*

Mendimet e studiuesve për këto dy mënyra të studimit të gjuhës janë të ndryshme. Termi “gramatikë” shpesh ngjall frikë për njerëzit që nuk merren me studimin e gjuhës. Por, Carnie<sup>11</sup> shprehet se ka dy mënyra për të shprehur rregullat gramatikore. Njëri është t’u tregojmë njerëzve se si duhet të flasim e të shkruajmë në bazë të një standardi; këto lloj rregullash quhen rregulla preskriptive. Qasja që na vjen nga gramatika tradicionale është ajo preskriptive. Ajo përcakton normat e përdorimit të saktë të gjuhës<sup>12</sup>, pra atë që “duhet” dhe “nuk duhet”. Disa shembuj të rregullave preskriptive për gjuhën shqipe<sup>13</sup> janë “në pajtim me traditën, për të shmangur homoniminë si edhe për të ruajtur strukturën e formimit, trajtat e shkurtra proklitike të përemrave **ia, iu**, të shkruhen me **i** dhe jo me **j** (**ia, iu** dhe jo **ja, ju**).” ose “te emrat që mbarojnë me **i** të theksuar, kur kjo në trajtat e tyre të ndryshme morfologjike ndiqet nga një zanore tjetër, të mos shkruhet **-j-** (*liri - liria*,

---

<sup>9</sup> V. J. Cook, Mark Newson, *La grammatica universale - introduzione a Chomsky*, 1996

<sup>10</sup> Noam Chomsky, *Aspects of the Theory of Syntax*, Massachusetts Institute of Technology, 1965, fq. 4-5

<sup>11</sup> Andrew Carnie, *Syntax: a Generative Introduction, Second Edition*, Blackwell Publishers Ltd, 2006, fq. 8

<sup>12</sup> James Mannes Bourke, *The grammar we teach*, tërhequr më 12.12.2014 nga <http://nus.edu.sg/celc/publications/BourkeVol4.pdf>, fq. 86

<sup>13</sup> Rezolutë e Kongresit të Drejtshkrimimit të Gjuhës Shqipe tërhequr më 17.12.2014 nga <https://sites.google.com/site/drejtshkrimishqip/rezolute>

*shtëpi - shtëpia*)” ose “emrat e përveçëm të huaj të shkruhen duke u mbështetur në traditën e përdorimit të tyre në gjuhën shqipe dhe duke marrë parasysh shqiptimin në gjuhën përkatëse”. Rregulla të tilla na tregojnë se si duhet përdorur gjuha jonë. Qasja tjetër është të formësojmë rregulla të cilat tregojnë në fakt se si ligjërojnë njerëzit, pavarësisht nëse ligjërimi është i saktë ose jo. Këto quhen rregullat deskriptive.

Bourke (2005) shprehet se gramatika preskriptive është mjaft dogmatike dhe i bën të qarta dallimet ndërmjet gramatikës “së mirë” dhe “të keqe”. Ashtu siç shprehet edhe Odlin<sup>14</sup> (1994, 1) “Në pjesën më të madhe të rasteve, vendimet për atë që është e mirë ose e keqe janë arbitrare dhe shpesh të pasakta dhe subjektive; ato kanë tendencën të anashkalojnë ligjërimin aktual”.

Kjo gramatikë e lë mënjanë faktin se gjuha është vazhdimisht në zhvillim, për më tepër që përdor ose mban të dhëna që tashmë nuk përdoren më. Rregullat e gramatikës preskriptive nuk i përshtaten plotësisht përdorimit aktual të gjuhës. Hung<sup>15</sup> (2003) shprehet se “gramatika e një gjuhe nuk qëndron në libra por në mendjen e folësve”. Gramatika preskriptive është zëvendësuar nga gramatika bashkëkohore deskriptive/përshkruese, e cila përshkruan gjuhën ashtu siç duhet të jetë. Është një gramatikë objektive, e bazuar në ligjërimin aktual të folur e të shkruar. Gramatika deskriptive mbështet si çdo gramatikë tjetër, në analiza strukturore.

Bourke<sup>16</sup> shprehet se kjo gramatikë vendoset në sintaksë në shumë nivele si në nivelin e morfemës, të fjalës, të sintagmës, të fjalisë dhe të tekstit. P.sh në nivelin e fjalisë, çdo fjali e thjeshtë analizohet në bazë të konstituentëve ose elementëve të fjalisë, pra kryefjalë, folje, kundrinë etj. këto njësi analizohen sipas komponentëve të sintagmës, pra sintagmë emërore, sintagmë fojore etj. Kjo gramatikë pretendon se përshkruan gjuhën “e vërtetë” dhe shembujt e përdorur merren nga kontekste reale të ligjërimin të përditshëm.

Çdo folës i një gjuhe, në rastin tonë i gjuhës shqipe, ligjëron dhe shkëmben një numër të madh të fjalive gramatikore. Folësi amtar i shqipes mund të mos jetë në gjendje të formulojë parimet e përgjithshme që përcaktojnë fjalitë që ai ligjëron, por ai ka një aftësi të brendshme dhe të pandërgjegjshme të parimit në fjalë; ky folës e ka të ngulitur gramatikën e shqipes. Aftësia e brendshme e folësit amtar për gramatikën e gjuhës është fokusi i studimeve në traditën Çomskiane<sup>17</sup>.

Haegeman<sup>18</sup> shprehet se kjo gramatikë është një formulim i qartë i njohurive gjuhësore të brendshme të folësit amtar, pra gramatika e brendshme. Zhvendosja e përqëndrimit nga gjuha tek vetë njohuria për gjuhën e folësit amtar është karakteristika

---

<sup>14</sup> Terence Odlin, *Perspectives on pedagogical grammar*. Cambridge: Cambridge University Press. 1994, fq. 1

<sup>15</sup> Toni Tong Ning Hung, *How linguistics can contribute to the teaching of grammar*. Në J.E. James (Ed.), *Grammar in the language classroom*. Singapore: SEAMEO Regional Language Centre 2003, fq. 44.

<sup>16</sup> James Mannes Bourke, *Po aty*, fq. 89

<sup>17</sup> Liliane Haegeman, *Introduction to Government and Binding Theory*, Second Edition, 1998, Blackwell Publishers Ltd, fq. 6

<sup>18</sup> L.Haegeman, *Po aty*, fq. 7

më e madhe e traditës Çomskiane. Si gjuhëtari gjenerativ ashtu edhe gjuhëtari tradicional do të ndërtojnë gramatika, pra sisteme të përgjithshme që përcaktojnë fjalitë e një gjuhe. Gramatika është përfaqësimi i njohurive të brendshme të gjuhës.

### ***1.2 Gramatika si sistem parimesh***

Në studimet në vazhdim mbi gjenerativizmin Chomsky<sup>19</sup> ka tërhequr vëmendjen mbi dallimin ndërmjet kompetencës (njohuritë gjuhësore të pavetëdijshme) dhe performancës (atë çfarë njerëzit thonë ose kuptojnë një bashkëbisedim në një kontekst të caktuar). Kompetenca është njohuria e pavetëdijshme e folës – dëgjuesit për gjuhën e tij, ndërsa performanca është përdorimi konkret i gjuhës në një situatë.

Shpesh, performanca është një reflektim jo i saktë i kompetencës: ndodh që të kemi rrëshqitje gramatikore të gjuhës dhe të kemi interpretime të gabuara në procesin e ligjërimit. Megjithatë, kjo s' do të thotë që folësit nuk njohin gjuhën e tyre amtare dhe që nuk kanë kompetencë për të. Ligjërimit apo interpretimit i gabuar janë gabime të performancës, të cilat mbarten nga një sërë faktorësh performance si lodhje, dembelizëm, shpërqendrim etj. Gramatika e vetë gjuhës të tregon çfarë duhet të dish në mënyrë që të kesh kompetencë – amtare të kësaj gjuhe (ligjërimit i rrjedhshëm i një gjuhe si një folës amtar), pra është e qartë se gramatika është e lidhur më shumë me kompetencën se me performancën.

Megjithatë kjo nuk e nënvlerëson performancën si fushë studimore, por kryesisht performanca mbetet të studiohet nga një tjetër disiplinë (pavarësisht lidhjes së ngushtë) – nga psikolinguistika, e cila studion proceset psikologjike në prodhimin dhe në të kuptuarit e ligjërimit.

Në terminologjinë e sjellë nga Chomsky<sup>20</sup>, kur studiohet kompetenca gramatikore e një folësi amtar të një gjuhe, jemi duke studiuar sistemin e brendshëm njohës në trurin e folësit; qëllimi final në studimin e kompetencës është përcaktimi i karakteristikave të sistemit gjuhësor të brendshëm (ose Internal – language, siç e quan Chomsky), që i bën folësit të aftë në një gjuhë të caktuar. Një qasje e tillë e njohjes ka një domethënie të dukshme për gjuhëtarin deskriptiv, i cili analizon gramatikën e kësaj gjuhe.

Pra, një veti e gramatikës gjenerative në të gjitha varietetet e saj është vëmendja që i kushtohet karakterizimit të kompetencës gjuhësore. Shumë studiues të gramatikës gjenerative do të donim të zhvillonin modele të performancës gjuhësore, por shumica<sup>21</sup> besojnë se një teori me fokus në kompetencë do të jetë mëse e nevojshme për një model të tillë. E thënë pak më ndryshe, pranohet gjerësisht se duke shpjeguar se si një gjuhë

---

<sup>19</sup> Noam Chomsky, *Aspects of the Theory of Syntax*, Massachusetts Institute of Technology, 1965, fq. 4

<sup>20</sup> Noam Chomsky, *Knowledge of Language: Its Nature, Origin, and Use*, Greenwood Publishing Group, 1986, fq. 19-56

<sup>21</sup> Thomas Wasow, *The Handbook of Linguistics*, Mark Aronoff, Janie Rees-Miller, Blackwell Publishers Ltd, 2001, fq. 296

përdoret në të vërtetë, do të thotë të kuptosh botëkuptimin/njohjen e folësve mbi këtë gjuhë.

Në fakt, folësi amtar nuk gjykon nëse një fjali është gramatikore ose jo; ky folës përdor intuitën për të vendosur nëse një ligjërim është i pranueshëm ose jo. Është detyra e gjuhëtarëve të përcaktojnë, në rastin kur një ndërtim është i papranueshëm, nëse kjo vjen si pasojë e parimeve gramatikore apo si pasojë e faktorëve të tjerë. Gjithashtu, gjuhëtari duhet të përcaktojë se sa është masa e papranueshmërisë së një ndërtimi; kjo duke patur parasysh parimet gramatikore. Sipas, Haegeman<sup>22</sup> detyra e gjuhëtarit është të përshkruajë ndërveprimin e gramatikës së brendshme të folësit dhe faktorëve të tjerë.

Një qasje në formulimin e gramatikës së një gjuhe do të ishte sikur të supozonim se njohuria e brendshme e folësit të shqipes të jetë jo më shumë se një tërësi me fjali të gatshme gramatikore. Duke pasur këtë kompetencë folësit mund të kontrollojnë çdo fjali që hasin në ligjërimin e përditshëm. Sipas kësaj logjike fjalitë të cilat përputhen me fjalitë në “listë” (pra, në gramatikën e brendshme) janë gramatikore, ndërsa ato që nuk përputhen nuk janë gramatikore. Në varësi të kësaj do të thoshim se gramatika e një gjuhe është thjesht një listë me fjali.

Në fakt, ky pohim nuk qëndron, sepse listimi i fjalive gramatikore të një gjuhe është një detyrë e pamundur; për më tepër listimi i fjalive gramatikore në cilëndo gjuhë është i pafundmë. U shprehëm se gjuhësia është studimi i gjuhës e si rrjedhim listimi i të dhënave gjuhësore nuk është i mjaftueshëm. Pra, duhen parime të përgjithshme për të shpjeguar të dhënat gjuhësore.

Për gjuhëtarin gjenerativ i cili përpiqet të sigurojë një përfaqësim të njohurisë së brendshme të folësit për një gjuhë të caktuar, listimi i një sërë fjalive nuk do të sillte kurrësi një përshkrim korrekt të gjuhës. Qëniet njerëzore, në rastin tonë, folësit e shqipes, kanë kujtesë të kufizuar: ndodh që të harrohen ligjërimet që dëgjojnë. Duke qenë se kapaciteti i kujtesës tonë është i kufizuar, do të ishte absurde të pretendonim se qëniet njerëzore janë në gjendje të mbajnë të gjitha fjalitë e mundshme të një gjuhe, pra një tërësi e pafundme. Për këtë arsye nuk është bindëse pohimi se njohuria e brendshme gjuhësore e njerëzve është thjesht një inventar fjalish.

Për më tepër (bazuar në studimet gjenerative) Haegeman<sup>23</sup> shprehet se qëniet njerëzore janë në një farë mënyre të pajisur me një sistem të kufizuar të njohurive, i cili mundëson ata të ndërtojnë dhe të interpretojnë një numër të pakufizuar të fjalive. Është pikërisht ky sistem i kufizuar i parimeve që është quajtur gramatika e brendshme e gjuhës. Gjuhëtari gjenerativ do të bëjë të qartë sistemin e kufizuar të parimeve që përbën kompetencën e folësit të një gjuhe.

Ndër konceptimet më të rëndësishme të Chomsky-t<sup>24</sup> është vëzhgimi se ka pafundësisht shumë fjali të mirë-formuara në çdo gjuhë natyrore. Kjo pasohet menjëherë

---

<sup>22</sup> Liliane Haegeman, *Introduction to Government and Binding Theory*, Second Edition, 1998, Blackwell Publishers Ltd, fq. 8

<sup>23</sup> *Po aty*, fq. 9

<sup>24</sup> Thomas Wasow, *The Handbook of Linguistics*, Mark Aronoff, Janie Rees-Miller, Blackwell Publishers Ltd, 2001, fq. 296

nga fakti se çdo kufi i imponuar në gjuhësinë e fjalisë mund të jetë arbitrar. Në anën tjetër, një gramatikë, e konceptuar si përshkrim i një gjuhe, duhet të jetë e fundme.

Por si mund të japim një përshkrim përfundimtar për diçka që është e pafundme? I frymëzuar nga puna e mëparshme në logjikën matematikore dhe në studimet për themelet e shkencës kompjuterike, Chomsky i është përgjigjur kësaj pyetjeje duke supozuar që gramatika është si pajisjet që vënë së bashku copa të fjalive sipas rregullave të sakta, e në këtë mënyrë “gjenerojnë” fjali të mirë-formuara. Nëse rregullat gramatikore mund të aplikohen mbi rezultatet e tyre (në zhargon teknik, nëse rregullat janë “rekursive”), atëherë është e mundur që gramatika e fundme të gjenerojë një gjuhë të pafundme.

### *1.3 Varfëria e stimullit*

Njohuria e folësit për gjuhën është e pandërgjegjshme dhe formalisht përfaqësohet si gramatika e gjuhës. Gramatika e gjuhës gjeneron fjalitë e gjuhës dhe i cakton çdo fjalie një seri përfaqësimesh të cilat paraqesin një karakterizim formal të disa prej karakteristikave të fjalisë (semantike, sintaksore, morfologjike, fonologjike, etj.). Gjuhëtarët mbështeten në materialin gjuhësor të vjelë nga ligjërimi i folësve për të ndërtuar një gramatikë sa më të qartë të gjuhës.

Për ta ilustruar shembullin për rastin e gjuhës shqipe shtrojmë pyetjen; si përftohet njohuria për gjuhën shqipe? Mund të thuhet se një teori përfiton saktësi shpjeguese kur paraqet në parim gramatikën e brendshme të folësve, pra nëse merr parasysh të zotëruarit e gjuhës. Sipas Chomsky-t<sup>25</sup> problemi i përfutimit të gjuhës është përmbledhur rreth problemit të varfërisë së stimullit. Kapaciteti ynë gjuhësor, në rastin konkret të shqipes, shkon përtej të dhënave që një folës i zotëron që fëmijëria.

Gjuhëtarët kanë për qëllim të nxjerrin në pah faktin se kompetenca gjuhësore zotërohet pavarësisht pamjaftueshmërisë/mungesës së stimullit, pra pavarësisht eksperiencës gjuhësore. Në studimet gjuhësore<sup>26</sup>, njihen tri lloje pamjaftueshmërie. E para, nuk hasim gjithmonë fjali gramatikore: ligjërimi në jetën e përditshme përbëhet edhe nga fjali të paplota, shmangie nga norma etj. Së dyti, eksperiencia, pra stimuli, është i kufizuar, ndërkohë që folësi është në gjendje të prodhojë një numër të pakufizuar fjalish. Së treti, ne zotërojmë njohuri për gjuhën tonë pa pasur nevojë të kemi të dhëna nga eksperiencia.

Wasow<sup>27</sup> shprehet se ajo që një gjuhëtar ose studiues kërkon është një sistem parimesh të njësuar, i cili është i pasur në strukturë të thellë, por nga ana tjetër me parametra të cilat janë vendosur nga eksperiencia. Mjetet e siguruar nga gramatika universale duhet të përputhen me dy kërkesa konfliktuale:

---

<sup>25</sup> Noam Chomsky, *Aspects of the Theory of Syntax*, Massachusetts Institute of Technology, 1965, fq. 58

<sup>26</sup> L. Haegeman, *Po aty*, fq. 11

<sup>27</sup> Thomas Wasow, *The Handbook of Linguistics*, Mark Aronoff, Janie Rees-Miller, Blackwell Publishers Ltd, 2001, fq. 297

1. ato duhet të jenë të pasura mjaftueshëm për të përshkruar modelet e realizuara në shumë gjuhë;

2. ato duhet të jenë mjaftueshëm të kufizuara në mënyrë që të mundësojnë përfitim të ndryshme mbi baza të gjurmëve të limituara, të cilat sigurisht që lënë shumë çështje të diskutueshme.

Problemi mund të përmblihet duke thënë se ka një hendek ndërmjet të dhënave ndaj të cilave ne ekspozohemi dhe njohurive që zotërojmë; stimuli ka të bëjë me njohurinë që merret.

#### ***1.4 Gramatika Universale***

Qëllimi përfundimtar i Chomsky-it është formulimi i teorisë së Gramatikës Universale<sup>28</sup> – UG e cila përgjithëson jo vetëm gramatikat e gjuhëve të nënvetëdijes (Internal - languages), por edhe gramatikat e të gjitha gjuhëve natyrore. Chomsky e përcakton gramatikën universale/UG si “teoria e gjuhëve njerëzore ... e cila identifikon gjuhët që përdoren nga njerëzit në kushte normale”. Me fjalë të tjera Gramatika Universale UG është teoria për natyrën e gramatikave të mundshme të gjuhëve njerëzore, e si rrjedhim kjo teori do të mund t’i përgjigjej pyetjes: “Cilët janë karakteristikat përcaktuese të gramatikave të gjuhëve njerëzore?”

Duke qenë se as mësimdhënia formale e as të dhënat ndaj të cilave ne ekspozohemi duket se nuk janë burimi i intuitës së folësit, atëherë është propozuar<sup>29</sup> që një pjesë e madhe e njohurive të folësit për gjuhën, pra gramatika e brendshme, është e lindur. Theksohet ideja se qeniet njerëzore kanë një dhunti gjenetike që i mundëson ata të mësojnë gjuhë. Është pikërisht kjo aftësi e lindur për përfitim të gjuhës (e njëjtë për të gjithë folësit e gjuhëve natyrore) që gjuhëtarët gjenerativistë duan të përshkruajnë.

Do të ishte e papranueshme të thoshim se disa ligjërues – p.sh. folësit amtarë të anglishtes kanë lindur me një gramatikë të veçantë vetëm për anglishten dhe të tjerë p.sh. folësit e shqipes kanë lindur me një gramatikë posaçërisht për shqipen. Qeniet njerëzore me karakteristika normale mendore janë në gjendje të mësojnë/zotërojnë çdo gjuhë njerëzore. Dhuntia e lindur gjuhësore funksionon për të gjitha gjuhët njerëzore dhe jo vetëm për një.

Ka një sërë kriteresh të pranueshmërisë që teoria e Gramatikës Universale duhet të përmbushë. Kriteri kryesor (i cili është i nënkuptueshëm duke gjykuar nga termi) është universaliteti, në aspektin që teoria e gramatikës universale duhet të na sigurojë mjetet e nevojshme për të siguruar një gramatikë të pranueshme nga ana përshkrimore për çdo gjuhë njerëzore.

---

<sup>28</sup> Alexander Grosu, *Review of N. Chomsky “Essays on form and interpretation”* Journal of Linguistics, 15, 1979, fq. 356-364.

<sup>29</sup> Andrew Radford, *Minimalist Syntax Exploring the Structure of English*, Cambridge Textbooks in Linguistics, 2004, fq. 2 – 7

Hipoteza sipas traditës Chomskiane përcakton se Gramatika Universale është e lindur për të gjitha qeniet njerëzore. Gramatika Universale është një dhunti gjenetike: folësit e një gjuhe lindin të pajisur me një tërësi parimesh të gjuhësisë universale. Chomsky<sup>30</sup> shprehet se “Gramatika Universale mund të mendohet si një sistem parimesh e njëjtë për qeniet njerëzore dhe në dispozicion të folësve para eksperiencës së tyre me gjuhën.

Gramatika Universale është baza për përfitimin e një gjuhe. Ajo është e njëjtë për të gjitha gjuhët njerëzore. Të gjithë dhe vetëm qeniet njerëzore janë të pajisura me Gramatikën Universale GU dhe si rrjedhim janë në gjendje të mësojnë/zotërojnë gjuhë. Sisteme të tjera (ndër to mund të përmendim, gjuha e kafshëve ose mjetet e komunikimit) nuk janë të pajisur me Gramatikën Universale GU dhe si rrjedhim nuk janë në gjendje të mësojnë gjuhë njerëzore.

#### ***1.4.1 Parametrat dhe Gramatika Universale***

Dhuntia gjuhësore e lindur Gramatika Universale GU nuk është kurrësi e mjaftueshme për të folur një gjuhë. Nëse do të ndodhte kështu, atëherë të gjithë njerëzit do të ishin në gjendje të flisnin cilëndo gjuhë pavarësisht vendit ku do të ishin lindur dhe veçanërisht mënyrës në të cilën do të rriteshin. Gjuha amtare flitet nga mjedisi ku lind fëmija. Do të ishte e pamundur që një fëmijë i cili rritet në një komunitet ku flitet shqip të jetë folës amtar i japonishtes. Haegeman<sup>31</sup> shprehet se qeniet njerëzore zakonisht zotërojnë një gjuhë me kompetencë amtare dhe e kanë të vështirë të mësojnë gjuhë të tjera më pas me të njëjtën kompetencë.

Ndërkohë që disa parime gramatikore janë universale, ka gjithashtu edhe shumë ndryshime ndërmjet gjuhëve të ndryshme. Gramatika e gjuhës shqipe ndryshon nga gramatika e gjuhëve të tjera, në aspekte të ndryshme. E thënë ndryshe, nëse njohim gramatikën e shqipes, kjo nuk mjafton për të njohur edhe gramatikën e një gjuhe tjetër, p.sh. të japonishtes. Nëse do të marrim parasysh rendin e vendosjes së gjymtyrëve në fjali në shqip dhe japonisht do të thoshim se fjalitë në shqip nuk kanë një rend të ngulitur por zakonisht do të vendosen sipas rendit kryefjalë – folje – kundrinë, ndërsa në japonisht, kundrina paraprin foljen dhe rendi i gjymtyrëve do të ishte kryefjalë – kundrinë – folje.

Shqipja dhe japonishtja janë të ngjashme për faktin se të dyja gjuhët përmbajnë fjali të cilat ndërtohen me kryefjalë, kundrina dhe folje, por ato ndryshojnë në mënyrën se si janë renditur këto elemente. Pra, hipoteza e rendit kryefjalë – folje – kundrinë, si pjesë e gramatikës së shqipes, nuk mund të përdoret si hipotezë universale, por si aspekt gramatikor i gjuhës shqipe (dhe i gjuhëve të tjera) por jo i japonishtes. Si mund të mësojë

---

<sup>30</sup> Noam Chomsky, *Lectures on government and binding: The Pisa Lectures*, Foris Publications, Dordrecht 1981, fq. 7

<sup>31</sup> Liliane Haegeman, *Introduction to Government and Binding Theory*, Second Edition, 1998, Blackwell Publishers Ltd, fq. 13

një fëmijë që gjuha shqipe ka rendin kryefjalë – folje – kundrinë? Chomsky<sup>32</sup> e ka interpretuar në këtë mënyrë. Dhuntia gjuhësore e Gramatikës Universale GU e mundëson, ndër të tjera, nocionet “kryefjalë”, “kundrinë”, “folje”. Le ta marrim të mirëqenë se këto elementë janë universale, të disponueshme në të gjitha gjuhët e botës. Kryefjala, folja dhe kundrina duhet të kenë një rend vendosjeje. Kur një fëmijë mëson një gjuhë do t’i duhet të vendosë cili rend është karakteristik për gjuhën e vet amtare.

Ekspozimi kundrejt materialit gjuhësor është një përbërës thelbësor në procesin e të mësuarit të gjuhës nga fëmija. Një fëmije do t’i duhet eksperiencë gjuhësore për të filluar të ndërtojë gramatikën e brendshme të gjuhës së tij dhe në këtë mënyrë të mburjtë njohuritë për gjuhën e tij. Pa ekspozimin e duhur fëmija nuk do të jetë në gjendje të ndërtojë gramatikën e tij të brendshme. Gramatika Universale GU është e rëndësishme në organizimin e eksperiencës fillestare gjuhësore. Gramatika Universale GU drejton mënyrën sipas të cilës fëmija do të interpretojë dhe analizojë gjuhën e vet amtare. Janë pranuar<sup>33</sup> dy karakteristika të gramatikës universale GU:

(i) GU përmban një tërësi me universale absolute, nocione dhe parime të cilat nuk variojnë nga një gjuhë te tjetra.

(ii) Ka karakteristika gjuhësore specifike të cilat nuk përshkruhen plotësisht nga GU dhe që variojnë sipas gjuhëve. Për këto karakteristika një seri zgjidhjesh mundësohen nga GU.

Parimet absolute universale janë të rrepta dhe nuk ka nevojë të mësohen. Nga kjo pikëpamje, mund të përfundojmë se zotërimi i një gjuhe nuk është vetëm si rezultat i të mësuarit. Në fakt, të pasurit e GU (pa parametra) dhe të ekspozuarit kundrejt një gjuhe është e mjaftueshme që një fëmijë të ndërtojë gramatikën e gjuhës së cilës i ekspozohet. Për këtë arsye termi “të mësuarit e gjuhës” është zëvendësuar shpesh herë me termin “të zotëruarit e gjuhës”.

Për më tepër, ekspozimi me gjuhën do të na pajisë gjithashtu me fjalorin, fjalët e gjuhës së cilës i ekspozohemi. Edhe nëse kemi njohuri të lindur të parimeve të gjuhës duhet të mësohet gjithashtu leksikoni i gjuhës, pra fjalët dhe kuptimi i tyre, në mënyrë që të jemi në gjendje të vendosim njohuritë në veprim. Në këtë mënyrë, një fëmijë shqiptar do t’i duhet të kuptojë të gjitha fjalët që formojnë një fjali të caktuar dhe të njohë edhe shumë të tjera në vazhdimësi gjatë procesit të rritjes.

Qeniet njerëzore janë të lindur me njohuri të pandërgjegjshme të gramatikës, pra me Gramatikën Universale GU. GU është një tërësi parimesh universale të gjuhës, disa prej të cilave janë rreptësisht të pandryshueshme e disa janë të parametrizuara. Prosesi i përfutimit të gjuhës është drejtpërdrejt i lidhur me eksperiencën gjuhësore të fëmijës. Ekspozimi do të aftësojë fëmijën të mësojë fjalorin e gjuhës. Përfutimi i gjuhës sipas

---

<sup>32</sup> Noam Chomsky, *Lectures on government and binding: The Pisa Lectures*, Foris Publications, Dordrecht 1981, fq. 7-11

<sup>33</sup> Liliane Haegeman, *Po aty*, fq. 15



qasjes së parametrave është baza e studimeve të tanishme në traditën gjenerative. Kjo analizë përmbledhet në teorinë e “Parimeve dhe Parametrave”.


Ka gjithashtu edhe argumentë të tjerë tipologjikë për ekzistencën e një aftësie të lindur të gjuhës. Të gjitha gjuhët në botë kanë karakteristika të përbashkëta (p.sh. të gjitha gjuhët kanë kryefjalë e folje). Këto karakteristika quhen parime universale të gjuhës. Ato ekzistojnë sepse të gjithë folësit e gjuhëve njerëzore e kanë të lindur, pra është i përbashkët materiali gjuhësor bazë për ndërtimin e gramatikës së gjuhës së tyre, pavarësisht gjuhës.

Për më tepër studimet<sup>34</sup> e fundit tregojnë se për sa i përket përvetësimit të një gjuhe nga fëmijët duket se ka ngjashmëri ndër-gjuhësore për faktin se fëmijët kalojnë nëpër të njëjtat faza dhe bëjnë të njëjtat gabime gjatë përvetësimit të një gjuhe, pavarësisht prejardhjes së tyre sociale e kulturore.

Si përfundim, ka një sërë argumentash biologjikë në favor të gramatikës universale – GU. Siç u përmend edhe më lart, zotërimi i gjuhës duket se është karakteristikë për qeniet njerëzore, me aftësi normale mendore. Kjo na shtyn të mendojmë se vetë të zotëruarit e gjuhës është një instikt.

### *1.5 Mësimi i gjuhës dhe zotërimi i gjuhës*

Nga ana skematike pikëpamjen gjenerative të përvetësimit të gjuhës mund ta paraqesim si më poshtë<sup>35</sup>:



Rreth moshës gjashtë vjeçare një fëmijë i ekspozuar kundrejt gjuhës shqipe do të ketë ndërtuar gramatikën e gjuhës shqipe. Kjo nuk do të thotë se nuk ka zhvillim të mëtejshëm në njohuritë e tij për gjuhën. Folësi amtar do të ketë mundësi të mësojë gjithashtu të gjitha lidhjet shoqërore e kulturore të lidhura me gjuhën, për shembull rasti i fjalëve që i përkasin një regjistri të lartë ndërsa të tjera i përkasin një fjalori më jozyrtar. Qëllimi i gjuhëtarëve gjenerativë është të zhvillojnë një teori të gjuhës e cila të shërbejë si model për përfitim e gjuhës.

Gjuhëtarët gjenerativë<sup>36</sup> bëjnë një dallim në lidhje me përfitim e njohurisë së vetëdijshme dhe të pavetdijshme. Njohuria e vetëdijshme (si rregullat matematikore, teoria sintaksore, parimet e kimisë organike etj) është e mësuar. Njohuria e

---

<sup>34</sup> Andrew Carnie, *Syntax: a Generative Introduction, Second Edition*, Blackwell Publishers Ltd, 2006, fq. 22

<sup>35</sup> Liliane Haegeman, *Po aty*, fq. 16

<sup>36</sup> Noam Chomsky, *Aspects of the Theory of Syntax*, Massachusetts Institute of Technology, 1965

pavetëdijshme, si të flasim ose aftësia për të parë, ecur etj është e lindur. Bazuar në parimet e hershme të Chomskit (1965) Carnie<sup>37</sup> ka përblehur rregullat e mëposhtme:

- (i): Sintaksa është një sistem produktiv, rekursiv dhe i pafundëm
- (ii): Rregullat të cilat përcaktojnë sistemet e pafundme janë të lindura dhe nuk mësohen.

Përfundimi: Si rrjedhim sintaksa është për folësit e një gjuhe një sistem i cili nuk mësohet, duke qenë se një pjesë e rregullave të saj janë për folësit të lindura.

Në vazhdim të studimeve gjenerative Prada<sup>38</sup> shprehet se gjuha:

a) Ka një strukturë modulare dmth që përpunimi i fjalisë realizohet në mënyrë të njëpasnjëshme nga module që veprojnë secili në një aspekt të caktuar (si ai sintaksor, morfologjik, semantik, fonologjik).

b) Ka funksion sintagmatik që ka për qëllim të organizojë elementët gjuhësorë në grupe të quajtura sintagma – të drejtuara nga elementi kokë, që paraqesin karakteristika të tilla që përcaktojnë sjelljet sintaksore; psh. *Qeni i kuq* përbën një grup të caktuar ku elementi kokë është ndërtuar nga një emër *qeni* dhe i gjithë segmenti sintaksor përcaktohet si emëror, pra kemi të bëjmë me një sintagmë emërore.

c) Të jetë rekursive sepse parashikon që rregullat sintaksore mund të përdoren njëra pas tjetrës duke krijuar struktura të gjata; psh. mund t'i shtojmë një emri sintagma të tjera në vazhdim si: *Djali i Mirës; djali i kushurirës së Mirës; djali i tezes së kushurirës së Mirës* etj. Zgjerimi i mëtejshëm i fjalisë mund të ndërpritet nga aftësitë njohëse (cognitive) të vetë folësit dhe dëgjuesit.

d) Ndjek një logjikë hierarkike për sa elementët për të cilat zbatohen rregullat gramatikore – konstituenti ose sintagma, siç do të shohim - organizohen në grupe të shkallëve të ndryshme. Psh. në fjalinë *Ajo vajza me syzet me skelet prej kocke* është e thjeshtë të gjesh grupe fjalësh/sintagma të ndryshme si sintagma *ajo vajza* dhe *skelet prej kocke*. Duke analizuar fjalinë do të pohojmë në mënyrë intuitive se *me syze* është në një farë mënyre e varur nga *ajo vajza*. Ashtu sikur edhe *me skelet* varet nga *me syzet* dhe (jo direkt nga *ajo vajza*) *prej kocke* varet nga *me skelet* (dhe jo direkt nga *ajo vajza me syzet*).

### **1.6 Elementë të zakonshëm formalë**

Shumë teori të ndryshme gramatikore i janë përshtatur karakterizimit të përgjithshëm që prej fillimit të studimit të Chomsky-t në vitet 1950. Pothuajse të gjitha mund të shihen si shtesa të asaj që njihet si "contextfree grammar (CFG) (struktura e sintagmës)".

---

<sup>37</sup> Andrew Carnie, *Po aty*, fq. 14-15

<sup>38</sup> Massimo Prada, *Annotazioni di sintassi generativa*, tërhequr më 05.06.2014 nga [http://webcen.di.unimi.it/2002-03/comdig/lingua\\_italiana2/files/248327.Sintassi%20generativa.pdf](http://webcen.di.unimi.it/2002-03/comdig/lingua_italiana2/files/248327.Sintassi%20generativa.pdf)

### **1.6.1 Context-free grammar – Gramatika jo kontekstuale**

CFG<sup>39</sup> fillon me supozimin relativisht të pakundërshtueshëm se fjalët mund të klasifikohen në kategori, bazuar në karakteristikat e tyre morfologjike (që do të thotë, ndryshimet që ato pësojnë nga fjalëformimi), modelet e tyre shpërndarëse (që ka të bëjë me fjalët e tjera që shfaqen/realizohen pranë tyre në fjali), dhe kuptimet e tyre.

Kategoritë tradicionale të emrit, foljes, etj (të trashëguara nga studimet gramatikore të Greqisë së lashtë) janë ende mëse të përdorshme dhe në përgjithësi të plotësuara me kategori të tjera.

Një premisë e dytë përgjithësisht e pranuar e CFG është se fjalët në fjali janë të grupuara në sintagma, të cilat vetë janë të grupuara së bashku në sintagma më të mëdha, dhe kështu me radhë.

Sintagmat identifikohen nga modelet e tyre të shpërndarjes dhe zakonisht funksionojnë edhe si njësi semantike në të njëjtën kohë. Ashtu si fjalët, sintagmat klasifikohen në përgjithësi në kategori; kategoritë më të përdorshme janë – psh. sintagma emërore (SE/NP), sintagma foljore (SF/VP), sintagma parafjalore (SP/PP) – të cilat rrjedhin nga kategoritë e fjalëve që shfaqen si bazë. Këto fjalë janë “kokat leksikore” (ose ndonjëherë vetëm "kokat") të sintagmave.

Wasow<sup>40</sup> shprehet se një CFG ka dy pjesë:

- Një leksikon, i përbërë nga një seri fjalësh, të shoqëruara nga kategoritë e tyre gramatikore (të referuara si “kategori leksikore”).
- Një grup i rregullave në formën A → B ku A është një kategori sintagmatike dhe B → C qëndron për çdo varg të kategorive leksikore dhe/ose frazore. Shigjeta tregon kuptimin që A → B mund të përbëhet nga B. Këto rregulla janë quajtur "rregullat e strukturës sintagmatike".

Ana e majtë e çdo rregulli specifikon llojin e sintagmës (duke përfshirë fjalinë si një lloj sintagme), dhe ana e djathtë jep një model të mundshëm për atë lloj sintagme. Për arsye se kategoritë sintagmatike mund të shfaqen në anën e djathtë të rregullave, është e mundur që të kemi sintagma të ngulitura brenda sintagmave të tjera. Në fakt, disa lloje sintagmash (si NP dhe PP mund të jenë të përfshira në sintagma të tjera të të njëjtit lloj, duke i dhënë CFG karakterin rekursiv të nevojshëm për të gjeneruar gjuhë të pafundme.

Një CFG ka normalisht një ose më shumë kategori sintagmatike që cilësohen si "simbolet e para." Këto janë llojet e sintagmave që mund të qëndrojnë vetë si fjali në gjuhë. Shumica CFG të thjeshta kanë vetëm një simbol të parë, të cilësuar "S".

Gjuha e gjeneruar nga gramatika është thjesht një përmbledhje e të gjitha fjalive që gjenerohen. Wasow<sup>41</sup> shprehet se CFG-së i mungon fuqia përshkruese për të shpjeguar të gjitha rregullat sintaksore të gjuhëve natyrore. Pavarësisht se janë ngritur pyetje të

---

<sup>39</sup> Thomas Wasow, *Po aty*, fq. 300-303

<sup>40</sup> Wasow, *Po aty*, fq. 301

<sup>41</sup> Wasow, *Po aty*, fq. 301

herëpashershme për disa prej këtyre çështjeve, përgjithsisht përfundimi mbetet i pranuar nga gjuhëtarët.

### ***1.6.2 Gramatika Transformuese***

Studime të hershme të Chomsky-it sugjerojnë se të metat e Context-Free-Grammar mund të rregullohen duke bërë ilustrimin e çdo fjalie të një gjuhe natyrore, jo vetëm me një pemë strukturore, por me një sekuencë të pemëve strukturore. Pema e parë në çdo sekuencë do të gjenerohet nga një Context-Free-Grammar (e quajtur shpesh si “baza”) dhe pemët e mëvonshme do të rrjedhin nëpërmjet një seri transformimesh - domethënë, rregullat që modifikojnë pemët në mënyra të përcaktuara saktësisht<sup>42</sup>.

Këto studime të hershme gjenerative u njohën si "gramatikë transformuese", sepse përveç transformimeve që pësoi CFG, ajo u cilësua si një risi vendimtare.

Gjatë gjithë historisë së gramatikës gjenerative, teoritë transformuese kanë pasur shumë avokatë - gjithmonë duke përfshirë dhe vetë Chomsky-in. Megjithatë, që nga fundi i viteve 1970 alternativat jotransformuese janë zhvilluar gjerësisht.

### ***1.6.3 Programi Minimalist***

Nocioni “minimalizëm” përfaqëson studimet më të fundit në punën e Chomsky-it<sup>43</sup>. Këto studime janë përmbledhur në Programin Minimalist – i cili është kulmimi logjik i një programi kërkimor ambicioz, që i ka fillimet e tij rreth fillimeve të ‘50, megjithëse ndoshta ishte shumë revolucionar për t’u kuptuar në atë kohë. Duke gjykuar dhe vlerësuar Programin Minimalist me studimet më të hershme mbi gjenerativizmin mund të themi se Chomsky nuk e ka ndryshuar vizionin e tij, ndonëse ai mund të ketë ndryshuar mendje herë pas here. Lasnik<sup>44</sup> shprehet se është e rëndësishme të themi se konteksti ka ndryshuar në mënyrë thelbësore; disiplina gjuhësore (disa prej tyre as që nuk ekzistonin para pesë dekadave) tashmë pranojnë vlerësimet e guximshme (për atë kohë) të Chomsky-it mbi natyrën e gjuhës.

Konkretisht, Programi Minimalist nuk është thjesht një program rregullash, por është një mënyrë për të parë çështjet gjuhësore nga një perspektivë intriguese. Kuadri i parimeve dhe i parametrave i dha shtysë ngritjes së minimalizmit. Mund të përmendim ndërveprimet ndërmjet leksikonit dhe sistemit kompiuterik të gjuhës njerëzore, dy

---

<sup>42</sup> Mark Baker, *The Handbook of Linguistics*, Mark Aronoff, Janie Rees-Miller, 2001, Blackwell Publishers Ltd

<sup>43</sup> Noam Chomsky, *The Minimalist Program*. (Current Studies in Linguistics 28.) Cambridge, MA: MIT Press, 1995.

<sup>44</sup> Howard Lasnik, tërhequr më 30. 05. 2014 nga

[http://www.blackwellpublishing.com/content/BPL/Images/Content\\_store/Samplechapter/978063\\_1199\\_878/Lasnik\\_sample%20chapter\\_A%20course%20in%20minimalist%20syntax.pdf](http://www.blackwellpublishing.com/content/BPL/Images/Content_store/Samplechapter/978063_1199_878/Lasnik_sample%20chapter_A%20course%20in%20minimalist%20syntax.pdf)

aspekte të mëdha të teorive si klasike dhe bashkëkohore. Këto dy aspekte i korrespondojnë fjalorit tradicional dhe gramatikës së gjuhës, por forma e duhur për secilën prej tyre është dhënë në varësi të faktorëve të ndryshëm teorikë.

Sipas Lasnik-ut, rreth fundit të viteve '60, gramatikat kuptoheshin si grupe rregullash për të ndërtuar strukturën e frazës, duke ndryshuar atë në mënyra të kufizuara (transformimet). Kjo ishte në thelb një dëshirë për të kufizuar ato që mendoheshin si rregulla të mundshme në atë kohë, në mënyrë që të shpjegojë më mirë se si të gjithë fëmijët e përfitojnë gjuhën në mënyrë kaq të shpejtë, e që si rrjedhim e drejtoi Chomskin në nocionet e përgjithshme të parimeve dhe parametrave<sup>45</sup>.

Analizat gramatikore në vazhdim kanë pasur tendencën të reduktojnë mekanizmat që lindin si pasojë e ndërveprimeve në kushte shumë abstrakte. Kështu, për shembull, në vend të rregullave të veçanta transformuese për formimin e pyetjeve, rendit të fjalëve ose të bashkërenditjes, mjeti gramatikor/ gramatika mendohet se përbën një transformim të vetëm në bazë të kufizimeve të përgjithshme; nga ana tjetër, variacionet e veçanta gjuhësore përcaktohen nga parametra të drejtimit dhe vendit (lokalitetit)<sup>46</sup>. Mbetet pra të themi që rregullat tradicionale u shndërruan në një aparat të thjeshtë taksonomik.

### ***1.7 E ardhmja e Gramatikës Gjenerative***

Pavarësisht nga shumëllojshmëritë e teorive gjenerative të prezantuara deri më tani, kjo fushë është dominuar gjatë gjithë historisë së saj nga puna e një gjuhëtari, Noam Chomsky-t<sup>47</sup>. Ai ishte themeluesi i saj dhe rrjedha kryesore e mëtejshme e kërkimit gjenerativ ka ndjekur gjithmonë shembullin e tij.

Madje edhe ithtarët e teorive alternative të tilla si qasjet jotransformuese në përgjithësi kanë marrë studimet e Chomsky-it si pikë të nisjes për propozimet e tyre.

Në vitet e para të gramatikës gjenerative, kjo fushë studimore do të lëvrohej në masë të madhe nga Chomsky, studentët dhe bashkëpunëtorët e tij. Megjithatë, gjatë dekadave në vazhdim, numri i gjuhëtarëve gjenerativë është rritur në mënyrë të ndjeshme. Nën këto rrethana, është më se e dukshme se Chomsky ka ruajtur pozitën e tij dominuese. Por ka të ngjarë që me studimet në vazhdim kjo përfundimisht të ndryshojë.

Thomas Wasow<sup>48</sup> shprehet se duke pasur parasysh tregun e mbingopur me punë akademike, ka ardhur duke u rritur numri i gjuhëtarëve që kërkojnë punë në industri. Kjo e vë në presion fushën në fjalë për t'i dhënë më shumë vëmendje zbatimeve të mundshme të teorive të saj. Zbatimi më i mundshëm në studimet e gramatikës gjenerative

---

<sup>45</sup> Noam Chomsky, Howard Lasnik, *Filters and Control, Linguistic Inquiry*, Vol. 8, No. 3 (Summer, 1977), The MIT Press fq. 425-504

<sup>46</sup> Howard Lasnik, J. Uriagereka. *A Course in GB Syntax: Lectures on Binding and Empty Categories*. MIT Press 1988

<sup>47</sup> Thomas Wasow, *The Handbook of Linguistics*, Mark Aronoff, Janie Rees-Miller, Blackwell Publishers Ltd, 2001, fq. 317

<sup>48</sup> *Po aty*, 317

do të ishte në zhvillimin e teknologjive të gjuhëve natyrore – që do të thotë, programe kompjuterike që kanë të bëjnë me gjuhët e njeriut, p.sh., duke bërë përkthim mekanik, tërheqje të informacionit nga tekste, përmbledhjen e teksteve e zbatime të tjera të ngjashme me to.

Për më tepër ai shton se duke pasur parasysh shumëllojshmërinë dhe masën e madhe të përdorimeve dhe për më tepër ndikimin që këto përdorime kanë duke motivuar punën teorike, ka mendime që zbatimet kompjuterike mund të luajnë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e teorive gjuhësore. Po kështu, zbatime të tilla bëjnë thirrje për të parë se si njerëzit në të vërtetë e përdorin gjuhën, në vend të nxjerrjes në pah apo fokusimit vetëm në atë që është gramatiksht e mundur.

Studimi kërkimor i të dhënave reale të përdorimit të gjuhës është lehtësuar në masë të madhe nga disponueshmëria e teksteve të dixhitalizuara, të cilat mund të modelohen dhe analizohen me mjete kompjuterike që nuk ekzistonin deri vonë. Kjo tashmë ka një efekt të dukshëm mbi llojet e të dhënave të përdorura nga gramatikanët gjenerativë në argumentet e tyre teorike.

Këto ndryshime të mundshme nuk duhet të jenë shqetësuese. Historia e gramatikës gjenerative është e përbërë nga “kryengritje” të shumta, siç është shprehur dhe vetë Chomsky në punën e tij. Këto kryengritje janë shoqëruar me debate të fuqishme dhe konkurrencë të gjallë nga kornizat alternative. Rezultati ka qenë – dhe premton të jetë – një linjë e fuqishme e hulumtimit që ka pasuruar në masë të madhe të kuptuarit tonë për aftësitë gjuhësore të njeriut.

## KREU II

### SINTAKSA – SHKENCA E NJOHJES NJERËZORE

#### *2.1 Sintaksa si shkencë e njohjes njerëzore të rregullave sintaksore*

Disiplina e gjuhësisë, ashtu si psikologjia, filozofia dhe shkencat kompiuterike formojnë nëndisiplina të shkencës së njohjes. Në këtë disiplinë fjalitë shërbejnë si mjeti për të shprehur nocionet, kështu që studimi i sintaksës është një bazë e rëndësishme për të kuptuar se si komunikojmë dhe ndërveprojmë me njëri-tjetrin, pra si e shprehim atë që njohim me anë të rregullave sintaksore. Kjo është dhe arsyeja që sintaksa konsiderohet si shkencë e njohjes njerëzore, sepse njeriu zotëron/njih në mënyrë të pavetëdijshme rregullat sintaksore të gjuhës së tij, kurse sintaksiologu i zbulon këto rregulla e i bën të vetëdijshëm folësit e një gjuhe për ekzistencën e këtyre rregullave.

Sipas Carnie<sup>49</sup> teoria më dominante e sintaksës është ajo e Noam Chomsky-t dhe idhtarëve të tij, e cila, siç e përmendëm edhe më lart, i ka fillimet në mes të viteve 1950 dhe vazhdon edhe sot. Kjo teori ka pësuar shumë ndryshime ndër vite, por të gjitha përfshihen nën një çadër të vetme të quajtur Gramatika Gjenerative. Baza e gramatikës gjenerative është se fjalitë gjenerohen nga një tërësi procesesh të pavetëdijshme (si program kompiuterik). Këto procese janë pjesë e mendimit, e aftësive tona njohëse në mënyrë të pavetëdijshme. Qëllimi i sintaksës është të përshkruajë këto procese. Çfarë njohin qeniet njerëzore në mënyrë të pavetëdijshme për gjuhën amtare në përgjithësi dhe sintaksën e gjuhës së tyre, në veçanti. Në gramatikën gjenerative mjetet për modelimin e këtyre proceseve janë një tërësi me rregulla gramatikore formale. Në këto raste gjuhëtari gjenerativist i zbulon këto rregulla dhe duke i zbuluar ato, provon se gjuha funksionon mbi bazën e këtyre rregullave. Qëllimi i gjuhëtarit, në rastin tone i sintaksologut, nuk është të diktojë si duhet shkruar një fjali, por në fakt të përshkruajë si shkruhet në ligjërimin aktual një e tillë.

---

<sup>49</sup> Andrew Carnie, *Syntax: a Generative Introduction, Second Edition*, Blackwell Publishers Ltd, 2006, fq. 4-5

Gjuhëtarët<sup>50</sup> formulojnë përgjithësime për materialin gjuhësor, pra për gjuhën. Sipas kësaj pikëpamjeje, një gjuhëtar do të përcaktojë parimet për formimin e një gjuhe të caktuar. Qëllimi është të sigurojë një përshkrim sistematik të formimit të fjalive, pra gramatikën e gjuhës në fjalë.

## **2.2 Leksikoni – fjala dhe konstituenti**

Fjalët, si pjesë ligjërata, luajnë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e fjalisë. Kjo ndodh sepse ato bartin një informacioni leksikor të caktuar. Informacioni leksikor është burimi i një sërë dukurive gjuhësore. Një leksikon për një gjuhë është një listë me njësitë leksikore të asaj gjuhe, të organizuara dhe të strukturuar me anë të kriterëve të përshtatshme.

Fjalët<sup>51</sup> u përkasin njësive sintaksore të ndryshme si emri, folja etj; vetë njësia sintaksore përcakton shpërndarjen e saj në varësi të kontekstit ku vendoset fjala. Normalisht folësi i një gjuhe nuk mund të shkëmbejë me lehtësi në të njëjtën pozicion sintaksor fjalët e një njësie sintaksore me fjalët e një njësie sintaksore tjetër në një fjali. P.sh. nëse do të provonim të shkëmbejmë foljen “takoj” me emrin që rrjedh prej saj, pra “takim” si në (1) atëherë nuk do të kishim një fjali të mirëformuar:

- (1) \*Agimi takim shokët në bibliotekë.

Gramatika e gjuhës shqipe, ashtu si e të gjitha gjuhëve, e përmban informacionin e njësive sintaksore që lidhet me njësitë leksikore duke qenë se ky informacion luan një rol të rëndësishëm në formimin e fjalive. Sipas gjenerativizmit informacioni sintaksor është në mendjen e folësve të gjuhës; është e kuptueshme nga folësit që fjalia në (1) është e papranueshme për shkak të përdorimit të gabuar të emrit “takim”. Gjuhëtarët shprehin se folësit e një gjuhe janë të pajisur me një “fjalor” të brendshëm të gjuhës, i cili mund të quhet edhe leksikoni mendor ose leksikoni, që përmban të gjithë informacionin që ata zotërojnë në lidhje me fjalët e gjuhës amtare. Ky leksikon mendor përmban ndër të tjera edhe informacionin për njësitë sintaksore. Haegeman shton se për çdo fjalë të një gjuhe përkatëse folësi liston në leksikonin e tij mendor specifikimet kategoriale ose të pjesëve të ligjërates.

---

<sup>50</sup> Liliane Haegeman, *Introduction to Government and Binding Theory*, Second Edition, 1998, Blackwell Publishers Ltd, fq. 4

<sup>51</sup> Liliane Haegeman, *Introduction to Government and Binding Theory*, Second Edition, 1998, Blackwell Publishers Ltd, fq. 37



Sipas studiueses Casadio<sup>52</sup> (1999) ka të paktën katër lloje të ndryshme informacioni që ndërtojnë njësinë leksikore dhe e lidhin leksikonin me nivelet e tjera gramatikore, në veçanti me fonologjinë dhe sintaksën:

**LLOJET E INFORMACIONIT LEKSIKOR**

Karakteristika fonologjike: tingujt, shkronjat...

Karakteristika morfologjike: eptimi, formimi ...

Karakteristika semantike: të brendshme, tematike, funksionale ...

Karakteristika sintaksore: nënkategorizim, marrëveshje, rasa .,

**SPECIFIKIME TË KARAKTERISTIKAVE**

Karakteristika të marrëveshjes: veta, gjinia, numri, rasa ...

Karakteristika të brendshme: human, frymor, abstrakt, kolektiv ...

Karakteristika kontekstuale: XP, YP ...

Karakteristika tematike: rolet (agjent, veprues)

Për ta konkretizuar, folja *shkatërroj* dhe emri që rrjedh prej kësaj foljeje, përkatësisht *shkatërrim* lidhen në mënyrë leksikore, por kemi ndryshim përsa i përket distribucionit sintaksor<sup>53</sup>: të dy fjalët u përkasin kategorive F (folje) dhe E (emër), për më tepër ato ndajnë karakteristika thelbësore semantike, të lidhura me konceptin e shkatërrimit (veprimi i të rrëzuarit/prishurit të diçkaje). Çdo njësi sintaksore përcaktohet në bazë të një grupi informacionesh që kanë të bëjnë me karakteristikat sintaksore, semantike, fonologjike.

djalë [+E], [+frym, +numr], [+hum, -abs], [+Konkr]

lexoj [+F], [+kalim], [F, -frym]

Por do të ishte e pamjaftueshme dhe e pasaktë të thoshim se njohuria leksikore e folësit të një gjuhe amtare është plotësisht e lindur. Nëse njohuria leksikore do të ishte e lindur, atëherë qeniet njerëzore do të ishin të pajisur që në lindje me leksikone të të gjitha gjuhëve të mundshme njerëzore.

Gjuhëtarët gjenerativë mendojnë se leksikoni i një gjuhe është i mësuar nga folësit e një gjuhe amtare. Folësi mëson fjalët e një gjuhe dhe kategorinë gramatikore të cilës i përket fjala. Por kjo nuk do të thotë se ai përballet me procesin e të mësuarit plotësisht i

---

<sup>52</sup> Claudia Casadio, *Minimalism and the logical structure of the lexicon*, tërhequr në 18.06.2014 nga <http://citeseer.uark.edu:8080/citeseerx/viewdoc/summary;jsessionid=99C6B85D18D7C7D94E5814AF329950A6?doi=10.1.1.27.2110>

<sup>53</sup> Noam Chomsky, *Remarks on Nominalization*, në R. Jacobs and P. Rosenbaum (eds.), *Readings in English Transformational Grammar*, Waltham, Mass.: Ginn, 1970, fq. 184-221 tërhequr në 18.06.2014 nga <http://citeseer.uark.edu:8080/citeseerx/viewdoc/summary;jsessionid=99C6B85D18D7C7D94E5814AF329950A6?doi=10.1.1.27.2110>

papërgatitur. Mendohet se Gramatika Universale GU, njohuria jonë e brendshme e gjuhës, përmban, p.sh. nocionin e kategorisë/njësisë sintaksore. Gjatë ekspozimit me fjalët e një gjuhe të caktuar, folësit do të kenë disa pritshmëri të brendshme për mënyrën e organizimit të fjalëve në gjuhën e tyre.

Haegeman<sup>54</sup> ka dhenë shembujt e mëposhtëm ku vendosja e rastësishme e emrave në fjalitë si më poshtë do të gjenerojë fjali të gabuara si rasti në (2b):

- (2a) Agimi do të takojë shokët e tij në bibliotekë.
- (2b) \*Agimi do të takojë bibliotekën e tij në shokë.

Folësi amtar i shqipes do të shprehej se (2b) është e pasaktë sepse folja “takoj” ndiqet nga sintagma emërore SE “bibliotekën e tij”. Pasaktësia qëndron në faktin se koncepti i foljes “takoj” përfshin një ndërveprim ndërmjet dy pjesëmarrësve frymorë, ndërsa koncepti “bibliotekën e tij” i referohet një jofrymori që nuk pritet të marrë pjesë në veprimin që përshkruan folja “takoj”. Fakti që fjalia (2b) është e gabuar nuk ka të bëjë vetëm me anën gramatikore. Mbi të gjitha pasaktësia e saj ka të bëjë me njohurinë tonë mbi botën. Vetëm në një botë imagjinare do të prisnim që dikush të *takohej me bibliotekën*.

Haegeman shprehet se çështje të përdorimit të gjuhës ku kemi të bëjmë me ndërveprimin ndërmjet gramatikës dhe informacionit ndër-gjuhësor si fjalia e përshkruar më lart nuk duhet të jenë pjesë e përshkrimit gramatikor. Gramatikat nuk përmbajnë parime për pikëpamjet/besimet e njerëzve/folësve të gjuhës. Kështu (2b) mund të konsiderohet si fjali gramatikore, por e pasaktë për sa i përket njohurisë së përgjithshme se *bibliotekat* nuk janë frymorë.

### ***2.3 Gramatika e strukturës së konstituentit***

Rregullat e strukturës së sintagmës të gramatikës gjenerative përcaktojnë marrëdhëniet gramatikore me bazë konstituentin. Ato e bëjnë të qartë dominimin e konstituentit, pra këto rregulla shprehin qartazi kushtet universale, karakteristike për “gjuhën njerëzore”<sup>55</sup>. Bëhet fjalë për marrëdhëniet strukturore ndërmjet konstituentëve të sintagmës, për të cilat do të flasim më gjerazi në vazhdim në kreun III.


Një pemë ka një strukturë hierarkike që do të thotë se një nyjë (node) **dominon** nyjet (nodes) që janë vendosur poshtë saj. “Dominimi” gjithashtu tregon se si një konstituent më i madh mund të përbëhet nga më shumë konstituentë më të vegjël. Është gjithashtu e rëndësishme të theksojmë se edhe struktura e pemës ruan rendin linear të

---

<sup>54</sup> Liliane Haegeman, *Introduction to Government and Binding Theory*, Second Edition, 1998, Blackwell Publishers Ltd, fq. 38

<sup>55</sup> Noam Chomsky, *Aspects of the Theory of Syntax*. Cambridge, MIT Press 1957, dhe Noam Chomsky, *Syntactic Structures*, The Hague/Paris: Mouton. 1965

konstituentëve. Sintagma e parë emërore i *paraprin* sintagmës foljore e cila i *paraprin* sintagmës së dytë emërore. Nyjat ose përemrat paraprijnë emrat. “Paraprirja” ashtu si “dominimi” tregohet në pemën strukturore. Lidhur me këtë, Graffi<sup>56</sup> thekson se lidhjet sintaksore tregohen materialisht në bazë të suksesionit (rrjedhës) të fjalëve, por nuk janë të shpjgueshme vetëm mbi këtë bazë: pra, në bazë të faktit që një fjalë *x* duhet (ose nuk duhet) të ndjekë një fjalë *y*. Lidhjet sintaksore bazohen mbi një strukturë. Një teori sintaksore do të kërkojë pikërisht të përcaktojë këtë strukturë dhe nuk do të shqetësohet tepër të përcaktojë një sintagmë, sesa të qartësojë motivet se përse një sintagmë është gramatikore dhe një tjetër nuk është e tillë. Sintagma foljore SF *ndoqi një mace* do të ilustruhet në pemën strukturore si më poshtë:



Pema 1: *SF ndoqi një mace*

Pemët e strukturës së sintagmës tregojnë lidhjet ndërmjet elementëve parësorë (fjalëve) që krijojnë konstituentët dhe gjithashtu tregojnë lidhjet ndërmjet konstituentëve që formojnë sintagma. P.sh. sintagma foljore SF paraqitet si një konstituent i formuar nga folja F dhe një tjetër konstituent që paraqitet si sintagmë emërore SE *një mace* e cila përbëhet nga përemri i pacaktuar Për. *një* dhe emri E *mace*.

Formimi i strukturave të organizuara hierarkike të konstituentëve si pasojë e lidhjes së fjalëve dhe e sintagmave kalon në një sërë modelesh gjuhësore që ndryshojnë në aspekte të ndryshme (p.sh. Chomsky, 1965; Bresnan, 2001; Pollard dhe Sag, 1994; Steedman, 2000; Goldberg, 1995; Frank, 2002)<sup>57</sup> dhe luan një rol të rëndësishëm në shpjegimin e shumë fenomeneve gjuhësore. Ndër modelet kryesore të cilat gjejnë përshtatshmëri në gjuhën shqipe do të jenë:

<sup>56</sup> Hysnie Hyska, Punim Masteri, Dorëshkrim “*Sintagma Emërore në Gjuhën Shqipe*”, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Departamenti i Gjuhës Shqipe, Tiranë 2009 fq. 10

<sup>57</sup> Colin Phillips, Matthew Wagers, *Constituent Structure and the Binding Problem* tërhequr më 02.06.2014 nga <http://ling.umd.edu/~colin/research/papers/phillips2005-bbs.pdf> me referencë nga Chomsky, N. (1965). *Aspects of the theory of syntax*. Cambridge, Mass.: MIT Press, Bresnan, J. (2001). *Lexical-functional syntax*. Oxford: Blackwell, Pollard, C. & Sag, I. A. (1994). *Head-driven phrase structure grammar*. Stanford, CA: CSLI Publications, Steedman, M. (2000). *The syntactic process*. Cambridge, Mass.: MIT Press, Goldberg, A. (1995). *Constructions: A construction grammar approach to argument structure*. Chicago: University of Chicago Press, Frank, R. (2002). *Phrase structure composition and syntactic dependencies*. Cambridge, Mass.: MIT Press.

(i) Rregullat e bashkërenditjes. Në shumicën e rasteve, kategori të njëjta mund të kombinohen dhe të formojnë përbërës më të mëdhenj të së njëjtës kategori: emrat të bashkërenditen me emra, foljet me folje, sintagmat foljore me sintagma foljore, sintagmat emërore me sintagma emërore etj. Në fjalinë, *Mësuesit dhe nxënësit që mbështetën grevën*, kemi të bëjmë me një sintagmë emërore në të cilën pjesa/fjalja e nënrenditur mund të plotësojë vetëm *nxënësit* ose të dyja *mësuesit* dhe *nxënësit*.

(ii) Marrëdhëniet anaforike. Gjuhët natyrore kanë përdorim të gjerë të shprehjeve anaforike që interpretohen ndryshe si shprehjet e zëvendësimit ose rimarrja e kuptimit të një konstituenti tjetër në fjali ose ligjërim. Përemrat si *ai* ose *ata* mund t'i referohen një konstituenti tjetër sintagmë emërore SE në fjalinë ku realizohen; gjithashtu forma të tilla si *po ashtu*, *gjithashtu*, janë shprehje anaforike të një sintagme foljore si në rastin *Ai iku, po ashtu edhe unë* Phillips dhe Wagers shprehen se në raste të tilla është vështirë të dallosh varësinë duke qenë modele ku mungojnë konstituentë të organizuar në mënyrë hierarkike<sup>58</sup>.

(iii) Varësitë në distancë të hasura në pyetje, në fjali nënrenditëse, forma joveprore dhe struktura të përziera, vazhdimisht kërkojnë realizimin e një konstituenti në një pozicion jo të zakonshëm si në rastin e sintagmës foljore SF *them se Agimi do të vijë* ku folja *them* plotësohet me një konstituent të shprehur me fjali kundrinore që kryen një funksion të ngjashëm me atë të një kundrine. Është e vështirë të formulosh këto rregulla pa përdorimin e konstituentëve.

### **2.3.1 Gramatika e konstituentit vs. gramatika e varësisë**

Ka dy mënyra për të përshkruar strukturën e fjalisë në gjuhët natyrore: a) duke i ndarë fjalitë në konstituentë, të cilët mund të ndahen më pas në konstituentë më të vegjël, që ka të bëjë me gramatikën e konstituentit dhe b) duke bërë lidhjen mes fjalëve si përbërës më vete, që ka të bëjë me gramatikën e varësisë<sup>59</sup>. Siç e përmendëm edhe më lart gramatika e konstituentit është sjellë për herë të parë nga Stoikët e hershëm prej të cilëve kaloi përmes logjikës formale të gjuhëtarë si Leonard Bloomfield, Rulon Wells, Zellig Harris dhe Noam Chomsky. Ajo është gjithashtu baza e një teorie formale të gjuhësisë kompiuterike.

Nga ana tjetër gramatika e varësisë ka shfaqje të hershme në kohë të përcjella nga gjuhëtarë të ndryshëm evropianë si Tesnière (1959), Sgall (1986) dhe Mel'uk (1988)<sup>60</sup>.

---


<sup>58</sup> Colin Phillips, Matthew Wagers, *Po aty*.

<sup>59</sup> Michael A. Covington, *A Fundamental Algorithm for Dependency Parsing*, Proceedings of the 39th Annual ACM Southeast Conference (2001), ed. John A. Miller and Jeffrey W. Smith, pp. 95–102. e tërhequr më 02.06.2014 nga <http://www.stanford.edu/~mjkay/covington.pdf>

<sup>60</sup> Lucien Tesnière, *Éléments de syntaxe structurale*. Librairie Klincksieck, Paris 1959, Sgall P., Haji. cová E., Panevová J., Mey J. L. (eds.) (1986) *The Meaning of the Sentence in its Semantic and Pragmatic Aspects*. Academia, Prague, Mel'uk I. (1988) *Dependency Syntax: Theory and Practice*. State University of NY Press, Albany.

Baza e gramatikës së varësisë qëndron në faktin që sa herë dy fjalë lidhen në marrëdhënie varësie, themi se një prej tyre është koka dhe tjetri është përbërësi i varur. Në përgjithësi, përbërësi i varur është modifikuesi, kundrinori ose plotësori; koka luan rolin kryesor për përcaktimin e mënyrës që do të realizohet veprimi në grupin e përbërësve. Për sa i përket zbatimeve kompiuterike të gramatikës së varësisë, pavarësisht faktit që gjuhëtarë<sup>61</sup> të ndryshëm kanë shprehur interes, përsëri pak studim kemi në lidhje me analizën gramatikore të varësisë.


Convigton<sup>62</sup> na ka sjellë si më poshtë mënyrën e paraqitjes në pemën strukturore të gramatikës së konstituentit dhe gramatikës së varësisë:



Pema 2: Pema e konstituentit

<sup>61</sup> Hays, David G. (1964) Dependency theory: a formalism and some observations. *Language* 40:511–525, (1966) *Readings in Automatic Language Processing*. New York: American Elsevier, Sgall, Peter (1994) Dependency-based formal description of language. In *The Encyclopedia of Language and Linguistics*, ed. R. E. Asher, vol. 2, 867–872. Oxford: Pergamon Press.

<sup>62</sup> Michael A. Covington, *Po aty*, fq. 1-2



Pema 3: Pema e varësisë

Gjuhësia gjenerative është dominuar që prej gjysmës së shekullit të kaluar nga formalizmi gramatikor që bazohet në gramatikën e konstituentit. Megjithatë, rregullat e ngritura duke u bazuar në gramatikën e varësisë janë gjithashtu të hershme<sup>63</sup>. Në ditët e sotme gramatika gjenerative është përqëndruar në kombinimin e dy gramatikave - pra asaj të konstituentit dhe asaj të varësisë duke përfutur prej elementëve të të dyjave.

Mark Dras etj. shprehet se metodat për kombinimin e gramatikës së varësisë dhe gramatikës së konstituentit mund të kategorizohen në tri klasa të gjera. Së pari, ka raste të përdorimit të gramatikës së varësisë të kombinuara me ato të gramatikës së konstituentit për arsye praktike, p. sh. rasti i analizave gramatikore statistikore të Magerman (1995), Collins (1997) dhe të tjerë të cilët përdorin marrëdhëniet e varësisë ndërmjet fjalëve; metodologjia e përkthimit të Palmer (1998); gjenerata multigjuhësore e Iordanskaja (1992)<sup>64</sup> etj.

Së dyti, është vërejtur qasja e përzgjedhjes së aspekteve të gramatikës së varësisë, duke i ndërthurur ato në gramatikën e konstituentit dhe e anasjellta. Ky zhvillim i ka bazat në shkollën e Parisit, ku rreth shekullit të 13 - 14 mbizotëronte formalizmi i bazuar

<sup>63</sup> Mark Dras, David Chiang, William Schuler, *On Relations of Constituency and Dependency Grammars*, tërhequr më 02.06.2014 nga <http://web.science.mq.edu.au/~madrass/papers/jlac.pdf>

<sup>64</sup> *Po aty* referuar nga Magerman D. (1995) *Statistical Decision-Tree Models for Parsing*. In *Proceedings of the 33rd Annual Meeting of the Association for Computational Linguistics (ACL'95)*, Collins M. (1997) *Three Generative, Lexicalised Models for Statistical Parsing*. In *Proceedings of the 35th Annual Meeting of the Association for Computational Linguistics (ACL '97)*, Palmer M., Rosenzweig J., Schuler W. (1998) *Capturing Motion Verb Generalizations with Synchronous TAG*. In Dizier P.S. (ed.), *Predicative Forms in NLP*, Kluwer Press.

në varësi (Covington, 1984)<sup>65</sup> – por, disa prej mbështetësve të tij e vlerësuan faktin që gramatika e konstituentit ishte e nevojshme për të shpjeguar aspekte si lidhëzat, bashkërenditja dhe ndërtimet pavetore. Përpyekjet më të fundit përmbliidhen në studimin e Gladkij (1980) mbi gjuhët evropiane lindore, sipas Mel’ uk dhe Pertsov (1987)<sup>66</sup>.

Nga ana tjetër do të vemë re rritjen e analizave në gramatikën e konstituentit bazuar në gramatikën e varësisë – Abney (1995)<sup>67</sup> përshkruan një teknikë të një analize gramatikore të shëndoshë, e cila pjesërisht i grupon fjalët në konstituentë dhe më pas i bashkon ato sipas lidhjes së varësisë; studimi i tij përfshin si themelet teorike në këtë kombinim bazuar në treguesit psikolinguistikë dhe ato të intonacionit gjithashtu edhe një sistem për një analizë gramatikore më të gjerë.

Në studimin e kryer nga Mark Dras<sup>68</sup>, ai shprehet se së fundmi ka përpjekje për të ndërlidhur konstituentin dhe varësinë në një formalizëm të vetëm; përfaqësimet e konstituentit dhe varësisë vazhdojnë të paraqiten të ndara por të bashkuara në njëfarë mënyre. Në një studim të hershëm mbi gramatikën e konstituentit, Gaifman (1965) dhe Hays (1964)<sup>69</sup> zbatuan modele të gramatikës së varësisë duke përdorur rregullat e strukturës së sintagmës dhe u kufizuan vetëm në projektimin e gramatikës së varësisë, duke treguar që këto janë paraqitje të dobëta të gramatikës context-free. Më pas, në kuadër të programit të gramatikës Transformuese, kishte më shumë propozime për përdorimin e gramatikës së varësisë dhe jo atë të context-free ose context-sensitive, si bazë e gramatikës transformuese (Robinson, 1970; Vater, 1975)<sup>70</sup>.

Në të gjitha këto, është e mundur të vemë re formalizmin në shumë nivele, ku një pjesë është e orientuar drejt konstituentit dhe tjetra e orjentuar drejt varësisë.

### ***2.3.2 Mbi mënyrat për dallimin e konstituentëve***

Konstituentët janë mjete që shërbejnë për të formuar fjali dhe emërtohen në bazë të funksioneve gramatikore që caktojnë. Për të bërë dallimin ndërmjet tyre përdoren *testet e konstituentëve* që verifikojnë në mënyrë efektive që një grup i caktuar fjalësh kryen në kompleksitetin e vet një funksion të përbashkët, si rrjedhim përfaqëson një njësi

---

<sup>65</sup> Po aty referuar nga Covington M. (1984) *Syntactic Theory in the High Middle Ages*. Cambridge University Press, London, UK.

<sup>66</sup> Mel’ cuk I., Pertsov N. (1987) *Surface Syntax of English: A Formal Model within the Meaning-Text Framework*. John Benjamins, Amsterdam, The Netherlands.

<sup>67</sup> S. Abney, *Chunks and Dependencies: Bringing Processing Evidence to Bear on Syntax*. Në Computational Linguistics and the Foundations of Linguistic Theory, CSLI, 1995

<sup>68</sup> Mark Dras etj., *Po aty*.

<sup>69</sup> H. Gaifman, *Dependency Systems and Phrase-Structure Systems*. Information and Control, 8, 1965 fq. 304–337, D. Hays, *Dependency Theory: A Formalism and Some Observations*. Language, 40, 1964, fq. 511–525

<sup>70</sup> J. Robinson, *Dependency Structures and Transformational Rules*. Language, 46/2, 1970, fq. 259–285, H. Vater, *Toward a Generative Dependency Theory*. Lingua, 36, 1975, fq. 121–145.

sintaksore. Teste të tilla janë quajtur *teste të konstituentëve* dhe janë gjashtë të tilla si më poshtë:

- a) testi i zhvendosjes;
- b) testi i lidhjes;
- c) testi i fragmentit;
- d) testi i zëvendësimit;
- e) testi i mungesës;
- f) testi i bashkërenditjes.

### **2.3.2.1 Testi i zhvendosjes**

Testi i zhvendosjes ka të bëjë me zhvendosjen sipas rregullave sintagmatike të vlefshme për gjuhën në përdorim të një grupi elementësh leksikorë nga njëri pozicion në tjetrin dhe në verifikimin që fjalia e përftuar nga zhvendosja të jetë gramatikore: nga momenti që realizimi i një fjalie kërkon që të transferohen njësitë sintaksore *në tërësinë e tyre*, fakti që zhvendosja e një grupi fjalësh gjeneron një fjali të pranueshme është tregues i tërësisë së saj.

Një nga përdorimet e testit ka të bëjë me realizimin e një fjalie të zhvendosur: sepse që një grup fjalësh të përfaqësojë një përbërës, ajo duhet të zhvendoset për të realizuar një fjali të zhvendosur ose të topikalizuar<sup>71</sup>. P.sh. fakti që, duke u nisur nga fjalia:

Agimi ka përgatitur tavë Elbasani *pa hudhër*.

... mund të përftohet fjalia e saktë gramatikore:  
Agimi e ka përgatitur *pa hudhër* tavën e Elbasanit.

... ose, sërish fjalia e saktë gramatikore:

Është *pa hudhër* tava e Elbasanit që ka përgatitur Agimi.

tregon që grupi i fjalëve *pa hudhër* është një konstituent.  
Në të kundërt, po të përftonim fjalinë:

\*Agimi ka përgatitur *tavë pa hudhër Elbasani*.

---

<sup>71</sup> Prada, Massimo, *Scrittura e comunicazione*, Milano, 2003, Led, Bonomi Ilaria, Andrea Masini, Silvia Morgana, Mario Piotti, 2003 *Elementi di linguistica italiana*, Roma, Carocci [Il volume è corredato da un Glossario a cura di Massimo Prada; ogni capitolo è seguito da esercizi a cura di Francesca Traversi]



... do të kuptonim se kjo fjali nuk është gramatikore e si rrjedhim *Elbasani* nuk mund të konsiderohet si konstituent.

### **2.3.2.2 Testi i lidhjes (i pandashmërisë)**

Testi i lidhjes (i pandashmërisë) ka të bëjë me vendosjen e një konstituenti në brendësi të një grupi fjalësh. Nëse veprimi prodhon një fjali jo gramatikore, grupi i fjalëve të ndara nga vendosja është një konstituent.

P.sh. fjalia më poshtë:

Agimi ka përgatitur *tavë Elbasani* pa hudhër

nuk mund të shndërrohet:

\*Ka përgatitur *tavë Elbasani* Agimi hudhër.

Kjo tregon që grupi i fjalëve *tavë Elbasani* ndërton një njësi të lidhur (të pandashme), e si rrjedhim konsiderohet një konstituent.

### **2.3.2.3 Testi i fragmentit**

Testi i fragmentit ka të bëjë me realizimin e një sintagme më vete, p.sh. në fjalitë me pyetje - përgjigje gramatiksht të sakta. Nëse ky veprim është i mundur, gjendet përballë një njësie sintaksore – semantike, d.m.th. përballë një konstituenti. Kështu p.sh njësia:

*Pa hudhër* është konstituent, sepse mund të konsiderohet pa dyshim si përgjigjia e një pyetjeje të tillë si:

- Si e ka përgatitur tavën e Elbasanit Agimi?
- *Pa hudhër.*

Për më tepër, nuk do të ishte gramatiksht e saktë dhe e mundur të formulonim një pyetje tjetër për të përfutur të njëjtën përgjigje. Të njëjtën gjë mund të themi edhe në rastet e pyetjeve si *Çfarë po lexon? Shekspirin* ose *Kush po vjen? Agimi* pra, përgjigjia e të cilave mund të jetë një sintagmë emërore SE si konstituent i sintagmës foljore SF; për fjalinë e parë *Shekspirin* dhe për fjalinë e dytë *Agimi*.

#### **2.3.2.4 Testi i zëvendësimit**

Testi i zëvendësimit ka të bëjë me zëvendësimin e një grupi fjalësh me një proformë (p.sh. një përemër); nëse veprimi është i realizueshëm gramatikisht grupi i fjalëve ndërton një njësi sintaksore – semantike, ose konstituent; kështu në fjalinë e mëposhtme:

Agimi ka përgatitur *tavë Elbasani* pa hudhër.

Sintagma emërore SE *tavë Elbasani* mund të zëvendësohet nga një trajtë e shkurtër (klitik) *e*:

(Si *e* ka përgatitur *tavën e Elbasanit* Agimi?) *E* ka përgatitur pa hudhër.

Por nuk ndodh kështu për grupin e fjalëve *Elbasani pa*:

\*Agimi e ka përgatitur *tavë hudhër*.

#### **2.3.2.5 Testi i mungesës**

Testi i mungesës kërkon që të heqë një grup fjalësh; nëse rezultati është një fjali eliptike por gramatikisht e saktë, grupi i fjalëve ndërton një njësi semantiko sintaksore (d.m.th. një konstituent); kështu në fjalinë:

*Do të doja* të ikja dhe nuk *do të doja* në të njëjtën kohë

kemi një mungesë të formës foljore *të ikja*, që është si rrjedhim një konstituent.

#### **2.3.2.6 Testi i bashkërenditjes**

Testi i bashkërenditjes ka të bëjë me bashkërenditjen e dy sintagmave të ngjashme; nëse kjo është e mundur të dyja grupet e bashkërenditura janë konstituentë; fjalia si më poshtë:

Agimi ka përgatitur *tavë Elbasani* pa hudhër.

... mund të zgjerohet nëpërmjet elementit të bashkërenditur *dhe pa kripë*, duke përfutur një fjali të tillë si më poshtë:

Agimi ka përgatitur *tavë Elbasani pa hudhër dhe pa kripë*.

*Pa hudhër është një konstituent po aq sa edhe pa kripë.*

### ***Përdorimet***

Nëse provojmë të përdorim testet e konstituentëve në një shembull për të verifikuar karakterin e konstituentëve të një bashkësie elementësh leksikorë do të përftojmë shembujt si më poshtë<sup>72</sup>:

***Çdo njeri dëshiron të shkojë në shtëpinë e vet.***

e përdorim këtë fjali me testet e mëposhtme:

**1: Testi i zhvendosjes dhe i ndërtimit të fjalisë së zhvendosur**

Në shtëpinë e vet, çdo njeri dëshiron të shkojë.

Është në shtëpinë e vet që çdo njeri dëshiron të shkojë.

**2: Testi i lidhjes (i pandashmërisë)**

\* Çdo njeri dëshiron të kthehet në shtëpi me shpejtësi vet.

**3: Testi i fragmentit**

Ku dëshiron të kthehet me shpejtësi *çdo njeri*?

Në shtëpinë e vet.

**4: Testi i zëvendësimit**

Çdo njeri dëshiron të shkojë aty.

**5: Testi i mungesës**

Çdo njeri dëshiron të shkojë (~~në shtëpinë e vet~~) dhe nuk dëshiron të shkojë në shtëpinë e vet.

**6: Testi i bashkërenditjes**

Çdo njeri dëshiron të shkojë *në shtëpinë e vet* dhe *në shtëpinë e të tjerëve*.

Të gjitha testet provojnë se përbërësi *në shtëpinë e vet* është një konstituent.

---

<sup>72</sup> Massimo Prada, *Po aty*, fq. 13-16

## **2.4 Fjala dhe sintagma**

Në thelb, gramatika e strukturës së sintagmës<sup>73</sup> është një version i shprehjes së informacionit duke përdorur rregullat e “ri – shkrimit”. Në këtë model gjuhëtari formalizon gramatikën me anë të rregullave gjenerative të cilat caktojnë strukturën e saktë të konstituentit në fjali. Këto sisteme janë quajtur thjesht “Gramatika e strukturës së sintagmës”.

Ky model gramatike tregon jo vetëm elementët fundorë apo konstituentët e një strukture lineare të cilët bashkohen për të formuar sintagma, por gjithashtu kjo gramatikë specifikon nënjësitë dhe nivelin në të cilin këto njësi formojnë grupe të natyrshme. Në këtë mënyrë gjuhëtari do të përqëndrohet në:

1. Modelin që përcjell fjalia dhe konstituentët dhe
2. Mjetet sintaksore të përdorura për të lidhur konstituentët dhe mënyrat në të cilat lidhen pjesë të ndryshme me njëra tjetrën.

A. Radford<sup>74</sup> pohon se në punimet gjuhësore të viteve '60 - '70 pranohej se vetëm kategoritë leksikore mund të projektonin sintagma, kurse kategoritë funksionale jo. Në punimet e mëvonshme është argumentuar se jo vetëm fjalët me përmbajtje (emri, folja, mbiemri, parafjala, ndajfolja), por edhe fjalët funksionale mund të shërbejnë si kokë e sintagmave. Përgjithësisht, në punimet e njëzet viteve të fundit pranohet se të gjitha kategoritë në nivelin e fjalës mund të shërbejnë si kokë sintagmash.

Në studimet gjenerative dallohen dy lloje sintagmash: sintagma leksikore dhe sintagma funksionale. Këto dy lloje sintagmash shënuan një ndarje mes gjuhësisë tradicionale dhe asaj moderne. Duke u nisur nga koka e sintagmës, dallohen:

- sintagma leksikore, të cilat kanë kokë kategori leksikore: emrin, mbiemrin, përemrin, foljen.
- sintagma funksionale, të cilat kanë kokë kategori funksionale determinantin, eptimin dhe kuantifikuesit.

Kjo ndarje nuk është përfundimtare, sepse tek ndonjë autor tjetër shohim se këto kategori përcaktohen ndryshe. D. Adger-i pohon se koka të sintagmave leksikore janë emri, folja, mbiemri, ndajfolja, përemri, kuantifikuesi, determinanti, kurse kategori funksionale janë eptimi dhe komplementuesi.

Kjo analizë bëhet në kuadër të teorisë X-bar, e cila, krahasuar me analizën tradicionale në pjesë ligjërata është më e gjerë, sepse përmban edhe sintagmat joleksikore, të cilat i quajtmë sintagma funksionale.

Pamë më lart disa nga kategoritë, parimet e teoritë e lidhura me sintagmën të përdorura në gramatikën gjenerative. Sipas studiuesve<sup>75</sup> kjo gramatikë nuk është një “filozofi e përgjithshme e gjuhës”, por një teori e artikuluar qartë (e cila, mund të jetë e

---

<sup>73</sup> <http://jilaniwarsi.tripod.com/ps.pdf>

<sup>74</sup> Po aty referuar nga Radford, *Minimalist Syntax, Exploring the structure of English*, 2004, f. 32.

<sup>75</sup> Giorgio Graffi, *Ç'është gramatika gjenerative*, Botimet Toena, 2008, fq. 25

drejtë ose e gabuar) për natyrën dhe strukturën e gjuhës njerëzore. Një njohje të paktën e përgjithshme e teknikave të analizës që ndjek gramatika gjenerative, është e domosdoshme për të krijuar një ide të drejtë për këtë teori linguistike dhe për të dhënë për të një gjykim të argumentuar.

Mbi bazën e kësaj teorie kanë gjetur zbatim analiza të thella gjuhësore të gjuhëve natyrore dhe ne do të përdorim, pikërisht, disa nga normat e mirëpërcaktuara nga gjenerativistët e huaj dhe shqiptarë për të shpjeguar disa nga karakteristikat e materialit gjuhësor të gjuhës shqipe.

## **2.5 Çështje të njësive sintaksore**

Në përcaktimin e njësive themelore sintaksore nuk ka njësi mendimi. Sipas Gramatikës së Akademisë<sup>76</sup> njësitë sintaksore të dallueshme janë: **fjalìa, periudha, gjymtyra e fjalisë dhe togfjalëshi**. Për analogji në gramatikën gjenerative do të thoshim se njësitë sintaksore janë **fjalìa, sintagma, argumenti, specifikuesi e modifikuesi**. Në të dyja gramatikat fjalìa zë vend si njësia themelore sintaksore, si mjeti e mënyra kryesore e formësimit, shprehjes dhe e kumtimit të mendimit. *Fjalìa<sup>77</sup> është framgmenti i ligjërimin i përbërë zakonisht prej dy a më shumë fjalësh kuptimplota të bashkuara sipas raportesh të caktuara, në bazë të ligjeve të një gjuhe, në një tërësi të vetme kuptimore, gramatikore e intonacionore.*

Për sa i përket konceptit të *togfjalëshit*, në sintaksën gjenerative do të përmendet termi *sintagmë*, si njësi e ndërmjetme ndërmjet fjalës dhe fjalisë, por ndryshe nga *togfjalëshi* koncepti *sintagmë* është më gjithëpërfshirës. Një analizë më e plotë për ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet tyre është dhënë si më poshtë në Kreun III.

Termet *argument, specifikues e modifikues* mund të përfshihen në termin *gjymtyrë fjalie* si njësi sintaksore më e vogël që dallohet në analizën e fjalisë; një nocion që është në raporte të caktuara me nocione të tjera. Sipas funksioneve që përmbushin, duke u nisur nga kriteret strukturore e kuptimore, dallohen gjymtyrë të ndryshme, ndër to gjymtyrë kryesore, kryefjala dhe kallëzuesi, që janë qendrat organizuese të fjalisë: lidhja e tyre përbën bërthamën e saj; ndërsa gjymtyrët e quajtura të dyta janë plotësuese, sado që ndonjëherë të domosdoshme.

### **2.5.1 Kriteret e dallimit të pjesëve të ligjëratës**

Të gjitha fjalët e një gjuhe grupohen në pjesë ligjërata sipas veçorive të përbashkëta. Në varësi të kriterëve për klasifikimin e fjalëve në pjesë ligjërata vërehen dy këndvështrime kryesore: a) tradicional dhe b) bashkëkohor. Sipas këndvështrimit

---

<sup>76</sup> Gramatika e gjuhës shqipe II, 2002, f. 60

<sup>77</sup> Gramatika..., Po aty.

tradicional kuptimi dhe veçoritë gramatikore të fjalëve janë dy tiparet kryesore për dallimin e klasave të fjalëve si pjesë ligjëratare. Mbi bazën e këtyre tipareve, nëpër gramatikat e ndryshme, janë përcaktuar dhe kriteret e dallimit të pjesëve të ligjëratare, përkatësisht kriteri semantik dhe kriteri gramatikor. Pra vendosen në të njëjtin plan kuptimi leksikor dhe veçoritë gramatikore.

Një këndvështrim tradicional të përshkrimit të pjesëve të ligjëratare e ndeshim dhe në gramatologjinë shqiptare. Historikisht, pjesët e ligjëratare janë përshkruar sipas kuptimit dhe veçorive gramatikore morfologjike dhe sintaksore. Problem është se cili prej këtyre kriterëve ka përparësi në përcaktimin e pjesëve të ligjëratare. Natyrisht teoria e përcaktimit të pjesëve të ligjëratare në gjuhën shqipe ka ardhur duke u thelluar e përsosur në dy drejtime kryesore: a) së pari, është përcaktuar qartë numri i grupimeve të fjalëve në pjesë ligjëratare.

Kështu p.sh. nga njëra anë janë lënë mënjanë, pra nuk merren më si pjesë ligjëratare, nyjat e përparme të mbiemrave dhe nyja e rasës gjinore, nga ana tjetër janë përfshirë te pjesët e ligjëratare pjesëzat; b) së dyti, janë bërë përshkrime të hollësishme të veçorive semantike e gramatikore dhe është theksuar se nuk ka një kriter të vetëm në dallimin e pjesëve të ligjëratare dhe se nuk mund të thuhet se cili kriter ka përparësi në dallimin e tyre, por përparësi ka here njëri here tjetri kriter.

Në gramatologjinë shqiptare trajtimin më të plotë të pjesëve të ligjëratare në gjuhën shqipe e ndeshim në veprën “Gramatika e gjuhës shqipe” 1, botimi i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2002. Më herët për kriteret e dallimit të pjesëve të ligjëratare ka shkruar dhe gjuhëtari Fatmir Agalliu<sup>78</sup> (1972), mendimet e të cilit janë pasqyruar në këtë gramatikë. Në Gramatikën akademike zënë vend të veçantë pjesët e ligjëratare dhe kriteret e dallimit të tyre. Aty theksohet se të gjitha fjalët e një gjuhe, sipas veçorive të përbashkëta leksikore e gramatikore, grupohen nëpër klasa ose kategori leksiko-gramatikore, të cilat quhen *pjesë ligjëratare*.<sup>79</sup> Ky përcaktim mendojmë se nuk është i mjaftueshëm për këto klasa, sepse nuk jepet asnjë informacion për rolin e tyre në fjali.

Vetë termi “pjesë ligjëratare” përdoret këtu si sinonim i termit “kategori leksiko-gramatikore”, që do të thotë se çdo fjalë ose pjesë ligjëratare ka anën e vet kuptimore dhe gramatikore, pa përmendur funksionin ose rolin e tyre në ndërtimin e fjalisë. Kështu që përcaktimi për secilën klasë fjalësh në gramatikën akademike supozohet se përmban njëkohësisht informacion për anën kuptimore dhe për veçoritë gramatikore.

Për pasojë, nisur nga kriteri semantik dhe gramatikor, dallimi i tyre duhet të bëhet sipas kriterit leksikor dhe atij gramatikor dhe duhet pasqyruar në përkufizimin e secilës pjesë ligjëratare. Përcaktimi që jepet në gramatikë për çdo pjesë ligjëratare përmban fillimisht informacionin për anën kuptimore dhe më pas vijohet me informacionin për veçoritë gramatikore.

---

<sup>78</sup> Fatmir Agalliu, *Mbi pjesët e ligjëratare në gjuhën shqipe*, “Çështje të fonetikës dhe gramatikës së shqipes së sotme”, Tiranë 1972

<sup>79</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe* 1, 2002, f. 36.

Megjithatë, nëse ndjekim mënyrën se si përcaktohen pjesët e ligjëratës në këtë gramatikë, vërehet se nuk ndiqet i njëjti model. Për disa klasa fjalësh përkufizimi i pjesës së ligjëratës fillon me informacionin semantik dhe më pas vijohet me informacionin gramatikor. Për disa klasa të tjera fjalësh përparësi ka kriteri gramatikor, pra fillohet me paraqitjen e informacionit gramatikor, kurse informacioni semantik është plotësues.

Përshkrimi fillimisht i informacionit kuptimor dhe më pas i atij gramatikor ndeshet në përkufizimin e pjesëve të tilla të ligjëratës si emri, mbiemri, përemri, folja, ndajfolja. Në përkufizimin e secilës prej këtyre pjesëve të ligjëratës përparësi ka kriteri semantik, aftësia e këtyre fjalëve për të emërtuar p.sh. frymorë, sende, tipare ose për të treguar në mënyrë të përgjithshme, pa i emërtuar, frymorë, sende, tipare. Më konkretisht përcaktimi që jepet në gramatikë për këto pjesë ligjërata është si vijon:

Emër = pjesë e ligjëratës që **emërton** qenie të gjalla dhe sende dhe ka kategoritë gramatikore të gjinisë, numrit, rasës dhe të shquarsisë e të pashquarsisë.(f.81)

Mbiemri = pjesë e ligjëratës që **emërton** një tipar të sendit dhe përshtatet në gjini, numër, e për një pjesë, edhe në rasë me emrin e këtij sendi. (f.153)

Përemri = pjesë e ligjëratës që **tregon** në mënyrë të përgjithshme, pa i emërtuar, frymorë, sende, tipare ose sasi të pacaktuara. (f. 215)

Folje = pjesë e fjalisë që **emërton** një veprim si proces dhe që ka kategoritë gramatikore të vetës, numrit, mënyrës, kohës e diatezës. (f.259)

Ndajfolja = pjesë e ligjëratës që **emërton** një tipar të veprimit a të gjendjes, rrethanat në të cilat vërtetohet ky veprim, ose tregon shkallën e një cilësie a të një rrethane ose intensitetin e veprimit. (f. 357).

Siç shihet, përcaktimi i, emrit, mbiemrit, përemrit, foljes dhe ndajfoljes, fillon me përshkrimin e veçorive kuptimore, aftësinë e këtyre fjalëve për të emërtuar ose treguar, e më pas vijohet me veçoritë e tyre gramatikore. Kjo do të thotë se në dallimin e këtyre pjesëve të ligjëratës përparësi ka kriteri semantik, aftësia e këtyre fjalëve për të emërtuar frymorë, sende, tipare ose për të treguar në mënyrë të përgjithshme, por pa i emërtuar, frymorë, sende, tipare. Informacioni gramatikor gjatë përkufizimit të këtyre pjesëve të ligjëratës është dytësor.

Ndryshe vepohet me përkufizimet e bëra për pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, përkatësisht parafjalët, lidhëzat, pjesëzat dhe pasthirrat. Në përkufizimin e parafjalëve, lidhëzave, pjesëzave dhe pasthirrmave si pjesë ligjërata jepet fillimisht informacioni gramatikor e më pas ai kuptimor, si më poshtë:

Parafjala = pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që shpreh marrëdhënie sintaksore varësie midis një emri, një numërori ose një përemri dhe një gjymtyre tjetër në togfjalësh. (f.380).

Lidhëza = pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që lidh dy gjymtyrë fjalië ose dy fjali dhe shpreh marrëdhënie të ndryshme sintaksore ndërmjet tyre. (f. 397).

Pjesëza = pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që shërben për të shprehur ngjyrimë kuptimore ose emocionuese plotësuese të një fjale a të një fjalië të tërë. (f. 413)

Pasthirrma = pjesë e pandryshueshme e ligjëratës me vlerë thirrmore që shërben për të shprehur ndijime, ndjenja a vullnetin e folësit, por pa i emërtuar.(f.413)

Ajo që të bie në sy është se në përcaktimin e parafjalëve, lidhëzave, pjesëzave dhe pasthirrmave si pjesë ligjërate jepet një dukuri gramatikore shumë e rëndësishme, përkatësisht aftësia e këtyre fjalëve për të mos ndryshuar formë. Ndryshe nga përkufizimet e bëra më parë në këtë gramatikë për emrin, mbiemrin, përemrin, foljen, ndajfoljen, nëpërmjet të cilave nuk sillet asnjë informacion morfologjik për ndryshueshmërinë ose pandryshueshmërinë e formës së fjalëve të shqipes, në përkufizimin e bërë për parafjalët, lidhëzat, pjesëzat dhe pasthirrmat, informacioni i parë që jepet për to është ai gramatikor, përkatësisht aftësia e këtyre fjalëve për të mos ndryshuar formë.

Pra siç shihet ka një mungesë koherence në kriteret e përkufizimeve për pjesët e ligjëratis. Herë ka përparësi kriteri semantik, herë ka përparësi kriteri gramatikor, përkatësisht morfologjik e sintaksor. Të paktën nisur nga përcaktimi që i bëhet në këtë gramatikë objektit të morfologjisë, që është forma e fjalës, përparësi në përcaktimin e pjesëve të ligjëratis i duhej dhënë dallimit të fjalëve sipas aftësisë së tyre për të ndryshuar ose mos ndryshuar formë.

Ne pajtohemi me mendimin se kuptimi konkret i fjalëve nuk duhet marrë si kriter parësor për përcaktimin e pjesëve të ligjëratis dhe për pasojë duhet mënjanuar mungesa e koherencës që vërehet në gramatikën akademike lidhur me përcaktimin e pjesëve konkrete të ligjëratis<sup>80</sup>. Edhe në gramatikën akademike me të drejtë thuhet se fjalë të tilla si *i mirë*, *i lig* etj. që emërtojnë cilësi nuk dallohen lehtë kuptimisht nga emrat përgjegjës *mirësi*, *ligësi*-. Po ashtu emrat e tipit të *lexuarit*, të *folurit*, që emërtojnë veprime, nuk dallohen lehtë kuptimisht nga foljet përgjegjëse *lexoj*, *flas*. Për pasojë, i vetmi mjet për përcaktimin e pjesëve të ligjëratis në këto raste janë veçoritë gramatikore.<sup>81</sup>

Një pohim i tillë në këtë gramatikë është shumë i rëndësishëm, por bie ndesh me formulimin e bërë këtu për përkufizimin e foljeve dhe të emrave, sepse fillohet me të dhënat e kuptimit konkret të fjalëve. Nisur nga përkufizimet e mësipërme, supozohet që nxënësi duhet të dijë patjetër kuptimin e fjalës për të përcaktuar pjesën e ligjëratis. Veç kësaj, marrja për bazë e kriterit kuptimor gjatë përkufizimit të pjesëve të ligjëratis në planin praktik do të kërkonte që nxënësi i nivelit parauniversitar, si folës i gjuhës shqipe, gjatë analizës së pjesëve të ligjëratis duhet të njohë pa tjetër kuptimet e të gjitha fjalëve, për të përcaktuar përkatësinë e tyre në këtë ose atë pjesë ligjërate. Por një gjë e tillë nuk ndodh realisht, mosnjohja e kuptimit leksikor nuk bëhet pengesë për dallimin e pjesëve të ligjëratis.

Folësi i gjuhës amtare, që gjatë shkollimit bëhet i vetëdijshëm për veçoritë gramatikore të fjalëve në fjali, si struktura morfologjike ose funksionet e fjalëve në fjali, pra ka informacion për mënyrën e funksionimit të fjalëve në fjali, është në gjendje të përcaktojë pjesën e ligjëratis edhe kur janë fjalë të panjohura për të ose pa ditur kuptimin

---

<sup>80</sup> Ludmila Buxheli, *Përsëri për profilin e Cipos si gjuhëtar dhe gramatikan*, Studime Filologjike, 3-4, 2012, fq. 5-21.

<sup>81</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë 2002, f.36.



e fjalëve. Pra, ndonëse kuptimi mund të jetë i panjohur, veçoritë gramatikore mundësojnë përcaktimin e pjesëve të ligjëratës. Shembujt e mëposhtëm e shprehin qartë këtë dukuri.

Le të ndalemi p.sh. në fjalitë e mëposhtme (1a) dhe (1b), të shkëputura nga konteksti, në të cilat nxënësit i kërkohet të përcaktojnë pjesën e ligjëratës për fjalët *fitorja* dhe *gëzimi*, kuptimi i të cilave është i panjohur për ta:

- (1) a. *Fitorja* nuk vonoi.  
b. *Gëzimi* nuk u ndie fare.

Nëse nxënësit me shqipen si gjuhë amtare do t'i kërkohet përcaktimi i pjesës së ligjëratës për fjalët *Fitorja*, *Gëzimi*, të marra jashtë kontekstit, ai nuk do të gabonte dhe do të thoshte se janë emra, ndonëse kuptimi konkret i fjalëve *Fitorja* dhe *Gëzimi* është i panjohur për të. Nxënësi është në gjendje të përcaktojë pjesën e ligjëratës në bazë të disa prej tipareve gramatikore të kësaj fjale, përkatësisht morfologjike ose sintaksore: *fitorja* - emër i gjinisë femërore, lakimi i tretë, njëjës, trajta e shquar, rasa emërore, mbaresa -a; *gëzimi* - emër i gjinisë mashkullore, lakimi i parë, njëjës, trajta e shquar, rasa emërore, prapashtesa -im. Nëse do t'i kërkohet që fjalët *fitorja* ose *gëzimi* të zëvendësohen me fjalën *për*, përgjigjia do të ishte se një gjë e tillë është e pamundur, sepse *për* si parafjalë nuk mund të lidhet me një folje e t'i prijë. Të njëjtën gjë do të bënte edhe nëse do t'i duhej të përcaktonte përkatësinë leksiko-gramatikore të termave shkencorë nga një fushë e panjohur prej tij.

Këtë aftësi për dallimin e pjesëve të ligjëratës nxënësi e zotëron jo vetëm nëse përballet me analizën e një fjalie në përbërjen e së cilës ka fjalë shqipe të panjohura për të, por edhe me fjalë që nuk tingëllojnë fare shqip, si në fjalinë e mëposhtme:

- (2) ***Krytesikratoríndgzi i tij krukrazdlulói*** hapur.

Nëse nxënësit do t'i kërkohet të bënte dallimin e pjesëve të ligjëratës në këtë fjali, ai do të mund ta bënte këtë gjë lehtësisht:

Folësi është në gjendje të thotë se fjala ***Krytesikratoríndgzi*** përfaqëson një emër në gjininë mashkullore, rasa emërore, lakimi i parë, njëjës, në funksionin e kryefjalës, kurse fjala ***krukrazdlulói*** përfaqëson formën e vetës së tretë njëjës, të së kryerës së thjeshtë të një foljeje të zgjedhimit të parë, të tipit *punoj* që përshtatet me kryefjalën. Pra ndonëse ai nuk është në gjendje të japë kuptimin konkret të këtyre dy fjalëve, nëse kemi të bëjmë me një emër njeriu, sendi, kafshe, konkret, abstrakt etj. ose nëse kemi të bëjmë me një folje që tregon lëvizje, gjendje etj., ai mund të përshkruajë tiparet gramatikore të fjalëve të panjohura e të huaja për leksikun e shqipes, sepse veçoritë gramatikore janë në përputhje me strukturën gramatikore të shqipes.

Edhe në një fjali në gjuhë të huaj, ku natyrshëm mangësitë leksikore janë më të mëdha se në gjuhën amtare, nxënësi shqipfolës është në gjendje të përcaktojë pjesët e ligjëratës, nëse merr informacionin e duhur për tiparet gramatikore dhe mjetet e shprehjes së tyre në fjalët e gjuhës përkatëse.

Folësi është në gjendje të përcaktojë pjesët e ligjëratës në këtë fjali, ndonëse kuptimisht për sa i përket emrit *Fitorja* nuk është në gjendje të vendosë nëse bëhet fjalë për një emër të përveçëm apo për një emër të përgjithshëm.

Veç kësaj, ndarja në klasa jepet e shkëputur nga funksioni që kryejnë fjalët e një klase. Në të vërtetë ndarja në klasa ose grupe fjalësh bëhet sepse secila klasë përcakton rregullat gramatikore të ndërtimit të fjalisë.

Veç kësaj, pak rëndësi i jepet strukturës morfologjike të fjalës, pothuajse kalimthi preket ky problem në dallimin e pjesëve të ligjëratës. Kemi parasysh distribucionin e morfemave të ndryshme, i cili kushtëzohet nga roli i tyre eptimor e fjalëformues. Veçoritë sintaksore preken vetëm në ndonjë rast, duket sikur për sa i përket aspektit gramatikor, ana sintaksore nuk merret në konsideratë.

Në lidhje me këtë problem Carnie<sup>82</sup> në analizën e tij shprehet se kriteri për përcaktimin e pjesëve të ligjëratës nuk mbështetet vetëm në kuptimin leksikor të fjalëve, por në përndarjen/distribucionin e tyre dhe të pjesëve përbërëse të strukturës së tyre. Folësi i një gjuhe do të ketë të ngulitur dy lloje distribucioni në përcaktimin e njësive të ligjëritimit, atë morfologjik dhe atë sintaksor. Në gramatikën e Akademisë<sup>83</sup> idenë e distribucionit do ta gjejmë me anë të shprehjes së raporteve sintaksore të cilat janë morfologjike dhe sintaksore.

Distribucioni morfologjik ka të bëjë me përdorimi e mjeteve morfologjike që karakterizojnë strukturën e fjalës, ai ka të bëjë me mënyrën si vendosen në strukturën e fjalës morfemat e saj, si p.sh. mbaresat, parashtesat prapashtesat. Distribucioni i morfemave të fjalës është tregues i rëndësishëm i përkatësisë së fjalës në një pjesë ligjërate të caktuar. Një shembull i distribucionit morfologjik do të ishte përdorimi i mbaresave rasore në fund të emrave në trajtën e shquar, p.sh. në fjalinë *Djali lexoi broshurën*. Në këtë fjali mbaresa e rasës emërore njëjës të shquar *djal-i* e bën të qartë pjesën e ligjëratës së kësaj fjale, po ashtu, mbaresa rasore –n e rasës kallëzore njëjës të shquar te fjala *broshurën*, shpreh përkatësinë leksiko-gramtikore të kësaj fjale si emër. Distribucioni i prapashtesave –im ose –je është gjithashtu një tregues i përkatësisë së një fjale te klasa e emrave.<sup>84</sup>

Distribucioni sintaksor ka të bëjë me mënyrën se si vendosen fjalët në fjali për t'u lidhur me njëra tjetrën. Distribucioni sintaksor karakterizohet përdorimi i mjeteve morfologjike, po i mjetit sintaksor të vendosjes pranë e pranë të njësive të lidhura nga ana kuptimore. Në të raportet sintaksore midis njësive të bashkuara nuk gjejmë shprehje me kushtëzim gramatikor të njësive të varura nga njësitë drejtuese, as me fjalët ndihmëse gramatikore që i bashkojnë njësitë. Kushte përcaktuese të kësaj forme të lidhjes sintaksore janë varësia kuptimore e njërës fjalë nga fjala tjetër, fqinjësia e tyre në vendosje dhe pandryshueshmëria morfologjike e fjalës së varur. P.sh parafjalët janë mjaft

---

<sup>82</sup> Andrew Carnie, *Syntax: a Generative Introduction, Second Edition*, Blackwell Publishers Ltd, 2006, fq. 38

<sup>83</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Tiranë 2002, fq. 67-69

<sup>84</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, Tiranë, 2002, fq.36.

herë polisemantike, kështu me një emër të rasës emërore të prirë nga parafjala *nga* mund të shënohen raporte shkakore, vendore, kohore, kundrinore etj. sipas rasteve:

- (3) Shfrynte *nga inati*.  
U largua *nga shtëpia*.  
Do të vijë *nga e marta*.

Në Gramatikën e Akademisë grupimi i fjalëve në pjesë ligjërata mbështetet në dy kritere kryesore: kriteri leksikor-kategorial dhe kriteri gramatikor. Kur flitet për kriter leksikor kihet parasysh kuptimi leksikor i fjalës i cili duhet të jetë: a) kuptim leksikor i përgjithshëm, dmth. fjala duhet të ketë aftësi për të shënuar diçka nga realiteti (p.sh. një send, një dukuri, një tipar, një veprim etj); b) kuptim leksikor-kategorial i cili shprehet në aftësinë që kanë një klasë fjalësh për të shënuar diçka të përbashkët, që e dallon këtë klasë nga klasat e tjera, p.sh. emrat shënojnë sende, mbiemrat shënojnë cilësi ose tipar, foljet emërtojnë veprim ose gjendje, numërorët tregojnë numra etj. c) kuptimi leksikor individual ose përmbajtja leksikore siç pasqyrohet në fjalor.

## KREU III

### VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I STRUKTURËS SË SINTAGMËS

#### 3.1 *Koncepti i sintagmës*

Qysh prej fillimit të studimeve mbi strukturën e sintagmës, Chomsky<sup>85</sup> e bazoi teorinë e tij mbi strukturën e konstituentit. Teoria e strukturës së konstituentit ka kaluar në tre periudha zhvillimi. Nocioni “strukturë konstituenti” është dhënë fillimisht nga Bloomfield<sup>86</sup>, i cili bëri shpjegimin e termit me anë të shembujve. Pasardhësit e tij si Eugene Nida, Rulon Wells, Zells Harris<sup>87</sup>, formuluan parimet e analizës së konstituentit në më shumë detaje, duke zëvendësuar analizën e Bloomfield me kriteret e shpërndarjes. Periudha e tretë përkon me studimet e Chomsky-t<sup>88</sup> dhe të ndjekësve të tij, të cilët e ngritën strukturën e konstituentit në baza formale dhe e quajtën “Gramatika e strukturës së sintagmës”.

Gjithashtu, ka analiza të tjera në versione më të sofistikuar të gramatikës së strukturës së sintagmës. Tri analizat më të njohura janë “Gramatika e Shkallës dhe e Kategorisë” e lidhur me gjuhëtarin Michael Halliday<sup>89</sup> të Universitetit të Londrës, “Tagmemika” e studiuesit Kenneth Pike<sup>90</sup> nga Universiteti i Michigan dhe “Gramatika Stratifikacionale” e lidhur me studiuesin Sidney Lamb<sup>91</sup> nga Universiteti i Yale.

---

<sup>85</sup> Noam Chomsky, *Syntactic Structures*. The Hague/Paris: Mouton, 1957.

<sup>86</sup> Leonard Bloomfield, *Language*. 1933, New York: Henry Holt, fq. 161 tërhequr më, 02.06.2014 nga <http://jilaniwarsi.tripod.com/ps.pdf>

<sup>87</sup> Eugene Nida, *A Synopses of English Grammar*, Instituto Linguistico de Verano, 1964 dhe Rulon S. Wells, *Immediate Constituents*, *Language*: 23. 1947, fq. 81–117

<sup>88</sup> Noam Chomsky, *Syntactic Structures*, The Hague/Paris: Mouton. 1957

<sup>89</sup> Michael Halliday, *On Grammar*, Vol. 1 in *The Collected Works of M.A.K. Halliday*. London: Continuum. 2002

<sup>90</sup> Kenneth L. Pike, *Language in relation to a unified theory of the structure of human behavior*. Vol. 3 në *Janua Linguarum, Series Maior*. The Hague: Mouton 1967.

<sup>91</sup> Sydney M. Lamb, *Outline of Stratificational Grammar*. Washington DC: Georgetown University Press, 1966.

Në fjalorin e jetës së përditshme, zakonisht, kur përmendim termin grup fjalësh na vjen në mendje termi “shprehje”. Në gjuhësi, kjo shprehje formon një njësi bazë dhe funksionon si një e tërë në sintaksën e një fjalie. Organizimi i fjalëve të një gjuhe në një fjali, në mënyrë hierarkike quhet sintagmë<sup>92</sup>. Është përdorur termi përbërës ose grup fjalësh si e barazvlershme me termin sintagmë (nga greq.  $\mu$ , “vendosje, rreshtim”)<sup>93</sup>. Përbërësit ose sintagmat janë të madhësive të ndryshme, nuk ka kufizime në përcaktimin e vëllimit të tyre, që nga përbërësit e një madhësie më të lartë deri te fjalët e vetme. Por, ndryshe nga fjalët të cilat janë kategori leksikore, sintagmat janë kategori sintagmatike me bazë një kokë, sipas së cilës emërtohet vetë sintagma. P.sh. në fjalinë *Globi rrotullohet* kemi dy sintagma: sintagmën emërore SE *globi* dhe sintagmën foljore SF *rrotullohet*, secila prej tyre e shprehur vetëm me kokën.

Liliane Haegeman<sup>94</sup> shprehet në studimin e saj *Introduction to Government and Binding Theory* se kemi këto lloj sintagmash: sintagmën foljore, sintagmën emërore, sintagmën mbiemërore dhe sintagmën parafjalore. Thoma Dhima<sup>95</sup> në *Gjuha Shqipe – Sintaksa*, duke patur parasysh ndërtimin e fjalisë nga sintagma, vë në dukje këta tipa përbërësish: grupin emëror, grupin foljor, grupin mbiemëror, grupin parafjalor dhe grupin ndajfoljor. Në fjalorin teknik të sintaksës bashkëkohore termi grup është zëvendësuar tashmë plotësisht me termin sintagmë, flitet pra, për sintagmë emërore, sintagmë foljore, sintagmë mbiemërore, sintagmë parafjalore dhe sintagmë ndajfoljore.

Ndërkohë D. Adger e përcakton sintagmën si një grup fjalësh që kanë një koherencë të caktuar të brendshme<sup>96</sup>. Përmendet termi “konstituent” që përdoret për të folur rreth objekteve sintaksore të cilat përmbajnë më shumë se një njësi leksikore. Kështu, fjalitë janë të organizuara në konstituentë dhe vetë konstituenti më i vogël është njësi leksikore (lexical item).

Në kuadrin e gramatikës gjenerative, sintagma është parë si një njësi e domosdoshme e operacioneve sintaksore. Teoria e sintagmës mundësoi zbrërthimin e fjalisë në përbërës, duke zbuluar kështu edhe lidhjet gramatikore të krijuara brenda fjalisë. Në lidhje me këtë çështje, Graffi thekson: “Nuk mund të bësh një analizë sintaksore adekuate duke pranuar që fjalitë janë ndërtuar thjesht nga fjalë, por është e nevojshme të pohohet ekzistenca e njësisive të ndërmjetme mes fjalive e fjalëve, pra ekzistenca e grupeve të fjalëve”<sup>97</sup>.

Termi sintagmë i përgjigjet termit të anglishtes *phrase* që nuk do të thotë frazë në kuptimin që e përdorim këtu (asaj i përgjigjet termi *clause* në kuptimin e frazës së

---

<sup>92</sup> Liliane Haegeman, *Introduction to Government and Binding Theory*, Second Edition, 1998, Blackwell Publishers Ltd, fq.34

<sup>93</sup> Thoma Dhima, *Gjuha Shqipe Sintaksa*, Gjirokastër 2010, fq.22

<sup>94</sup> Liliane Haegeman, Po aty, fq.87 - 103

<sup>95</sup> Thoma Dhima, Po aty, fq. 29

<sup>96</sup> David Adger, *Core Syntax: A Minimalist Approach*, 2003, Oxford University Press, fq. 62.

<sup>97</sup> Hysnie Hyska, Punim Masteri, Dorëshkrim “Sintagma Emërore në Gjuhën Shqipe” Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Departamenti i Gjuhës Shqipe, Tiranë 2009, fq. 9-10 referuar nga G. Graffi, *Sintassi*, f. 76.


thjeshtë dhe *sentence* në kuptimin edhe të frazës së thjeshtë, edhe të frazës së përbërë), por shënon një grup fjalësh që është pjesë e një fraze.

Teoria që na vjen në ndihmë për të shpjeguar strukturën përbërëse të sintagmës është teoria **X – bar**. Kjo teori nxjerr në pah atë që është e përbashkët në strukturën e sintagmave. Ajo provon se përbërësit e sintagmave organizohen në një strukturë hierarkike të saktë. Por, si paraqitet strukturalisht sintagma e një fjalie? L. Haegeman (1998) pohon se struktura përbërëse e një fjalie përfaqësohet në një nga tre format e mëposhtme<sup>98</sup>:

- (a) me anë të diagramës në formë peme
- (b) me anë të rregullave strukturore sintagmatike
- (c) me anë të emërtimeve brenda kllapave

Konkretisht ne kemi analizuar fjalinë *Tregëtarët ngritën çmimet gjatë ditëve të festave*; këtë fjali mund ta paraqesim në këtë mënyrë, sipas formave apo modeleve të mësipërme të paraqitjes së fjalisë:

- (a) me anë të diagramës në formë peme



Pema 1: *Tregëtarët ngritën çmimet gjatë ditëve të festave*

<sup>98</sup> Liliane Haegeman, *Introduction to Government and Binding Theory*, Second Edition, 1998, Blackwell Publishers Ltd, fq.34

(b) me anë të rregullave strukturore sintagmatike

- (i) Fjalia  $\longrightarrow$  SE – SF''
- (ii) SE  $\longrightarrow$  E
- (iii) SF''  $\longrightarrow$  SF' – SP
- (iv) SF'  $\longrightarrow$  F – E
- (v) SP  $\longrightarrow$  P – SE
- (vi) SE  $\longrightarrow$  E – nyjë – E
- (vii) E  $\longrightarrow$  *tregëtarët, çmimet, ditëve, festave*
- (viii) F  $\longrightarrow$  *ngritën*
- (ix) P  $\longrightarrow$  *gjatë*
- (x) nyjë  $\longrightarrow$  *të*

(c) me anë të emërtimeve brenda kllapave

[Fj[SE[E Tregëtarët]] [SF [F ngritën] [SE [E çmimet] [SP [P gjatë] [SE [E ditëve] [nyjë të] [E festave]]]]]]].

Testet apo kriteret e ndarjes në përbërës tregojnë se fjalitë nuk analizohen si sekuenca të thjeshta fjalësh, por në të kundërt janë të ndërtuara nga sintagmat, të cilat në raste të caktuara mund të përbëhen nga sintagma të tjera. E gjithë kjo tregon se fjalitë e gjuhëve natyrale nuk kanë vetëm një strukturë lineare, por edhe një strukturë hierarkike.

Gramatika gjenerative<sup>99</sup> pranon se rregullat që organizojnë gjuhën në mënyrë sintaksore veprojnë në grupe me elementë gjuhësorë, sintagmat; për faktin që ato bëjnë pjesë në përbërjen e njësisë sintaksore më të mëdha, sintagmat janë quajtur – sidomos kur ato u referohen funksioneve të tyre përbërëse – edhe konstituentë.

Jemi shprehur që sintagma është një grup elementësh gjuhësorë: për të qenë sa më formalë mund ta përkufizojmë sintagmën një njësi, mes fjalisë dhe leksemës (elementi i vetëm leksikor, “fjala”), mbi të cilën aplikohen rregullat e gramatikës.

Për aq kohë sa, në studimet gjuhësore<sup>100</sup>, termi sintagmë përdoret për t’ju referuar një grupi fjalësh, në gjenerativizëm quhet sintagmë edhe një element i vetëm leksikor, që do të mbartëte të njëjtat funksione sintaksore që do të kishte një grup fjalësh në një fjali. Praktikisht, konsiderojmë një sintagmë emërore “Zoti Shehu”, “Shehu” kur përdoren në një pozicion në të cilin shkëmbehen me njëri tjetrin dhe e bëjnë këtë për aq kohë sa pranojmë që sintagma është një njësi sintaksore e tërësishme, një lloj mjeti i përdorur në situata të caktuara (dhe vetëm në ato) dhe në varësi të madhësisë së saj, në disa raste. Pra, sintagmat kanë madhësi të ndryshme në varësi të përbërësve që ndodhen në të.

---

<sup>99</sup> Massimo Prada, *Annotazioni di sintassi generativa*, tërhequr më 05.06.2014 nga [http://webcen.di.unimi.it/2002-03/comdig/lingua\\_italiana2/files/248327.Sintassi%20generativa.pdf](http://webcen.di.unimi.it/2002-03/comdig/lingua_italiana2/files/248327.Sintassi%20generativa.pdf)

<sup>100</sup> Massimo Prada, *Annotazioni ...*, fq. 13

### 3.2 Teoria X bar

Teoria X-bar është një zhvillim i gramatikës gjenerative ku paraqitet mënyra me të cilën konstituentët realizohen në një fjali. Emërtimi *X-bar*, buron nga ajo që koka e sintagmës mund të ketë disa nivele (bars). Baza kryesore formuese qëndron në konstituentët të cilët janë njësi modulare të realizuara në mënyrë rikursive e të organizuara në shumë nivele.

Prada shprehet se teoria X-bar<sup>101</sup> është rikursive dhe modulare sepse parashikon që konstituentët, modulet sintaksore, mund të ndërthurren njëri me tjetrin, praktikisht pa kufij teorikë. Përveç kësaj teoria parashikon që ato të artikulojnë në shumë nivele në mënyrë që të bëhet i qartë fakti që folësi t'i bëjë ato të funksionojnë si konstituentë, sipas rregullave të mirëvendosura. Përdorimi i kësaj skeme është një mënyrë për të rimarrë konceptet për strukturën sintagmatike, të paraqitur me diagramin e pemës mbështetur në teorinë e Parimeve dhe Parametrave<sup>102</sup>.

Një nga parimet e kësaj teorie është parimi i kokës së sintagmës. Nuk ka sintagmë pa kokë. Pozicioni i kokës mund të caktohet definitivisht në çdo gjuhë duke i caktuar një vlerë parametrin kokë. Sintaksa X-bar ndërthurr leksikun me gramatikën përmes parimit të projekcionit. “Një strukturë X-bar përbëhet nga projeksione të kokave të seleksionuara në leksik”<sup>103</sup>. V. J. Cook dhe Mark Newson shprehen se nga njëra anë, kjo teori ka të bëjë me karakteristikat e kategorive leksikore emër, folje, mbiemër, parafjalë; nga ana tjetër, struktura sintaksore e frazës reflekton veçoritë e elementeve leksikore prej të cilave përbëhet<sup>104</sup>. Folja *push*, p.sh., duhet të ndiqet nga një sintagmë emërore SE plotësor në rolin kundrinës. Parimi i projekcionit, i cili projekton karakteristikat e njësive leksikore në sintaksë specifikon kontekstet e mundshme në të cilat mund të dalë një element leksikor. Sintagmat karakterizohen të gjitha nga një pjesë e caktuar e ligjëratës, përkatësisht nga: emri, folja, mbiemri, parafjala dhe ndajfolja. Të gjitha këto janë kategori leksikore dhe mund të përbëjnë atë që quhet **kokë** e sintagmës. Koka është i vetmi element që duhet të shfaqet detyrimisht në çdo përbërës të një kategorie të caktuar. Kur flasim për strukturën e sintagmës, përveç termit kokë, do të hasim edhe elementë të tjerë si **specifikuesit**, **plotësorët** dhe **modifikuesit**.

Për sa i përket kategorive leksikore të emrit E, foljes F, parafjalës P, mbiemrit M, Haegeman<sup>105</sup> shprehet se projekcionin sintagmatik të tyre mund ta paraqesim sipas skemave të mëposhtme:

---

<sup>101</sup> Massimo Prada, *Po aty*


<sup>102</sup> V. J. Cook, Mark Newson, 1996, *La grammatica universale - introduzione a Chomsky*

<sup>103</sup> Noam Chomsky, (1993). *Language and Thought* Wakefield, RI: Moyer Bell, fq. 6

<sup>104</sup> V. J. Cook, Mark Newson, *Po aty*


<sup>105</sup> Liliane Haegeman, *Introduction to Government and Binding Theory*, Second Edition, 1998, Blackwell Publishers Ltd, fq. 103-106





Pemët 2: Pemët e projeksioneve sintagmatike

Por duke u bazuar në përgjithësimet e teorisë X-bar do të mund ta paraqisim informacionin e mësipërm me anë të pemës së mëposhtme të strukturës së sintagmës:




Pema 3: X-bar

Ku  $X^0$  përfaqëson E, F, P, M. Pra, gramatika jonë nuk ka nevojë të ketë katër skema, por vetëm një. Format i përgjithshëm për strukturën e sintagmës është përmbledhur në rregullat e mëposhtme:

- XP  $\longrightarrow$  Spec; X'
- X'  $\longrightarrow$  X'; YP
- X'  $\longrightarrow$  X; YP

Teoria X – bar përcjell atë që është e njëjtë për strukturën e sintagmave. Plotësorët kombinohen me  $X^0$  për të formuar projeksionin X'; adjunktët kombinohen me X' për të formuar projeksionin e ndërmjetëm X'; specifikuesi kombinohet me nivelin më të lartë të X për të formuar projeksionin maksimal XP.

Ndonëse mendohet që ndarja në pemën strukturore është universale, rendi linear i konstituentëve, në bazë të kokës së projeksionit, nuk mund të përcaktohet në mënyrë universale, sepse duhen respektuar specifikimet që vijnë nga gjuhët. Kështu për gjuhën shqipe pema strukturore do të paraqitet si më poshtë:



Pemët 3, 4: Modele të pemëve strukturore për gjuhën shqipe

Këto pemë sintaksore tregojnë se koka  $X^0$  e projeksonit SX është e lidhur me dy projeksonet, atë të ndërmjetëm  $X'$  dhe atë maksimal SX, specifikuuesin dhe plotësorin SY lidhet me pozicionin e ndërmjetëm  $X'$ , kurse specifikuuesi lidhet vetëm me projeksonin maksimal SX. Marrëdhënia ndërmjet  $X^0$  dhe specifikuuesit nga një anë dhe plotësorit nga ana tjetër mund të përmblihet me projeksonin maksimal SX.

Nëse e trajtojmë më gjerë strukturën e sintagmës do të thoshim se një fëmijë që përthith ose kap një gjuhë nuk ka nevojë mësojë këtë skemë/pemë në momentin e ligjërimit. Në fakt fëmija ka nevojë për vetëm pak të dhëna të cilat do të mjaftonin për të bërë dallimet e rendit sipas gjuhës. Një fëmijë shqiptar do t'i mjaftonte të dëgjonte disa fjali me folje kalimtare për të kuptuar se foljet kalimtare në shqipe realizohen në pjesën më të madhe të rasteve duke u paraprirë plotësorëve (rasti Pema 3), por duke qenë se në shqipe rendi nuk është i ngurtësuar atëherë mund të realizohen gjithashtu edhe pas plotësorëve të tyre (rasti Pema 4).

Në lidhje me rendin e vendosjes së përbërësve të sintagmës duhet të kemi parasysh gjithashtu tipin e gjuhës, por është e rëndësishme të theksojmë se teoria X – bar i shpjegon me të njëjtin parim të gjitha renditjet e mundshme të përbërësve të sintagmave. Pikërisht, shkalla e lartë e përgjithësimi e bën këtë teori të zbatueshme jo vetëm për të gjitha llojet e sintagmave të gjuhëve, por edhe për të gjitha gjuhët. Mes këtyre përbërësve të sintagmës vendosen raporte të caktuara formale dhe kuptimore, të cilat kushtëzohen nga natyra e kokës së sintagmës.

Pra, përbërësit që formojnë sintagmat vendosen sipas një strukture të mirë organizuar, të udhëhequr nga një kokë, e cila është një kategori leksikore dhe që ngrihet gjithashtu në një projekson të caktuar duke formuar kështu një kategori sintagmatike<sup>106</sup>.

### 3.2.1 Specifikuuesi

<sup>106</sup> Shiko Liliane Haegeman, fq.87

Një vend të veçantë në pemën strukturore zë specifikuesi. Në kuadrin e teorisë X-bar Chomsky<sup>107</sup> prezantoi termin specifikues (1970a: 210), duke i bashkangjitur këtë element njësisive sintaksore si SF, SE, SP etj., duke e ilustruar grafikisht me skemën:

$$(1) \quad X'' \longrightarrow [\text{Spec}, X'] X'$$

Sipas kësaj pikëpamjeje, një specifikues përfshin një grup të shumëllojshëm të elementëve që bashkohen me projeksionin maksimal SX. Specifikuesit nuk mund të jenë kokë e sintagmës, roli i tyre është ndihmës. Ata shërbejnë për të treguar veçoritë gramatikore të kokës së sintagmës, prandaj quhen **specifikues**.

Ndër specifikuesit përfshihen nyjat, përemrat, fjalët e shkallës dhe llojet e ndryshme të fjalëve shërbyese. Sipas Chomsky-t, specifikues janë edhe përemrat lidhorë dhe lidhëzat në periudhat me fjali të varura si dhe kuptime gramatikore të foljes, si koha etj. Ashtu si për modifikuesit edhe për specifikuesit ka mendime të ndryshme. Disa autorë<sup>108</sup> përemrat dëftorë, fjalët e shkallës dhe kategori të tjera joleksikore nuk i quajnë specifikues. Kështu pra, sipas opinionit të përgjithshëm mund të themi se koka dhe plotësori i saj formojnë një përbërës që qëndron një nivel më lart, i cili paraprihet nga elementi tjetër, pra nga specifikuesi (Spec).

Jackendoff<sup>109</sup> (1977: 14) thekson se nuk është e qartë nëse Chomsky e konsideron specifikuesin si një konstituent apo një element shtesë për konstituent. Diagramet në modelin e Chomsky-t (1970) i tregojnë specifikuesit si konstituentë. Jackendoff (1977) mendon se specifikuesit nuk mund të trajtohen si konstituentë, ndërsa Hornstein<sup>110</sup> (1977) mbron tezën që ata janë konstituentë.

Megjithatë, përtej të qenit apo të mosqenit një konstituent dhe përtej lidhjes me kokën, nuk janë ende të qarta cilat janë karakteristikat përcaktuese të specifikuesit. Me zhvillimin e analizave/studimin mbi X-bar nga 1970 në 1980, gjithmonë e më shumë hasim elementët që Chomsky dhe Jackendoff i konsideronin si specifikues, tashmë konsiderohen/analizohen si kokë të një projeksioni funksional<sup>111</sup> (Abney: 1987). Chametzky<sup>112</sup> (2000) e përcakton termin specifikues me karakteristikat e mëposhtme: (i) zakonisht një sintagmë emërore, (ii) lidhet në mënyrë të veçantë me kokën. Në studimet e fundit mbi strukturën e sintagmës, specifikuesi është trajtuar si një element problematik dhe gjuhëtarë të ndryshëm pohojnë se ajo nuk duhet të jetë pjesë e strukturës së sintagmës. P.sh. Kayne<sup>113</sup> (1994) paraqet një model të ri të strukturës së sintagmës ku sugjeron se një rend universal për specifikuesin mund të jetë si më poshtë:

---

<sup>107</sup> Noam Chomsky, *Remarks on nominalization*. Readings in English Transformational Grammar, Roderick A. Jacobs and Peter S. Rosenbaum (eds.), Waltham, Mass.: Ginn, 1970a, fq. 210

<sup>108</sup> Rami Memushaj, *Gjuhësia Gjenerative*, SHBLU, 2003, fq. 129, referuar nga Lieber, R., (1992) *Deconstructing Morphology*, The University of Chicago Press, 38-39

<sup>109</sup> Ray Jackendoff, *X-bar Theory*. Cambridge, MA: The MIT Press, 1977, fq. 14

<sup>110</sup> Norbert Hornstein, *S and X-bar convention*. Linguistic Analysis 3, 1977, fq. 137-176.


<sup>111</sup> Steven Abney, *The English Noun Phrase in its Sentential Aspect*. Disertacioni doktorate, MIT, 1987

<sup>112</sup> Robert A. Chametzky, *Phrase Structure: From GB to Minimalism*. Malden: Blackwell, 2000

<sup>113</sup> Richard S. Kayne, *The Antisymmetry of Syntax*. Cambridge, MA: The MIT Press, 1994


(2) specifikues → kokë → plotësor

U mbetet studimeve të mëvonshme mbi strukturën e sintagmës të vlerësojnë rolin dhe pozicionin e specifikuesit si pjesë apo jo në strukturën/përbërjen në sintagmë. Në këtë punim specifikuesi trajtohet sipas pozicionit të shprehur në pemën e mëposhtme, me simbolin YP, i cili bashkohet gjithmonë me projektionin maksimal XP dhe është motër e projektionit të ndërmjetëm X', që qëndron ndërmjet X dhe XP. YP dhe X' konsiderohen si bija të XP, projektionit maksimal:




Pema 5: Pema e specifikuesit

Nëse do të paraqitnim pemën e sintagmave sipas kësaj skeme në mënyrë të thjeshtuar për **Dielli** ndriçon tokën:




Pema 6: Dielli ndriçon tokën

do të shohim se sintagma emërore SE **dielli** është vendosur në pozicionin e specifikuesit si motër e projektionit të ndërmjetëm EPT'. Në rastin e sintagmës emërore SE **Një libër i bukur** do të përftonim pemën strukturore:



Pema 7: SE një libër i bukur

ku përemri i pacaktuar *një* është vendosur në pozicionin e specificikuesit si motër e projekcionit të ndërmjetëm SE'. Por në rastin e sintagmës foljore SF *Ecën shpejt* do të përftonim pemën strukturore:




Pema 8: Ecën shpejt

ku pozicioni i specificikuesit është bosh.

### 3.2.2 Modifikuesi

U shprehëm sa më sipër se plotësorët janë argumente të brendshme që zgjidhen nga koka e sintagmës. Ato janë elemente të domosdoshme. Për sa u përket modifikuesve, përmbajtja e tyre është më pak e qartë, pasi në literaturën për teorinë X – bar rrallë bëhet dallimi mes modifikuesve dhe specificikuesve. Sipas një propozimi, me modifikues duhen kuptuar përbërësit e sintagmës që kanë funksion kufizues ndaj kokës leksikore dhe, si të tillë, ata lidhen me emrin, i cili ka nevojë për kufizimin e kuptimit. Ndryshe nga plotësori, modifikuesi nuk është element i domosdoshëm kuptimor ose strukturor.

P.sh. në pemën strukturore të sintagmës emërore SE *llamba mbi tavolinë* do të thoshim se *tavolinë* është një plotësor i përemrit *mbi*, pra një sintagmë parafjalore SP, *mbi tavolinë* dhe e gjithë kjo SP shërben si modifikues i emrit *llamba*.



Pema 9: SE llamba mbi tavolinë

Gjuhëtarët<sup>114</sup> shprehen se modifikuesi është një element dytësor në strukturën e sintagmës duke qenë se nuk është i domosdoshëm në fjali. Një modifikues e kufizon, e thekson apo cilëson kuptimin e fjalës/kokës që ka pranë. Modifikuesi mund të hiqet pa prishur kuptimin bazë të fjalisë. P.sh. në fjalinë *Petriti bleu një libër sot* “sot” është një modifikues i foljes *bleu*. Sjell kuptim plotësues për foljen *bleu*. Po ashtu në fjalinë *Ky është një top i kuq*, mbiemri *i kuq* është një modifikues i emrit *topi*. Mungesa e modifikuesit nuk do ta prishte kuptimin e fjalisë, por do ta shndërronte atë në: *Ky është një top* – pra në një fjali gramatiksht të saktë.

Koncepti modifikues është shprehur edhe me terma të tjera, ndër të cilat mund të përmendim termat si përcaktorë, cilësues dhe adjunkt. Këto koncepte ndryshojnë nga koncepti e elementeve si plotësor dhe argument të cilët janë elementë të domosdoshëm të fjalisë. P.sh. në shembullin *Fytyra e tij u bë e kuqe* në këtë rast *e kuqe* do të konsiderohet si një plotësor/argument i foljes *u bë* dhe jo një modifikues sepse mungesa e tij do ta bënte fjalinë jogramatike *\*Fytyra e tij u bë*.

### 3.2.3 Endocentriteti

Mark Newson<sup>115</sup> shprehet se një rrjedhojë e qartë e nocionit të projektimit është se nuk mund të hasim kurrë një sintagmë që paraqitet si një kategori e caktuar, me një kokë të një kategorie tjetër. Pra nëse kemi një sintagmë foljore, koka e kësaj sintagme duhet të jetë pa tjetër një folje. Por nga ana tjetër, ideja që mund të gjejmë një sintagmë të cilës i mungon koka, nuk është edhe aq absurd. Ka një dallim tradicional ndërmjet elementëve gjuhësore endocentrikë dhe atyre ekzocentrikë. Dallimi mes të dy koncepteve është bërë fillimisht nga Bloomfield<sup>116</sup> (1930). Një sintagmë endocentrike i fiton karakteristikat e saj

<sup>114</sup> <http://grammar.about.com/od/mod/modterm.htm>

<sup>115</sup> Mark Newson etj., *Basic English Syntax with Exercises*, 2006, Bölcsész Konzorcium HEFOP Iroda, fq. 89

<sup>116</sup> Leonard Bloomfield, *Language*. New York: Henry Holt, 1933. tërhequr në 13.06.2014 nga [http://en.wikipedia.org/wiki/Endocentric\\_and\\_exocentric#cite\\_note-2](http://en.wikipedia.org/wiki/Endocentric_and_exocentric#cite_note-2)

nga një element i caktuar që është përbërës i saj dhe si rrjedhim ky element mund të funksionojë si sintagmë më vete. Le ta ilustrojmë si më poshtë:

- (1) a. Unë pashë [tre mace të bardha]
- b. Unë pashë [mace]

Një sintagmë ekzocentrike nga ana tjetër nuk përmban ndonjë element që ka të njëjtën funksion si një sintagmë e vetme dhe për më tepër duket se ka karakteristika të pavarura nga elementët që përmban në tërësi kjo sintagmë. Një shembull standart i një sintagme ekzocentrike është:

- (2) a. Ne pamë atë [në park]
- b. \*ne pamë atë [në]
- c. \*ne pamë atë [park]

Kjo çështje është disi komplekse. Qasja tradicionale kombinon kategorinë dhe funksionin në mënyrë të tillë që nuk është fort e përshtatshme. Çështja është se rregullat X-bar përcaktojnë se, kategorikisht, të gjitha sintagmat janë endocentrike; me fjalë të tjera të gjitha sintagmat kanë në përbërje një kokë, e cila përcakton natyrën e kategorisë së tyre.

Por ka një ndërtim gramatikor që duket me një vështrim të parë sikur qëndron jashtë sistemit X-bar për faktin se mungon një kokë, dhe përkatësisht bëhet fjalë për fjalinë. Nga perspektiva funksionale fjalia nuk përmban elementë që mund të zëvendësojnë të gjithë ndërtimin, sepse as SE kryefjalë dhe as sintagma foljore mund të funksionojnë si kokë të fjalisë:

- (3) a. [Suzana] [qëlloi Markun]
- b. [Suzana]
- c. [qëlloi Markun]

Shembujt në (3) kanë natyrë të ndryshme, qoftë edhe nga ana e kategorisë që shprehin. Shpesh është argumentuar se sintagmat foljore mund të shërbejnë si fjali.

Si rrjedhim, mund të duket se fjalitë janë ndërtime ekzocentrike, të cilat nuk kanë kokë dhe si rrjedhim qëndrojnë jashtë sistemit X-bar. Por gjenerativizmi e ka sfiduar këtë përfundim tradicional duke provuar që fjalitë kanë kokë, pavarësisht se koka e tyre nuk është vetë kryefjala apo vetë sintagma foljore.

Me zbatimin e Teorisë X-bar në Gramatikën Transformuese<sup>117</sup> në 1970, ndarja ekzocentrike e fjalisë u la mënjanë duke i lënë vendin analizave endocentrike, ku fjalia shihet si një sintagmë eptimore (SEPT), që është pra një projektim i eptimit (EPT). Nga

---


<sup>117</sup> Noam Chomsky, *Syntactic structures*. The Hague: Mouton tërhequr në 13.06.2014 nga [http://en.wikipedia.org/wiki/Endocentric\\_and\\_exocentric#cite\\_note-2](http://en.wikipedia.org/wiki/Endocentric_and_exocentric#cite_note-2)

kjo perspektivë, teoria X-bar është një teori e përgjithshme, e zbatueshme në të gjitha ndërtimet e gjuhëve natyrore.

### 3.2.3.1 Koka

Eptimi [EPT] është një rezultat i rëndësishëm i teorisë së drejtimit dhe lidhjes sipas Chomsky-t<sup>118</sup> (1986), ku shprehet se fjalitë janë ndërtime endocentrike me kokë sintaksore eptimin (EPT). Kjo pikëpamje zëvendëson një traditë të gjatë që i paraqiste fjalitë si ndërtime të përbëra nga dy pjesë të mëdha, kryefjala dhe folja; një teori e formuar në fillimet e rregullave strukturore të sintagmës sipas Chomsky-t (1957).

Siç e kemi përmendur edhe më lart Koka e projekcionit është një projekcion 0 ( $X^0$ ), në nivelin e parë, e cila i jep emrin strukturës. Kokat janë nyjat përfundimtare: ato dominojnë fjalët. Pra, Koka e sintagmës mendohet se është fleksioni (eptimi) i shënuar në pemën strukturore<sup>119</sup> me EPT.



Pema 10: Sintagma eptimore SEPT

Siç është paraqitur edhe në pemën strukturore, eptimi EPT është kokë e fjalisë, kurse SEPT është projekcion maksimal i eptimit.

Në analizat e gramatikës gjenerative elementet përbërëse të sintagmës ndahen në elemente leksikore dhe funksionale. Kjo ndarje shkon më tej duke ndarë edhe kokat e sintagmave në koka leksikore dhe funksionale. Kokët leksikore janë emri, folja, përemri, parafjala, ndajfolja, ndërsa për sa i përket tipareve kryesore të elementeve funksionale ato kanë karakteristikat si më poshtë<sup>120</sup>:

- formojnë klasa leksikore të mbyllura.
- janë të varur fonologjikisht dhe morfologjikisht
- lejojnë vetëm një plotësor, i cili në përgjithësi nuk është argument. Si rrjedhim, ka pak ose aspak variacion leksikor në kategorinë funksion kundrejt kategorive plotësor.
- elementet funksionale zakonisht janë të pandashme nga plotësorët e tyre.

<sup>118</sup> Noam Chomsky, *Barriers*. Cambridge, MA: MIT Press, 1986.

<sup>119</sup> Sam Featherston, *The finite verb and the clause: IP*, tërhequr në 22.01.2015 nga <http://www.sfs.uni-tuebingen.de/~sam/teach/IntroGenLing/handouts/syn6HO.pdf>


<sup>120</sup> Hysnie Hyska, Punim Masteri, Dorëshkrim “*Sintagma Emërore në Gjuhën Shqipe*”, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Departamenti i Gjuhës Shqipe, Tiranë 2009 fq. 10 referuar nga Chamtzky, *Phrase Structure in Principles and Parameters Syntax*, f. 21.



– nuk kanë përmbajtje, semantika e tyre është e dorës së dytë.


### ***3.3 Marrëdhëniet ndërmjet nyjeve të pemës strukturore***

Konstituentët janë grupe fjalësh që funksionojnë si një njësi e vetme. Ata janë të vendosur në pemën sintaksore sipas disa rregullave të caktuara, që kanë të bëjnë me pjesët përbërëse të pemës dhe rregullat që gjenerojnë pemën strukturore<sup>121</sup>. Pjesë të ndryshme të pemëve strukturore janë organizuar në mënyrë hierarkike. Haegeman<sup>122</sup> shprehet se kur flasim për një pemë strukturore është e nevojshme të kemi parasysh një sërë termash teknikë të cilët përshkruajnë marrëdhëniet ndërmjet elementëve në pemë. Pema sintaksore përbëhet nga disa nyje të cilat emërtohen në mënyra të ndryshme. Disa quhen nyje fundore, disa quhen nyje jofundore. Disa nyje të tjera emërtohen me fjalë që tregojnë lidhje farefisnie si motër, bijë. Karakteristikë e këtyre nyjave është se ato hyjnë në marrëdhënie me njëra tjerën. Nyjat fundore emërtohen me fjalë nga fjalori, kurse nyjat jo fundore emërtohen me sintagma, si më poshtë:



Pema 11: *Nyjat e pemës strukturore të sintagmës foljore SF FLE*

Këtu kemi një pemë të një sintagme foljore SF. Nyjat janë SF dhe F. SF është një jofundore, ajo emërtohet me një njësinë sintaksore SF. F është nyje fundore, ajo emërtohet me një fjalë nga leksiku, folja FLE.



Pema 12: *Nyjat e pemës strukturore të sintagmës emërore SE LULE*

Marrëdhëniet ndërmjet nyjave të pemës sintaksore janë disa: dominimi, paraprirja, c-komanda, m-komanda dhe drejtimi, të cilat do t'i shohim si më poshtë.

---

<sup>121</sup> Noam Chomsky, *Barriers*. Cambridge, MA: MIT Press (1986)


<sup>122</sup> Liliane Haegeman, *Introduction to Government and Binding Theory*, Second Edition, (1998), Blackwell Publishers Ltd, fq. 85

### 3.3.1 Dominimi

Përbërësit/Elementët vendosen në pemë me anë të një rendi të caktuar, në nivelet e caktuara. Ato paraqiten në node/ nyjet e degëve ku disa node janë në nivel më të lartë në pemë se nodet e tjera. Kjo ka të bëjë me faktin se ka një hierarki konstituentësh në pemë. Në veçanti duhet të theksojmë nodet që janë në nivele më të larta ose më të ulta dhe lidhjen ndërmjet tyre. Marrëdhënia që përshkruan të dy nodet në konfigurimin e një peme quhet **dominim**<sup>123</sup>. Nyja që vendoset mbi një nyje tjetër dhe lidhet me të me një degë, e dominon nyjen që ka poshtë.

(1) *Dominimi: Nyja A dominon nyjen B vetëm dhe nëse A është më lart në pemë se B dhe nëse heqim një vizë nga A në B ajo do të shkojë vetëm poshtë.*

Në pemën strukturore (13) të paraqitur nga Carnie (2006) si më poshtë shihet që M dominon të gjitha nyjet e tjera (N, O, D, E, F, H, I, J). N dominon D, E, dhe F, ndërsa O dominon H, I, J. O nuk dominon F, duke qenë se nuk mund të heqim një vizë apo nuk ka një degë që të lidhë këto dy nyje.



Pema 13: *Dominimi*

Dominimi është në thelb një marrëdhënie e përbajtjes së sintagmës. Sintagma N përmban si nyje fundore D, E dhe F. Përbajtja është më e qartë kur pema zëvendësohet/shndërrohet në diagram me kllapa si më poshtë në (2):

(2) [M [N D E F] [O H I J]]

Në (2) kllapat e lidhura me N ([N D E F]) përmbajnë nyjet D, E, dhe F. E njëjta gjë ndodh për O e cila përmban H, I, dhe J. M i përmban të dyja N dhe O dhe të gjitha nodet/nyjet që ato vetë përmbajnë. Kështu dominimi është një mënyrë teknike për të shprehur/ paraqitur se cilat njësi sintaksore i përkasin njësisive sintaksore më të mëdha.

<sup>123</sup> Andrew Carnie, *Syntax: a Generative Introduction, Second Edition*, Blackwell Publishers Ltd, 2006, fq. 104

### **3.3.1.1 Dominimi i drejtpërdrejtë**

Dominimi është një nocion i përgjithshëm; nëse rimarrim pemën strukturore (13) si më lart, M dominon të gjitha nyjet poshtë tij. Në disa raste është e nevojshme të paraqesim marrëdhënien ndërmjet njësive më të vogla. Kjo është marrëdhënia e drejtpërdrejtë. Një nyjë dominon drejtpërdrejt një tjetër nyjë nëse lidhet me të vetëm një degë.

(3) *Dominimi i drejtpërdrejtë: Nyja A dominon drejtpërdrejt nyjen B nëse nuk ka një tjetër nyjë G që të dominohet nga A, por ajo dominon drejtpërdrejt B.*

Në pemën strukturore (13)<sup>124</sup>, M dominon të gjitha nyjet e tjera në pemë, por ajo dominon drejtpërdrejt vetëm N dhe O. Ajo nuk dominon drejtpërdrejt nyjet e tjera sepse kemi ndërhyrjen e nyjes N dhe O. Ka një sërë elementësh joformalë që përdoren shpesh kur i referohemi dominimit të drejtpërdrejtë. Këto elementë bazohen në faktin që pemët sintaksore/ strukturore përngjajnë me pemët familjare. Nëse një nyjë dominon drejtpërdrejtë një tjetër nyjë do të thotë se ajo është nyja nënë; nyja që dominohet drejtpërdrejtë quhet nyjë bijë. Në pemën e mësipërme (1), N është nëna e D dhe D është e bija e N. Mund ta zgjerojmë analogjinë me pemën familjare duke thënë se M është gjyshja e D.

*Nënë: A është nëna e B nëse A dominon drejtpërdrejt B.*

*Bijë: B është e bija e A nëse B dominohet drejtpërdrejt nga A.*

E përafërt me këto përcaktime është dhe termi motër.

*Motër: Dy nyjë të cilat kanë të njëjtën nënë.*

Për sa i përket përcaktimeve në lidhje me temat mund të themi gjithashtu se:

*Nyja rrënjë: Nyja që dominon të gjitha nyjet dhe nuk dominohet nga ndonjë nyjë tjetër. (Nyja që nuk është nyjë bijë).*

*Nyja përfundimtare: Nyja që nuk dominon gjë. (Një nyjë që nuk është nyjë nënë).*

*Nyja jo përfundimtare: Nyja që dominon një tjetër nyjë. (Një nyjë që është një nënë).*

### **3.3.2 Paraprirja**

---

<sup>124</sup> Po aty, fq. 107

Pemët strukturore nuk paraqesin vetëm organizimin hierarkik të fjalisë, ato paraqesin gjithashtu edhe rendin linear të konstituentëve. Rendi linear ka të bëjë me rendin me të cilin fjalët thuhën në ligjërim ose shkruhen. Për rastin e gjuhës shqipe rendi do të jetë nga e majta në të djathtë, duke e paraqitur sipas skemës së mëposhtme:

$$(1) \quad M \rightarrow A B$$

Ky rregull nuk thotë vetëm se M dominon A dhe B dhe përbëhet nga A dhe B. Gjithashtu tregon se A duhet të paraprijë B në rendin linear. A duhet thënë para B në ligjërim, sepse ajo paraqitet në të majtë të B sipas rregullit. Marrëdhënia ndërmjet përbërësve të fjalisë që ka të bëjë me “cilin element/përbërës vendosim para tjetrit” quhet **paraprirje**. Carnie<sup>125</sup> shprehet se për ta paraqitur sa më saktë këtë nocion do të ishte e nevojshme të njiheshim me termin paraprirja motër sipas Chomsky-t (1986):

(2) *Paraprirja Motër: Nyja A thuhet se kryen paraprirje motër të nyjes B nëse dhe vetëm nëse të dyja ndjekin shigjetën në rregullin e strukturës sintagmatike dhe A shfaqet në të majtë të B (p.sh,  $C \rightarrow \dots A \dots B \dots$ )*


Më tej ai shprehet se duke patur parasysh sa më lart do të mund të japim një përcaktim më të përgjithshëm të paraprirjes:

(3) *Paraprirja: Nyja A paraprin nyjen B nëse dhe vetëm nëse as A nuk dominon B dhe as B nuk dominon A; ka një tjetër nyjë E që dominon A dhe një tjetër nyjë F që dominon B, dhe E kryen një paraprirje motër të F, ose vetë A kryen paraprirje motër të B.*

Duke qenë se ky përcaktim është pak i ndërlikuar, do të ishte me vend ta ndanim në pjesë. Pjesa e parë thotë se “as A nuk dominon B dhe as B nuk dominon A”. Arsyja për këtë është e vetëkuptueshme. Carnie na sjell shembullin e mëposhtëm. Nëse kemi një kuti me një top brenda, nuk mund të themi se kutia ndodhet në të majtë të topit. Është e pamundur fizikisht. Kutia e rrethon topin. E njëjta gjë ndodh edhe me dominimin. Pra nuk mund të dominosh dhe të paraprish apo ndjekësh. Pjesa e dytë e përcaktimit thotë “ka një tjetër nyjë E që dominon A dhe një tjetër nyjë F që dominon B, dhe E kryen një paraprirje motër të F”. Carnie (2006) shprehet se kjo mund të jetë një mënyrë komplekse për të thënë “majtas”. Kjo ka të bëjë me faktin që nyjet përfundimtare të një peme dominohen nga të tjera nyje që mund të paraprijnë ose të ndjekin. Nëse analizojmë pemën si më poshtë (14):

---


<sup>125</sup> Po aty, fq. 108



Pema 14: Paraprirja

Do të shohim se folja *puth-i* është vendosur në të majtë të emrit *djali*. Në fakt, nuk do të ishte e saktë të thoshim se folja *puthi* paraprin emrin *djali* duke qenë se fjalia është ligjëruar “*Djali puthi qenin*” ku folja *puthi* ndjek emrin *djali*. SE kryen paraprirje motër të SF sepse sipas rregullit të fjalisë: *Fjalia* → SE SF. Kjo do të thotë se [E djali] paraprin [F puthi], sepse SE paraprin SF. Gjithashtu [E djali] paraprin [SE qenin].

Carnie (2006) shprehet gjithashtu se pjesa e dytë e përcaktimit gjithashtu lejon të shpjegojmë një kufizim të rëndësishëm të pemëve strukturore: Nuk mundet që degët të kryqëzohen. Pemë strukturore si (15) janë të papranueshme (është e pamundur të gjenerosh rregulla për strukturën e sintagmës nga këto pemë strukturore):



Pema 15: Shembull për pemë të gabuara strukturore

Në këtë pemë, Q është vendosur në të majtë të R, pra duke paraprirë R, por duke u bazuar në rregullin e paraprirjes sa më lart, kjo pemë nuk është gramatikore. Q është në të majtë të R, por O e cila dominon Q nuk është. Me fjalë të tjera, nuk mund të kryqëzohen degët. Një tjetër mënyrë e paraqitjes së sintagmës është dhënë si më poshtë në (4):

(4) *Kufizimi i kryqëzimit të degëve: Nëse një nyje X paraprin një tjetër Y atëherë X dhe të gjitha nyjet e dominuara nga X duhet të paraprijnë Y dhe të gjitha nyjet e dominuara nga Y.*

Siç ndodhi edhe në marrëdhënien e dominimit ku ka një përcaktim lokal të quajtur “dominim i drejtpërdrejtë,” ka një formë lokale të paraprirjes të quajtur “paraprirje e drejtpërdrejtë”:

(5) *Paraprirja e drejtpërdrejtë: A paraprin drejtpërdrejt B nëse nuk ka nyje G që ndjek A por paraprin B.*

### 3.3.3 C-komand (komanda e konstituentit ose e përbërësit)

Sipas studiuesve <sup>126</sup> c-komanda ose komanda e konstituentit është nga marrëdhëniet strukturore më të rëndësishme. Ajo është më e përdorura nga të gjitha marrëdhëniet. Kjo dukuri shprehet si më poshtë në (1) dhe më formalisht në (2):

(1) *Një nyje c-komandon motrat e veta dhe të gjitha bijat (dhe mbesat e stërmbesat) e motrave të saj.*


(2) *C-komand: Nyja A c-komandon nyjën B, nëse çdo nyje që dominon A gjithashtu dominon dhe B, dhe as A e as B nuk e dominojnë atë në të kundërt.*

Konkretisht<sup>127</sup>, sipas përkufizimit të c-komandës, çdo nyje c-komandon motrën e saj dhe bijat e motrës së saj. Për shembull, në skemën e mëposhtme (16), A nuk c-komandon ndonjë nyje tjetër përderisa nuk ka asnjë motër. Nyja B c-komandon G, H dhe I sepse motra e B është G e cila përmban H dhe I. C c-komandon vetëm D, sepse kjo është motra e saj, që nuk përmban asnjë përbërës tjetër; po ashtu edhe D c-komandon vetëm C. E dhe F c-komandojnë vetëm njëra-tjetrën, sepse janë motra dhe nuk kanë përbërës të tjerë. G c-komandon B, C, D, E dhe F sepse B është motra e G dhe ka përbërësit C, D, E, F. H dhe I po ashtu c-komandojnë vetëm njëra-tjetrën sepse janë motra dhe nuk kanë bija të tyre.

---

<sup>126</sup> Andrew Carnie, *Syntax: a Generative Introduction, Second Edition*, Blackwell Publishers Ltd, 2006, fq. 111


<sup>127</sup> Anila Çepani, *Dorëshkrimi doktorate “Anafora në gjuhën shqipe”*, 2011, fq. 26



- B c-komandon G, H, I
- G c-komandon B, C, D, E, F
- C c-komandon D;
- D c-komandon C, E, F
- H c-komandon I
- I c-komandon H
- E c-komandon F
- F c-komandon E

Pema 16<sup>128</sup>: C-komanda

Nëse nisemi nga pema strukturore (17):



Pema 17: marrëdhëniet ndërmjet përbërësve

vëmë re se midis secilës njëje vendosen këto lloj marrëdhëniesh:

- *A është e lirë, për shkak se ajo as nuk c-komandohet e as nuk bashkindeksohet me ndonjë njëje tjetër.*
- *B është e lidhur nga D. D c-komandon B dhe B është e bashkindeksuar me D.*
- *C është e lirë (ajo nuk është e c-komanduar).*
- *D është e lidhur nga B. B c-komandon D dhe D është e bashkindeksuar me B.*
- *E është i lirë (ajo nuk është e bashkindeksuar me ndonjë njëje).*
- *F është e lidhur nga C. C c-komandon F, F dhe është e bashkindeksuar me C.*


Ka disa lloje të c-komandës. E para është kur dy njëje c-komandojnë njëra tjetrën. Ky quhet c-komandim simetrik dhe përcaktohet në (3):

(3) *C-komanda simetrike: Një c-komandë simetrike c-komandon B, nëse A c-komandon B dhe B c-komandon A.*

Kjo marrëdhënie zhvillohet vetëm ndërmjet motrave. Lloji tjetër i c-komandës zhvillohet ndërmjet një tezeje dhe mbesave të saj. Ky quhet c-komandimi asimetric:

<sup>128</sup> Po aty

(4) *C-komanda asimetrike*: A komandon asimetrikisht B nëse A c-komandon B por B nuk e c-komandon A.




Pema 18: *C-komanda simetrike dhe asimetrike*

Konkretisht, nëse e ilustrim me pemën strukturore në (18); N dhe O c-komandojnë simetrikisht njëra tjetrën (siç bëjnë të gjitha çiftet e motrave). Megjithatë, N c-komandon asimetrikisht A, B, C, D duke qenë se asnjë prej tyre nuk c-komandon N.

### 3.3.4 Drejtimi

Duke qenë se për dominimin dhe paraprirjen kemi versione lokale (të drejtpërdrejta), gjithashtu edhe për c-komandën kemi një version të tillë. Carnie<sup>129</sup> shprehet se ky version quhet **drejtimi** (dhe jo c-komandë e drejtpërdrejtë). Ka një sërë përcaktimesh për drejtimin. Nëse i kthehemi pas përcaktimeve për paraprirjen e drejtpërdrejtë dhe dominimin e drejtpërdrejtë, do të shohim se në të dyja rastet afërsia e marrëdhënieve përcaktohet në këtë mënyrë: në (19a) nuk ka një ndërmjet A dhe B, kështu që A dominon drejtpërdrejt B. Nga ana tjetër në (19b) G është ndërmjet tyre, kështu që A nuk e dominon drejtpërdrejt B.



Pema 19: *Dominimi i drejtpërdrejtë*

<sup>129</sup> Carnie, *Po aty*, fq. 113



E njëjta ide zhvillohet edhe në paraprirje. Në (20a), A paraprin drejtpërdrejt B sepse nuk ka diçka ndërmjet tyre; në (20b) A paraprin B, por ajo nuk paraprin drejtpërdrejt B, sepse G ndërhy.




Pemët 20: Paraprirja e drejtpërdrejtë

Drejtimi<sup>130</sup> përcaktohet në të njëjtën mënyrë:

(1) *Drejtimi (versioni i parë)* Nyja A drejton nyjen B nëse A c-komandon B, dhe nuk ka një tjetër G, pra që G të c-komandohet nga A dhe G të c-komandojë B.

Drejtimi është ilustruar me pemën strukturore në (20):



Pema 20: Drejtimi


Në këtë pemë A drejton B. Ajo c-komandon B, dhe nuk ka një tjetër që c-komandon B që A gjithashtu c-komandon. (Duhet të kemi parasysh që A gjithashtu drejton N sipas këtij përcaktimi, A c-komandon N, dhe nuk ka asnjë një që N të c-komandojë që gjithashtu të c-komandojë A. E kundërta është gjithashtu e vërtetë, N drejton A sepse marrëdhënia ndërmjet A dhe N është c-komandë simetrike. B nuk drejton A sepse B nuk e c-komandon A).

Në vitet e fundit, elementi drejtim ka humbur peshën që ka patur. Ndërkohë marrëdhëniet lokale që më parë lidheshin me drejtimin, tashmë shpjegohen me atë që quhet marrëdhënie ndërmjet specifikuesit dhe kokës.


<sup>130</sup> Po aty...

### 3.3.5 M-komanda dhe drejtimi

Për të dhënë një panoramë të m-komandës brenda kuadrit të marrëdhënieve strukturore jemi mbështetur në analizën e Haegeman (1998) duke rimarrë konceptet e Chomsky-t mbi marrëdhëniet strukturore (Barriers; 1986). Në pemët strukturore të sintagmave foljore SF si më poshtë:



Pema 21: M-komanda dhe drejtimi 1



Pema 22: *M-komanda dhe drejtimi 2*

Haegeman<sup>131</sup> shprehet se nëse rimarrim përcaktimet për c-komandën dhe drejtimin sa më lart, do të kuptojmë se marrëdhënia ndërmjet foljes *F la* dhe sintagmës parafjalore *SP në vjeshtë* në (21) është e ndryshme nga marrëdhënia ndërmjet foljes *F iku* dhe sintagmës parafjalore *në vjeshtë* në (22), megjithëse në të dyja rastet sintagma parafjalore *SP* është një adjunkt kohe.

Në (21) folja *F la* c-komandon sintagmën emërore *SE punën*, të cilën e drejton dhe në fakt e theta drejton. Në vazhdim të përcaktimeve sa më lart, folja *F la* nuk e c-komandon apo drejton sintagmën parafjalore *SP në vjeshtë*. Folja *F* nuk e c-komandon sintagmën parafjalore *SP* sepse nyja e parë që e dominon atë është projeksion më i ulët, *F'*, i cili nuk dominon sintagmën parafjalore *SP*. Folja *F* nuk e drejton sintagmën parafjalore *SP* sepse nuk e c-komandon atë.

Në (22), folja *F iku* c-komandon sintagmën parafjalore *SP në vjeshtë*: nyja e parë dominuese është niveli më i lartë i projeksionit në *F'*, i cili gjithashtu dominon sintagmën parafjalore *SP*. *SP* gjithashtu c-komandon foljen *F* duke qenë se nyja e parë që dominon sintagmën parafjalore *SP* është niveli i lartë i foljes *F'*, i cili dominon gjithashtu edhe vetë foljen *F*. Për ta përmbledhur mund të themi se në (22) folja *F* dhe sintagma parafjalore *SP në vjeshtë* c-komandojnë njëra tjetrën. Folja *F* c-komandon përemrin *P* dhe sintagmën emërore *SE*; parafjala *P* dhe sintagma emërore nuk c-komandojnë foljen *F*.

Haegeman shprehet se folja *F* drejton dhe c-komandon sintagmën parafjalore *SP në vjeshtë* në (22), por nuk ndodh e njëjta gjë në (21). Për më tepër ajo shton se në

<sup>131</sup> Liliane Haegeman, *Introduction to Government and Binding Theory*, Second Edition, 1998, Blackwell Publishers Ltd, fq. 136

mënyrë intuitive duket sikur të dyja foljet, *lë* dhe *iku*, kanë të njëjtën marrëdhënie me sintagmën parafjalore SP në vjeshtë.

Në studimet<sup>132</sup> e gramatikës gjenerative drejtimi dhe c-komanda janë diskutuar gjerësisht. Mbi bazën e një sërë analizash empirike dhe teorike është propozuar se në konfigurime si ato në (21,22) folja F duhet të drejtojë në mënyrë uniforme sintagmën parafjalore SP në të dyja rastet (21) dhe (22). Në mënyrë që të mbërrijmë në këtë përfundim, të dyja nocionet e c-komandës dhe të drejtimit janë riformuluar në kuadër të projeksioneve maksimale.

Në Barrierat (Barriers), Chomsky (1986b:8) propozon përcaktimet e mëposhtme të c-komandës:

(1) *C-komanda: A c-komandon B nëse dhe vetëm nëse A nuk e dominon B dhe çdo X që dominon A gjithashtu dominon edhe B.*


*Për sa i përket X janë marrë parasysh dy aspekte. Kur X është i barabartë me nyjen e degës së parë, atëherë do të përftojë përcaktimin e c-komandës si më poshtë:*

*c-komanda: Nyja A c-komandon nyjen B nëse dhe vetëm nëse A nuk e dominon B dhe B nuk e dominon A, dhe nyja e degës së parë që dominon A gjithashtu dominon edhe B.*


Kjo marrëdhënie strukturore është quajtur **c-komanda e rreptë**. Nga ana tjetër X interpretohet si projekcioni maksimal. Sipas interpretimit të fundit në (1) mund të themi ndryshe se A **m-komandon** B.

---

<sup>132</sup> Haegeman, *Po aty*



Pema 21: M-komanda dhe drejtimi 1



Pema 22: M-komanda dhe drejtimi 2

Nëse e ilustruam këtu përcaktim me shembujt sa më lart në (21/22) do të thoshim se folja F *lë* c-komandon sintagmën emërore SE *punën* në (21), por jo sintagmën parafjalore SP *në vjeshtë*. Nga ana tjetër, folja F m-komandon të dyja sintagmën emërore SE *punën* dhe sintagmën parafjalore SP *në vjeshtë*, gjithashtu parafjalën *në* dhe sintagmën emërore *vjeshtë*. Parafjala P c-komandon sintagmën emërore SE *vjeshtë*, dhe parafjala P gjithashtu m-komandon sintagmën emërore SE *vjeshtë*. megjithatë, parafjala P nuk e c-komandon foljen F; P', nyja e degës së parë që dominon parafjalën P, nuk e dominon foljen F. P nuk e m-komandon F gjithashtu sepse ka një projektion maksimal SP i cili dominon P dhe nuk dominon F. Në pemën strukturore (22) folja F c-komandon sintagmën parafjalore SP (ndryshe nga pema strukturore (21), dhe ajo gjithashtu m-komandon sintagmën parafjalore SP, kokën P dhe sintagmën emërore SE brenda sintagmës parafjalore SP. Marrëdhënia ndërmjet F dhe sintagmës parafjalore SP është e ngjashme me atë në (21).

Duke përdorur nocionin e m-komandës të dhënë nga Chomsky (1986b: 8), propozohet që drejtimi të përcaktohet si më poshtë:

(2) *Drejtimi: A drejton B nëse dhe vetëm nëse A është drejtuesi, dhe nëse A m-komandon B dhe nëse nuk ka ndërhyrës (barriers) që të ndërhyjnë ndërmjet A dhe B.*

*Projektionet maksimale janë ndërhyrës (barriers) në drejtim. Drejtuesit janë kokë.*

Në të dyja (21) dhe (22) foljet, *lë* dhe *iku*, drejtojnë sintagmën parafjalore SP *në vjeshtë*. Folja F nuk do të jetë në gjendje drejtojë sintagmën parafjalore SP duke qenë se

SP është vendosur në një projektion maksimal. Si rrjedhim, foljet në (21) dhe në (22) m-komandojnë sintagmën emërore SE *vjeshtë* por ato nuk e drejtojnë atë.

Haegeman<sup>133</sup> shprehet se përcaktimi i dhënë në (2) është më i kuptueshëm duke qenë se na lejon të vendosim të njëjtën marrëdhënie ndërmjet foljes F dhe sintagmës parafjalore SP në shembujt e dhënë (21) dhe (22).

### 3.4 Marrëdhëniet gramatikore

Përveç marrëdhënieve strukturore, nëpërmjet pemës së sintagmës shprehen edhe marrëdhënie gramatikore<sup>134</sup>. Koncepti marrëdhënie gramatikore ka të bëjë me karakteristikat morfosintaksore që e lidhin një argument në një sintagmë, argumente të tilla si kryefjala ose kundrinori. Terma të tjerë të përdorur për marrëdhëniet gramatikore janë gjithashtu edhe të tilla si funksione sintaksore ose role sintaksore, role të cilat përcaktojnë marrëdhënien sintaksore të këtyre njësive në sintagmë duke funksionuar si kryefjalë, kundrinor i drejtë, kundrinor i zhdrejtë etj.

Ky është pikërisht ndryshimi ndërmjet roleve sintaksore dhe roleve semantike apo (-roles): rolet semantike nuk tregojnë marrëdhëniet sintaksore të argumentëve me foljen, pra nëse do ta ilustronim me shembullin *Agimi preu xhamin* vs. *Agimi u pre nga xhami* në të dyja rastet sintagma emërore SE *Agimi* shërben si kryefjalë e fjalisë. Por, në rastin e fjalisë veprorë SE *Agimi* bart rolin semantik të vepruesit për foljen “pres”, ndërsa në rastin e ndërtimit në joveprorë, SE *Agimi* bart rolin semantik të pësuesit të foljes “pres”.

Karakteristikat sintaksore janë konsideruar tradicionalisht si elementët kyç të marrëdhënieve gramatikore, p.sh në shembullin e mësipërm, *Agimi* është vendosur në vetën e tretë njëjës, rasa emërore, që hyn në marrëdhënie kallëzuesore me kallëzuesin, pra bart karakteristikat për t’u quajtur kryefjalë<sup>135</sup>.

Sintagma emërore SE *xhamin* në rastin e fjalisë veprorë është argument i foljes “pres” dhe bart rolin semantik të pësuesit dhe për sa u përket marrëdhënieve gramatikore *xhamin* është kundrinë e drejtë<sup>136</sup> sepse shënon objektin tek i cili kalon pandërmjetshëm veprimi i shprehur nga folja dhe vihet në rasën kallëzore pa parafjalë.

Sintagma përemërore SP *nga xhami* në rastin e fjalisë joveprorë bart rolin semantik të burimit, dhe për u përket marrëdhënieve gramatikore SP *nga xhami* bart funksionin e kundrinës së zhdrejtë me parafjalë<sup>137</sup> sepse ajo plotëson foljen kalimtare “pres” dhe shpreh objektin që shërben si pikënisje a burim.

---

<sup>133</sup> Liliane Haegeman, *Introduction to Government and Binding Theory*, Second Edition, 1998, Blackwell Publishers Ltd, fq 138

<sup>134</sup> Carnie, *Vepër e cituar*, fq. 116

<sup>135</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Tiranë 2002, fq. 167

<sup>136</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Tiranë 2002, fq. 253

<sup>137</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Tiranë 2002, fq. 261

### **3.5 Folja dhe argumentet**

Në gramatologjinë shqiptare konceptin e foljes e hasim edhe në veprën e Ilija Dilo Sheperit *Gramatika dhe Sindaksa e Gjuhës Shqipe*<sup>138</sup>, ku folja tregon *vetën, numurin, fytyrën, mënyrën dhe kohën. Përmbledhja e gjithë trajtave të foljes quhet zgjedhim.*

Folja përbën bërthamën e fjalisë. Në Gramatikën e Akademisë<sup>139</sup> ajo emërton një veprim si proces dhe ka kategoritë gramatikore të vetës, numrit, mënyrës, kohës dhe diatezës. Folja dallohet nga pjesët e tjera të ligjëratës sidomos nëpërmjet kategorive gramatikore. Ajo ka kategori gramatikore, që nuk i ka asnjë pjesë tjetër e ligjëratës (diatezë, mënyrë dhe kohë). Edhe kategoritë e vetës e të numrit të folja ndryshojnë nga kategoria e vetës të përemrat vectorë e pronorë dhe nga kategoria e numrit të emri. Te folja këto dy kategori gramatikore kanë karakter sintaksor, pasi kushtëzohen nga veta dhe numri i kryefjalës, e si rrjedhim nuk sjellin ndonjë ndryshim në kuptimin leksikor të saj, kurse kategoria e vetës të përemrat vectorë e pronorë dhe kategoria e numrit tek emri kanë karakter josintaksor.

**Kallëzuesia**<sup>140</sup> (predikativiteti) është një tipar themelor i fjalisë që përfaqëson një referim të realiteti. Quhet kallëzuesi, pasi kallëzuesi (predikati) është gjymtyra që lidh përmbajtjen e fjalisë me botën e jashtme. Pra, bosht i kallëzuesisë është folja, e cila e vendos veprimin e kumtuar nga fjalia në një kohë të caktuar (kuptimi kohor), e paraqet atë si real, si të dëshiruar, si urdhër etj. (mënyra), si veprim që kryen folësi, dëgjuesi apo një person larg tyre (veta), që kryen apo e pëson një nga këta (diateza) etj.

Edhe kur folja mungon në fjali, ajo nënkuptohet, kështu që kallëzuesia realizohet, dmth. nuk ka fjali pa kallëzuesi. P.sh., në fragmentin *Natë. Ecim pa ditur ku shkojmë, natë* nuk emërton thjesht një ndarje kohe. Ajo është fjali, që na kumton momentin kohor kur ndodh diçka dhe lexuesi ose dëgjuesi, me ndihmën e kontekstit, nuk e kanë të vështirë ta lidhin *natë* me një plan të caktuar kohor të realitetit.

Kategoritë e kohës dhe të mënyrës janë të domosdoshme për shprehjen e kallëzuesisë së fjalisë. Prandaj kallëzuesi, megjithëse gramatikisht është gjymtyrë përcaktuese, në gramatikën e sotme merret si organizatori kryesor i fjalisë.

### **3.6 Nënkatëgorizimi dhe selektimi**

Dukuria e nënkategorizimit është sjellë fillimisht nga Chomsky<sup>141</sup> në veprën “Aspekte të Teorisë së Sintaksës” (*Aspects of the Theory of Syntax (ATS)*) (1965). Në të Chomsky argumenton se një njësi leksikore duhet të përmbajë informacion sintaksor në lidhje me llojin e foljes, p.sh. nëse ajo është kalimtare, jokalimtare, bikalimtare etj. Në

---

<sup>138</sup> Ilija Dilo Sheperi, *Gramatika dhe Sindaksa e Gjuhës Shqipe*, ribotim Albin 2001, f. 74

<sup>139</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë 2002, f. 260

<sup>140</sup> Rami Memushaj, Dorëshkrim “*Bukuria e gjuhës 2*”, 2008, fq. 14

<sup>141</sup> Noam Chomsky. *Aspects of the theory of syntax*. Cambridge, Mass.: MIT Press, 1965

bazë të këtij informacioni realizohet dukuria e nënkategorizimit, si veti idiosinkretike e brendshme e foljes.

Sipas Lasnik<sup>142</sup>, në fund të viteve 1970, Chomsky vuri re se ky informacion ishte i panevojshëm/i padobishëm me të dhënat e përftuara nga rregullat e strukturës së sintagmës. Për shembull, kemi një kuadër të nënkategorizimit për foljet si *fle*, *lexoj*, *jap* etj. i cili së bashku me rregullat e strukturës së sintagmës na tregon se një sintagmë foljore përbëhet nga (a) një folje, (b) një folje dhe një përbërës emëror, (c) një folje dhe dy përbërës emërorë.

(1) a. SF F                      b. SF F SE                      c. SF F SE SE . . .

P.sh. sintagma foljore SF *fle*, sintagma foljore SF *lexoj librin* dhe sintagma foljore SF *I jap librin Agimit*. Pra, rregulla të tilla u përdorën për të caktuar karakteristikat e sintagmave (phrase – markers PM)<sup>143</sup> deri nga mesi i viteve 1970. Informacioni i përfshirë në (1) ishte gjithashtu i nevojshëm në leksikon duke theksuar që do të ishte e pamundur p.sh. të përdornim foljen *fle* sipas modelit (1b):

(2) \*Unë fle krevatin


Megjithatë, vetë folja/ njësia leksikore duket që parandalon realizime të tilla në ligjërim dhe është e qartë për folësin se nga informacioni i brendshëm mbi nënkategorizimin foljet si më poshtë realizohen në këtë mënyrë:

---


<sup>142</sup> Howard Lasnik, Juan Uriagereka, Cedric Boeckx, Minimalist Expectations Preliminary Assumptions, with a Review of Some Familiar Notions tërhequr në 17.06.2014 nga [http://www.blackwellpublishing.com/content/BPL/Images/Content\\_store/Sample\\_chapter/9780631199878/Lasnik\\_sample%20chapter\\_A%20course%20in%20minimalist%20syntax.pdf](http://www.blackwellpublishing.com/content/BPL/Images/Content_store/Sample_chapter/9780631199878/Lasnik_sample%20chapter_A%20course%20in%20minimalist%20syntax.pdf)

<sup>143</sup> *Po aty* referuar nga Chomsky, Noam. 1970. *Remarks on nominalization*. Në Roderick Jacobs and Peter Rosenbaum, eds., *Readings in English transformational grammar*. Waltham, MA: Blaisdell.






Pema 1: *Shmangu takimin*



Pema 2: *Renditi ngjarjet*



Pema 3: Vajza porositi drekën

Në të tri fjalitë e mësipërme të paraqitura me pemët strukturore (1), (2), (3) sintagma foljore SF përbëhet nga koka e sintagmës foljore SF, që është folja F dhe sintagma emërore SE, pra kundrina e drejtë. Nëse fjalitë do të përbëheshin edhe nga një sintagmë parafjalore SP, pra *Shmangu takimin në momentin e fundit, Agimi renditi ngjarjet sipas viteve, Vajza porositi drekën në restorantin përballë*, në të tri rastet prania e sintagmës parafjalore SP nuk është e domosdoshme; ato japin më shumë informacion për kohën, mënyrën dhe vendin në fjalitë përkatëse, por mungesa e tyre nuk i bën fjalitë jogramatikore siç do ta shohim më poshtë në (3), (4), (5).

- (3) Shmangu **takimin**.
- (4) Agimi renditi **ngjarjet**.
- (5) Vajza porositi **drekën**.

Në gramatikën gjenerative<sup>144</sup> përbërësit e padomosdoshëm strukturalisht në një fjali quhen **adjunktë**. Gjithashtu në rastet e mësipërme do të vërejmë se në fjali kemi jo vetëm përbërës fakultativë, por kemi dhe përbërës të domosdoshëm. Ky është rasti i sintagmave emërore SE që shërbejnë si **argumente** të foljeve, pra kundrinorët e drejtë; ata nuk mund të hiqen sepse do të bëjnë që fjalitë të jenë jogramatikore:

- (6) \*Shmangu.
- (7) \*Agimi renditi.
- (8) \*Vajza porositi.

<sup>144</sup> Liliane Haegeman, *Introduction to Government and Binding Theory*, Second Edition, 1998, Blackwell Publishers Ltd, fq. 40 - 42

Por kjo nuk do të thotë që të gjitha fjalitë duhet të kenë patjetër një argument të brendshëm të shprehur me SE. Në shembujt e mëposhtëm:

- (9) Vajza heshti.
- (10) Babai i dhuroi librin të bijës.

Po të shtojmë një SE menjëherë pas foljes në (9), atëherë fjalia do të ishte jogramatikore:

- (9.a) Vajza heshti *\*veten/ \*shokun*.

Gjithashtu në fjalinë (10) folja *dhuroj* nënkategorizon dy sintagma emërore SE, përkatësisht *librin* dhe *të bijës*, sepse kërkon që të ndiqet nga dy argumentë të brendshëm.

- (10.a) Babai i dhuroi librin Agimit (*kujt*).  
*\*Babai i dhuroi librin (kujt)*.

Haegeman<sup>145</sup> shprehet se në gramatikën tradicionale kërkesa që ka folja për të marrë ose jo sintagma emërore SE brenda vetë sintagmës foljore SF, njihet si karakteristikë e vetë foljes. Dallohen të paktën tri klasa të foljeve: folje kalimtare, folje kalimtare me dy kundrinorë dhe folje jokalistare. Nëse koka e SF është një folje kalimtare, atëherë do të kërkojë një SE si kundrinë të drejtë, ose një fjali kundrinore që luan rolin e kundrinës së drejtë *Tha se do të vinte*. Nëse koka e SF është një folje kalimtare me dy kundrina, atëherë kjo folje do të shoqërohet me dy SE ose me një SE dhe një sintagmë parafjalore SP (d.m.th. një kundrinor të drejtë dhe një të zhdrejtë, me apo pa parafjalë). Por, nëse folja e fjalisë do të jetë jokalistare, atëherë brenda SF nuk do të gjejmë një SE. Pavarësisht se në cilën klasë përfshihet folja, ndarja e mësipërme cilësohet të jetë karakteristikë sintaksore formale e vetë foljes.

Për më tepër ajo shton se bazuar në gramatikën gjenerative, folësit e një gjuhe duhet të kenë njohjen e brendshme për të dalluar llojin e foljes dhe përbërësit e sintagmës foljore SF, pra nënkategorizimi i foljeve duhet të jetë pjesë e vetë njohjes leksikore të tyre. Struktura e përbërësve të një SF është e lidhur drejtpërdrejt me kuptimin leksikor të vetë foljes dhe folësit e një gjuhe nuk njohin thjesht foljen si kategori sintaksore, por edhe nënkategoritë e saj.

Në traditën e gramatikës gjenerative nocionet si kalimtare, jokalistare etj. vendosen në struktura shpërndarëse. Foljet klasifikohen sipas llojit të SF ku vendoset vetë folja. P.sh folja *porosit* kërkon domosdoshmërisht pas saj një plotësor, p.sh. një SE. Kjo tregon se në cilën strukturë sintaksore duhet vendosur folja *porosit*. Folja *hesht*, nga ana tjetër nuk ka nevojë të marrë pas një plotësor për të plotësuar SF.

---

<sup>145</sup> *Po aty*

Lidhja mes kuptimit të foljes dhe nënkategorizimit nuk është e re. Gjuhëtarët<sup>146</sup> e mbështesin fort mendimin se kuptimi i një fjale është thelbi i nënkategorizimit; për shembull Green (1974)<sup>147</sup> ka treguar se kuptime të ndryshme të një foljeje të caktuar ka nënkategorizime të ndryshme. Le ta ilustrojmë idenë me foljen *qesh* dhe të japim dy kuptimet përkatëse të kësaj folje:

Nëse folja *qesh* përdoret si folje kalimtare, kuptimi i përcjellë është ai i talljes, i vënies në lojë të dikujt, e përqeshjes, e qesëndisjes së dikujt. Ky kuptim është ilustruar si më poshtë:

- (11) Mjaft e **qeshe** atë.
- (12) **Qeshin** njerëzit me të.

Kur folja *qesh* përdoret si folje jokalimtare kuptimi i përcjellë është nxjerr zë të pandërprerë si shprehje gëzimi dhe kënaqësie dhe nuk përfshin diçka nga kuptimi i dhënë më lart. Le ta ilustrojmë:

- (13) **Qeshi** me lot.
- (14) **Qeshi** me gjithë zemër/shpirt.
- (15) I **qeshin** sytë.

Gjuhëtarë të tjerë, si Gruber<sup>148</sup> (1965) dhe Fillmore (1968), gjithashtu kanë treguar se nënkategorizimi sintaksor i një foljeje është i lidhur me semantikën e argumenteve të saj. Kështu, shprehen ata, nëse do të analizojmë dy folje p.sh. foljen “*ofroj*” dhe “*ngas një mjet*” është mëse e pritshme që një folje që përcjell kuptimin e *ofrimit* të ketë karakteristika sintaksore të ndryshme nga një folje që përcjell kuptimin e *ngarjes/voztjes* së një mjete. Por në të njëjtën kohë, nëse të dy kuptimet e të njëjtës foljeje përcjellin idenë e “*ofrimit*” dhe të “*voztjes*”, këto dy kuptime duhet të kenë karakteristika sintaksore të ndryshme; p.sh. le ta ilustrojmë idenë me rastin e foljes “*jap*” – ajo ka kuptimin “*ofroj*” dhe “*vozt*” (mes shumë kuptimeve të tjera të kësaj foljeje)<sup>149</sup>.

Në rastin kur folja “*jap*” ka kuptimin “*i dorëztoj, i zgjat a i vë përpara dikujt një gjë për ta marrë; i fal dikujt një gjë timen; e pajis me diçka; dhuroj*” ajo paraqitet si një folje kalimtare bikalimtare, ku folja nënkategorizon dy sintagma plotësorë, e për sa i përket strukturës argumentore sintagma foljore paraqitet me tri argumente, të cilët bartin

---

<sup>146</sup> Douglas William Roland, *Verb Sense and Verb Subcategorization Probabilities*, Disertacion për mbrojtjen e titullit Doktor i Shkencave, Departamenti i Gjuhësisë, University of Colorado, 2001, fq. 17

<sup>147</sup> *Po aty* referuar nga Green, G. (1974). *Semantics and syntactic regularity*. Bloomington: Indiana University Press.

<sup>148</sup> *Po aty* referuar nga Gruber, J. (1965). *Studies in lexical relations*. Ph.D. Dissertation, MIT, Cambridge, MA. dhe Fillmore, C. J. (1968). *The case for case*. In E. W. Bach & R. T. Harms (Eds.), *Universals in Linguistic Theory* (fq. 1-88). New York: Holt, Rinehart & Winston.

<sup>149</sup> Kryesisht shembujt janë tërhequr nga *Fjalori i Gjuhës Shqipe* 2006,

rolet semantike të një vepruesi, një teme dhe një përfutuesi; gjithashtu jepet ideja e dhënies, dhurimit dhe përcjelljes së diçkaje për dikë si te shembujt më poshtë:

- (16) I **dha** librin shokut.
- (17) I **dha** një gotë ujë.
- (18) I **dha** dorën.
- (19) Na ka **dhënë** një roman të bukur.

Në rastin kur folja “jap” ka kuptimin “ngas një mjet udhëtimi; vë në lëvizje diçka”, ideja e përcjellë është ajo e lëvizjes, e vënies në punë të një mjeti dhe për më tepër është rasti i një folje jokalimtare si në shembujt më poshtë:

- (20) I **jap** makinës.
- (21) I **dha** çikrikut.
- (22) **Jepi** shpejt majtas.

Është gjithashtu e mundur që kuptime të ndryshme të kenë një njëjtin nënkategorizim. Idenë e ilustruam me foljen “**drejtoj**”. Të dyja rastet e përdorura me kuptime të ndryshme kërkojnë një kundrinor të drejtë që të realizohen.

Kuptimi i parë është “*e bëj të drejtë, e shtrij, e kthej në gjendjen e vet të zakonshme diçka të shtrembër ose e kthej në një drejtim / e vë në një qëndrim të caktuar*”:

- (23) **Drejtoj** gozhdën.
- (24) **Drejtoi** krahun.
- (25) E **drejtoi** nga vetja.
- (26) **Drejtoi** sytë nga lindja.

Dhe kuptimi i dytë është “*i dërgoj dikujt një letër, një kërkesë; i bëj të njohur diçka a i bëj thirrje për diçka; e nis për diku*”:

- (27) I **drejtoi** një telegram.
- (28) I **drejtoi** një pyetje.
- (29) E **drejtoi** në ministri.

Një rast të ngjashëm e gjejmë me foljen “**çoj**”. Mes shumë kuptimeve të kësaj folje kemi veçuar dy. Rasti i parë është kur ideja e shprehur përfshin “*e nis me dikë a e mbart me një mjet te dikush a deri diku, shpie; e nis dikë në një vend, dërgoj*” dhe kemi lëvizshmëri në realizimin e foljes si më poshtë:

- (30) E **çoi** në shkollë.
- (31) E **çoi** me shërbim.
- (32) E **çoi** topin në rrjetë.

Dhe rasti i dytë për foljen “çoj” përcjell kuptimin “ngre” dhe gjithashtu kemi lëvizshmëri të shprehur:

- (33) E **çoi** peshë.
- (34) E **çoi** në mësim.
- (35) **Çoi** tryezën

Studime të tjera në lidhje me nënkategorizimin shprehen për lidhjen që haset ndërmjet dallimeve kuptimore dhe paraqitjeve sintaksore të këtyre kuptimeve. Kështu Pinker<sup>150</sup> (1989) propozon se struktura sintaksore në të cilën shfaqet një folje është tërësisht e përcaktuar nga semantika e kontekstit ku zhvillohet veprimi. Në këtë teori, ka përfaqësime të ndryshme kuptimore të foljes për çdo model sintaksor. Shembujt e mëposhtëm janë diskutuar gjerazi nga gjuhëtarët Goldberg (1995) dhe Pinker (1989). Ata analizojnë foljen *sprucoj*. Shembujt e mëposhtëm na përcjellin idenë se fjalia (36) tregon se muri është lyer plotësisht me bojë me anë të veprimit të të sprucuarit, ndërsa në shembullin (37), vetëm një pjesë e murit është e lyer/ e sprucuar dhe jo i gjithë muri. Si rrjedhim mund të mendojmë se këto janë dy kuptime të ndryshme të foljes *sprucoj*.

- (36) Miri **sprucoi** murin me bojë.
- (37) Miri **sprucoi** bojë në mur.

Edhe pse Pinker (1989, f. 228) pretendon se secili nënkategorizim i një foljeje ka një strukturë unike semantike, ai gjithashtu pohon se shumë nga dallimet janë aq delikate sa kërkojnë grupe të reja të përfaqësimeve semantike në mënyrë që të jemi në gjendje të kuptojmë dallimet.

Ndër folje të tjera me karakteristika të ngjashme mund të përmendim edhe foljet: *cikroj, spërkat (spërkas), stërpik, pikëloj, pikoj, çikëloj, çikërroj, ndyj, ngjyey, pompoj, derdh, njolloj, njollos, ndot* etj. *Spërkat rrobat me baltë; vs. Spërkati me baltë fustanin.*

Për sa i përket gramatikës së varësisë dhe lidhjes së saj me nënkategorizimin Schneider<sup>151</sup> do të shprehej se me nënkategorizim do të kuptojmë ndarjen e klasave të fjalëve në nënklasa më të vogla në bazë të sjelljes së tyre sintaksore. Në gramatikën e varësisë termi nënkategorizim është zëvendësuar nga termi valencë. Kjo vjen për faktin se gramatika e varësisë ndryshe nga gramatika e konstituentit nuk ndahet në kategori e si rrjedhim nuk mund të ndahet as në nënkategori. Është e rëndësishme të theksojmë se foljet i krijojnë mundësi emrave që të realizohen pranë tyre, duke e quajtur këtë proces, valencë.

---

<sup>150</sup> *Po aty*, f. 18-20, referuar nga Pinker, S. 1989, *Learnability and cognition: The acquisition of argument structure*. Cambridge, MA, USA: MIT Press.

<sup>151</sup> Gerold Schneider, *A Linguistic Comparison of Constituency, Dependency and Link Grammar* - Diploma Paper, 1998, Institut für Informatik der Universität Zürich

Në artikullin e mbajtur nga Thoma Dhima<sup>152</sup> *Mbi klasifikimin e foljeve sipas valencës*, ai shprehet se reksioni (nënkategorizimi) është parë më tepër si një veti e brendshme e foljes si një mundësi e saj për të mos marrë ose për të marrë një ose dy kundrinorë dhe dallohen klasat e foljeve sipas kësaj mundësie, kurse valenca përveçse mundësi e foljes, është tipar kontekstual i saj nëpërmjet të cilit shprehen lidhjet e detyrueshme të foljes në kontekstin e dhënë me fjalët e tjera të fjalisë.

Si përfundim, sintagma foljore SF në shqipe ka veçoritë e saj të nënkategorizimit. Selektimi nga ana tjetër duhet dalluar prej nënkategorizimit, sepse skema e selektimit përfshin të gjithë elementet që lidhen me foljen, pra edhe ato që janë në funksion kryefjale.

### **3.7 Struktura kuptimore dhe struktura e argumentit**

Sintagma foljore SF në gjuhën shqipe mund të përshkruhet edhe sipas aftësisë së foljes për të caktuar *role semantike* dhe *argumentet* që i bartin këto role semantike.<sup>153</sup> Në vartësi të numrit të roleve semantike përcaktohet nga folja edhe numri i argumenteve. Role semantike përbëjnë një pjesë jashtëzakonisht të rëndësishme të kuptimit sintaksor të frazës. Një fjali si: *Drejtori i ngarkoi një detyrë Agimit*, ka tre role theta të caktuara nga folja *ngarkoj*: *drejtori* që i referohet personit që kryen veprimin (*Vepruesi*), një detyrë, objekti mbi të cilin bie veprimi (*Pësuesi*), Agimit, personi që “merr” objektin (*Përfituesi*). Rolet semantike ose theta trajtohen në teorinë e parimeve e parametrave në modulën e teorisë theta, apo shkurt . Edhe kjo teori merr në konsideratë mënyrën se si sillen elementet leksikore.

V. J. Cook dhe Mark Newson shprehen se duke u integruar me sintaksën X-bar dhe me parimin e projeksionit, teoria theta merret me caktimin e roleve semantike elementeve të strukturës së fjalisë. Rolet theta shprehin lidhje të caktuara kuptimore midis elementeve. Kriteri theta kontrollon caktimin e roleve theta duke verifikuar që të gjitha elementet të marrin një rol theta dhe që të gjitha rolet semantike të caktohen. Në gramatikën gjenerative përveç *role tematike/semantike* do të ndeshemi gjithashtu edhe me termin *strukturë e argumentit*. Foljet caktojnë role semantike të cilat, për t’u realizuar, kërkojnë argumente, në varësi të numrit të këtyre roleve semantike. P.sh. nëse folja cakton një rol semantik, ajo merr një argument *Agimi ecën – Agimi* është argumenti i vetëm i foljes *ecën*.

Të dyja këto dukuri tregojnë se kategoritë leksikore luajnë një rol të veçantë në paraqitjen strukturore-sintaksore të fjalisë. Kategoritë leksikore jo vetëm shërbejnë si kokë e sintagmave përkatëse, por njëkohësisht, me rolet tematike/semantike që marrin nga folja, shërbejnë si plotësorë të domosdoshëm të strukturës së fjalisë. Kështu pra,

---

<sup>152</sup> Thoma Dhima “*Mbi klasifikimin e foljeve sipas valencës*”, Artikull mbajtur në Seminarin XXI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë 19.08 – 01. 09. 2002

<sup>153</sup> V. J. Cook, Mark Newson, *Po aty*

struktura e argumentit në gjuhën shqipe (ashtu si në çdo gjuhë tjetër natyrore) lidhet ngushtë me strukturën semantike të foljes.

Kjo do të thotë që folja, përveç strukturës së argumentit ka edhe një strukturë kuptimore të caktuar, të cilën ua jep argumenteve të saj, të cilët mund të jenë përkatësisht të brendshëm ose të jashtëm. Vërehet se secili prej argumenteve të një fjalie ka një rol semantik të caktuar, p.sh: veprues, pësues, objekt, eksperimentues, përfitues, burimor, vendor etj.

Këtë rol semantik ai e merr nga predikati përkatës. Nuk mund të ndodhë që i njëjti argument të ketë më shumë se një rol semantik, po ashtu, i njëjti rol semantik nuk mund t'u caktohet njëkohësisht dy argumenteve të një folje. Studiuesit mendojnë se kjo dukuri është pasojë e veprimit në të gjitha gjuhët të një parimi universal që njihet si "parimi i rolit semantik ose i rolit theta" përmbajtja e të cilit është si më poshtë:

**Çdo argument ka vetëm një rol semantik të caktuar.**

**Çdo rol semantik i jepet vetëm një argumenti të fjalisë<sup>154</sup>.**

Kur trajtohet struktura argumentore e fjalisë hasim gjithashtu termin *adjunkt*, i cili përfaqëson përbërësit ose sintagmat që nuk janë të domosdoshme në fjali. Ato japin një informacion shtesë për ndërtimin dhe kuptimin e fjalisë, por nuk janë argumentë të foljes, pra mund të mos të jenë të shprehura fonetikisht dhe të panënkuptuara kuptimisht. Ato mund të shtohen dhe hiqen lirshëm nga fjalia, ndryshe nga argumentët të cilët janë të përcaktuar qartë dhe që nuk mund të shtohen apo të mënjnohen pa kriter.

### ***3.7.1 Struktura argumentore në gjuhët natyrore***

Në vazhdim të logjikës së mësipërme Heageman<sup>155</sup> e ka përmbledhur problemin me një metaforë duke u shprehur se foljet janë si skenari i një filmi. Në një skenar një numër rolesh u caktohen aktorëve. Argumentët e një fjalie janë si rolet e caktuara në skenar. Çdo rol i caktohet një aktori përgjegjës. Do të ishte e pamendueshme të mungonte një pjesë/aktor apo nëse do të ishte një pjesë/aktor i tepërt që nuk do të kishte vend në film. Adjunktet mund të krahasohen me pjesët jo kryesore/dytësore të filmit. Struktura argumentore e foljeve përcakton cilat elementë të fjalisë janë të domosdoshme.

Nëse folja shpreh një veprim që përfshin dy argumentë, do të jetë e nevojshme të ketë të paktën dy konstituentë në fjali që të shprehin këto dy argumentë. Kjo strukturë argumentore e përcaktuar mund të zëvendësojë pjesërisht klasifikimin e foljeve sipas ndarjes së kalimtarësisë dhe jokolimtarësisë ose kuadrin e nënkategorizimit të përshkruar

---

<sup>154</sup> Ludmila Buxheli, *Modelet e Caktimit Rasor në Gjuhën e Sotme Shqipe*, Botimet Neraida, 2007, fq. 193-194, referuar nga Haegeman, L. (1991), *Introduction to Government and Binding Theory*, Blackwell Publishers Ltd, fq. 41

<sup>155</sup> Liliane Haegeman, *Introduction to Government and Binding Theory*, Second Edition, 1998, Blackwell Publishers Ltd, fq. 44 - 46



si më lart. Nëse një folës e di kuptimin e foljes *takoj*, me fjalë të tjera, nëse ai e di se çfarë veprimesh shprehen atëherë ky folës e di se sa pjesëmarrës janë përfshirë dhe si rrjedhim e di se sa argumentë i duhen foljes *takoj*. Folja *takoj* përfshin dy pjesëmarrës dhe si rrjedhim do t'i duhen dy argumentë. Nëse një argument realizohet si kryefjalë e fjalisë atëherë argumenti i dytë do të realizohet si plotësor, pra si pjesë e sintagmës foljore SF.

Ka një dallim të rëndësishëm ndërmjet kuadrit të nënkategorizimit dhe strukturës argumentore. Nënkategorizimi specifikon plotësorët e foljes, pra konstituentët që janë të domosdoshëm brenda sintagmës foljore SF. Sintagma emërore SE që bart funksionin e kryefjalës nuk është pjesë e kuadrit të nënkategorizimit sepse të gjitha foljet kanë kryefjalë; karakteristika që çdo fjali ka një kryefjalë nuk krijon një nënkategori të foljes, ndërsa prania e kundrinës është një nënkategori e foljes. Struktura argumentore liston të gjithë argumentët: ajo gjithashtu përfshin edhe argumentin kryefjalë i cili realizohet jashtë sintagmës foljore SF.

Sipas Buxhelit<sup>156</sup> lënda gjuhësore e shqipes tregon se struktura e argumentit foljor dhe dukuria e nënkategorizimit ose kuptimi kalimtar/jokalimtar nuk përputhen plotësisht me njëra-tjetrën. Struktura e argumentit foljor të një foljeje është më e gjerë se struktura e nënkategorizimit përkatësisht kuptimit kalimtar ose jokalimtar, sepse ajo përmban gjithë argumentet e domosdoshme për realizimin e kuptimit të foljes. Kuptimi kalimtar/jokalimtar, ndryshe nga struktura e argumentit foljor, përmban vetëm me argumentin e brendshëm të foljes. Kështu p.sh., struktura argumentore e foljes jokalimtare *fluturon* në fjalinë “*Aeroplani fluturoi në agim*” përmban vetëm një argument të jashtëm (Aeroplani), i cili i prin foljes. Kjo strukturë jepet formalisht në këtë mënyrë:

- a) Struktura argumentore: *fluturon*: folje 1  
SE

Po kjo folje, sipas nënkategorizimit, ka këtë skemë distribucionale:

- b) Skema e nënkategorizimit: *fluturon*: folje jokalimtare [—]

Edhe struktura argumentore e foljes kalimtare *jap* në fjalinë “Petriti i dha **librin Agimit**” përmban tre argumente, një të jashtëm (Petriti) dhe dy të brendshëm (librin, Agimit), kurse sipas nënkategorizimit ose e kuptimit kalimtar folja *jap* u prin dy emrave në funksionin e kundrinës. Këto dy skema jepen në këtë mënyrë:

- a) Struktura argumentore e foljes *jap*:

*jap*: folje; 1    2    3  
SE    SE    SE

---

<sup>156</sup> Ludmila Buxheli, *Foljet Njëvetore në Gjuhën e Sotme Shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2011

b) Skema e nënkategorizimit për foljen jap:  
jap: folje; [— SE, SE]

### 3.8 Parimi i projeksionit

Si do ta kuptojmë termin projeksion si shprehje e vendosjes së përbërësve në sintagmë? Fjalët që janë përbërësit e një fjalie luajnë një rol të rëndësishëm në strukturën sintaksore. Kategoritë leksikore që shërbejnë si bërthama/koka të përbërësve, përcaktojnë kategorinë e vetë përbërësve. Ky koncept, përmbledhet në të ashtuquajturin **parimin e projeksionit**<sup>157</sup>:

#### *Informacioni leksikor përfaqësohet sintaksorisht.*

Kjo dukuri ka të bëjë me atë që informacioni leksikor përfaqësohet në mënyrë sintaksore. Në terminologjinë e gjuhësisë gjenerative mund të themi se të gjitha sintagmat janë endocentrike, me një strukturë kompozicionale, trinivelëshe, të përbërë nga një qendër e vetme X. Në fillimet e analizave gjenerative sintagma identifikohet me kokën leksikore të saj; më vonë në teorinë X-bar kjo dukuri e kokës leksikore të çdo sintagme u shpreh me simbolin të veçantë, i cili u përdor si simbol përgjithësues i llojeve të kokave të sintagmave; kurse simboli (‘) ose baret shënojnë nivelet e projeksionit të kësaj koke.

Në pemën e një sintagme koka e projeksionit të sintagmës ndodhet në nivelin e parë. Ajo përfaqëson një projeksion 0 ( $X^0$ ), dhe i jep emrin sintagmës. Kokat janë nyjat përfundimtare. Teoria X-bar dallon dhe dy nivele të tjera projeksioni. Komplementët/plotësorët kombinohen me X për të formuar projeksionin e ndërmjetëm –  $X'$ , nivelin e dytë; adjunktet kombinohen me  $X'$  për të formuar projeksionin –  $X''$ ; specifikuesi\* kombinohet me nivelin më të lartë të  $X'$  për të formuar projeksionin maksimal  $X'''$  ose  $XP$ <sup>158</sup>, pra nivelin e tretë.

Në fillim<sup>159</sup> pranoheshin vetëm sintagma me koka leksikore, d.m.th. sintagma që kishin si kokë kategori leksikore (emër, mbiemër, folje, parafjalë dhe ndajfolje), ndërsa më vonë u pranuan edhe sintagma funksionale, si sintagmat determinative, kuantifikative dhe komplementuese. Në këtë këndvështrim, sintagma mund të jetë edhe një fjali, si sintagma eptimore, ose fleksionale.

---

<sup>157</sup> Liliane Haegeman, *Po aty*, fq. 55

\* Në strukturën hierarkike të sintagmës eptimore (SEPT) specifikuesi shërben si motër e EPT', pasi kombinohet me sintagmën eptimore' (EPT'), për krijimin e projeksionit maksimal, që në rastin tonë është fjalia ose SEPT. (shiko Ludmila Buxheli, *Modelet e Caktimit Rasor në Gjuhën e Sotme Shqipe*, Botimet Neraida, 2007, fq. 78 - 79)

<sup>158</sup> Liliane Haegeman, *Introduction to Government and Binding Theory*, Second Edition, 1998, Blackwell Publishers Ltd, fq.105

<sup>159</sup> Hysnie Hyska, Punim Masteri, Dorëshkrim “*Sintagma Emërore në Gjuhën Shqipe*”, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Departamenti i Gjuhës Shqipe, Tiranë 2009, fq 9.

## KREU IV

### SINTAGMA FOLJORE NË GJUHËN SHQIPE

#### *4.1 Struktura e sintagmës foljore në gjuhën shqipe*

Termi sintagmë dhe sintagmë foljore nuk janë përdorur në Gramatikën e Gjuhës Shqipe 2; për analogji në gramatikën tradicionale është përdorur termi *togfjalësh foljor*. Është shprehur se nga ndërtimi dhe kuptimi, togfjalëshat foljorë përbëjnë një tip shumë të ndërlikuar dhe të larmishëm.

Foljet bashkohen me emra e përemra në rase të ndryshme me ose pa parafjalë, me ndajfolje, me paskajore, përcjellore e pjesore. Ato shprehin marrëdhënie objektore ose rrethimore, shprehin marrëdhënie të procesit me objektin e drejtpërdrejtë, marrëdhënie hapsinore, vendore, kohore, shkakore, shoqërimi, të veprimit me mjetin etj. në varësi të kombinimit të foljes me gjymtyrën e varur <sup>160</sup>.

Ndërkohë në gramatikën gjenerative folja nuk konsiderohet thjesht si bërthama e sintagmës foljore, pra koka e saj, por është pikërisht folja, që duke u nisur nga interpretimi kuptimor i saj, u cakton përbërësve të tjerë të sintagmës rolet semantike që do të mbartin dhe strukturën e tyre.

#### *4.1.1 Tradita gramatikore shqiptare; koncepti i sintagmës përkundrejt konceptit të togfjalëshit*

Gjuhësia jonë është ende në fillimet e zbatimit të konceptit të sintagmës në sintaksën e gjuhës shqipe. Duke qenë se teoritë që e përbëjnë atë janë universale dhe të zbatueshme në të gjitha gjuhët natyrore, atëherë gjuhëtarët tanë kanë shfrytëzuar teorinë e kufizimit, teorinë e drejtimit, teorinë theta, teorinë e lidhjes, teorinë e rasës dhe teorinë e kontrollit duke e përshtatur më së miri në materialin gjuhësor të gjuhës shqipe dhe duke e konkretizuar në termin sintagmë, siç e përmendëm dhe më lart.

---

<sup>160</sup> *Gramatika e Gjuhës Shqipe II* Tiranë 2002, fq. 90-100

Në gramatikën e shqipes, koncepti i togfjalëshit është futur nga gjuhëtari S. Floqi<sup>161</sup>, i cili e ka huazuar këtë koncept nga gramatika ruse. Emërtimi i fjalës “togfjalësh” është një kalk nga fjala ruse *slovoçoetanie* “bashkim, grup fjalësh”. Por edhe termi në rusisht, nga ana e tij, është kalk i fjalës gjermane *wortgruppe*, të përdorur nga J. Ries-i.

Para se S. Floqi të parashtronte teorinë e togfjalëshit në vitin 1968, në gramatikën e shqipes kishte munguar një koncept i ngjashëm i njësisë së ndërmjetme mes gjymtyrës dhe fjalisë, si në sintaksën e Mahir Domit, edhe të Spiro Priftit<sup>162</sup>.

Në Gramatikën e Gjuhës Shqipe II<sup>163</sup> termi sintagmë nuk është përdorur. Për analogji gjejmë termin togfjalësh që quhet njësia strukturore e formuar nga bashkimi i dy a më shumë fjalëve të plotkuptimshme në raporte të caktuara kuptimore e gramatikore midis tyre.

Togfjalëshi ka hyrë në gjuhësinë shqiptare si një kategori e ndërmjetme midis kategorisë fjalë dhe kategorisë fjali. Na vihet në dukje termi togfjalësh i lirë ose togfjalësh i lirë sintaksor, i cili është objekt i sintaksës, për ta dalluar nga togfjalëshi i qëndrueshëm, nga togjet e fjalëve me drejtim leksikor, nga togjet e leksikalizuara ose frazeologjizmat, të cilat janë objekt i leksikologjisë.

Minella Totoni<sup>164</sup> shprehet se si tipare themelore dalluese që i vënë përballë togfjalëshat e lirë dhe togfjalëshat e qëndrueshëm është humbja e lidhjeve sintaksore dhe ngurosjat të paktën e njëjës prej gjymtyrëve, gjë që sjell si rrjedhim që frazeologjizmi të ketë “një ose disa trajta, por jo një sistem të plotë trajtash, një paradigmë të plotë”. Këto veçori shihen të kushtëzuara nga njësia kuptimore e frazeologjizmit. Ajo që të bie në sy në këto pohime, është përgjithësimi në bazë të fakteve të pjesshme. Siç vë në dukje me të drejtë Jani Thomai<sup>165</sup> frazeologjizmat kanë shkallë të ndryshme ngurtësimi.

Nga ana sintaksore togfjalëshat e qëndrueshëm janë trajtuar nga Mahir Domi<sup>166</sup> i cili kur i referohet togfjalëshave foljore i quan ato shprehje foljore. Ai shprehet se “si kallëzues foljor mund të kemi edhe shprehje foljore të formuara prej një foljeje dhe prej një emri të shoqëruar ose jo me parafjalë. Në këto raste ky grup fjalësh formon një kuptim të vetëm, ka vlerën e një foljeje të vetme dhe mund të marrë edhe kundrinë të drejtë a të zhdrejtë. Të tilla janë shprehjet: *mbaj mend, kam frikë, ngul këmbë, i zë besë, e qis në krye (një punë), i bëj ballë, vë gojë, vë vesh, vë dorë etj*”.

---

<sup>161</sup> Hysnie Hyska, Punim Masteri, Dorëshkrim “*Sintagma Emërore në Gjuhën Shqipe*”, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Departamenti i Gjuhës Shqipe, Tiranë 2009 referuar nga S. Floqi, *Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*, Studime Filologjike, Tiranë, 1968, nr. 1.

<sup>162</sup> *Gramatika e Gjuhës Shqipe II Sintaksa*, Tiranë 1957 dhe Spiro Prifti, *Sintaksa*, Tiranë, 1957

<sup>163</sup> *Gramatika e Gjuhës Shqipe II Sintaksa*, Tiranë 2002, fq. 61

<sup>164</sup> Minella Totoni, *A është togfjalësh struktura e një frazeologjizmi foljor?*, Studime Filologjike, Tiranë, 1994, nr. 1 – 4, fq. 178 referuar nga J. Thomai, *Leksikologjia ...*, fq. 140

<sup>165</sup> *Po aty*, fq. 140

<sup>166</sup> *Gramatika e Gjuhës Shqipe II Sintaksa*, Tiranë 1957, fq. 28

Por si trajtohen në strukturën e sintagmës togfjalëshi frazeologjik<sup>167</sup>? Për sa i përket njësive shumëfjalëshe që studion frazeologjia, në frazeologjinë shqipe deri më sot ato njihen me emrin togfjalështa (të qëndrueshëm) dhe në përbërjen e tyre ka të paktën dy fjalë shënuese<sup>168</sup>. Kështu, në tekstin “Leksikologjia e gjuhës shqipe” (2006), theksohet se “njësia frazeologjike është njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë shënuese, me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale të vetme, që riprodhohet e funksionon në ligjërim si njësi e gatshme dhe e pandashme”, ndërsa në “*Fjalorin frazeologjik të gjuhës shqipe*” (1999) theksohet se “në fushën e shqipes si tipare të përgjithshme të njësisë frazeologjike janë njohur struktura togfjalëshore, njësia kuptimore, qëndrueshmëria, figurshmëria, neutralizimi i raporteve të brendshme sintaksore, njëvlerësia me fjalën nga ana e kuptimit kategorial dhe e funksionit në ligjërim”.

Edhe S. Floqi (1968), kur pohon se “togfjalëshet e qëndrueshme, frazeologjike, si ekuivalente të një fjale të vetme, [.....] nuk studiohen nga sintaksa, por nga leksikologjia (më saktë nga frazeologjia)”, pranon, me të drejtë, se frazeologjia studion togfjalëshat e qëndrueshëm, por e ngushton vëllimin frazeologjik të togfjalëshave të qëndrueshëm vetëm në ata që janë të barasvlershëm me një fjalë të vetme. Deri më sot modeli strukturor me të cilin operojnë gjuhëtarët shqiptarë në frazeologji, dhe jo vetëm në frazeologji, është togfjalëshi me të paktën dy fjalë shënuese.

Cili është dallimi midis togfjalëshit dhe sintagmës? A duhet përdorur termi sintagmë në vend të termit togfjalësh? Termi gjuhësor togfjalësh është krijuar për t’iu përgjigjur termave të ndryshëm gjuhësorë të huaj midis të cilëve edhe termi “syntagme” (sintagmë) të Saussure-it<sup>169</sup>, por përbërja nocionore që i është dhënë është e ndryshme nga ajo e sintagmës. Për rrjedhojë, për lidhjen, grupin apo kombinimin e fjalëve shqipja rezulton me dy terma gjuhësorë, por me përmbajtje të ndryshme.

Çështja e nocionit të togfjalëshit paraqet dy aspekte: aspekti i parë lidhet me sasinë minimale të fjalëve ndërsa aspekti i dytë lidhet me llojin e fjalëve që e përbëjnë. Ai përbëhet së paku prej dy fjalësh, por jo prej fjalësh çfarëdo, por prej dy fjalësh shënuese<sup>170</sup>. Ky është togfjalëshi i thjeshtë, fjalët shënuese janë gjymtyrët e tij, ndërsa fjalët shërbyese (nyjat, parafjalët etj) janë, krahas trajtave të fjalëve, mjetet e lidhjes së togfjalëshit, por jo gjymtyrët e tij.

Për sasinë e fjalëve të gjithë studiuesit shqiptarë deri vonë kanë qenë të mendimit se togfjalëshi është njësi sintaksore që karakterizohet nga “dygjymtyrësia”<sup>171</sup>. H. Agani (1975) e kundërshton dygjymtyrësinë duke i hapur rrugë kështu teorisë së sintagmës për të cilën Th. Dhima (2007) thekson se “nuk ka sasi të caktuar fjalësh që përbëjnë vëllimin

---

<sup>167</sup> Harallamb Miçoni, Disertacion për marrjen e gradës shkencore Doktor, “*Rreth Frazeologjisë së Gjuhës Shqipe Krahasuar me Greqishten*”, Tiranë 2013

<sup>168</sup> Spiro Floqi, *Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*, Studime filologjike nr.1, Tiranë. 1968.

<sup>169</sup> Spiro Floqi, *Vep. e cit.* 1968

<sup>170</sup> Spiro Floqi, *Vep. e cit.* 1968

<sup>171</sup> R. Përnaska, *Dikutim për kumtesën e S. Floqit*, Studime filologjike nr.1, Tiranë, 1972

e saj”. Për rrjedhojë, sintagma mund të jetë një- apo shumëgjymtyrëshe dhe në përbërjen e saj mund të përfshihen si përbërës edhe përemrat, numërorët dhe parafjalët edhe pse nuk janë fjalë shënuese.

Togfjalëshi ka vlerën e një termi gjuhësor, sepse nuk tregon një grumbull, një grup, një tog çfarëdo fjalësh, por një tog të caktuar.

Në Sintaksën e Akademisë dallohen disa lloje togfjalëshash sipas strukturës:

1. Togfjalëshat e përbërë nga përemrat e pacaktuar: *një, secili, çdo, njëri* etj., gjithashtu nga përemrat dëftorë: *ky, kjo, ai, ajo* dhe një emër, si rregull funksionojnë në fjali si një gjymtyrë e vetme: *një shoku*.

2. Togfjalëshat e përbërë nga përemrat e pacaktuar: *njëfarë, lloj-lloj, gjithfarë, gjithfarëlloj, turlu* dhe nga një emër në rrjedhore të pashquar funksionojnë në fjali si një gjymtyrë e vetme: *njëfarë gjallërie*.

3. Togfjalëshat e përbërë nga një emër me kuptimin e një njësie të kohës, të masës, të peshës a të çmimit dhe nga një fjalë me kuptim sasi, në radhë të parë nga një numëror themelor përmbushin të njëjtin funksion si shembujt e mësipërm, ata funksionojnë si një gjymtyrë e vetme fjali, kur duhet të shprehin shkallën e masës a të sasisë, peshën, çmimin, si dhe zgjatjen e veprimit a të procesit të kohës: *katër orë, dy metra*.

4. Togfjalëshat emër + mbiemër, kur përdoren me rendin mbiemër + emër, i kanë treguesit rasorë të formës e të funksionit vetëm të përbërësi i parë i togfjalëshit, të mbiemri, duke e lënë emrin në trajtë të pacaktuar emërore-kallëzore, prandaj i gjithë togfjalëshi shërben si gjymtyrë e vetme fjali: *të shkretin plak*.

5. Togfjalëshat përemër pronor + emër funksionojnë si gjymtyrë e vetme. *im atë, yt vëlla*.

Ashtu si te sintagma, ku bërthama e saj është një kokë, edhe te togfjalëshi njëra gjymtyrë e tij është gramatikisht kryesore. Gjymtyra tjetër është e varur. Togfjalëshi është një lloj sintagme, një nga realizimet e saj. Sintagma mund të përbëhet nga një togfjalësh ose nga dy a më shumë togfjalësha, por mund të jetë dhe një fjalë e vetme.

Kufizimi i vëllimit të togfjalëshit minimalisht me dy gjymtyrë ka bërë që të mos shpjegohen me teorinë e togfjalëshit fjalitë e ashtuquajtura njëkryegjymtyrëshe, si: “*Nisemi, Mëngjes, Vetëtin etj*”.

Ndërkohë që gjuhëtarët shprehen se edhe në fjalitë njëkryegjymtyrëshe kemi sintagma, por në to, ndryshe nga fjalitë dykryegjymtyrëshe, njëra nga dy sintagmat që përbëjnë fjalinë, SE ose SF, në përputhje me natyrën e shqipes, nuk shprehet, është sintagmë zero. Kështu në këto raste, fjalia përbëhet nga dy sintagma, njëra prej të cilave është sintagma zero dhe vendi i saj është bosh në skemën e treguesit sintagmatik të fjalisë<sup>172</sup>.

Kemi këto modele kryesore të togfjalëshve, sipas pjesës së ligjëratës me të cilën është shprehur gjymtyra kryesore e togfjalëshit: togfjalëshi emëror, togfjalëshi foljor,

---

<sup>172</sup> Thoma Dhima, *Probleme të njësive sintaksore (Togfjalëshi dhe Sintagma)*, Studime Filologjike 3 - 4, 2007 Tiranë, fq. 73 - 78

togfjalëshi mbiemëror, togfjalëshi përemëror, togfjalëshi numëror, togfjalëshi ndajfoljor dhe togfjalëshi parafjalor<sup>173</sup>.

Sipas Gramatikës së Akademisë fjalët që mund të bashkohen dhe që formojnë togfjalësha, janë emrat, mbiemrat, përemrat, numërorët, foljet, ndajfoljet, kurse për parafjalët, lidhëzat, krahas formave të fjalëve, thuhet se janë vetëm mjete për bashkimin e fjalëve kuptimplota në togfjalësha. Por, studiuesit<sup>174</sup> vënë në dukje se parafjalët formojnë sintagma parafjalore. Sintagma parafjalore ka tre nivele projektimi sipas teorisë X-bar. Ajo plotësohet me një plotësor dhe specifikues, ku vetë parafjala paraqitet si koka e sintagmës.

Për sa u përket raporteve sintaksore ndërmjet togfjalëshave në Gramatikën<sup>175</sup> e Akademisë nuk ka mendim të njëjtë. Nga shumica e studiuesve pranohet vetëm togjet me raporte nënrenditëse, duke përjashtuar bashkimet me raporte bashkërenditëse, shpesh edhe bashkimet kallëzuesore (kryefjalë - kallëzues) të karakterizuara me raporte të veçanta ndërvarësie të ndërsjellë.

Sipas Spiro Floqit uniteti gramatikor dhe kuptimor i togfjalëshit zbulohet vetëm në lidhjen e nënrenditjes prandaj dhe përjashtohen nga teoria e togfjalëshit të ashtuquajturat “togfjalëshe me bashkërenditje”, sepse vetitë e tyre zbulohen në teorinë e gjymtyrëve të fjalisë, te gjymtyrët homogjene.

Ndërkohë Ludmila Buxheli<sup>176</sup> duke iu referuar Chomsky-t (1986), fjalinë e analizon ndryshe, ajo e përshkruan si një sintagmë eptimore (SEPT), koka e së cilës është eptimi (EPT). Mendohet që si kokë e fjalisë nuk mund të jetë as një sintagmë emërore (SE) as një sintagmë foljore (SF).

Një çështje tjetër që del në pah është ajo e togfjalëshit predikativ. Pra, ka studiues që në bazë të raporteve i ndajnë togfjalëshat në predikativë dhe jopredikativë dhe se togjet kallëzuesore shprehin marrëdhënie midis bartësit të veprimit a gjendjes dhe vetë veprimit a gjendjes (*ai iku, shiu pushoi* etj.), pa thënë se këto struktura mund të formojnë fjali.

Floqi dallon në mënyrë të prerë fjalinë nga togfjalëshi predikativ: “togfjalëshi predikativ përbën vetëm bërthamën leksiko-gramatikore të fjalisë”<sup>177</sup>. Ai nuk pajtohet me mendimin e profesorit polak Klemensieviç dhe të akademikut rus Vinogradov tek pohon se togfjalëshi predikativ nuk mund të përfshihet në teorinë e fjalisë. Kundërshtimin e tij ai e mbështet me këto argumente:

### *1. Togfjalëshi predikativ nuk njeh qëllimin e thënies*

---

<sup>173</sup> Spiro Floqi, *Çështje të Teorisë së Togfjalëshit në Shqipëri e Sotme*, Studime Filologjike Nr. 1, 1968, fq. 76 - 77

<sup>174</sup> Liliane Haegeman, *Po aty*, fq.103 ; Flora Koleci, Giuseppina Turano, *Po aty*, fq. 40-41

<sup>175</sup> *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, Tiranë 2002, fq. 61

<sup>176</sup> Ludmila Buxheli, *Po aty*, fq. 78 - 79

<sup>177</sup> Hysnie Hyska, Punim Masteri, Dorëshkrim “*Sintagma Emërore në Gjuhën Shqipe*”, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Departamenti i Gjuhës Shqipe, Tiranë 2009 referuar nga S. Floqi, *Çështje të teorisë...*, vep. e cit., f. 81.

2. *Togfjalëshi predikativ nuk njeh rend fjalësh*
3. *Togfjalëshit predikativ i mungon intonacioni*
4. *Togfjalëshi predikativ nuk ka të bëjë me pikënisjen e thënies, d.m.th. me atë që folësi di ose që është e qartë nga konteksti a situata dhe as me të panjohurën që folësi mendon rreth së njohurës.*

Në analizën e togfjalëshit predikativ vëmë re se autori e analizon fjalinë si një ndërtim ekzocentrik, të ndarë në një togfjalësh emëror dhe një predikativ. Edhe Thoma Dhima<sup>178</sup> duke iu referuar Chomsky-t shprehet në artikullin e tij se pranimit nga Spiro Floqi i togfjalëshit predikativ e zgjeron shumë konceptin e togëzueshmërisë së fjalëve brenda njësisë sintaksore që është marrë si togfjalësh, del jashtë kufijve të kësaj njësie, duke kaluar në një njësi tjetër që është fjalia. Në konceptimin e sotëm të analizës së fjalisë, në këto struktura kemi fjali, që përbëhen nga dy elemente, dy përbërës ose dy sintagma, përkatësisht, sintagma emërore (SE - kryefjala) dhe sintagma foljore (SF – folja, kallëzuesi).

Kjo është një ndarje në nivelin e parë të analizës, pastaj secili nga këta përbërës u nënshtrohet ndarjeve të tjera, në qoftë se është i zgjeruar, deri te elementet fundore që janë gjymtyrët minimale ose fjalët. Lidhja kryefjalë – folje është një lidhje e veçantë që ndryshon nga lidhja nënrenditëse, karakteristike për togfjalëshin. Teoria e togfjalëshit përjashton lidhjet me bashkërenditje për formimin e një togfjalëshi, sepse uniteti gramatikor dhe kuptimor i togfjalëshit zbulohet vetëm me lidhjen e nënrenditjes<sup>179</sup>.

Përparësia e analizës së fjalisë në sintagma është se krahas sintagmave me lidhje varësie, dallohen edhe sintagmat me bashkërenditje, kështu që me teorinë e sintagmës shpjegohen edhe këto lloj lidhjesh të fjalisë. Pra koncepti sintagmë, ndryshe nga koncepti i togfjalëshit, është gjithëpërfshirës. Për më tepër, analiza në togfjalësha është një skemë horizontale e rrafshët, që shënon bashkimet dyshe të fjalëve në mënyrë mekanike, pa zbuluar strukturën e brendshme të njëpasnjëshme të bashkimit të tyre. Kurse analiza në sintagma zbulon vendosjen hierarkike të fjalëve në mënyrë më të hollësishme, duke zbuluar kombinimet reale të mundshme të tyre; p.sh dominimi, komadimi, drejtimi, struktura e argumentit apo ndarja e roleve semantike te folja, e bën më të thjeshtë dhe të qartë rendin e përbërësve në fjali dhe rëndësinë e interpretimit kuptimor të fjalëve.

Sipas teorisë së togfjalëshit, në togfjalësh shprehen marrëdhënie predikative, pra marrëdhënie midis subjektit të veprimit a bartësit të procesit dhe vetë veprimit a procesit, marrëdhënie kundrinore, pra midis veprimit dhe objektit, marrëdhënie përcaktore dhe marrëdhënie rrethanore.

Teoria e togfjalëshit mbetet në kuadrin e gjuhësisë tradicionale, që e shihte fjalinë të përbërë nga gjymtyrë të lidhura në mënyrë lineare me njëra-tjetrën. Por, në të vërtetë,

---

<sup>178</sup> Thoma Dhima, *Po aty*, fq. 74

<sup>179</sup> Spiro Floqi, *Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*, Studime Filologjike Nr. 1, 1968 Tiranë, fq. 27



procesi i krijimit të fjalisë nuk është një proces linear, gjatë të cilit një togfjalësh lidhet me një togfjalësh vijues. Fjalët lidhen me njëra-tjetrën për të krijuar njësi më të mëdha.

Kjo lidhje kalon në disa shkallë, duke krijuar në këtë mënyrë marrëdhënie hierarkike midis fjalëve. Në këtë proces hierarkik, në dallim nga procesi linear i teorisë së togfjalëshit, fjalët marrin një “status” të veçantë<sup>180</sup>. Ato shihen si pjesë të domosdoshme e një konstituenti.

Cila është rëndësia e sintagmës në sintaksë<sup>181</sup>. Për rëndësinë e sintagmës në sintaksë do t’u referohemi vlerësimeve të Th. Dhimes (2007) i cili thekson se “analiza në sintagma zbulon vendosjen hierarkike të fjalëve në mënyrë më të hollësishme, më të qartë, duke zbuluar kombinimet reale të mundshme të tyre....”.

Midis përbërësve të sintagmave gjithashtu vendosen raporte të ndryshme strukturore e kuptimore. Evidentimi i lidhjeve strukturore të përbërësve të sintagmës si dhe i argumenteve të brendshëm dhe të jashtëm që cakton folja, si bërthama e fjalisë, dhe parimi i përzgjedhjes në bazë të informacionit leksikor që mbart folja, krijojnë gjithashtu raportet të cilat do të analizohen në mënyrë më të detajuar në kapitujt në vazhdim.

#### **4.2 Teoria X – bar për sintagmën foljore**

Foljet e shqipes mund të përdoren në fjali vetëm nëse bashkohen ose lidhen me fjalë të tjera, duke krijuar kështu një konstituent foljor ose sintagmë, madhësia e së cilës është e papërcaktuar. Praninë e konstituentëve foljorë në fjalitë e gjuhës shqipe mund ta provojmë duke zbatuar kriteret e përmendura më sipër, kur kemi folur për konstituentin në përgjithësi. Kriteret për dallimin e konstituentit foljor në gjuhën shqipe janë si më poshtë<sup>182</sup>:

- 1) Testi i zëvendësimit
- 2) Testi i zhvendosjes ose i lëvizjes
- 3) Testi i bashkërenditjes
- 4) Testi i fragmentit

Konkretisht, **testi i zëvendësimit** provon se një grup fjalësh është konstituent foljor nëse në vend të tij përdoret shprehja *po ashtu*. Pra, **konstituentët foljorë mund të zëvendësohen nga shprehja *po ashtu***:

Petriti erdhi, edhe Agimi *erdhi* = Petriti erdhi, *po ashtu* edhe Agimi. Petriti lexoi librin, edhe Vera *lexoi librin* = Petriti lexoi librin, *po ashtu* edhe Vera.

Krah. me *\*po ashtu librin* edhe Vera.

---

<sup>180</sup> H. Hyska, *Po aty*

<sup>181</sup> Harallamb Miçoni, Dorëshkrim, Disertacion për marrjen e gradës shkencore Doktor, “*Rreth Frazologjisë se Gjuhës Shqipe Krahasuar me Greqishten*”, Tiranë 2013, fq. 11, referuar nga Th. Dhima 2007.

<sup>182</sup> A. Carnie, *Modern Syntax*, A Coursebook, Cambridge University Press, 2011, fq. 114-116.

Fjalja e fundit është jogramatikore, sepse shprehja *po ashtu* e ka zëvendësuar vetëm pjesërisht konstituentin foljor, i cili në të vërtetë përbëhet nga një folje kalimtare dhe një emër në kallëzore si kundrinë e drejtë. Nëse folja ka një kundrinë të drejtë, ajo është pjesë e konstituentit foljor. Kështu që *po ashtu* duhet ta zëvendësojë foljen bashkë me emrin në kallëzore.

**Sipas testit të lëvizjes**, një grup fjalësh është konstituent foljor ose sintagmë foljore SF nëse mund të paravendoset e tëra, me gjithë fjalët me të cilat lidhet folja, dhe jo vetëm një pjesë e fjalëve të këtij grupi. P.sh. Petriti **erdhi në mëngjes** vs. **erdhi në mëngjes** Petriti.

**Sipas testit të bashkërenditjes** mund të bashkërenditen dy konstituentë vetëm nëse ata shprehen me të njëjtën kategori. P.sh dy folje:

Petriti *erdhi* dhe *iku* shpejt.

Petriti *erdhi* dhe *\*ikja* shpejt.

**Testi i fragmentit** përdoret në përgjigjet e fjalive pyetëse për të provuar praninë e konstituentit foljor. Në këto raste një fjalë ose grup fjalësh është konstituent nëse:

a) përgjigjia e një fjalie pyetëse mund të jetë me pjesëzën *po* ose *jo*. P.sh.:

Erdhi Petriti? **Po**.

b) nëse një fjalie pyetëse mund t'i përgjigjemi me një fjalë të vetme, kjo fjalë është konstituent.

Di të lexojë Petriti? Po, po **di**.

Në këto fjali njësitë *po* dhe *di* janë konstituentë, sepse qëndrojnë më vete në përgjigjen e pyetjes.

Por cilët janë përbërësit e sintagmës foljore? Sipas pemës strukturore të sintagmës foljore SF shohim se ajo përmban një fundore dhe jofundore.

SF (një jofundore, emërtohet me një sintagmë)

|  
F (një fundore, emërtohet me një fjalë nga leksiku)

|  
LEXOJ

Pema 1: *Nyjat e pemës strukturore të sintagmës foljore SF LEXOJ*

Cilat janë marrëdhëniet strukturore e gramatikore të pemës së sintagmës foljore të gjuhës shqipe. Në pemën strukturore (1), SF dominon F dhe LEXOJ, dhe F dominon

LEXOJ. Nyja që dominon të gjitha nyjat e tjera në pemë dhe nuk dominohet nga asnjë është **nyja rrënjë**.

Përbërësit e sintagmës foljore kanë një strukturë hierarkike. Teoria që shpjegon mënyrën e projektimit të këtyre përbërësve është teoria X – bar, paraqitur fillimisht nga Chomsky (1970) dhe u vazhdua më pas nga Jackendoff (1977) etj.<sup>183</sup>.

Kur Chomsky zhvilloi modelin e gramatikës transformuese, ai iu rikthye çështjes së pjesëve tradicionale të ligjëratës. Ai argumentoi se të gjitha gjuhët duhet të kenë pjesë ligjërata. Ky argument është ngritur bazuar në tezën e tij se ka rregulla universale të strukturës së sintagmave që gjejnë zbatim në të gjitha gjuhët. X-bar erdhi në ndihmë të gjuhëtarëve si një kategori e cila do të shërbente për të plotësuar dhe lidhur leksemën dhe sintagmën<sup>184</sup>.

Ajo që vihet në dukje është se njerëzit janë të lindur me njohuri gjuhësore që paraqiten në skemat e X – bar. Ndryshe nga Strukturalizmi Amerikan ku çdo ndërtim me përbërësit përkatës quhej ekzocentrik (d.m.th. “qendra”- koka i përkiste një tjetër kategorie ndryshe nga e tëra), në teorinë X-bar, çdo sintagmë është endocentrike. Kjo do të thotë se çdo sintagmë ka një element në përbërjen e tij që shërben si kokë dhe është e të njëjtës kategori që emërtohet dhe vetë sintagma.

Siç kemi thënë, **koka** është elementi qendror dhe i domosdoshëm. Në gjuhën shqipe koka do të lidhet me **plotësorin**. Koka dhe plotësori i saj formojnë një përbërës që qëndron në nivel më lart, i cili paraprihet nga një tjetër element, **specifikuesi (Spec)**. Në sintagmën foljore të shqipes specifikuesi bashkohet me projektionin maksimal SF, kurse plotësori bashkohet me kokën e sintagmës në nivelin e ndërmjetëm F’.

Projektimi i sintagmës foljore bëhet gjithnjë nga poshtë lart, ndonëse leximi i saj mund të bëhet ose nga poshtë lart, ose nga lart poshtë, duke filluar nga projektioni maksimal. Në brendësi të sintagmës, F përfaqëson kokën apo projektionin zero. Nga bashkimi i foljes me plotësorin formohet projektioni i ndërmjetëm F’ dhe nga bashkimi i këtij të fundit me specifikuesin krijohet projektioni maksimal F’’ apo SF/VP (nga ang. *verb phrase/sintagma foljore*)<sup>185</sup>. Të tre projektionet e kokës formojnë atë që quhet shtylla e pemës dhe degët e saj përbëjnë ato që quhen nyjat përfundimtare. Në shembullin e mëposhtëm:


- (1) Vajza fotografoi kalanë.

---

<sup>183</sup> Noam Chomsky, *Remarks on Nominalization*. In: R. Jacobs and P. Rosenbaum (eds.) *Reading in English Transformational Grammar*, Waltham: Ginn, 1970, fq. 184-221. Dhe Ray Jackendoff, *X-bar syntax: a study of phrase structure*. Cambridge MA: MIT Press, 1977

<sup>184</sup> Robert N. St. Clair, *X-Bar Syntax*, tërhequr në 13.03.2012 nga <http://epistemic-forms.com/ps-xbar.html>

<sup>185</sup> Flora Koleci, Giuseppina Turano, *Hyrje në Sintaksën Gjenerative të Shqipes*, 2011, SHBLU, fq. 35-40



Pema 2: SEPT Vajza fotografoi kalanë

folja *fotografoi* përfaqëson kokën e sintagmës foljore SF “fotografoi kalanë”. Emri *kalanë* përfaqëson pozicionin e plotësorit, ndërsa emri *vajza* është specifikuesi i fjalisë.

Një plotësor është element përbërës i një dhe vetëm një koke në një sintagmë foljore. Duke ndjekur terminologjinë gjenerative, sintagma emërore SE *kalanë* si plotësori foljor paraqitet si motra e kokës F ose bija e projeksionit të ndërmjetëm dhe plotëson kuptimin e saj.

Për sa u përket specifikuesve, si specifikues të foljes mund të dalin pjesëzat trajtëformuese, por edhe kuptimet gramatikore të foljes. Ndër këto të fundit Chomsky përmend kuptimin kohor dhe atë që ai quan [ $\pm$ AGR] (*agreement – përshtatje*), që nuk janë tjetër veçse kuptimet gramatikore që rrjedhin nga përshtatja e foljes në fjali<sup>186</sup>. Specifikuesi (Spec) është quajtur motra e projeksionit të ndërmjetëm EPT’ ose bija e projeksionit maksimal SEPT. Përcaktimi konfigurues i specifikuesit është pranuar gjerësisht si pozicion tipik sintaksor, i cili ka pak apo aspak kuptim në kuptimin tërësor të sintagmës. Për shembull Speas<sup>187</sup> shprehet se specifikuesit u referohen elementëve të klasave të mbyllura si fjalë që tregojnë masë apo përcaktojnë (përemra dëftorë), të cilat në dukje specifikojnë apo referojnë për sintagmën, por më tej shton se ky përcaktim i termit specifikues është i papranueshëm, sepse fjalët që tregojnë masë janë trajtuar si **modifikues** dhe jo si specifikues. Nga ana tjetër, Stowell<sup>188</sup> i trajton përemrat dëftorë si koka e sintagmës përemërore dhe jo si specifikues, duke ndjekur kështu Hipotezën e

<sup>186</sup> Rami Memushaj, *Gjuhësia Gjenerative*, SHBLU, 2003, fq. 131 - 132

<sup>187</sup> Margaret Speas, *Phrase Structure in Natural Language*. Kluwer, London, UK, 1990, fq. 37

<sup>188</sup> Jerry T. Ball, *Towards a Semantics of X-bar Theory*, e tërhequr më 13.03.2012 nga <http://www.doublertheory.com/SemanticsOfXBarTheory.pdf> referuar nga Tim Stowell, *Subjects, Specifiers, and X-Bar Theory*, në *Alternative Conceptions of Phrase Structure*, ed. nga M. Baltin & A. Kroch, The University of Chicago Press, Chicago, IL, 1989

Kokës Funktionale. Megjithatë gjuhëtarë të tjerë vazhdojnë të pranojnë këto fjalë si specifikues<sup>189</sup>.

Modifikuesit janë kategori të përgjithshme dhe jo një fjalë e vetme; janë të varura nga koka e sintagmës, por jo detyrimisht janë të domosdoshëm nga ana kuptimore; ata mund të shprehin nocione të ndryshme si kohë dhe vend. Si modifikues gjejmë dhe sintagma parafjalore dhe fjali të nënrenditura përcaktore<sup>190</sup>. Nga sintagma foljore varen këto kategori:

1. **Argumentet (specifikuesi dhe plotësori)**
2. **Modifikuesit = Adjunktet**

Rregullat e strukturës së sintagmave foljore janë:

Për specifikuesin (kryefjalë) e kokës X:

**XP → YP    X'**

Për çdo plotësor të kokës X do të kishim:

**X' → X    ZP'**

Për modifikuesit nuk ka një numër të përcaktuar në një fjali; gjithashtu rendi i tyre është i ndryshueshëm duke mos cënuar kuptimin e fjalisë. Kështu, modifikuesit mund të vendosen si më poshtë:

**XP → XP    ModP**  
**X' → X'    ModP**

Në përgjithësi, ndryshe nga plotësorët dy ose më shumë përbërës të të njëjtit modifikues mund të kenë të njëjtën kokë. Plotësorët kombinohen me kokën leksikore për të formuar një sintagmë minimale, kurse modifikuesit kombinohen me një sintagmë për të formuar projektionin maksimal<sup>191</sup>.

Zakonisht modifikuesit renditen pas plotësorëve, megjithëse ashtu siç thamë më lart, rendi i tyre është i ndryshueshëm dhe vendosja apo mosvendosja e tyre është fakultative dhe nuk e prish gramatikalitetin e fjalisë, pra si të tilla ato mendohet se janë

---

<sup>189</sup> *Po aty*, fq. 1

<sup>190</sup> Ted Gibson, *Psycholinguistics: Syntax II*, e tërhequr më 13.03.2012 nga [http://ocw.mit.edu/courses/brain-and-cognitive-sciences/9-59j-psycholinguistics-spring-2005/lecture-notes/0208\\_syntax\\_2.pdf](http://ocw.mit.edu/courses/brain-and-cognitive-sciences/9-59j-psycholinguistics-spring-2005/lecture-notes/0208_syntax_2.pdf)

\* Numri i plotësorëve/komplementëve ndryshon në varësi të marrëdhënies kuptimore që cakton folja me argumentet me të cilat kërkon të plotësohet.

<sup>191</sup> Jong-Bok Kim, Peter Sells, *Chapter 4: Head, Complements, and Modifiers*, e tërhequr më 13.03.2012 nga <http://web.khu.ac.kr/~jongbok/teaching/eng-syn-class/chap4-slide.pdf>

sintagma parafjalore PP/SP. Por studiuesi Manfred Krifka<sup>192</sup> shprehet se jo gjithmonë sintagmat parafjalore shërbejnë si modifikues. Në fjalinë:

(2) Mira banon **në Tiranë**

folja *banon*, nuk mund të qëndrojë pa u plotësuar nga një SP, në rastin konkret *në Tiranë*, dhe për ta vazhduar më tej analizën kuptimore kjo folje nuk kushtëzon apo tregon që vepruesi, pra *Mira*, është/ndodhet në këtë moment *në Tiranë*. Si rrjedhim mund të themi se folje të tilla si *banoj*, *kthehem*, *shtrihet*, *jetoj* (*me kuptim banoj*) etj. plotësohen me sintagma parafjalore që shërbejnë si plotësorë të domosdoshëm për të cilët do të flasim më poshtë.

### **4.3 Struktura argumentore e foljes**

Më lart trajtuam strukturën përbërëse të sintagmës foljore dhe u ndeshëm me koncepte si **argument** dhe **adjunkt** e **rol semantik**. Struktura argumentore në veçanti ka tërhequr vëmendjen për shkak të perspektivave të ndryshme. Si sintagmat emërore lidhen vetvetiu me foljet përkatëse kërkon një qasje jo vetëm shumëdimensionale, por edhe shumëdisiplinore; një qasje që të jetë në gjendje të sjellë bashkë aspekte të semantikës, morfologjisë, tipologjisë, diakronisë, përvetësimit, njohjes dhe disa insistojnë dhe për pragmatikën.

Një sintagmë emërore që zë vendin e argumentit të një foljeje të caktuar shfaq karakteristika të llojeve/dimensioneve të ndryshme<sup>193</sup>: gramatikisht mund të jetë një kryefjalë kalimtare, semantikisht një përjetues, morfologjikisht një përemër, nga ana pragmatike mund të japë informacion. Në këto dimensione shihet fillimisht struktura semantike që duhet të merret parasysh seriozisht si një ndikim potencial e madje përcaktor i strukturës argumentore.

Du Bois<sup>194</sup> shprehet se lidhja me qasjen semantike i ka rrënjët pa dyshim në faktin e kuptimit të shprehur nga një folje e caktuar dhe nga çdo bashkë-argument i shfaqur brenda konfigurimit argumentor të përgjithshëm. Për më tepër, vetë folja duket se e identifikon dhe e izolon saktësisht një kontekst të caktuar, i cili mund të karakterizohet sistematikisht përmes analizave semantike. Por pritshmëria që vetëm semantika e kontekstit mund të sigurojë bazën tërësore për të kuptuar strukturën argumentore fillon të duket pa baza reale deri në atë pikë sa anashkalon kontributin e rëndësishëm të faktorëve të tjerë.

---

<sup>192</sup> Manfred Krifka, *Predicates, Modifiers, Definite NPs, X-bar Theory, and Types*, e tërhequr më 13.03.2012 nga [http://amor.cms.hu-berlin.de/~h2816i3x/Lehre/2000\\_Semantics/SemanticsI-05.pdf](http://amor.cms.hu-berlin.de/~h2816i3x/Lehre/2000_Semantics/SemanticsI-05.pdf), fq. 73

<sup>193</sup> John W. DuBois, Lorraine E. Kumpf, William J. Ashby “*Preferred argument structure: Grammar as architecture for function*”, 2003, John Benjamins B.V, fq. 11 - 20

<sup>194</sup> *Po aty*, fq. 15

Në rast mungese të shpjegimit semantik përkatës atëherë bëhet mëse i qartë problemi i ngritur në ligjërim; pra strukturat argumentore përdoren për të dhënë të tëra veprimet që folësi ka nevojë të kryejë.

Dimensioni i ekuacionit të strukturës argumentore i cili është ndjekur më së shumti është gramatika dhe më specifikisht pragmatika e ligjërimit, por struktura argumentore tashmë shtron kërkesa më të forta për studiuesit, duke kërkuar vëmendje simultane drejt një rrjeti me faktorë të ndërlikur, duke përfshirë strukturën semantike dhe strukturën konceptuale në nivelet e fjalës dhe shprehjes.

Le t'i kthehemi qasjes se si struktura argumentore është zhvilluar në gjuhësinë moderne me fokus në përpjekjet që gjuhëtarët kanë bërë për të kuptuar gramatikën dhe kuptimin. Gjuhësia moderne u njoh me nocionin e argumentit nga filozofia, ku ka shërbyer për një kohë të gjatë si mjet konceptual për analizat logjike, me rrënjë që shkojnë deri te Frege (1879 [1960])<sup>195</sup>. Për Frege struktura argumentore ishte një instrument për formulimin e “mendimit të pastër” dhe çdo qasje e saj në gramatikat e gjuhëve të veçanta ishte një aspekt i dorës së dytë.

Sapo gjuhëtarët<sup>196</sup> përcaktuan konceptin e argumentit, vëmendja dhe qëllimi ishte të ndiqnin më tej lidhjen mes strukturës argumentore në organizimin e shprehjes gjuhësore.

Në fillim struktura argumentore përfaqësonte pak a shumë një mënyrë për të përshkruar kuptime në terma logjike, pa lidhje të detajuar me forma gjuhësore, me kalimin e kohës, ajo frymëzoi qëllime më ambicioze dhe më të thella në studimin e gjuhës. Struktura argumentore njihet si një element i padiskutueshëm i gramatikës që influencon teori të përgjithshme të gramatikës dhe kuptimit si dhe ndihmon në përshkrimin e fenomeneve të veçanta gramatikore dhe semantike të gjuhëve të botës.

Koncepti anon tashmë më shumë drejt strukturës, por anon dhe drejt kuptimit; detyra më e rëndësishme mbetet përafrimi i të dyjave. Struktura argumentore qartësisht ngre problemin e artikulimit mes disa marrëdhënive kuptimore nga një anë dhe disa marrëdhënive gramatikore nga ana tjetër. Rëndësia e saj qëndron në udhëkryqin: struktura argumentore qëndron aty ku kuptimi takon gramatikën dhe fjala takon sintaksën. Për më tepër, nëse Frege kishte të drejtë, atëherë funksioni pragmatik mund të përfaqësohet në këtë udhëkryq gjithashtu, pavarësisht nëse është njohur apo integruar në analizat e strukturës argumentore.

Struktura argumentore përcakton në mënyrë efektive marrëdhëniet mes komponentëve gramatikorë kryesorë të predikativitetit. Për shkak të lidhjeve me repertorin leksikor të kuptimit të një foljeje, struktura argumentore është njohur si përfaqësuese e vetë kuptimit.

Por në fakt, struktura argumentore përkon me një kuadër organizativ që vendos marrëdhënie kombinuere ndërmjet elementëve në të paktën dy dimensione paralele dhe

---

<sup>195</sup> *Po aty* referuar nga Gottlob Frege, 1879 [1960]. “Begriffsschrift: A formalized language of pure thought modelled upon the language of arithmetic”. Në P. Geach and M. Black (eds), *Translations From the Philosophical Writings of Gottlob Frege*. Oxford: Blackwell, 1–20

<sup>196</sup> John W. DuBois, *Po aty*, fq. 16-18

përsëri vendos një tërësi të mëtejshme marrëdhëniesh ndërmjet këtyre dimensioneve. Në dimensionet kombinuese, (1) gramatikisht, emrat vendosen pranë foljeve si kryefjalë, kundrinorë etj; (2) semantikisht konceptet bazë lidhen me konceptet e kontekstit si veprues, pësues etj. Në këtë mënyrë ndërmjet këtyre dy niveleve ngrihet një kuadër sistematik i një tërësie marrëdhëniesh semantike dhe i një tërësie marrëdhëniesh gramatikore. Procesi i ngritjes së këtij kuadri karakterizohet nga përzgjedhja e argumentave. Specifikimi leksikor hyn në lojë si një pjesë e repertorit të foljes që e përcakton atë specifikisht në bazë të parimeve të përgjithshme të ligjëritimit. Një formulim i mundshëm do të ishte:

*Funksionet argumentore janë drejtpërdrejt të lidhura me rolet semantike në strukturat predikat-argumentore. Ato sigurojnë një mënyrë uniforme të paraqituri të ngjarjeve, veprimeve dhe situatave të cilat janë projektuar në nënklasa të ndryshme predikative (Bresnan dhe Mchombo 1987:757)<sup>197</sup>.*

Strukturat argumentore dhe marrëdhëniet gramatikore mbartin një lidhje të motivuar përtej tërësisë së tyre siç shprehet dhe Frege<sup>198</sup>. Marrëdhëniet gramatikore dhe strukturat argumentore janë konsideruar si të lidhura me fusha të ndryshme si logjika, semantika dhe pragmatika në fjali që do të shprehin vlera si veprim, qëllimshmëri, ndjeshmëri, aktualitet etj. Për shumë, lidhjet më të forta gramatikore ndërmjet një strukture argumentore të foljes rrjedhin nga kuptimi i saj. Për sa i përket lidhjes semantike mjafton të themi se rregullat e lidhjes duhet të jenë të specifikuar dhe semantika e foljes duhet pjesërisht të përcaktojë strukturën sintaksore:

*Kuptimi i foljes është një faktor në përcaktimin e strukturës sintaksore të fjalive. Ngjashmëritë e hasura në gjuhë të ndryshme sugjerojnë fuqishëm që kuptimi është pjesë e arkitekturës së gjuhës (Levin dhe Rappaport Hovav 1995: 1)<sup>199</sup>.*

Qëndrueshmëria e këtyre paraleleve ndër-gjuhësore në modelet e lidhjeve mes argumenteve (ose përzgjedhjes së argumenteve) është një tregues i dobishëm për fuqinë e tyre për të formësuar gramatikën. Por pavarësisht njohurive të thella për lidhjen që duhet identifikuar mes strukturës argumentore dhe kuptimit përsëri nuk kemi të dhëna mbi faktin se si arrihet kjo lidhje. Sipas Bresnan<sup>200</sup>:

*Arsyeja për këtë është se struktura argumentore ka dy anë, semantike dhe gramatikore. Në anën semantike, struktura argumentore përfaqëson pjesëmarrësit kryesorë në ngjarje (gjendje, procese) të projektuar nga një predikat i vetëm. Nga kjo pikëpamje duket si një lloj përfaqësimi i strukturës së ngjarjeve. Nga ana sintaksore, struktura argumentore përfaqëson infomacionin minimal të nevojshëm për të karakterizuar vartësit sintaksorë të një koke që merr argumente. Nga kjo pikëpamje duket*

---

<sup>197</sup> Joan Bresnan, Sam A. Mchombo, "Topic, pronoun, and agreement in Chichewa", *Language* 63: 1987, 741–782

<sup>198</sup> Gottlob Frege, *Po aty*

<sup>199</sup> Beth Levin, Malka Rappaport Hovav, *Unaccusativity: At the Syntax-Lexical Semantics Interface*. Cambridge: MIT Press, 1995.

<sup>200</sup> Joan Bresnan, *Lexical-Functional Syntax*. Oxford: Blackwell, 2001, fq. 304



si një lloj nënkategorizimi ose valencë. Në këtë mënyrë struktura argumentore është një ndërthurje mes semantikës dhe sintaksës së foljeve (Bresnan 2001:304).

Megjithatë struktura argumentore është për Bresnan “një ndërtim tërësisht leksikor sintaksor dhe jo një ndërtim semantik”, e cila përmban sasinë, tipin dhe organizimin hierarkik të argumenteve si një parathënie për projektimin e tyre në strukturat sintaksore (2001:304). Ne pranojmë faktin që struktura argumentore ngre një tërësi qasjesh – me të paktën dy anë dhe që qëndron si një aspekt i fjalëve (ndërtimeve) e cila kryesisht ngjyros procesin e shprehjes së kuptimit.

Por si janë trajtuar më konkretisht këto koncepte në gramatikën gjenerative<sup>201</sup>? Marrim rastin e foljes *fotografoj*. Ajo shpreh një veprim i cili përfshin dy pjesëmarrës; një pjesëmarrës aktiv, pra personi që bën fotografi dhe një pjesëmarrës pasiv, d.m.th. personi/sendi/dukuria që fotografohet.

Ky nocion i “pjesëmarrësve në një veprim” është formalizuar në bazë të qëndrimeve tërësisht logjike. Si rrjedhim, vendosja e “pjesëmarrësve” në realizimin e një veprimi shpjegohet me strukturën argumentore të fjalisë. Mendohet se është vetë folja që përcakton “pjesëmarrësit në një veprim”. Në fjalinë:

(1) Vajza fotografoi kalanë.

folja *fotografoj* nuk referon thjesht një person apo send, por ajo përcakton lidhjet mes “pjesëmarrësve” në veprim. Në rastin në fjalë, folja *fotografoj* kërkon dy argumente për kryerjen e veprimit, përkatësisht *vajza* dhe *kalanë*. Foljet kalimtare kërkojnë dy argumente që të plotësohen kuptimisht e gramatikisht. Këto argumente janë në rastin konkret dy SE; sintagma emërore *vajza* – në funksionin e kryefjalës dhe *kalanë* – në funksionin e kundrinorit të drejtë.

Duke vazhduar në këtë logjikë mund të flasim për argumente të brendshëm dhe të jashtëm<sup>202</sup>. Quhet **argument i brendshëm** përbërësi i SF (plotësori) i cili është i domosdoshëm në sintagmë, ai nuk mund të hiqet dhe është përbërësi në funksionin e kundrinorit të drejtë që vendoset menjëherë pas foljes.

Quhet **argument i jashtëm** ai përbërës i sintagmës foljore që vendoset në funksionin e kryefjalës (zakonisht specifikuesi). Termat i brendshëm/i jashtëm kanë të bëjnë me faktin që argumenti i brendshëm ndodhet brenda sintagmës foljore SF, ndërsa argumenti i jashtëm zë një pozicion në periferinë e majtë të kësaj sintagme. Argumenti i jashtëm nuk shënohet vetëm nga folja, por nga bashkimi i saj me argumentin e brendshëm, pra nga vetë sintagma foljore.

Foljet jokalistare kërkojnë të plotësohen vetëm nga një argument.

(2) Treni ecën.

---

<sup>201</sup> Liliane Haegeman, *Introduction to Government and Binding Theory*, Second Edition, 1998, Blackwell Publishers Ltd, fq. 42-46

<sup>202</sup> Flora Koleci, Giuseppina Turano, *Hyrje në Sintaksën Gjenerative të Shqipes*, 2011, SHBLU, fq. 51-52

Në rastin e fjalisë së mësipërme (2), *treni* – në funksionin e kryefjalës është argumenti i vetëm i SF.

Për sa i përket foljeve bikalimtare mund të themi se ato i kërkojnë dy argumente të brendshme për t'u plotësuar, pra kundrinorin e drejtë dhe kundrinorin e zhdrejtë.

(3) Djali i dha lulen vajzës.

Pra, folje të tilla si *jap, them, dhuroj* realizohen duke caktuar argumentin e parë të brendshëm – kundrinorin e drejtë dhe më pas, caktojnë argumentin e dytë të brendshëm – kundrinorin e zhdrejtë.

Duke ndjekur logjikën e përdorur më lart mund të themi se çdo folje ka strukturën e vet argumentore, d.m.th. ajo përcakton numrin e argumenteve që kërkon. Argumentët janë përbërësit minimalë për të përmbushur veprimin e shprehur nga folja. Struktura argumentore e foljes përcakton se cilët elementë janë të domosdoshëm për t'u përdorur. Nëse folja shpreh një veprim apo gjendje që përfshin dy argumente, duhet të jenë të paktën dy përbërës në fjali që mbartin këtë rol.

Struktura argumentore e foljes mund të shpjegohet pjesërisht edhe nga struktura nënkategorizuese e përmendur më lart. Nëse një folës i gjuhës e di kuptimin e foljes *fotografoj*, atëherë ai e di se sa “pjesëmarrës” duhen për plotësimin e veprimit dhe si rrjedhim e di numrin e argumenteve që kërkon folja në fjalë.

Nga ana tjetër duhet të shtojmë se ka një dallim të rëndësishëm mes strukturave nënkategorizuese dhe strukturës argumentore. Të parat specifikojnë vetëm përbërësit e SF, pra ato përbërës që janë të detyrueshëm brenda SF. Kryefjala e fjalisë, pra SE, nuk bën pjesë në strukturat nënkategorizuese, sepse të gjitha foljet kanë kryefjalë dhe fakti që kanë kryefjalë nuk përbën një karakteristikë të foljes, ndryshe nga kundrinorët të cilët përcaktojnë strukturat nënkategorizuese të foljeve. Struktura argumentore liston të gjitha argumentet; pra përfshin edhe kryefjalët, të cilat realizohen jashtë SF.

#### **4.4 Struktura argumentore dhe pragmatika**

Brenda kuadrit të ngushtë gramatikor të artikuluar nga një folje dhe argumentët e varur të saj mund të zbulohen qasje strukturore që i përgjigjen jo vetëm gramatikës dhe kuptimit, siç njihet gjerësisht, por gjithashtu dhe kërkesave specifike të pragmatikës së ligjërimit. Gjuhët i lejojnë folësit të zgjedhin mes perspektivave alternative në bazë të konteksteve të dhëna. Modeli i përzgjedhjes argumentore varion në masën e realizimit të perspektivave të ndryshme nga foljet e ndryshme leksikore.

Për të njohur rolin e përzgjedhjes së folësit, Fillmore<sup>203</sup> na vë në dukje një aspekt të ligjërimit, pragmatikën. Struktura argumentore është tashmë baza për një sërë qasjesh

---

<sup>203</sup> Charles J. Fillmore, “*The case for case reopened*”. Në P. Cole (ed.), *Syntax and semantics vol. 8: Grammatical Relations*. New York: Academic Press, 1977b, fq. 59–81

në gjuhë. E vërteta qëndron në faktin se vëmendja më e madhe shkon për karakterizimin gramatikor të strukturës argumentore, por dhe për shpjegimet semantike të propozuara.

Nëse trajtojmë një marrëdhënie gramatikore të izoluar (p.sh. kryefjalën) në raport me një grup foljesh, shumëllojshmëria e marrëdhënieve semantike që gjenerohen është i vështirë për t'u karakterizuar. Kjo ka motivuar shumë gjuhëtarë të zgjerojnë pikëpamjen në lidhje me një sërë bashkë-argumentesh sintaksore që përfshihen në një strukturë të dhënë argumentore në mënyrë që të kuptojmë më mirë se si marrëdhëniet gramatikore brenda një sintagme mund të ndërveprojmë për përzgjedhjen e kryefjalës. Megjithatë sfidat qëndrojnë në faktin që rolet semantike i mbivendosen roleve gramatikore.

(1) Linda:     and she *admired* him; (ajo e *admironte* atë)

(2) Mary:     ... And then of course he *adores* me; (ai më *adhuron* mua)

Argumenti që është zgjedhur si kryefjalë (ajo; ai) e foljeve *admiroj* dhe *adhuroj* nuk është zbatues i veprimit të shprehur nga folja, por është përjetues i një gjendjeje psikologjike. Kundrinorët (atë; mua) që zakonisht luajnë rolin e përjetuesit do të gjenden në këtë rast në rolin e vepruesit – në fakt kundrinori në këtë rast mund të jetë i pavetëdijshëm për veprimin. Për më tepër, kundrinori mund të interpretohet si stimul i cili shkakton gjendjen e përjetuesit. Konceptet e leksikalizuara në foljet si *admiroj* dhe *adhuroj* mund të thuhet se përfshijnë dy argumente, me argumentin e përjetuesit të realizuar si kryefjalë dhe stimuli i realizuar si kundrinor.

Por gjithashtu kemi rastin kur e njëjta skemë mund të trajtohet me një qasje tjetër në kuadrin e strukturës argumentore (Fillmore 1977a, 1977b, Grimshaw 1990)<sup>204</sup>. Krahasojmë në rastin e shqipes foljet *frikësohem* dhe *trembem*:

(3) Danny:   ... Because they *feared* **God**. (Sepse ata i *frikësohen* **Zotit**)

(4) Mary:     ... did I *scare* **you kids**?     (Ju *tremba* **fëmijë**?)

Në fjalitë e paraqitura më lart mund të themi se përfshihen përjetuesi dhe stimuli. Por folja *frikësohem* e vendos përjetuesin në rolin e kryefjalës dhe stimulën në rolin e kundrinorit, ndërsa folja *trembem* e përmbys ekuacionin duke vendosur stimulën në rolin e kryefjalës dhe përjetuesin në rolin e kundrinorit. Ndryshime kaq të thella gramatikore në folje të lidhura ngushtë nga ana kuptimore janë shfrytëzuar nga studiuesit për të ndërtuar arbitraritetin e strukturës argumentore dhe si rrjedhim përzgjedhjen argumentore.

Këto sfida në lidhje me konceptimet më të thjeshta të përzgjedhjes së kryefjalës dhe kundrinorit janë të shumë trajtuara dhe kanë ngitur shumë formulime alternative në

<sup>204</sup> John W. DuBois, *Po aty*, referuar nga Fillmore, Charles J. 1977a. "Topics in lexical semantics". Në R. Cole (ed.), *Current Issues in Linguistic Theory*. Bloomington: Indiana University Press, 76–138. Fillmore, Charles J. 1977b. "*The case for case reopened*". Në P. Cole (ed.), *Syntax and semantics vol. 8: Grammatical Relations*. New York: Academic Press, 59–81. dhe Grimshaw, Jane. 1990. *Argument Structure*. Cambridge: MIT Press.

lidhje me kriteret për realizimin e strukturave argumentore dhe marrëdhëniet gramatikore individuale.

Shpesh është nxjerrë në pah fakti që në ligjërim faktorët pragmatikë duket se janë më të përfshirë me faktorët semantikë, por mbetet ende i paqartë fakti i ndërveprimit të këtyre efekteve.

Nga perspektiva e gramatikës në përdorim, mund të themi se struktura argumentore është një produkt i gramatikalizimit që i përgjigjet një variacioni të kërkesave funksionale komplekse dhe përcillet mes proceseve komplekse të përzgjedhjes. Termi *strukturë* argumentore mbetet gjithsesi i justifikuar, sepse në fund të procesit të gramatikalizimit do të kemi foljet me strukturën e tyre argumentore, duke ndërtuar për folësit e të gjitha gjuhëve një kornizë arkitekturore të qëndrueshme dhe të parashikueshme të funksioneve gjuhësore.

#### **4.4.1 Zhvillime semantike nën ndikimin e gjuhëve të huaja**

Brenda kuadrit të strukturës argumentore na duket me vend të përfshijmë disa raste të përdorimeve të strukturës argumentore foljore në gjuhën shqipe, të cilat kanë ardhur si pasojë e ndikimeve nga gjuhët e huaja dhe të zhvillimeve të ndryshme sociale, ekonomike e gjuhësore.

Është rasti të përmendim disa shembuj me folje që, nën ndikimin e gjuhëve të huaja, sot sillen ndryshe nga rregullat gramatikore e semantike të shqipes, të pasqyruara në Gramatikën Akademike dhe në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe (2006). Folje të tilla janë p.sh. *rrezikohem, vuaj, bëj* etj. Këto folje ose ndryshojnë kalimtarësinë ose nuk e ndryshojnë kalimtarësinë, por zgjedhin emrin e gabuar ose ndodh rasti tjetër që struktura argumentore në një gjuhë tjetër merret si e mirëqenë edhe në shqipe duke shprehur veprimin me foljen e pasaktë. Ka prej tyre që përdoren në vend të foljeve të tjera.

- Kështu është për t'u përmendur rasti i foljes vetvetore **rrezikohem**, në përdorime të tilla si:

- *rrezikon gripin* në vend të *rrezikohet nga gripi*, *rrezikon përmbytje* në vend të *rrezikohet të përmbytet*,

- *bën të pafajshmin* në vend të *bën si i pafajshëm*,

- *bën avokatin* në vend të *ushtron profesionin e avokatit*, ku folja ruan kalimtarësinë, por përdoret me kuptimin e një foljeje tjetër, pra përzgjedh emrin e gabuar.

- *Bën të paditurin* në vend të *hiqet si i paditur*.

- *telefonoj shokun* në vend të *I telefonoj shokut*

- Gjithashtu kemi rastin e foljes jokalimtare **vuaj**, që nën ndikimin e gjuhëve të huaja përdoret si kalimtare: *vuajnë papunësinë* në vend të, *vuan nga papunësia*, *vuan mungesën e strehimit* në vend të *vuan për shak të strehimit*, *vuaj pasojat e ndotjes së ambientit* etj.

- Probleme në strukturën argumentore të foljeve gjejmë edhe në përdorimet në veçore, kur në fakt norma pranon përdorimet në joveprore: **diplomoj** (p.sh. *Si një person që ka diplomuar në Princeton dhe Harvard*, GSH 3 korrik, 2011), në vend të përdorimit ... *që është diplomuar në Princeton*; **doktoroj, specializoj** (p.sh. *angazhoj (Kam zgjedhur të angazhoj me PD në vend të Kam zgjedhur të angazhohem me PD)*).
- Realizime të gabuara në rastet e përdorimit të **kalimtarësisë për jokalimtarësi**: *vuaj probleme shëndetësore në vend të vuaj nga problem shëndetësore, këshilloj një psikolog/fjalor/manual për këshillohem me një psikolog, buron probleme (për “gjeneron”), përkujdes traditat (për “kuroj”)*.
- Realizime të gabuara në rastet e përdorimit të **jokalimtarësisë për kalimtarësi**: *votoj partinë X në vend të votoj për partinë X, protestoj vendimin (Familjarët protestojnë vendimin, Neës 24, lajme 14 shtator 2009 për ... protestojnë kundër vendimit), ose përkundrazi jokalimtare për kalimtare nën ndikimin e ndërtimeve të huaja: parandalon në sëmundjet për parandalon sëmundjet etj.*
- Përdorimi i foljes kalimtare **frekuentoj** si folje në diatezën vetvatore reciproke në rastin *ata frekuentoheshin (si çift)*, kundrejt përdorimit të foljes kalimtare **frekuentoj** në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (2006) me kuptimin *ndjek* (për shkollën).
- Ndërtime me foljen **gjej**, të tilla si *E gjeta si pjatë të shijshme* (Programi Mastershef, Top Channel 22 Nëntor 2014) përkundrajt *Më duket pjatë e shijshme*.

#### **4.4.1.1 Përdorimet e gabuara në shqipe nën ndikimin e greqishtes – rast studimor**

Problemi i prirjeve për ndryshimin e strukturës argumentore foljore është veçanërisht i hasur në të folmen e minoritetit grek në jug të vendit dhe në të folmen e emigrantëve shqiptarë të kthyer rrishtas në Shqipëri pas qëndrimit disa vjeçar në Greqi.

Rastet e paraqitura si më poshtë janë pjesë e materialit që është vjelë me anë të intervistave personale të zhvilluara me anëtarë të këtij komuniteti të cilët nën ndikimin e strukturave gjuhësore të greqishtes realizojnë ndërtime të pasakta në shqipe, duke i caktuar një foljeje argumentin e gabuar ose duke e patur të ngulitur strukturën argumentore të greqishtes e përdorin atë në të njëjtën mënyë për ndërtimin përkatës në gjuhën shqipe. Është shqetësues fakti që këto përdorime i hasim shpesh edhe në ligjërimin, veçanërisht të fëmijëve të emigrantëve shqiptarë në Greqi, të cilët në mungesë të njohjes së saktë gjuhësore të shqipes, huazojnë struktura argumentore të gatshme nga greqishtja e si rrjedhim formojnë ndërtime jo të sakta duke i pranëvendosur emrave foljet e gabuara.

- Kështu p.sh. folja **vë** në sintagmën *vë syza*, zëvendësohet nga folja **vesh** ( ) sipas përdorimit në greqisht . Të njëjtën gjë mund të themi edhe për argumentin *shall* ose *vathë* në rastin *vesh shallin/vathët* ( / ) në vend të *vë shallin/vathët*. Gjithashtu kemi përdorimin e gabuar të po

kësaj foljeje në rastin *vendos fëmijën në gjumë* ( ) në vend të *vë fëmijën në gjumë*.

- Folja **shkruaj** në përdorimin *shkruaj në provim* sipas përdorimit në greqishte ; me kuptimin *si dole në provim?* Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe pranëvendosja e parafjalës së lokalitetit *në* si kokë e sintagmës parafjalore SP tregon vetëm vendin ku është shkruar, jo rezultatit e arritur pas kryerjes së veprimit të të shkruarit – pra, *shkruaj në dërrasë*, *shkruaj në rërë* etj.

- Folja **mbyll** në përdorimin *fëmija mbylli tre vjeç sot* sipas ndërtimit në greqishte  $\mu$   $\mu$  . në vend të përdorimit të foljes **mbush** – *mbushi tre vjeç sot*. Gjithashtu përdorimi jo i saktë *mbyll takim* sipas përdorimit në vend të përzgjedhjes së foljes **lë** në *lë një takim*.

- Folja **kaloj** në rastin *kaloj materialin në usb* ( *usb*) në vend të foljes **hedh** në ndërtimin *hedh materialin në usb*.

- Përzgjedhje e gabuar e foljes **them** në *të të them kafënë/ filxhanin* ( / ) në vend të foljes **lexoj** në *lexoj filxhanin*.

- Rasti i ndërtimeve **ka ftohtë/vapë sot**, ( / ) në vend të përdorimit më të shpeshtë të foljes **jam** ose **bëj** në shqipe, pra *është, bën ftohtë/vapë sot*.

- Përzgjedhje e gabuar e foljes **kap** në rastin *më kapi makina* ( $\mu$  ‘ ) në vend të përdorimit të foljes **zë** në shqipe *më zuri makina*.

- Rastet më të shpeshta hasen në përdorimin e gabuar të foljes **nxjerr** në sintagmën *nxjerr dhëmbin* ( ) në vend të përdorimit të foljes **heq** në *heq dhëmbin*; rasti i pranëvendosjes së argumentit *biletën në të nxjerr biletën* sipas ndërtimit në greqishte në vend të *të pres biletën*, pavarësisht se në greqishte i ndeshim të dyja përdorimet, pra si me foljen *nxjerr* ( ) ashtu edhe me foljen *pres* ( ). Përdorim të gabuar të kësaj foljeje kemi edhe në rastin *nxorrën flokët* – në vend të foljes **shkul** në *shkulën flokët*. Gjithashtu përdorim të gabuar në përzgjedhjen e emrit *dhëmbë* me foljen përkatëse kemi edhe në ndërtimin *vulos dhëmbin* ( ), ku në vend të foljes *vulos* struktura argumentore në shqipe kërkon foljen **mbush**, për *mbush dhëmbin*.

- Folja **drejtoj** në përdorimin *drejtoj makinën* sipas ndërtimit në greqishte , kur në fakt përdorimi më i zakonshëm në shqip është me foljen *ngas* ose *jap* në rastet *ngas makinë/ i jap makinës*.

- Për sa i përket përzgjedhjes së gabuar të foljeve për të përshkruar veprimet në drejtimin e mjeteve të transportit kemi edhe rastin e foljes **bëj** në *bëj biçikletë* ( ), në vend të **ngas** *biçikletën*.

- Përdorimi i gabuar i foljes **lexoj** në ndërtimin *lexoj djalin* sipas ndërtimit në greqisht ( ), kundrejt përdorimit në shqipe *ndihmoj djalin të lexojë*. Folja kalimtare *lexoj* në shqipe është një folje me karakteristikën [– Human], pra nuk mund të shoqërohet me një kundrinë frymor, por kryefjala e fjalisë me këtë folje do të jetë gjithmonë një frymor [+ Human].

- Rasti i përzgjedhjes së gabuar të mbiemrit **e bukur** në rastin *Kapuçino ishte e bukur* sipas ndërtimit në greqishte (  $\mu$  ), kundrejt *Kapuçino ishte e mirë*.

- Përdorimi i gabuar i foljes **fle** në rastin *do flemë djalin* sipas modelit në greqisht (  $\mu$  ), në vend të ndërtimit *do vemë djalin për të fjetur*. Folja **fle** në shqipe është një folje jokalimtare e si rrjedhim struktura argumentore e saj përbëhet nga një argument, pra nga kryefjala që bart rolin semantik të përjetuesit.

- Përdorimi i gabuar i foljes kalimtare **ngre** në rastin *ngrita fotografitë në feisbuk (facebook)* sipas modelit në greqishte (  $\mu$  facebook), në vend të përdorimit të foljes **hedh** për realizimin e saktë të *hedh fotografitë në feisbuk (facebook)*.

- Përdorim i gabuar i foljes **bëj** apo **ngre**, në rastin *bëri/ngriti temperaturë djali dje* sipas ndërtimit me foljen **bëj** në greqishte (  $\mu$  /  $\mu$  ), në vend të përdorimit të saktë të foljes **kam** në *kishte temperaturë djali dje*.

- Përdorim i gabuar i foljes **ndryshoj** apo **prish** në rastin *ndryshoj apo prish para*, sipas ndërtimit në greqishte me foljen  $\mu$  apo (  $\mu$  /  $\mu$  ), në vend të përdorimit të foljes **këmbej** për ndërtimin e saktë në shqipe *këmbej para*.

- Përdorim i gabuar i foljes **zbres** në rastin *do zbresë për kandidat bashkie*, sipas ndërtimit në greqishte (  $\mu$  ), në vend të përdorimit të foljes **kandidoj** për ndërtimin e saktë në shqipe *do kandidojë për kryetar bashkie*.

Në fakt, ky është një fenomen që ndodh edhe me shqiptarët që emigrojnë në Greqi, të cilët duke mos patur njohuri gjuhësore të sakta të greqishtes përdorin ndërtimet në greqisht sipas modelit të strukturës argumentore të shqipes si p.sh:

- Rasti i përdorimit të mbiemrit foljor **i zënë** (për telefonin), duke ligjruar në greqishte ndërtimin e gabuar  $\mu$  sipas ndërtimit në shqipe *Telefoni është i zënë* në vend të  $\mu$  . Gjithashtu përdorimi i këtij mbiemri në rastin  $\mu$   $\mu$   $\mu$  , sipas ndërtimit në shqipe *Jam i zënë me punë* në vend të  $\mu$   $\mu$  .

- Gjithashtu mund të përmendim përdorimin e gabuar të foljes **bëj** në ndërtimin *bëj fotografi* (  $\mu$  ) në vend të përdorimit të foljes **nxjerr** për greqishten në  $\mu$  .

- Ndër përdorimet nga struktura argumentore e shqipes në greqisht është edhe ndërtimi *do bjerë shi/ borë* (  $\mu$  /  $\mu$  ) në vend të ndërtimit më të zakonshëm për greqishten  $\mu$  /  $\mu$  .

Këto janë raste që kërkojnë studime të tjera më të thelluara, sepse fenomene të tilla nuk mund të shpjegohen vetëm me përzgjedhjen/ caktimin e strukturës argumentore në një gjuhë të caktuar, në thelb kemi ndërlidhjen e asaj që gjenerativizmi si teori gjuhësore ndërthur, pra përfitim e një gjuhe, sintaksën e kësaj gjuhe dhe pragmatikën e saj.

#### **4.5 Identifikimi i plotësorëve**

Sipas Adam Meyers etj.<sup>205</sup> një përcaktim i termit plotësor do të ishte:

*Nëse një sintagmë foljore përbëhet nga një folje kokë F dhe një sintagmë SX, atëherë SX është një plotësor nëse është pjesë e brendshme e veprimit, gjendjes, ngjarjes etj. të përshkruar në SF, folja përzgjedh SX.*

Në shqipe R. Memushaj<sup>206</sup> modifikuesin e kokës e quan *plotësor*, duke e përdorur si përgjegjës të termit të huaj *complement*, i cili përdoret jo vetëm për kryefjalën e kundrinat, por edhe për gjithçka që del në të djathtë të kokës.

Në përcaktimin e tyre për plotësorët Quirk etj. (1985:1150)<sup>207</sup> shprehen se plotësori është “një pjesë e sintagmës i cili ndjek një fjalë të caktuar dhe plotëson marrëdhënien kuptimore që kjo fjalë përcjell”.

Në studimet e tyre mbi strukturën argumentore të foljes Meyers, Macleod dhe Grishman (1994) kanë dhënë disa nga kriteret e nevojshme që duhet të plotësojë një përbërës për t’u quajtur plotësor.

#### **Kriteret për plotësor**

1. Domosdoshmëria – SX është element i domosdoshëm i SF për të shprehur një marrëdhënie kuptimore e gramatikore me foljen së cilës i bashkangjitet.

- (1)
  - a. Mira rrëzoi (SE *pemën*). (plotësor)
  - b. \*Mira rrëzoi
  - c. Mira zgjoi (SE *Agimin*). (plotësor)
  - d. Mira u zgjua.
  - e. Mira u zgjua (SP *me ngadalë*) (nuk është plotësor)

2. Në joveprore – sintagma SX mund të jetë kryefjalë në formën joveprore nëse ajo është një plotësor.

- (2)
  - a. Mira përgatiti (SE *ëmbëlsirën*)
  - b. SE *Ëmbëlsira* u përgatit nga Mira.
  - c. Shumë njerëz banojnë (SP *në* (SE *atë shtëpi*)).
  - d. SE *Ajo shtëpi* banohet nga shumë njerëz.

---

<sup>205</sup> Adam Meyers, Catherine Macleod, Ralph Grishman, *Standardization of the Complement/Adjunct Distinction*, tërhequr më, 26.06.2014 nga

[http://www.euralex.org/elix\\_proceedings/Euralex1996\\_1/018\\_Adam%20Meyers,%20Catherine%20Macleod%20&%20Ralph%20Grishman%20-tandardization%20of%20the%20Complement%20Adjunct%20Di.pdf](http://www.euralex.org/elix_proceedings/Euralex1996_1/018_Adam%20Meyers,%20Catherine%20Macleod%20&%20Ralph%20Grishman%20-tandardization%20of%20the%20Complement%20Adjunct%20Di.pdf)

<sup>206</sup> Rami Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*, SHBLU, Tiranë, 2003, f. 129.

<sup>207</sup> R. Quirk, S. Greenbaum, G. Leech, J. Svartvik, *A Comprehensive Grammar of English Language*, London, Longman, 1985



3. Rolet Theta – SX mbart një rol theta argument: temë, burim, pësues, përftues, përjetues, çështje etj (Gruber 1965)<sup>208</sup>.

- (3) a. Agimi i dha *Mirës* (përfitues) *librin* (tema)
- b. Makina erdhi (*nga Tirana*) (burimi)
- c. Qeni i zi trembi (*djalin*) (përjetues)
- d. Mira puthi *vëllanë* (pësues)

4. Kuptim i brendshëm – SX ndodh të jetë fakultative, por është e nënkuptuar nëse nuk është shprehur.

- (4) a. Agimi hëngri (*diçka*)
- b. Agimi hëngri

Pjesa në kllapa në fjalinë (4a) është një plotësor sepse realizime të tilla të SE shpesh janë të nënkuptuara edhe kur nuk shprehen ose mungojnë në fjali, si në rastin e fjalisë (4b).

5. Kufizime në përzgjedhje – nëse folja F i imponon kufizime kuptimore në përzgjedhje një SX, atëherë SX është një plotësor.

Kriteri 5 tregon se në një sintagmë të caktuar (F SX), nëse folja F i imponon plotësit SX kufizime në përzgjedhje, atëherë SX është plotësor i kësaj foljeje. Duke shfrytëzuar studimin e McCawley (1968) (i mbështetur në analizën e Fillmore) dhe Lakoff<sup>209</sup> (1969) do të kuptojmë qëndrimin e foljes lidhur me kufizimet në përzgjedhjen e një konstituenti dhe natyrën e tij. P.sh. folja *bezdis* në (5) nënkupton se plotësori i saj është frymor.

- (5) Mira bezdisi *Agimin/atë* (+frymor)

Në fjalinë (5), *Agimin* dhe *atë* janë përdorur si dy përbërës që plotësojnë kufizimet në përzgjedhje. Në këtë mënyrë, përemri *atë* mund t'i referohet një *qeni* por jo një *libri*.

Në fjalitë (6) si më poshtë është ilustruar rasti i anomalive semantike (pra nuk shprehet në kuptimin literal) që ndërveprojnë me kufizimet në përzgjedhje. Nëse do të ndryshohej këndvështrimi ynë për botën dhe ligjërimi do të vendosej në një tjetër dimension do të përftonim fjali të mirëformuara të cilat përdoren në kontekste të caktuara dhe siç shprehen Adam Meyers etj. me një anomali semantike të treguar në përqindje

---

<sup>208</sup> *Po aty*, referuar nga Gruber, Jeffrey S. (1965). *Studies in Lexical Relations*, Ph.D. dissertation, MIT (Reproduced by Indiana University Linguistics Club, January 1970)


<sup>209</sup> *Po aty*, referuar nga McCawley, J. D. (1968). "The Role of Semantics in a Grammar," në E. Bach and R. T. Harms (eds.) (1968) *Universals in Linguistic Theory*, New York: Holt, Rinehart and Winston, Lakoff, George (1969). "Presuppositions and Relative Grammaticality," në *Journal of Philosophical Linguistics*, vol 1., no. 1, 103-16.

(%). Kjo dukuri ka të bëjë me aftësinë që ka folja të përzgjedhë si plotësor një SE me tipar +frymor, -frymor.

- (6) a. Mira përkëdheli (*djalin*) (plotësor, + frymor)  
b. % Mira i përkëdheli (*sedrën*) (plotësor, - frymor, - lit.)

Pra, plotësorët ose komplementët janë elemente të detyrueshëm në përbërjen e sintagmës të cilët mund të shprehen me një sintagmë leksikore ose funksionale. Për sa i përket gjuhës shqipe plotësorët e foljes, pwrkatwsisht tw sintagmws foljore SF, kanë si argument të brendshëm të shprehur me një a) *sintagmë emërore SE* (siç e pamë edhe më lart), b) *një fjali kryefjalore, kundrinore, me ose pa lidhëz* dhe c) *një fjali të varur SEPT* si më poshtë:

- a) Me një sintagmë leksikore SE  
Fotografoi ***kalanë***



Pema 3: Plotësori me sintagmë leksikore SE

Për sa i përket plotësorëve të foljeve të shprehura me fjali të varura kryefjalore ose kundrinore, duke u bazuar në Gramatikën e Gjuhës Shqipe 2<sup>210</sup>, do të thoshim se këto fjali zëvendësojnë gjymtyrë të domosdoshme të fjalive që plotësojnë. Për sa u përket lidhëzave – në Gramatikën 2 shprehet se ato s’janë tregues i veçantë i raporteve sintaksore. Për përcaktimin e këtyre ndihmon struktura dhe përbërja e fjalisë drejtuese, paplotësia e saj, natyra gramatikore, ndonjëherë edhe kategoria semantike e fjalës që ka nevojë të plotësohet.

Kështu, fjalitë kryefjalore lidhëzore<sup>211</sup> mund të jenë dëftore, urdhërore, dëshirore, fjali pyetëse dhe të kenë të bëjnë me kallëzues të shprehur me fjalë të disa grupeve të caktuara leksikore. Mjetet e lidhjes janë lidhëza të caktuara. Këto ndonjëherë mund edhe të mos shprehen, duke u lidhur drejtpërdrejtë fjalia kryefjalore me fjalinë drejtuese, kur e ka kallëzuesin në mënyrën lidhore.

<sup>210</sup> Gramatika e Gjuhës Shqipe II, Tiranë 2002, fq. 496

<sup>211</sup> Po aty, fq. 504

Kur fjalia kryefjalore është fjali dëftore dhe bashkohet me lidhëzën ffilluese, atëherë fjalia e varur ka të bëjë me:

- Folje që tregojnë ligjërim në mënyrë të përgjithshme, të trajtës së vetës së tretë njëjës, pësore si: *thuhet, flitet, tregohet* etj. *I është thënë të vijë pa u vonuar.*

- Folje e lokucione foljore që shprehin të kuptuar, të perceptuar, proces të të menduarit, e opinion, të gjitha folje kalimtare pësore në vetën e tretë njëjës, fjalia kryefjalore bashkohet me lidhëzat ffilluese *se, që,* dhe me lidhëzat funksionalisht ffilluese si *kur, si, në (nëse), po:* *Nga arshivat zyrtare të Republikës Veneciane provohet katërcipërisht që Skënderbeu s'ia la Krujën Venetisë ...*

- Folje e lokucione foljore jokalimtare, gjithmonë në vetën e tretë njëjës, me kuptimin leksikor të të ndodhur: *ndodh, ngjan, ngjet, godit, qëllon, rastis:* *Po si ndodhi xhanëm që e humbe zagarin ...*

Kur fjalia kryefjalore është fjali urdhërore a dëshirore<sup>212</sup> me folje-kallëzues në lidhore përdoret me:

- Folje të shprehjes së vullnetit në vetën e tretë njëjës të diatezës pësore: *kërkohet, lejohet, ndalohet* etj: *Na është ndaluar të quajmë një sharrë të vogël "sharrëzë" ...*

Kur fjalia kryefjalore është fjali pyetëse e zhdrejtë<sup>213</sup>, ajo ka të bëjë me:

- Folje e lokucione foljore të të kumtuarit, të perceptuarit të një procesi mendor: *Nuk më kujtohet mirë se me cilin karvan e bëmë udhën.*

Fjalitë kundrinore lidhëzore<sup>214</sup> fitillojnë kuptimin e kallëzuesit foljor të fjalisë kryesore e drejtuese të shprehur me folje kalimtare veprorë të disa kategorive semantike, e pikërisht të foljeve që tregojnë të kumtuar, të perceptuar shqisor a mendor, brendi të procesit të të menduarit a vlerësim të një fakti.

Fjalia kundrinore është fjali dëftore, kur bashkohet me lidhëzat *se, që, si, sikur* dhe ffillon kuptimin e një gjymtyre të shprehur me folje veprorë e lokucione që tregojnë të kumtuar me:

- Folje që tregojnë të kumtuar në mënyrë të përgjithshme: *them, flas, tregoj, rrëfej, dëftoj, lajmëroj* etj. *Ishin milicët që i thoshnin dikujt që të dorëzohej.*

Fjalia kundrinore është fjali dëshirore a urdhërore kur plotëson një folje që tregon dëshirë, shprehje të vullnetit, të kumtuar, e ka kallëzuesin në mënyrën lidhore (me ose pa lidhëzën që). Përfshihen folje e lokucione si: *pranoj, ëndërroj, parapëlqej, kundërshtoj, dëshiroj, dua, kërktoj, miratoj, uroj, autorizoj, lejoj, këshilloj, propozoj, lutem, porosit, bëj thirrje* etj. *E ftoi mikun të ulej pranë tij. Veç të lutem të largohesh nga ura.*

Fjalitë kundrinore me përemra lidhorë<sup>215</sup> bëjnë me një folje kalimtare veprorë të çdo kuptimi leksikor; ato bashkohen me përemrat e pacaktuar *kush, ç', çfarë, gjithë ç', gjithçka:* *Ajo bëri ç'i thanë shoqet.*

---

<sup>212</sup> *Po aty*, fq. 505

<sup>213</sup> *Po aty*, fq. 506

<sup>214</sup> *Po aty*, fq. 516

<sup>215</sup> *Po aty*, fq. 519


Fjalitë kundrinore pyetëse të zhdrejta kanë të bëjnë me folje me kuptim të caktuar leksikor që tregojnë ligjërim si: *pyes, them, rrëfej, tregoj*; perceptim mendor: *kuptoj, kujtoj, sjell ndër mend, mësoj, marr vesh, di, hetoj, zbuloj*; procese të të menduarit *mendoj, besoj, druhem, kam frikë*: *E di mirë kush martohet*.

Fjalia e varur kundrinore thirrmore e zhdrejtë varet nga një folje me kuptim leksikor të të kumtuarit, të të perceptuarit a të një procesi mendor; lidhet me fjalinë drejtuese me fjalët *sa, si*: *Ja, shiko si vetëtin përjashta!*

Duke qenë se janë përbërës të domosdoshëm për të plotësuar kuptimin e foljes, atëherë këto fjali të varura janë pjesë e sintagmës foljore SF, pemën strukturore të së cilës e ilustruam më poshtë:

b) një SL (sintagmë lidhëzore)

Tha *se do të vonohej*.




Pema 4: Plotësori me sintagmë lidhëzore SL

Pjesë e sintagmës foljore SF mund të jetë edhe një fjali e varur SEPT, e cila shërben si pjesë e domosdoshme kuptimore e foljes, pra një plotësor.

c) një SEPT, ose fjali e varur,

Pa *Benin të vraponte*



Pema 5: Plotësori me fjali të varur SEPT

#### 4.6 Adjunktët

Brenda sintagmës foljore, në fjalitë e përdorura gjatë aktit të ligjëritimit do të ndeshim sintagma të domosdoshme dhe sintagma fakultative<sup>216</sup> të shprehura me sintagma ndajfoljore SN, sintagma parafjalore SP dhe fjali të varura rrethore. Nëse do të analizojmë shembullin e mëposhtëm:

- (1) Tregëtarët ngritën çmimet gjatë ditëve të festave.

Fjalja (1) përbëhet nga një sintagmë foljore SF (*ngritën çmimet*), një sintagmë emërore SE (*Tregëtarët*) dhe nga një sintagmë parafjalore SP (*gjatë ditëve të festave*). Sintagma foljore përbëhet nga folja *ngritën* dhe kundrinori i drejtë *çmimet*, i cili është i domosdoshëm për kuptimin e fjalisë, nuk mund të hiqet sepse do të bënte që fjalja të ishte jogramatikore, pra kundrinori i drejtë *çmimet* është argumenti i brendshëm i foljes *ngritën*.


Ndërkohë që prania e sintagmës parafjalore SP – *gjatë ditëve të festave* – është fakultative, ajo jep një informacion shtesë në lidhje me kohën e kryerjes së veprimit, por që në fakt jo të domosdoshme për ndërtimin dhe kuptimin e fjalisë, pra mund të mos jetë e shprehur. Le ta ilustrujmë në shembujt e mëposhtëm:

- (2) a. Tregëtarët ngitën çmimet.  
 b. \* Tregëtarët ngritën gjatë ditëve të festave.  
 c. Gjatë ditëve të festave tregëtarët ngritën çmimet.

<sup>216</sup> Flora Koleci, Giuseppina Turano, *Hyrje në Sintaksën Gjenerative të Shqipes*, SHBLU, 2011, fq. 54-56

Ndërtimi jogramatikor në (2.b) tregon se në strukturën e sintagmës foljore ka një pozicion të përcaktuar qartë për secilin argument dhe se adjunktët janë ata përbërës fakultativë që zënë pozicione të ndryshme në skemën që paraqet strukturën e fjalisë.

Siç e përmendëm edhe më lart sintagma foljore në (1) përbëhet nga folja *ngritën* dhe plotësori i saj *çmimet*. Bashkimi i kokës F me plotësorin formon projeksionin e ndërmjetëm SF. Përbërësi tjetër, pra adjunkti SP, *gjatë ditëve të festave*, i shtohet më vonë SF duke u paraqitur në këtë mënyrë në skemën e fjalisë si më poshtë:



Pema 1: *Tregëtarët ngitën çmimet gjatë ditëve të festave*

Adam Meyers etj.<sup>217</sup> shprehen se ka të paktën tre faktorë që bëjnë ndryshimin ndërmjet plotësorëve (që realizohen në formën e argumentëve) dhe adjunktëve në gjuhët natyrore:

1. Plotësorët realizohen me disa folje të caktuara në mënyrë më të shpeshtë se me folje të tjera, kurse adjunktët përzgjidhen nga foljet pa pasur kërkesë për varësi.
2. Klasifikimi jo i saktë i një plotësori si adjunkt ose e kundërta mund të shkaktojë një vlerësim të gabuar në ndarjen gramatikore.

<sup>217</sup> Adam Meyers, Catherine Macleod, Ralph Grishman, *Standardization of the Complement/Adjunct Distinction*, tërhequr më, 26.06.2014 nga [http://www.euralex.org/elx\\_proceedings/Euralex1996\\_1/018\\_Adam%20Meyers,%20Catherine%20Macleod%20&%20Ralph%20Grishman%20-tandardization%20of%20the%20Complement%20Adjunct%20Di.pdf](http://www.euralex.org/elx_proceedings/Euralex1996_1/018_Adam%20Meyers,%20Catherine%20Macleod%20&%20Ralph%20Grishman%20-tandardization%20of%20the%20Complement%20Adjunct%20Di.pdf)

3. Përfaqësimi i saktë i strukturës argumentore të foljes tregon si foljet përzgjedhin plotësorët e tyre, ndërsa adjunktët përzgjidhen nga koka që ata përcaktojnë.

Faktori 1 është i rëndësishëm duke u bazuar në studimin e Frazier<sup>218</sup> (1978) mbi *analizën e bashkangjites minimale*. Kjo analizë i jep përparësi klasifikimit të një përbërësi si plotësor dhe jo si adjunkt në rastin e përdorimeve që ngrenë diskutime. Frazier e ka ilustruar këtë analizë me shembullin e mëposhtëm:

(3) I thashë Mirës të vrapojë (*për në shtëpi*).

Shembulli i mësipërm është i diskutueshëm në varësi të klasifikimit të përbërësit në kllapa *për në shtëpi*. Rasti 1. Veprimi i të thënit/kumtuarit zhvillohet për në shtëpi (SP është një adjunkt i foljes *thashë*); Rasti 2. Veprimi i të vrapuarit zhvillohet për në shtëpi (SP është një adjunkt i foljes *vrapoj*); dhe rasti 3. Shtëpia është pika përfundimtare ose qëllimi i të vrapuarit (SP është një plotësor i foljes *vrapoj*). Në bazë të analizës së bashkangjites formale SP *për në shtëpi* vlerësohet si një plotësor.

Faktori 2 parashikon një vlerësim gramatikor i cili gjeneron të gjitha ndarjet e mundshme për një fjali të caktuar. Përbërësi në kllapa në fjalinë (4) është një rast i diskutueshëm

(4) Fëmija po zvarritej (*poshtë tavolinës*).

sepse mund të konsiderohet një plotësor nëse e trajtojmë pjesën në kllapa si pika përfundimtare e fëmijës, ose qëllimi të ishte *poshtë tavolinës*, dhe do të trajtohej si një adjunkt nëse *poshtë tavolinës* tregon thjesht një vendndodhje ku fëmija po zvarritet. Duke qenë se në shumicën e rasteve interpretimi i përgjithshëm<sup>219</sup> për foljen *zvarrit* do të ishte se ajo nuk kërkon të plotësohet nga një plotësor e si rrjedhim pjesa në kllapa është një adjunkt; për më tepër do të duhej një cilësim më specifik nga folja *zvarrit* që ky rast të trajtohej si një plotësor.

Duke krahasuar fjalinë (4) me pjesën në kllapa në fjalinë (5) si më poshtë do të thoshim se në fjalinë (5) nuk ka rast të diskutueshëm për praninë e një adjunkti.

(5) Fëmija hëngri biskotën (*poshtë tavolinës*).

Faktori 3 dallon marrëdhënien ndërmjet plotësorëve dhe adjunktëve. Një pasojë e kësaj marrëdhënieje është se adjunktët i imponojnë kufizime në përzgjedhje kokëve të sintagmave, ndërsa kokët nga ana tjetër i imponojnë kufizime në përzgjedhje plotësorëve.

#### **4.6.1 Identifikimi i Adjunktve**

---

<sup>218</sup> *Po aty*, referuar nga Frazier, L. (1978). *On Comprehending Sentences: Syntactic Parsing Strategies*, Ph.D. Dissertation, University of Connecticut. Indiana University Linguistics Club

<sup>219</sup> Adam Meyers etj., *Po aty*

Sipas Adam Meyers etj. një përcaktim i termit adjunkt do të ishte:

*Nëse një sintagmë foljore përbëhet nga koka F dhe një plotës SX, SX është një adjunkt nëse SX plotëson F ose SF. SX nuk është pjesë e brendshme e SF.*

***Kriteret për adjunkt të foljes***

Modifikuesit e foljes ose të sintagmës foljore SF janë adjunktët<sup>220</sup>. Ata mund të shprehen me: a) ndajfolje ose sintagmë ndajfoljore SN ose b) fjali të nënrenditur. Adjunktët mund të kategorizohen sipas kuptimit; për sa i përket përdorimit – SX në funksionin e adjunktit realizohet me pjesën më të madhe të foljeve me të njëjtin nivel përdorimi dhe kuptimi. Rastet si më poshtë janë format më të shpeshta të paraqitjes së adjunktëve në fjali<sup>221</sup>:

*Shkakore* – Adjunktët shkakorë plotësojnë fjalinë me shkakun ose arsyen për të cilën ka ndodhur veprimi ose gjendja.

Karrigia u thye **sepse ishte e vjetër**. (arsye, pra adjunkti këtu shprehet me një fjali shkakore)

*Lejore* – Adjunktët lejorë plotësojnë fjalinë me situata të kundërta.

Mira doli jashtë **megjithëse binte shi**.

*Kushtore* – Adjunktët kushtorë plotësojnë fjalinë me kushtin që duhet të plotësohet për të ndodhur veprimi ose gjendja.

Agimi do të jetonte në Londër, **po të gjente një punë**.

*Rrjedhimore* – Adjunktët rrjedhimorë plotësojnë fjalinë me efektin ose rezultatin e veprimit/ gjendjes.

Ra kaq shumë shi, **sa rrugët u mbushën**.

*Qëllimore* – Adjunktët qëllimorë plotësojnë fjalinë me qëllimin e veprimit.

Agimi punon shumë **në mënyrë që të mbajë familjen**.

*Instrumentalë* – Adjunktët instrumentalë plotësojnë fjalinë me instrumentin/ mjetin që duhet për të plotësuar veprimin.

Agimi e shkroi letrën **me laps**.

*Lokativë* – Adjunktët lokativë plotësojnë fjalinë me vendndodhjen e veprimit ose gjendjes.

Agimi u ul **mbi tavolinë**.

*Masa* – Adjunktët e masës plotësojnë fjalinë me masën, sasisë, cilësinë që zhvillohet veprimi ose që mbart gjendja.

Puna ishte **plotësisht** e përfunduar.

Kjo është **mëse** e vërtetë.

*Modale* – Adjunktët modalë plotësojnë fjalinë me nivelin që folësit gjykojnë për një veprim ose gjendje si të (pa) mundur, të (pa) nevojshëm etj.

---

<sup>220</sup> Tërhequr më 09.03.2015 nga <http://www.linguisticsgirl.com/verb-phrase-modifier-english-grammar/>

<sup>221</sup> Tërhequr më 26.06.2014 nga [http://en.wikipedia.org/wiki/Adjunct\\_%28grammar%29#cite\\_note-5](http://en.wikipedia.org/wiki/Adjunct_%28grammar%29#cite_note-5)



Ata **ndoshta** u larguan.

*Mënyrorë* – Adjunktët mënyroë plotësojnë fjalinë me mënyrës se si ndodhi veprimi apo se si është gjendja.

Djali vrapoi **me vështirësi**. (mënyrë)

Ai qëndroi **në heshtje**. (gjendje)

*Kohorë* – Adjunktët kohorë plotësojnë fjalinë me shprehje/ plotës kohorë si kur, për sa kohë, sa shpesh veprimi ose gjendja do të ndodhë.

Agimi mbërriti **dje**. (kur)

Ai qëndroi **për dy javë**. (kohëzgjatje)

#### **4.7 Rolet semantike të foljes**

Le të analizojmë strukturën argumentore të foljes *mbuloj*.

(1) Dëbora mbuloi malet.

Të dyja (SE) argumentet e foljes *mbuloj* – *dëbora* dhe *malet* krijojnë marrëdhënie kuptimore të ndryshme me foljen. Argumenti *dëbora*, i vendosur në funksionin e kryefjalës, shpreh se është **Vepruesi** i veprimit, pra i të mbuluarit. Argumenti tjetër *malet*, në funksionin e kundrinorit të drejtë, shpreh se është **Pësuesi** i veprimit. Në gramatikën gjenerative marrëdhëniet mes foljeve dhe argumenteve të tyre zbulohen me anë të roleve semantike ose roleve theta ( roles). Pra, mund të themi se folja *mbuloj* merr dy argumente dhe secilës i cakton nga një rol semantik, përkatësisht atë të vepruesit dhe pësuesit.

Në përgjithësi, struktura semantike analizohet për foljet, por jo vetëm, shumë studiues janë shprehur se emri, përemri kanë strukturë semantike. Pjesa e gramatikës gjenerative që rregullon caktimin e roleve semantike quhet teoria theta.

Pavarësisht se shumë gjuhëtarë<sup>222</sup> bien dakord me rëndësinë e strukturave kuptimore për procese të caktuara sintaksore, teoria e roleve semantike është ende disi e ngurtë. P.sh. deri tani nuk kemi të caktuar sa role semantike specifike janë dhe si do të quhen ato. Kemi role të tilla si:

**Veprues/Aktor:** ai që fillon/kryen veprimin e shprehur nga folja.

**Pësues:** personi apo sendi që pëson nga veprimi i shprehur në folje.

**Tema:** personi apo sendi që shtyhet nga veprimi i shprehur në folje.

**Përvoja:** gjendje (psikologjike) të ndryshme të shprehura nga folja.

**Përfitues:** gjendje përfituese të shprehura nga veprimi i foljes.

**Qëllim:** drejtimi drejt të cilit shkon si rezultat i veprimit të shprehur nga folja.

---

<sup>222</sup> Liliane Haegeman, *Introduction to Government and Binding Theory*, Second Edition, 1998, Blackwell Publishers Ltd, fq. 49-55

**Burim:** drejtimi nga i cili del si rezultat i veprimit të shprehur nga folja.

**Vendndodhje:** vendi ku është vendosur veprimi ose gjendja e shprehur nga folja.

Shumica e gjuhëtarëve<sup>223</sup> e kanë shkrirë rolin e pësuesit dhe temës në një të vetme – **TEMA**. Kështu nëse do të përcaktonim rolet semantike në fjalinë e mëposhtme do të dallonim:

- (2) Vajza i dha librin djalit.  
 Veprues      Tema Përfitues/Qëllim
- (3) Vajza është në shtëpi.  
 Tema            Vendndodhje

Dallimi dhe emërtimi i roleve semantike nuk është i thjeshtë, por folësi e përcakton gjatë aktit të ligjërimit nëse argumentet që vendos para apo pas foljes do të jenë veprues, temë, përvojë, qëllim etj. Në gramatikën gjenerative paraqitja e argumenteve dhe ndarja e tyre kuptimore do të bëhet me anë të një table – tabela semantike – e cila është pjesë e përfaqësimit kuptimor të vetë foljes. Kështu tabela semantike e foljes *mbuloj* do të jetë si më poshtë:

- (4) mbuloj

VEPRUES	TEMË
SE	SE

Tabela 1: Tabela semantike e foljes *mbuloj*

Tabela (1) tregon se folja *mbuloj* cakton dy role semantike (Veprues dhe Temë). Ajo nuk mund të marrë role të tjera semantike dhe as të heqë ndonjë prej tyre, përndryshe fjalitë do të ishin jogramatikore.

- (5a) *Dëbora mbuloi malet.*  
 (5b) \**Dëbora mbuloi.*  
 (5c) \**Dëbora mbuloi malet Gjirokastër.*

Pra, siç kuptohet nga (5b) folja *mbuloi* e kërkon me domosdoshmëri argumentin që ka pësuar veprimin e të mbuluarit, kurse në (5c) folja *mbuloi* nuk mund të caktojë një rol tjetër semantik veç dy roleve semantike që u ka caktuar argumenteve *dëborë* dhe *maleve*; nëse do të shtonim një parafjalë, përkatësisht parafjalën *në* para SE Gjirokastër në fjalinë (5c), atëherë do të përftonim një fjali gramatikore në të cilën, parafjala *në* do t'i

---

<sup>223</sup> *Po aty*, fq. 50

caktojë rolin semantik të Vendndodhjes fjalës *Gjirokastër*, duke formuar kështu sintagmën përemërore (SP) në *Gjirokastër*.

(6) Dëbora mbuloi malet në Gjirokastër.

Duke qenë se SP dalin në pjesën më të madhe të rasteve si adjunkte në fjali, ato mund t'i heqim apo t'u ndryshojmë rendin dhe kuptimi i fjalisë të mos ndryshojë, atëherë SP në *Gjirokastër* mund të hiqet pa ia prishur gramatikalitetin fjalisë.

Kështu materialin e mësipërm të foljes *mbuloi* mund ta përmbledhim në *Informacionin Leksikor Minimal*<sup>224</sup> ku:

- |    |                          |  |
|----|--------------------------|--|
| a. | informacioni fonologjik: | <mbuloi>   |
| b. | informacioni sintaksor:  | folje, veta e tretë, njëjës, koha e kryer e thjeshtë                   |
| c. | informacioni argumentor: | <veprues <sub>v</sub> , tema <sub>t</sub> , vendndodhje <sub>e</sub> > |
| d. | informacioni kuptimor:   | mbuloi' (v,t,l)  |

Çdo përfaqësim sintaksor i fjalive bëhet në bazë të foljeve që ndodhen në fjali. Çdo folje përfaqësohet nga struktura e vet argumentore që cakton. Argumentet realizohen në bazë të kësaj strukture, pra folja cakton role semantike dhe çdo rol i caktohet një argumenti. Pra, sipas kriterit semantik – kriterit theta:

*Çdo argumenti i caktohet një dhe vetëm një rol semantik.*

*Çdo roli semantik i caktohet një dhe vetëm një argument.*

#### **4.8 Valenca e foljes**

Nevoja që shprehin foljet për t'u plotësuar kuptimisht dhe strukturalisht me anë të fjalëve apo përbërësve që ato kërkojnë pranë vetes quhet valencë<sup>225</sup>. Ky term ka hyrë në gjuhësi nga kimia, i përdorur për herë të parë nga gjuhëtari francez Lucien Tesnier (1959) e si rrjedhim ky term është i lidhur drejtpërdrejt *me gramatikën e varësisë*. Valenca e atomit, sipas përcaktimit në kimi, qëndron në aftësinë që ka për t'u lidhur me atome të tjera apo me grupe atome për të formuar atome të përbëra. Formula kimike e ujit H<sub>2</sub>O tregon se për të formuar një molekulë ujë është e nevojshme prania e dy atomeve hidrogjen dhe e një atomi oksigjen. Po kështu për te pasur një frazë të formuar drejt, me një folje si *fotografj*, është e nevojshme që ajo të shoqërohet nga dy përbërës.

---

<sup>224</sup> Jong-Bok Kim & Peter Sells, Chapter 4: Head, Complements, and Modifiers, fq. 29 e tërhequr në dt. 07.11.2013 nga <http://web.khu.ac.kr/~jongbok/teaching/eng-syn-class/chap4-slide.pdf>

<sup>225</sup> Flora Koleci, Giuseppina Turano, Po aty, fq. 33

Herbst dhe Götz<sup>226</sup> shprehen se një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e teorisë së valencës është dhënë nga gjuhëtarët gjermanë që prej 1960. Është për t'u vlerësuar veçanërisht studimi i Gerhard Helpig dhe publikimi i një sërë fjalorëve gjermanë për valencën (Helbig dhe Schenkel 1969; Engel dhe Schumacher 1976; Valbu 2004) që kanë shërbyer si bazë për studime të mëtejshme për këtë koncept. Për më tepër këtë gjuhëtarë shprehen se studimet mbi valencën si nga ana leksikografike ashtu dhe nga ana teorike kanë ngritur diskutime mbi kriteret e dallimit ndërmjet plotësorëve dhe adjunktëve, gjithashtu mbi dallimet ndërmjet llojeve të ndryshme të plotësorëve për sa i përket nivelit të domosdoshmërisë në realizimin e tyre në fjali.

Fenomeni i valencës është trajtuar në gjuhësi nën një sërë emërtimeve duke variuar nga gramatika tradicionale me përcaktimin si reksion e deri te gramatika gjenerative që e vendos valencën në kuadrin e nënkategorizimit ose emërtimit komplementim i përdorur në gramatikën deskriptive.

Megjithatë, duke qenë se gramatika gjenerative ishte paradigma dominuese në teorisë gjuhësore veçanërisht gjatë viteve '60, sipas Rickheit dhe Sichelschmidt<sup>227</sup> gjuhësia teorike e rizbuloi nocionin e valencës rreth viteve '70. Që atëherë, kuadri i gramatikës së varësisë ka marrë hov si në gjuhësinë teorike ashtu edhe në atë të aplikuar. Një sërë botimesh teorike e empirike janë botuar në lidhje me një sërë aspektesh të gramatikës së varësisë dhe numri i tyre rritet ndjeshëm (Agel et al. 2003)<sup>228</sup>.

Kur flasim për klasifikim të foljeve sipas valencës, kemi parasysh ndarjen e klasës së foljeve në nënklasa ose në nënkategori. Nënkategoritë dallohen në bazë të karakteristikave të brendshme të pjesëve të ligjëratës. Në kuadrin e gramatikës së varësisë, aftësia e kontrollit të një sërë argumentësh në fjali është një karakteristikë e brendshme e foljes, valenca siguron mjetet për të bërë nënklasifikimin e foljeve në varësi të njësive të varura. Këto njësi të varura qofshin kundrinorë, qofshin kryefjalë janë sipas gramatikës së varësisë në thelb me vlerë të njëjtë e si rrjedhim kanë status të njëjtë.

Po pjesët e ligjëratës mund të nënkategorizohen edhe në bazë të veçorive të tyre kontekstuale, pra, sipas klasave ose nënklasave të ndryshme të fjalëve me të cilat shkojnë ose lidhen. Nocioni i valencës nuk presupozon që njësitë e varura të një foljeje të jenë domosdoshmërisht sintagma emërore. Përbërësit që janë quajtur tradicionalisht plotësorë rrethorë të kohës, vendit etj. gjithashtu mund të analizohen nga pikëpamja e valencës (Lyons 1981: 116-117)<sup>229</sup>.

---

<sup>226</sup> Thomas Herbst, Katrin Götz – Votteler, *Valency - theoretical, descriptive and cognitive issues*. Trends in Linguistics Studies and Monographs 187. (2007) Walter de Gruyter GmbH & Co, fq. 4-5

<sup>227</sup> Gert Rickheit, Lorenz Sichelschmidt, *Valency and cognition - a notion in transition*, në Thomas Herbst, Katrin Götz – Votteler, *Valency - theoretical, descriptive and cognitive issues*. Trends in Linguistics Studies and Monographs 187. (2007), fq. 165

<sup>228</sup> Po aty, referuar nga Agel, Vilmos, Ludwig M. Eichinger, Hans-Werner Erasm, Peter Hellwig, Hans-Jurgen Heringer, Henning Lobin (eds.) 2003 *Dependenz und Valenz* - në internationales Handbuch der zeitgenossischen Forschung. Berlin: de Gruyter.

<sup>229</sup> Po aty, referuar nga John Lyons, 1981, *Language and Linguistics. An Introduction*. Cambridge: Cambridge University Press.

Elementet që shënojnë valencën e një foljeje d.m.th. ata që detyrimisht duhet të përdoren bashkë me të janë quajtur nga Tesnieri *aktantë*<sup>230</sup>. Të tjerë i kanë quajtur elemente nukleare ose argumente të foljes (për analogji në gramatikën e strukturës së konstituentit). Në një frazë bashkë me argumentet mund të shfaqen edhe elemente të tjera, fakultative që quhen adjunktë, të shprehur në gramatikën e Tesnier si *circumstantials*. Argumentet dallohen nga adjunktët nga kriteret e mëposhtme<sup>231</sup>.

1) **Në bazë të kriterit semantik:** ndërsa argumentet kanë të bëjnë me thelbin e procesit të shprehur nga folja drejtpërdrejt, adjunktet tregojnë kontekstin në të cilën zhvillohet ky proces. Argumentet shënojnë marrëdhënien e një numri vendesh të shprehura nga folja, adjunktet specifikojnë një aspekt të kësaj marrëdhënieje. Në shembullin e mëposhtëm:

(1) Vajza bën detyrat në orën pesë.

fjalët *vajza* dhe *detyrat* janë argumente, ndërsa *në orën pesë* zë pozicionin e një adjunkti. Nëse heqim adjunktin, kjo frazë mbetet gramatikore. Po të heqim argumentin *detyrat*, atëherë fraza do të jetë jogramatikore.

(1.a) Vajza bën detyrat.

(1.b) \* Vajza bën në orën pesë.

Ndryshe nga adjunktet, argumentet janë fjalë të detyrueshme në fjali. Në rastin e foljeve kalimtare që përdoren si jokalimtare, si *Ndaloi makinën* dhe *Ndalova në vend*, nuk tregon se objekti i foljeve të këtij tipi është një element jo i domosdoshëm, por se ky tip foljesh pranon dy ndërtime, një me dy argumente dhe një tjetër vetëm me një argument. Në rastin e foljeve kalimtare që dalin në ndërtime pa objekt, kemi të bëjmë me elipsë (mungesë) dhe objekti mund të mungojë kur bëhet i qartë nga konteksti.

2) **Kriteri i zgjedhjes:** zgjedhja e argumenteve bëhet nga folja, kurse zgjedhja e adjunkteve jo. Pra, me një folje të caktuar argumentet duhet të karakterizohen nga tipare të caktuara të zgjedhjes dhe t'i takojnë kategorive të caktuara, ndërsa zgjedhja e adjunkteve është e lirë. P.sh. foljet *lexoj* dhe *shkruaj* i nënshtrohen parimit të zgjedhjes, sepse të dyja këto folje kërkojnë që të argumenti i brendshëm të jetë jofrymor, kurse argumenti i jashtëm të jetë frymor p.sh:

(2) Agimi lexoi letrën para një ore.

\* Agimi lexoi shokun

(3) Vajza shkruan detyrën.

\* Vajza shkruan shokun.

---

<sup>230</sup> Lucien Tesnieri, *Elements de syntaxe structural*, 1959, Paris, Klincksieck

<sup>231</sup> Thoma Dhima, *Gjuha Shqipe - Sintaksa*, 2010, Gjirokastrë, fq. 18

Të dy argumentet e brendshëm janë vendosur në rasën kallëzore dhe janë të domosdoshëm për kuptimin e fjalisë, kurse adjunktet, pra elementet shtesë, nuk kanë nevojë për karakteristika të zgjedhjes dhe nuk u përkasin detyrimisht kategorive të caktuara.

3) **Kriteri i rendit:** argumentet dallohen nga adjunktet edhe nga rendi i tyre, i cili është më i ngulitur për argumentet dhe shumë më i lirë për adjunktet. Fjalitë e mëposhtme do të ishin jogramatike nëse do t'i përdornim në këtë mënyrë:

(4.a) \* Letra lexoi Gonin.

(4.b) \* Floku kreh vajzën.

Kurse adjunktet do të mund të përdreshin me lehtësi në fillim, në mes apo në fund të fjalisë.

(5) Para një ore Goni lexoi letrën.

(6) Goni lexoi para një ore letrën.

Në bazë të valencave të tyre, d.m.th. sipas numrit të argumenteve të ndryshme që shoqërojnë një folje, dallohen katër klasa foljesh: zerovalente, njëvalente, dyvalente dhe trevalente. Sipas foljeve të ndryshme, si argumente dalin grupe emërore, grupe parafjalore dhe fraza.

**Foljet zerovalente** nuk shoqërohen me asnjë argument. Të tilla janë foljet që emërtojnë një dukuri atmosferike, si: *vetëtin, bubullin, veson, bën ftohtë* etj. Po kur këto folje marrin një emër si kryefjalë, atëherë dalin si njëvalente: *fryn (veriu), gjëmon (toka), verdhon (fusha)*.

**Foljet njëvalente** shoqërohen vetëm me një argument që mund të jetë një emër ose një grup emëror. Në këtë rast do të përmendim veçanërisht foljet jokalimtare që tregojnë lëvizje, si p.sh. *eci, hyj, shkoj, vdes, fle, ndodh, ngjan, rastis* etj. Në disa përdorime, si: *Vajza ngjan të jetë e lumtur*, duket sikur foljet e këtij tipi dalin dyvalente. Po këtu kemi daljen para të kryefjalës së fjalisë së nënrenditur për arsye kumtuese, prandaj në realitet, foljet e këtij tipi janë njëvalente.

**Foljet dyvalente** janë foljet kalimtare që shoqërohen me dy argumente të brendshëm e të jashtëm të cilat mund të jenë emra, përemra ose grupe emërore, po edhe fjali të nënrenditura ose kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë si në rastin e foljeve *shoh, dua, hap, besoj* etj.

**Foljet trivalente** shoqërohen me tri argumente dhe ilustrohen me foljet *them, jap, dhuroj*. Argumentet e këtyre foljeve shprehen me emra, përemra ose pjesë të nënrenditura.

Duket sikur klasat e foljeve zerovalente, njëvalente, dyvalente e trivalente ngjajnë me foljet që gramatika jonë i quan pavetore, jokalimtare dhe kalimtare. Po kjo ngjashmëri është vetëm e pjesshme. Së pari, sepse kriteret e klasifikimit janë krejt të ndryshme dhe së dyti, klasifikimi tradicional i foljeve nuk përputhet me klasifikimin sipas valencës.

Thoma Dhima<sup>232</sup> shprehet se në gramatikën tradicionale nuk ekziston një klasë që t'i korrespondojë foljeve trivalente, të cilat përgjithësisht lidhen me kalimtarët. Për të bërë një përjasje midis klasifikimit tradicional dhe klasifikimit sipas valencës do të merret për bazë klasifikimi që është bërë në *Gramatikën e gjuhës shqipe I* (Tiranë 1995), si klasifikimi më i përgjithshëm sipas transivititetit. Këtu merret në konsideratë raporti i foljes me kundrinorët që mund të marrë ose raporti i saj si fjalë sunduese me fjalën e sunduar (me kundrinorin), pra nënkategorizimi i saj, dhe nuk bëhet fjalë për raportet e saj me kryefjalën si njëri nga argumentet.

Nga ana tjetër Rickheit dhe Sichelschmidt<sup>233</sup> shprehen se nocioni i valencës ka disa pika të dobta: ky nocion është i kufizuar me aspektet strukturore duke qenë se tenton më shumë të sigurojë një përshkrim të kuptimit të fjalëve dhe fjalive – duke mos patur parasysh faktin se kuptimi i çdo fjalie (të paktën i një pjese të saj) i detyrohet përdorimit në një situatë të caktuar. Nocioni i valencës është i kufizuar duke qenë se analizat e varësisë operojnë sipas një modeli post-hoc dhe shumë rrallë i thyejnë kufijtë e fjalisë – gjë e cila e zbeh faktin që ligjërimi prodhohet dhe transmetohet në një kontekst të caktuar. Për më tepër ata shtojnë se analizat e valencës janë ngritur në intuitën e gjuhëtarëve dhe jo në analiza të provuara mbi funksionalitetin e valencës në vetë përdorimin e gjuhës.

#### **4.9 Realizimi i rasës së SE në rolin e kryefjalës**

Në gjuhën shqipe SE në pozicionin e kryefjalës mund të realizohet fonetikiisht ose mund të mos realizohet fonetikiisht. Realizimi fonetik i SE në pozicionin e kryefjalës kushtëzohet nga aftësia e fleksionit për t'i caktuar rasë.

- (1) a. Unë punova tokën.  
b. Io ho lavoro la terra.  
c. .

Gjuhët flektive si shqipja, italishtja, greqishtja etj. mund të mos e kenë të shprehur fonologjikisht kryefjalën, por ajo është e nënkuptueshme dhe mund të futet lehtë në fjali.

- (2) a. Pro Punova tokën.  
b. Pro Ho lavoro la terra.  
c. Pro .

---

<sup>232</sup> Thoma Dhima “Mbi klasifikimin e foljeve sipas valencës”, Artikull mbajtur në Seminarin XXI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë 19.08 – 01. 09. 2002

<sup>233</sup> Gert Rickheit, Lorenz Sichelschmidt, *Valency and cognition - a notion in transition*, në Thomas Herbst, Katrin Götz – Votteler, *Valency - theoretical, descriptive and cognitive issues*. Trends in Linguistics Studies and Monographs 187. (2007), fq. 170

Në fjalitë (2.a.b.c) kemi të bëjmë me kryefjalë zero. Simbolikisht kjo kryefjalë e pashprehur shënohet me *pro* (nga ang. pronoun). Ajo është e perealizuar fonetikisht, d.m.th. e pashprehur në pozicionin e vet sintaksor në strukturën sipërfaqësore, por e nënkuptuar, dhe që mund të futet lehtë në fjali, në këto struktura, mendohet që “ka rënë”, pa e cënuar kuptimin e fjalisë. Kryefjala e perealizuar fonetikisht, në këto raste, quhet *kryefjalë zero (null subject)*, kurse mosrealizimi fonetik i saj mund të emërtohet si *dukuria e rënies së kryefjalës*.

Në literaturën gjuhësore bashkëkohore<sup>234</sup> kjo dukuri njihet me termin *pro-drop*. Termi *pro* përfaqëson një kategori emërore fonetikisht zero, kurse *drop* do të thotë *rënie*. Simboli *pro* në këto fjali përfaqëson një SE që fonetikisht është e pashprehur, por e nënkuptueshme, me vlerë sintaksore të kryefjalës. Kjo SE është argument i foljes dhe krijon lidhje përshtatjeje me eptimin. Pra, mungesën e gjymtyrës kryefjalë, përbërësi EPT (eptim) i saj e kompeson me përshtatjen në vetë, që në gramatikën gjenerative njihet si tipari [ $\pm$  AGR] (përshtatje). Kryefjalë zero kanë gjuhët me tiparin [+ AGR] dhe për këto përdoret elementi *pro* në pozicionin e kryefjalës zero. Ndërsa në gjuhë të tjera, si p.sh anglishtja e frëngjishtja, janë gjuhë me tiparin [- AGR], prandaj në këto gjuhë kryefjala e fjalive të pavarura është e domosdoshme të shprehet<sup>235</sup>.

Dukuria *pro-drop* meriton vëmendje në gjuhën shqipe, sepse tregon që edhe në këtë gjuhë, një SE në pozicionin [+ Rasë] mund të realizohet ose të mos realizohet fonetikisht. Ndonëse shkaqet stilistike ndikojnë në shprehjen ose mosshprehjen e SE kryefjalë, në gjuhën shqipe, realizimi ose mosrealizimi fonetik i SE kryefjalë, shpjegohet, së pari me shkaqe strukturore. Realizimi ose mosrealizimi fonetik i SE ose përndarja plotësuese, kjo e fundit nuk mund të anashkalohet. Realizimi i kategorisë *pro* dhe rënia e saj kushtëzohen strukturalisht nga lloji i caktuesit rasor<sup>236</sup>.

Gjuhëtarja Ludmila Buxheli, në studimin “*Modelet e Caktimit Rasor në Gjuhën Shqipe*” (2007) shprehet se në gjuhën shqipe dukuria *pro-drop* është e mundshme në qoftë se një SE si kryefjalë është në rasën emërore, d.m.th. nëse në strukturën bazë ajo ndodhet në pozicionin e specifikuesit të sintagmës emërore, me EPT të karakterizuar si [+Pr, +K]. Në ndërtimet me kryefjalë një SE në rasë kallëzore përjashtimore (exceptional case), dukuria *pro-drop* nuk është e mundshme. SE në rolin e kryefjalës në rasën kallëzore përjashtimore nuk mund të bjerë. Caktuesi i saj rasor, d.m.th. folja, nuk e mundëson rënien. Përndryshe fjalia do të ishte jogramatikore.

- (3) a. Unë *shoh* [*Petritin* të vrapojë].  
b. Unë *e shoh* [*Petritin* të vrapojë].  
c. Unë *e shoh* [ $\emptyset$  të vrapojë].

<sup>234</sup> Ludmila Buxheli, *Modelet e Caktimit Rasor në Gjuhën e Sotme Shqipe*, Botimet Neraida, 2007, fq. 98-99, referuar nga H. Borer, Empty subjects and constraints on thematic relations, në “*Cahiers linguistique d’Ottawa*”, vol.9, 1980; O. Jaegli dhe K. J. Safir, 1989, *The null subject parameter*, (përmbledhje studimesh), 1989; L.Rizzi, Null objects in Italian and theory of pro, në “*Linguistic inquiry*”, 17, fq. 526.

<sup>235</sup> Giorgio Graffi, *Sintassi*, (1994), il Mulino, fq. 212

<sup>236</sup> Ludmila Buxheli, *Po aty*, fq. 98-99



d. \* *Unë shoh [ø të vrapojë].*

Në shembujt (3 a,b) fjalitë e varura e kanë të shprehur kryefjalën me një emër në rasën kallëzore, SE *Petritin*. Në (3 b) SE *Petritin* rimerret nga trajta e shkurtër *e* në rasën kallëzore. Në (3 c) SE *Petritin* nuk realizohet fonetikisht, pra kemi një kategori të zbrazët, por fjalia është gramatikore, sepse rolin e kryefjalës përjashtimore e kryen përemri i trajtës së shkurtër *e*. Në (3 d) fjalia është jogramatikore, sepse kryefjala nuk shprehet as me SE *Petritin*, as me trajtën e shkurtër. Mungesa e trajtës së plotë dhe të shkurtër e bën fjalinë (3 d) jogramatikore, gjë që provon se dukuria pro-drop është e pamundshme në struktura me SE me rasë kallëzore përjashtimore.

Kjo provon përsëri rolin e eptimit me përbërësit e tij për caktimin e rasës emërore. Dukuria pro-drop është e mundshme vetëm për SE kryefjalë në rasën emërore, pra vetëm nëse SE ndodhet në pozicionin e specifikuesit të një SEPT, me EPT [+Pr, +K]. Nëse një SE në rolin e kryefjalës është në rasën kallëzore përjashtimore, pra nëse realizohet brenda pozicionit [SPEC, SEPT] me EPT [+Pr, – K], dukuria pro-drop nuk është e mundshme.

Mosrealizimi fonetik i SE në rolin e kryefjalës nuk përfaqësohet gjithmonë me një element *pro*. Ka raste në gjuhën shqipe që SE është e kuptueshme, por nuk mund të realizohet fonetikisht. Arsyeja është se SE në këto raste nuk mund të marrë rasë. Rasa e bën të mundshme realizimin fonetik të SE. Në materialin gjuhësor të shqipes gjejmë raste të mosshprehjes së kryefjalës, veçanërisht në fjalitë me forma të pashtjelluara ose lidhore, të cilat nuk japin të dhëna për kryefjalën. Gramatika gjenerative përdor elementin **PRO** (me të mëdha) që përfaqëson një kryefjalë të pashprehur.

- (4) *Djali shkoi [PRO të takojë prindërit].*
- (5) *Ata u ulën [PRO për të parë filmin].*
- (6) *She wanted [PRO to speak in English].*
- (7) *Lei voleva [PRO parlare in Italiano].*

Ky element zë vendin e kryefjalës në këto ndërtime, pra duhet të marrë një sintagmë emërore me tiparet [+anaforik, +përemëror]. Ndryshe nga kategoria *pro*, **PRO** është e papërcaktuar ose e pashënuar nga eptimi i foljes. Duke parë fjalitë e mësipërme, vërehet se EPT i fjalisë së varur ka tiparin [+Pr], por folja përshtatet me kryefjalën e fjalisë drejtuese, d.m.th. kallëzuesi i fjalisë së varur është një folje në të njëjtin numër dhe vetë, si dhe folja e kallëzuesit të fjalisë kryesore.

Buxheli<sup>237</sup>, në lidhje me realizimin apo mosrealizimin e kryefjalës në fjalitë e mësipërme të gjuhës shqipe, shprehet se edhe pozicioni i kryefjalës së porealizuar fonetikisht karakterizohet nga një rol semantik referencial ose anaforik, sepse kontrollohet nga roli semantik i kryefjalës së fjalisë drejtuese. Ndonëse kryefjala në fjalitë në kllapa mungon, ajo është e nënkuptueshme dhe e motivueshme kuptimisht nga kryefjala e fjalisë drejtuese.

---

<sup>237</sup> Ludmila Buxheli, *Po aty*, fq. 102-110

Nga ana tjetër, pamundësia e përdorimit të një SE të realizuar fonetikisht në rolin e kryefjalës në rasën emërore, për fjalinë e varur, tregon që EPT i kësaj fjalie është [–Kohë], pasi në këtë fjali koha e foljes në lidhore është anaforike dhe nuk mund të ndryshohet. Koha e foljes së fjalisë drejtuese detyrimisht duhet të rimerret ose të përsëritet te folja e fjalisë së varur, që kjo e fundit të jetë gramatikisht korrekte. Kjo do të thotë që pozicioni i zbrazët ose zero përmban gjithashtu tiparin [–Rasë]. Pra, kemi të bëjmë me dy SE me marrëdhënie referenciale, nga të cilat, SE e fjalisë drejtuese është e realizuar fonetikisht, kurse ajo e fjalisë së varur është e përealizuar fonetikisht, ndonëse ka një rol semantik të caktuar. Secila prej këtyre SE e merr rasën dhe rolin semantik në fjalinë përkatëse.

Në fjali të tipit “*Unë di të lexoj*” vendi i SE në rolin e kryefjalës së fjalisë së varur, me folje në lidhore, përfaqëson një “*kategori të zbrazët*” (KZ), me tipare [+rol semantik anaforik, –rasë], sepse kjo SE e nënkuptuar, në rolin e kryefjalës, nuk mund të marrë rasë as nga eptimi i fjalisë së varur, i cili është [+Pr, –K], as nga folja e fjalisë drejtuese. PRO është pikërisht kjo KZ që ndonëse ndodhet në pozicion ku mund të drejtohet, sepse eptimi është i shtjelluar, përsëri kjo KZ nuk drejtohet. Arsyeja është se asaj nuk mund t’i caktohet rasë as nga kategori funksionale, përkatësisht eptimi, as nga ndonjë kategori leksikore në fjalië drejtuese.

Për pasojë, PRO është një kategori e lidhur, jo e pavarur, sepse është kuptimisht referenciale dhe dominohet nga SE paraprijëse në fjalinë drejtuese. Kategoria PRO karakterizohet, kështu, nga tipari i lidhjes ose tipari [+anaforë]. Kjo kategori është e ngjashme, pjesërisht, me përemrin vetvetor, i cili në terminologjinë gjuhësore njihet me emrin anaforë.

## KREU V

### SINTAGMA FOLJORE ME FOLJE JOKALIMTARE

Sipas Gramatikës së Akademisë<sup>238</sup> (2002) folje jokalmtare quhen foljet të cilat emërtojnë veprime që mbeten tek ai që i kryen dhe personi a sendi mbi të cilin bien në fjali shprehet me anë të një emri, përemri, ose çdo fjale tjetër të emëruar në rasën emërore pa parafjalë.

Në gramatikën gjenerative studime të thelluara mbi foljet jokalmtare janë kryer nga Perlmutter<sup>239</sup> (1978) (të cilit do t'i referohemi gjerësisht në këtë kapitull), i cili vë në dukje se foljet jokalmtare mund të ndahen në dy kategori, përkatësisht *joergative* dhe *joakuzative*. Ai shprehet se foljet e secilës klasë kanë sjellje të ndryshme sintaksore. Perlmutter e përpunoi dhe e përmbodhi analizën e tij në Hipotezën Joakuzative (*Unaccusative Hypothesis, UH*), të cilën e zhvilloi në kuadrin e Gramatikës Relacionale (*Relational Grammar*).

Foljet joergative dhe joakuzative shoqërohen me konfigurime të ndryshme sintaksore. Ndryshimi sintaksor ndërmjet foljeve joergative dhe joakuzative mendohet se qëndron në ndryshimin e tyre semantik<sup>240</sup>: foljet joergative zakonisht përshkruajnë veprime të qëllimshme apo të vullnetshme dhe roli semantik i kryefjalëve të këtyre foljeve është ai i një vepruesi ose përjetuesi ndërsa foljet joakuzative përshkruajnë ndryshimin e gjendjes apo vendndodhjen dhe roli semantik i kryefjalës së tyre është ai i një pësuesi.

Tabela<sup>241</sup> si më poshtë tregon ndarjen e foljeve jokalmtare:

---

<sup>238</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Vëllimi I – Morfologjia, Tiranë 2002, fq. 266

<sup>239</sup> David M. Perlmutter, *Impersonal passives and the unaccusative hypothesis*. BLS. 1978.

<sup>240</sup> Noriko Ue, *On Unergative and Unaccusative Verbs in English* tërhequr në 30.12.2013 nga [http://repo.lib.ryukoku.ac.jp/jspui/bitstream/10519/896/1/r-rn\\_473\\_009.pdf](http://repo.lib.ryukoku.ac.jp/jspui/bitstream/10519/896/1/r-rn_473_009.pdf) referuar nga Gruber, Jeffrey S. (1976) *Lexical Structure in Syntax and Semantics*. Amsterdam: North-Holland, Jackendoff, Ray (1990) *Semantic Structures*. Cambridge, Mass.: MIT Press.

<sup>241</sup> [http://en.wikipedia.org/wiki/Causative\\_alternation](http://en.wikipedia.org/wiki/Causative_alternation) tërhequr më 29.09.2014





Tabela 1: Ndarja e foljeve jokalimtare

Për sa i përket strukturës së brendshme të foljes jokalimtare<sup>242</sup> (p.sh. rasti i foljes *ha*) dhe realizimit të saj në pemën X-bar do të përftonim konfigurimet e mëposhtme:



Pemët 2: Projeksione në pemë strukturore të foljes *ha*

Pemët e mësipërme ndryshojnë nga njëra tjetra nga prania e projeksionit të ndërmjetëm të paraqitur në pemën *a*. Me një vështrim të parë pema e dytë mund të duket më e përshtatshme duke qenë se është më e thjeshtë (për faktin se ka më pak node). Megjithatë, pema *a* është më e saktë duke qenë se përmbush më mirë rregullat e përcaktimet e përmendura në lidhje me skemën X-bar. P.sh. pema *a* lejon të zbatojmë testin e zëvendësimit duke përdorur *po ashtu*:

<sup>242</sup> *Intransitive elementary trees*, tërhequr në 01.07.2014 nga <http://www.ling.upenn.edu/~beatrice/syntax-textbook/ch4.html>

(1) Djali ha, po ashtu dhe unë.

**Po ashtu** zëvendëson projektimin e ndërmjetëm F'.

Gjithashtu një arsye tjetër për paraqitjen e nivelit të ndërmjetëm F' është rregulli i specifikuesve si më poshtë:

*Specifikuesit janë motra të projekteve të ndërmjetme F'.*

Foljet jokalmtare sillen ndryshe në bazë të vendosjes së tyre në alternime të ndryshme në diateza të cilat do t'i shohim si më poshtë.

### **5.1 Foljet joergative përkundrejt foljeve joakuzative**

Siç e përmendëm edhe më lart që qasjen e bërë në Gramatikën Relacionale nga Perlmutter<sup>243</sup> (1978) dhe Perlmutter e Postal<sup>244</sup> (1984) foljet joergative dhe joakuzative shoqërohen me konfigurime të ndryshme sintaksore. Ky ndryshim sintaksor motivohet nga kuptimi i foljeve jokalmtare. Sipas Perlmutter, foljet joergative përfshijnë folje që përshkruajnë veprime të qëllimshme, të dëshiruara ose të vullnetshme si: *luaj, punoj, qesh, kërcej etj.* dhe folje që përshkruajnë procese trupore të pavullnetshme si *teshtij, lemzoj, mërdhij, mërdhit, mizëron, ofshaj, ofshëtij, psherëtij etj.* Klasa e foljeve joergative i korrespondon ngushtësisht nocionit të veprimit dhe rolet semantike të kryefjalës së këtyre foljeve janë ato të vepruesit ose përjetuesit.

Ndryshe nga sa më sipër, klasa e foljeve joakuzative është shumë më e madhe. Ajo përfshin folje ku argumenti i vetëm i të cilave është një pësues, të tilla si: *triumfoj, shkulloj, shkas, spekuloj, kapitulloj, këmbëzon, kllapurit (kllapuris), kontraston, krikëllon, etj;* folje që shprehin të qenit ose të ekzistuarit si: *ekzistoj, ndodh, jam ndodh, ngjaj, ngjan, ngjas, ngjasoj, ngjet, përngjaj, përngjas;* folje që kanë të bëjnë me ndjesi të pavullnetshme të lidhura me dritën, zhurmën, nuhatjen si: *gacon, gërvin, gërgërit, gërgëlloj, gurgullon, gjëmoj, jehon, keqtingëllon, xixon, vezullon, ushton, trakulloj etj;* folje që tregojnë kohëzgjatje si: *filloj, vijoj, përfundoj, zgjat, qëndrojmë etj.*

Foljet joakuzative përgjithësisht përshkruajnë veprime të pavullnetshme ose ndryshim të gjendjes/vendndodhjes në të cilat kryefjala mbart rolin semantik të pësuesit/temës<sup>245</sup> (duke referuar studimin e Gruber 1976 dhe Jackendoff 1990). Në këtë

---

<sup>243</sup> David M. Perlmutter, *Po aty*

<sup>244</sup> David M. Perlmutter, Paul M. Postal. *The I-advancement exclusiveness law*. Në David M. Perlmutter dhe Carol Rosen (eds.), *Studies in relational grammar 2*, Chicago: University of Chicago Press, 1984, fq. 81–125.

<sup>245</sup> Noriko Ue, *On Unergative and Unaccusative Verbs in English* tërhequr në 30.12.2013 nga [http://repo.lib.ryukoku.ac.jp/jspui/bitstream/10519/896/1/r-rn\\_473\\_009.pdf](http://repo.lib.ryukoku.ac.jp/jspui/bitstream/10519/896/1/r-rn_473_009.pdf) referuar nga Gruber, Jeffrey S.

mënyrë, përcillet mendimi se joergativiteti vs. joakuzativiteti mund të parashikohet dhe përcaktohet në bazë të rolit semantik të kryefjalës së foljes.

Bazuar në analizën e sipërpërmendur, Perlmutter (1978: 162-163) dhe Perlmutter e Postal (1984)<sup>246</sup> shprehen se koherenca semantike ekziston në të dyja klasat. Duke vendosur materialin e vjelë për foljet jokalimtare të gjuhës shqipe në këtë kontekst kemi paraqitur listën e mëposhtme me disa nga grupimet e përgjithshme që i dallojnë këto klasa e duke i paraqitur këto folje në alternimet që realizojnë gjatë vendosjes në diateza. Kemi përdorur termin diatezë duke qenë se në gramatologjinë shqiptare koncepti i kategorisë së diatezës është i ngjashëm me konceptin e nënkategorizimit në gramatikën gjenerative.

Për analogji me nënkategorizimin, diateza sipas përcaktimit të dhënë në Gramatikën e Akademisë<sup>247</sup>, është ajo kategori gramatikore nëpërmjet të cilës shprehet lidhja midis veprimit të emërtuar nga folja dhe kryefjalës së fjalisë, lidhje e cila shprehet morfologjikisht me formën veprare dhe atë joverprare. Kategorinë e diatezës e kanë ato folje të cilat mund të përdoren si në formën veprare ashtu edhe në formën joverprare me kundërvëniet kuptimore përkatëse<sup>248</sup>. Por e marrë në një kuptim më të gjerë kjo kategori i përfshin të gjitha foljet – duke përfshirë edhe foljet që përdoren vetëm në formën veprare, siç janë foljet jokalimtare, edhe folje të cilat përdoren vetëm në formën joverprare, siç janë foljet *kollem, dukem, pendohem* etj.

## **5.2 Karakteristikat e foljeve joergative**

**Foljet që shprehin vullnet, veprime të vullnetshme ose të dëshiruara si:** *banoj, buzëqesh, dafnjej, dasmoj, debutoj, deroj, dertoj, desantoj, dyluftoj, dyshoj, dhëndëroj, erëzon, farfurin, farfurit, femëron, fërfëllij, fërfërin, fërfërit, fiqiroj, fishkëllej, fjalëtoj, fjaloj, fjalos, flakërij, flakërit, flakëroj, flakoj, flirtoj, folezon, fugoj, futësoj, gumçoj, guxoj, gëlon, gjethis, haharis, hesht, hyj, këmbëngul, klikoj, kooperoj, kukuris, kundërveproj, kurvëroj, ligjëroj, mëkatoj, mëngjesoj, ndërdyj, ndërhyj, ndërmjetësoj, ndërsy, ndërvëproj, negocij, ngarrit (ngarris), ngulmoj, ngurroj, pasojm, përmënoj, pikëtoj, prostituoj, protestoj, puf, reagoj, rivalizoj, rrëshen, rri, rrogoj, sftyryj, silloj, sjellu, spekuloj, squk, shakatoj, shëmoj, shërbej, shfrej, shkrofëtij, shllapurit (shllapuris), shpërbej, shpërbetoj, shter, shtërzoj, shtozoj, shuj, tallazon, tenderoj, tinëzj, trakullij, trokas (si jokalimtare), trokëllit (trokëllis), turfulloj, thimthon, thuqëroj, ushton, uturin,*

---

(1976) Lexical Structure in Syntax and Semantics. Amsterdam: North-Holland, Jackendoff, Ray (1990) Semantic Structures. Cambridge, Mass.: MIT Press.

<sup>246</sup> Naoko Takahashi, *On Unaccusativity* tërhequr në 01.07.2014 nga

[https://www.google.com/search?sourceid=navclient&ie=UTF8&rlz=1T4ASUM\\_enAL579AL584&q=On+Unaccusativity+Naoko+TAKAHASHI](https://www.google.com/search?sourceid=navclient&ie=UTF8&rlz=1T4ASUM_enAL579AL584&q=On+Unaccusativity+Naoko+TAKAHASHI)

<sup>247</sup> *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1976

<sup>248</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, fq. 270

*vapoj, ven, vegjetoj, veproj, veshtoj, vetëvendos, vetëveproj, vërshëllez, vickëlon, vigjiloj, vjeshtoj, votoj, yej, zelloj, zëmëroj, zgërqesh, zuzëroj (zuzaroj).*

Foljet e kësaj klase konsiderohen si folje tipike joergative sepse argument i tyre i vetëm është një veprues, ato mund të përdoren me plotësorë kohorë, vendi dhe mënyre apo kundrina të zhdrejta me parafjalë dhe paraqesin modele tipike joergative.

Duke u mbështetur në artikullin e Ethem Likaj<sup>249</sup> *Disa çështje të kategorisë gramatikore të diatezës në gjuhën shqipe* është marrë parasysh që alternimet në diatezë të mos ngatërrohen me kalimtarinë (tranzitivitetin) dhe jokalmimtarinë (intransitivitetin). Sipas Likajt kategoria gramatikore e diatezës tregon një gjendje të kryefjalës, që shprehet nga folja në një formë a ndërtim sintaksor të caktuar. Ai shprehet se edhe foljet jokalmimtare mund të konsiderohen se përbëjnë një diatezë më vete, krahas diatezës veprare, pësore, mesore e reciproke.

Një pikëpamje e tillë në analizën e foljeve jokalmimtare duket më e gjerë e gjithëpërfshirëse, ndryshe nga pikëpamja e shprehur në Gramatikën e Akademisë ku specifikohet se *kategorinë gramatikore të diatezës (sipas kuptimit të ngushtë të termit) e kanë vetëm ato folje kalimtare që përdoren në kundërvëniet formale veprare – joveprare me kundërvëniet kuptimore përkatëse*. Kështu foljet *veproj, dyshoj, rri* në formën veprare në diatezën jokalmimtare do ta gjejmë si më poshtë në (1):

- (1) Forma veprare (Diateza jokalmimtare)<sup>250</sup>  
***Veproj*** sipas ligjit.  
***S'dyshon*** aspak.  
***Rri*** në këmbë.

Këto folje jokalmimtare mund të përdoren edhe në formën joveprare<sup>251</sup> zakonisht duke u realizuar në vetën e tretë, numri njëjës, përkatësisht si folje pavetore (në disa raste, por folja *votoj* mund të realizohet në joveprare *votohem*). Në pjesën më të madhe të rasteve do t'i gjejmë të shoqëruara me një trajtë të shkurtër të përemrit vetor në rasën dhanore, që shërben për të përcaktuar personin të cilit i referohet veprimi i emërtuar në mënyrë të pacaktuar. Këto folje pavetore shprehin sipas rrethanave, ngjyrimet modale të mundësisë ose të dëshirës a të një “disponimi të brendshëm” të vetës së përfaqësuar nga trajta e shkurtër e përemrit vetor.

- (2) Forma joveprare (folje pavetore)  
Nuk ***veprohet*** kështu.  
Për këtë s' mund të ***dyshohet***.

---

<sup>249</sup> Ethem Likaj, *Disa çështje të kategorisë gramatikore të diatezës në gjuhën shqipe*, Studime Filologjike Nr. 4, Tiranë, 1970

<sup>250</sup> Për shembujt e kreut V si më poshtë, janë vjelë ilustrimet në hyrjet e foljeve përkatëse nga *Fjalori i Gjuhës Shqipe* (2006) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë

<sup>251</sup> *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Vëllimi I – Morfologjia, Tiranë, 2002, fq. 268-270

S'i **rrihet** pa folur.

**Foljet e vrapimit** (Foljet e mënyrës së lëvizjes) të cilat janë: *dal, depërtoj, eci, fluturoj, iki, imigroj, kuturis, lëvrij, livadhis, lundroj, luzmon, marshoj, mbikalaj, migroj, ngas, ngjëroj, notoj, pararend, përparoj, përspjet, pupëztoj, qarkulloj, rend, rravgoj, rropat (rropas), rrugëtoj, shqepoj, shtegoj, tërthoraj, trapit (trapis), trokon, udhako, udhëtoj, vete, vij, vërshoj, vrapoj, vrulloj, vrundulloj, zabërhanis, zbres (si jokalimtare)*. Këto folje shprehin lëvizje dinamike, të tilla që nuk tregojnë pikën e përfundimit të veprimit. Ato janë tipike joergative.

- (3) **Vërshoi** Shkumbini.  
**Eci** nëpër dhomë.  
**Fluturuan** drejt Hënës.

Këta shembuj tregojnë gjithashtu për llojin e sintagmës që plotëson kokën e SF. P. sh. sintagmat parafjalore SP *nëpër dhomë, drejt hënës* tregojnë vendin ku kryhet ose do të kryhet veprimi. Por plotësori mund të jetë edhe një fjali e varur rrethore:

- (4) Vërshoi **atje ku errozioni kishte shkatuar dëme**.

**Folje që tregojnë mënyrën e të folurit:** *bërtas, gërgëlloj, gërthas, hungëroj, klith, kukuris, kumbon, llapëroj, lllomotit (llomotis), mërmërit (mërmëris) murmërij, murmurit (murmuris), murmuroj, nëpërdhëmb, ngurmazoj, pall, pëllas, pipëtij, piskat (piskas), sokëllij, sokëllit, shfrej, shushurin, shushurit, shushuroj, turtullit (turtullis), thuqëroj, ulërij, xërlis, xhaunis*.

- (5) **Murmuriti** ca fjalë.  
**Bërtiste** nga dhimbjet.  
**Ushtojnë** topat.

**Folje që përshkruajnë tinguj të bërë nga kafshët:** *blegërij, blegëroj, cicëroj, gargarit (gargaris), gërthet, guguron, gugat (gugas), guit (guis), gumëzhin, gumëzhit, hingëllij, hungëroj, kerrmëzon, kerrnjon, kërret, kijat, kikiris, krakëllin, krakëllit, kuak, karkat, kakaris, kuaçit, kuit (kuis), kukat (kukas), laris, leh, mekërin, mjaullin, mjaullit, muet, pëllas, pingëron, rikat, turrnak, tuturit, vakërron, vrumbullit, zëzëlloj, zukat (zukas), zhuit*. Pjesa më e madhe e foljeve që përshkruajnë tinguj të bëra nga kafshët realizohen në vetën e III. Këto folje shprehin gjithmonë një veprim real fizik të kryefjalës (pra kafshëve) e si rrjedhim kryefjala është gjithmonë me tiparin + frymor.

---

\* *fluturoj*, përveç kuptimit nr. 4 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, “flak, hedh” si folje kalimtare, fq. 284

\* *qarkulloj*, përveç kuptimit 5 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 868

\* *kukas*, përveç kuptimit 2 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 503



- (6) Qeni që *leh*, nuk të ha.  
*Gagarisin* patat.  
*Vrumbullit* tigri.

**Foljet që shprehin procese fiziologjike e trupore jo të vullnetshme:** *dalldis, dergj, djersit, dremit, dushkoj, dhemb, endim, etshoj, fërgëlloj, fshaj, fend, gërhas, gërhij, gogësisj, gogësit, gromësisj, gromësit, guhat (guhas), gulçoj, kakëdhin, lemzoj, mërdhij, mërdhit, mizëron, ofshaj, ofshëtij, psherëtij, pulson, qaj, rigon, shëmoj, shkep, shkepoj, shqepoj, shtatoj, teshtij, tërfat, zumron.*

Këto folje tregojnë procese të pavullnetshme trupore të cilat nuk janë nën kontrollin e vepruesit që i kryen/shpreh.

- (7) *Teshtij* fort.  
Ai s'para *djersit*.  
*Lemzon* shumë.  
*Psherëtin* nga malli.

Këto folje plotësohen me sintagma parafjalore SP, sintagma ndajfoljore SN, por edhe me fjali të varura rrethore në varësi të kontekstit dhe kuptimit leksikor të kokës F:

- (8) Zumron *kur fluturon*.

### **5.3 Karakteristikat e foljeve joakuzative**

**Klasa tjetër e foljeve jokalmimtare është ajo e foljeve joakuzative si më poshtë:**

**Folje, argumenti i të cilave është semantikisht një pësues:** *bie, falimentoj, fllluskoj, fqinjësoj, funksionoj, gacullon, galdoj, gemon, gëlon, graçoj, grafulloj, gufoj, gulfoj, gurron, gjyfqej, hamullon, hirron, humboj, humbulloj, intereson, jermoj, jeshilon, kapitulloj, këmbëzon, kllapurit (kllapuris), kontraston, krikëllon, kurthon, lektis, leverdis, lëngoji, mbes, mizon, mjaftoj, mugullon, mundi, mungoj, ndikoj, ndjeshmëroj, ngallon, ngec, ngel, ngurroj, ondis, përheqi, përkoj, përtoj, pipton, pluskoj, puf, qaroj, qëndroj (si folje jokalmimtare), refkëtij, regëtij, regëtoj, reson, rënkoj, rimon, roit, rrapëllij, rrezon, rrësmon, rrëshqas, rri, rrjedh, rryej, rrymon, sëmbon, sython, sharroji, shkas, shkumoj, shtangoj, shter, shterpëroj, shtënoj, shuj, shtie (si folje jokalmimtare), shtozoj, shtrapnon,*

---

\* *gulçoj*, përveç kuptimit nr. 4 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, “e dëshiroj a e lakmoj shumë diçka” si folje kalimtare, fq. 335

\* *qaj*, përveç kuptimeve 5, 6 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 866-867

\* *bie*, përveç kuptimeve 6, 9, 10 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 90

\* *gufoj*, përveç kuptimit 4 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 334

\* *ngec*, përveç kuptimit 3 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 685

*shtrep, shtroh, shungulloj, tallazon, tekët, teptis, trevon, triumfoj, thekon, ujtis, ulon, ushton, uturin, vërshoj, vëngon, vlej, vrujon, vyej, xixëmon, xhufkon, yjëzon, zallit (zallis), zhardhokëzon, zhgjedhëson, zhuit, zhurmëron, zhurmoj, zhuzhet, zhuzhurit.* Grupohen në folje jokalimtare joakuzative sepse argumenti i tyre i vetëm nuk është një veprues, pra nuk e ndërmerr vetë veprimin, ose nuk është përgjegjës në mënyrë aktive për veprimin e foljes; ose e thënë ndryshe e trajton argumentin si argument kallëzor (akuzativ) nëse do të kishim një fjali me folje kalimtare. Këto folje quhen joakuzative sepse kryefjala ka rolin semantik të pësuesit dhe vetëkuptohet që ky pësues nuk mund të realizohet në rasën kallëzore.

Duke qenë se kufiri ndarës ndërmjet dy grupeve të foljeve joergative dhe joakuzative është i ngushtë do të kemi folje të cilat janë me dy kuptime, duke patur një kuptim joakuzativ dhe një kuptim veprues<sup>252</sup>. P. sh. kemi rastin e foljeve tipike të vendndodhjes si *rri* dhe *qëndroj* që kërkojnë të plotësohen me lokativë. P.sh. Folja *rri* dhe *qëndroj* shprehin kuptimin "të jesh vendosur në një vend të caktuar" (ndoshta me një orientim të caktuar), ose me kuptimin "të mbash një qëndrim në të cilin pesha mbështetet në skajin e fundëm". Në fjalitë e ilustruara si më poshtë:

- (1) **Agimi rri** në karrige.  
**Agimi qëndron** në këmbë.  
**Agimi shkoi** në Tiranë.

Në këtë përdorime, foljet nuk janë joakuzative duke qenë se ato realizojnë argumente veprues: vetëm kush është në gjendje në bazë të një veprimi të vullnetshëm mund të "rrijë" ose të "qëndrojë" në këtë kuptim në rastin e dy fjalive të para. Por në rastin e fjalive si më poshtë:

- (2) **Tavolina rri** në qoshe.  
**Kalendari qëndron** i varur në mur.  
**Ora shkoi**.

Në këto përdorime do të gjejmë nuanca të joakuzativitetit duke qenë se kryefjalët *tavolina* dhe *kalendari* nuk janë veprues, nuk kanë kryer veprime në mënyrë të vullnetshme, por janë vendosur me lokativet *në qoshe* dhe *në mur* nga dikush që ka vullnetin, aftësinë, mundësinë apo dëshirën për ta kryer këtë veprim dhe rezulton që kryefjalët *tavolina* dhe *kalendari* në këto raste të jenë thjesht pësues dhe foljet *rri* dhe *qëndroj* të përcjellin veprime joakuzative.

---

\* *shungulloj*, përveç kuptimit 10 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 1068

\* *vlej*, përveç kuptimit 3 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 1194

<sup>252</sup> Mark Newson etj., *Basic English Syntax with Exercises*, Bölcsész Konzorcium HEFOP Iroda, 2006, fq. 156

Këto folje plotësohen me sintagma parafjalore SP, sintagma ndajfoljore SN, por edhe me fjali të varura rrethanore në varësi të kuptimit leksikor të foljes F, p.sh:

(3) Rrëshqiti *kur akulli mbuloi rrugën*.

Gjithashtu një tjetër faktor dallues është tipari + Human / - Human. Në rastin e fjalive të para do të kemi realizimin foljes me tiparet: + Human, + Lokativ; në rastin e fjalive të dyta do të kemi realizimin e foljes me tiparet: - Human, + Lokativ.

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për folje të tjera të cilat kanë përdorime të dykuptimshme si p.sh. *shtie, teptis, uturin, trokas, puf, shter, ushton, vërshoj, zhuit* etj. Folje të tilla do t'i gjejmë në përdorime joergative dhe joakuzative si më poshtë:

(4)

<i>Shtiu</i> rrufeja / me pushkë.	Konfigurim joergativ
<i>Shtiu</i> pela.	Konfigurim joakuzativ (vetëm në vetë e tretë)
Mani <i>ka shtënë</i> degë të reja.	
<i>Teptisi</i> djali.	Konfigurim joergativ
I <i>teptisën</i> lotët.	Konfigurim joakuzativ (vetëm në vetë e tretë)
<i>Uturin</i> traktori.	Konfigurim joergativ (vetëm në vetë e tretë)
Më <i>uturijnë</i> veshët.	Konfigurim joakuzativ (vetëm në vetë e tretë)
Zemra më <i>troket</i> fort.	Konfigurim joergativ (vetëm në vetë e tretë)
Porta po <i>troket</i> .	Konfigurim joakuzativ (vetëm në vetë e tretë)
<i>Puf</i> duke nxjerrë shtëllunga.	Konfigurim joergativ
<i>Pufin</i> gështenjat në zjarr.	Konfigurim joakuzativ (vetëm në vetë e tretë)

**Foljet që tregojnë ndryshim në gjendjen e foljeve** si: *avullon, fleton, fluron, gjethon, kuqërron, kuqëson, kuqon, lagësoj, lylëzon, mbij, mugëllon, ngrij, përrijon, precipiton, qason, qelbëson, rrjedh, shkrij (në përdorimet si folje jokalmimtare), shkulmon, shkumoj, tymton, thyej, ujësin, ujtis, vagëlloj, vesoj, vjell (për ngjyrën), zbardhëllen, zyfnon*. Në këtë rast argumenti i vetëm i këtyre foljeve përjeton një ndryshim në gjendjen e shprehur. Kur përdoren si folje jokalmimtare foljet e kësaj nënkllase janë tipike joakuzative. Pjesa më e madhe e këtyre foljeve realizohen në vetë të tretë dhe mbartin tiparin – Frymor.

---

\* *lagësoj*, përveç kuptimit 3 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 518

\* *ngrij*, përveç kuptimeve 4, 5, në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 688

\* *thyej*, vetëm kuptimi 9 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 1132

\* *vesoj*, vetëm kuptimi 1 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 1169

- (5a) Po *thyen dita / nata*.  
*Shkriu akulli*.  
*Avulloi benzina*.

por

- (5b) *Shkriva* nga vapa. (veta I, + Frymor)

Gjithashtu këto folje plotësohen me sintagma parafjalore SP, sintagma ndajfoljore SN, por edhe me fjali të varura rrethore në varësi të kuptimit leksikor të foljes F, p.sh:

- (6) Mbiu *kur u ngoh koha*.

**Foljet që përcjellin idenë e të ekzistuarit** si: *fillëroj, ekzistoj, gjalloj, gjëllij, lashtoj, jam, jetoj, mbijetoj, mbretëroj, ndodh, ngjaj, ngjan, ngjas, ngjasoj, ngjet, përngjaj, përngjas, përngjasoj, rastis<sup>253</sup>, rezulton, rroj, trashëgoj<sup>254</sup>, tregon<sup>254</sup>, vdes (si jokalimtare), vegjetoj, vetëlind.*)

Kuptimi i kësaj nënkllase të foljeve është i lidhur me të qenurit/ ekzistuarit të një tërësie në një vendndodhje të caktuar. Ato janë folje të gjendjes dhe si rrjedhim veprimi i shprehur është i papërfunduar; por në fakt sjellja e tyre joakuzative pranohet si e tillë nga gjuhëtarët<sup>253</sup>.

- (7) *Ekzistojnë kushtet*.  
*Sot jemi, nesër s'jemi*.  
*Ka jetuar gjatë*.

Kuptimi i foljeve të kësaj klase mund të plotësohet nga sintagma parafjalore SP, sintagma ndajfoljore SN dhe fjali të varura rrethore, p.sh:

- (8) Ngjani *shumë kur qeshni*.

Kuptimi leksikor i kësaj klase mund të plotësohet edhe me fjali kryefjalore lidhëzore<sup>254</sup> si pjesë e sintagmës foljore SF, gjithmonë me foljen jokalimtare në vetën e tretë njëjës, p.sh:

---

\* *lashtoj*, përveç kuptimit 3 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 529

\* *rastis*, përveç kuptimit 3 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 892

\* *trashëgoj*, vetëm kuptimi 5 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 1102

\* *tregon*, vetëm kuptimi 5 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 1103

<sup>253</sup> Noriko Ue, *Vepër e cituar*, fq. 127

<sup>254</sup> *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Vëllimi II – Sintaksa, Tiranë, 2002, fq. 504

- (9) Kështu ngjau që fillova të hyja përsëri në udhën e njerëzve.

**Folje që tregojnë përcjellje të pavullnetshme të veprimeve/aktiviteteve që kanë efekt në shqisa (drita, zhurma, ndjesi etj):** *gacon, gërvin, gërgërit, gërgëlloj, gurgullon, gjëmoj, jehon, keqtingëllon, kërcas, kërcëlloj, kumbon, kuqëlloj, llamburit, ndrij, ndrit (ndris)\*, oshtin, perëndoj, rikumbon, rrëngjen, rrëzëllen, shkëlqej, shkëlqeron, shkëndijon, shkëndit (shkëndis), shkrepin, shndrij, shndrit (shndris)\*, tingëllon, trakulloj, thëllon, vegullon, vetëtin, vetëtit, vezullon, vrungulloj, vrungullit, xixërin, xixon, zbardhëllon, zhangëllon, zhaurin.*

- (10) **Shkëndit** zjarri.  
**Perëndoi** dielli.

Pjesa më e madhe e foljeve sa më lart realizohen në vetë të tretë, ndërsa disa prej tyre si *shkreptin, mugëllon, vetëtin* etj. janë folje pavetore. Kuptimi i foljeve të kësaj klase mund të plotësohet nga sintagma parafjalore SP, sintagma ndajfoljore SN dhe fjali të varura rrethanore, p.sh:

- (11) Oshtin shtëpia **kur vijnë fëmijët**.

**Folje që tregojnë kohëzgjatje:** *filloj, hap, mbërrij, nis, përfundoj, pushoj, rifilloj, vijoj, zgjat, zgjatoj*. Karakteristike për këtë grup është se kur këto folje përdoren **si folje jokalimtare**, ato vendosen në vetë të tretë (përveç foljeve *mbërrij, zgjat, zgjatoj* dhe *përfundoj* në disa kuptime).

- (12) **Filloi** dimri / të agonte.  
**Hapi** qershia.  
**Pushoi** shiu / zhurma / zemra.

Gjithashtu kuptimi i foljeve të kësaj klase mund të plotësohet nga sintagma parafjalore SP, sintagma ndajfoljore SN dhe fjali të varura rrethanore, p.sh:

- (13) Pushoi **kur mbaruan punë**.

---

\* *ndrit*, përveç kuptimit 5 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 670

\* *shndrit*, përveç kuptimit 4 në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 1029

\* *pushoj*, përveç kuptimeve 4, 5, në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, 2006, fq. 862

Perlmutter<sup>255</sup> e ka zhvilluar analizën mbi foljet jokalmtare duke marrë për shembull foljet jokalmtare të gjuhës angleze, megjithatë ai shprehet, duke qenë se kuptimi i këtyre foljeve është i njëjtë edhe për gjuhë të tjera, atëherë kjo e bën këtë teori të pranueshme dhe të zbatueshme edhe për gjuhë të tjera. Takahashi<sup>256</sup> shprehet se analizës së Perlmutter i mungon një diagnozë semantike e detajuar, përveç klasifikimit bazuar në kuptimin e këtyre foljeve. Megjithatë, kjo listë përfshin nocione e çështje të përgjithshme mbi joakuzativitetin.

Sipas studimit të Noriko Ue<sup>257</sup>, në analizën e Perlmutter dhe Postal do të hasim në disa probleme. Për sa i përket klasifikimit të foljeve sipas Perlmutter dhe Postal ata sugjerojnë një karakteristikë përcaktuese për të gjitha foljet joergative dhe të gjitha foljet joakuzative, (nëse është e mundur). Klasifikimi i tyre për foljet joakuzative përfshin disa nënkategori të foljeve. A ka ndonjë komponent kuptimor të përbashkët për të gjitha foljet joakuzative?

Gjithashtu, disa folje që përcjellin kuptimin e proceseve trupore të pavullnetshme si: *teshtij*, *lemzoi*, *gromësi*, përfshihen në klasën e foljeve joergative. Këto folje janë qartësisht joveprorë, për të cilat gjuhëtarët sugjerojnë që ato duhen analizuar si folje joakuzative duke pasur parasysh dallimin veprues vs. pësues/temë.

Në studimet e Levin dhe Rappaport Hovav<sup>258</sup> (1995) mbi joakuzativitetin, ato kanë dalë në përfundimin se joakuzativiteti përcaktohet semantikisht dhe përfaqësohet në mënyrë sintaksore, ose në fjalë të tjera mund të themi se dallimi joergative-joakuzative është shënuar në mënyrë sintaksore në bazë të kuptimit leksikor të foljes. Ato paraqesin një dallim semantik ndërmjet faktorëve “*të brendshëm*” dhe “*të jashtëm*” dhe propozojnë që ky dallim semantik luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin kuptimor të joakuzativitetit. Duke përdorur nocionin e shkakut të brendshëm dhe të jashtëm, ato i klasifikojnë foljet jokalmtare si më poshtë:

a. folje me shkak të brendshëm (monadike)

[x FOLJE]

b. folje me shkak të jashtëm (dyadike)

[[x VEPRON] SHKAKTON [y KTHEHET NË GJENDJE]]

c. folje të genies dhe dukjes (dyadike): dy argumente të brendshëm

---

<sup>255</sup> David M. Perlmutter, Paul M. Postal. (1984) *The I-advancement exclusiveness law*. Në David M. Perlmutter dhe Carol Rosen (eds.), *Studies in relational grammar 2*, 81–125. Chicago: University of Chicago Press

<sup>256</sup> Naoko Takahashi, *On Unaccusativity* tërhequr në 01.07.2014 nga [https://www.google.com/search?sourceid=navclient&ie=UTF-8&rlz=1T4ASUM\\_enAL579AL584&q=On+Unaccusativity+Naoko+TAKAHASHI](https://www.google.com/search?sourceid=navclient&ie=UTF-8&rlz=1T4ASUM_enAL579AL584&q=On+Unaccusativity+Naoko+TAKAHASHI)

<sup>257</sup> Noriko Ue, *On Unergative and Unaccusative Verbs in English* tërhequr në 30. 12. 2013 nga [http://repo.lib.ryukoku.ac.jp/jspui/bitstream/10519/896/1/r-rn\\_473\\_009.pdf](http://repo.lib.ryukoku.ac.jp/jspui/bitstream/10519/896/1/r-rn_473_009.pdf) referuar nga Gruber, Jeffrey S. (1976) *Lexical Structure in Syntax and Semantics*. Amsterdam: North - Holland, Jackendoff, Ray (1990) *Semantic Structures*. Cambridge, Mass.: MIT Press.

<sup>258</sup> Beth Levin, Malka Rappaport Hovav, *Unaccusativity: At the Syntax-Lexical Semantic Interface*. Cambridge, MA: MIT Press, 1995

Mendohet se ndryshimi i ardhur nga *shkak i brendshëm – shkaku i jashtëm* mund të përdoret për të dalluar ndërmjet foljeve jokalmtare të cilat realizohen në alternime *shkakore ose jo shkakore*. Një variant jokalmtar joakuzativ i foljeve që përdoren në alternimin shkakor mendohet se rrjedh nga një proces në të cilin kalojnë foljet me shkaku të jashtëm.

[[x VEPROJ] SHKAKTOJ {y KTHEHET NË GJENDJE )]

a. x është leksikalisht i lidhur → jokalmtare joakuzative

(psh. Dritarja u thye.)

b. x është leksikalisht i realizuar → kalimtare

(psh. Xhoni theu dritaren.)

Në analizën e tyre Levin dhe Rappaport Hovav shprehen se për sa i përket përfaqësimit leksikor semantik, folja “thyej” (*break*) në rastin – *Dritarja u thye* (*The window broke*) është realizuar si një folje dyadike e shkaku, e cila kalon në procesin e dekalimtarësisë. Por sipas gjuhëtarëve<sup>259</sup> të tjerë duket se ka dy probleme me qasjen e Levin dhe Rappaport Hovav për joakuzativitetin.

Ato e lidhin dallimin ndërmjet foljeve foljeve me *shkaku të brendshëm dhe të jashtëm* me dallimin joergative – joakuzative. Megjithatë, ato pohojnë se foljet joakuzative përbëhen nga folje me shkaku të jashtëm dhe folje të qenies dhe dukjes. Këto të fundit janë folje joakuzative që nuk realizohen me ndonjë shkaku të jashtëm. Levin dhe Rappaport Hovav propozojnë se këto folje i përkasin klasës së foljeve për të cilën nocioni shkaku i brendshëm – shkaku i jashtëm nuk mund të përdoret. Ato shprehen se joakuzativiteti i këtyre foljeve ka një burim të ndryshëm nga joakuzativiteti i foljeve me shkaku të jashtëm si *thyej*.

Në studimin e tyre mbi joakuzativitetin Vendler<sup>260</sup> dhe Dowty<sup>261</sup> (1979) kanë argumentuar se joakuzativiteti është i lidhur me klasat e foljeve që bazohen në aspekte të kryeshmërisë vs. moskryeshmërisë (*telic vs. atelic*) së veprimit. Sipas tyre foljet klasifikohen në katër kategori: *gjendjet, veprimet, arritjet dhe përmbushjet*. Van Valin<sup>262</sup> (1990), paraqet një analizë semantike në *Gramatikën e Rolit dhe Referencës* bazuar në teorinë e klasifikimit të foljeve propozuar nga Dowty dhe sugjeron që në rastet kur shprehen veprime monodike, foljet janë joergative, ndërsa foljet që shprehin gjendjet, arritjet dhe përmbushjet janë joakuzative.

---

<sup>259</sup> Noriko Ue, *Po aty*.

<sup>260</sup> *Po aty*, referuar nga Vendler, Zeno, "Verbs and times". The Philosophical Review 66 (2):, 1957, 143–160

<sup>261</sup> Noriko Ue, *Po aty*, referuar nga Dowty, David (1979) *Word Meaning and Montague Grammar*. Dordrecht: Reidel

<sup>262</sup> *Po aty*, referuar nga Van Valin, Robert O. (1990) *Semantic Parameters of Split Intransitivity*, Language 66, 221-260

Rëndësia e *kryershmërisë* (*telic actions*) si një karakteristikë përcaktuese për joakuzativitetin është përdorur për të analizuar foljet e lëvizjes. Folje që tregojnë lëvizje si *eci, vrapoj, notoj, kërcëj*, etj. janë normalisht folje të aktivitetit/vepruese dhe si rrjedhim janë joergative:

a. John walked in the park for an hour / \*in an hour. (*konfigurim joergativ*)  
Xhoni eci në park (për) një orë / \* në një orë.

Por ato mund të paraqesin gjithashtu sjellje joakuzative në mjedise të caktuara sintaksore. Kur veprimi i këtyre foljeve bëhet për një qëllim të caktuar, ato paraqiten në konfigurim sintaksor joakuzativ.

b. John walked to the park in an hour / \*for an hour. (*konfigurim joakuzativ*)  
Xhoni eci drejt parkut në një orë / \* për një orë.

Folja *eci* në (a) pa një sintagmë parafjalore SP që tregon qëllim tregon një aktivitet/veprim por në (b) kemi rastin e një foljeje të përmbushjes.

Kryershmëria e veprimit mendohet se luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e joakuzativitetit. Foljet jokalimtare që tregojnë veprim të përfunduar si foljet e ndryshimit të gjendjes (psh. *thyej, shkrij etj*) dhe foljet me drejtim të brendshëm (psh. *mbërrij, vij, zbres etj*) janë folje tipike joakuzative. Foljet, argumenti i tyre i vetëm është një veprues (p.sh. *protestoj, notoj, reagoj etj*), janë tipike joergative. Për sa i përket klasifikimit të foljeve nga Vendler<sup>263</sup>, foljet e *arritjes* dhe *përmbushjes* i përkasin grupit të foljeve joakuzative, ndërsa foljet që shprehin aktivitet/veprim i përkasin grupit të foljeve joergative.

Megjithatë, përsëri shtrohet problemi i analizimit të foljeve të *gjendjes* duke përdorur qasjen e *kryershmërisë*. Foljet e *gjendjes* si foljet e *qenies* (psh. *ekzistoj, qëndrojmë, rri*) janë folje që nuk shprehin përfundim në kryerjen e veprimit. Por, ndryshe nga foljet që shprehin vazhdimësi veprimi, ato janë joakuzative. N. Ue<sup>264</sup> shprehet se para se të trajtojmë këtë sjellje të foljeve të *gjendjes* ndarazi nga pjesa tjetër e foljeve që shprehin veprim të kryer/ të përfunduar, do të na duhet të gjejmë mënyra të tjera që do të na japin mundësi për të bërë unifikimin e tyre.

#### **5.4 Dikotomia / dyanësia e foljeve joergative – joakuzative**

---

<sup>263</sup> Po aty, referuar nga Vendler, Zeno (1957). "Verbs and times". The Philosophical Review 66 (2): 143–160

<sup>264</sup> Noriko Ue, *Vepër e cituar*.



Në analizën e tij Vendler<sup>265</sup> ka shfrytëzuar ndarjen e klasave të foljeve sipas kuptimit duke përdorur një folje përfaqësuese për çdo klasë; ai ka përdorur foljet tradicionale për të dhënë kuptimin si *jam*, *kthehet*, *veproj* dhe *shkaktoj*, strukturat leksikore të të cilave mund të paraqiten si më poshtë:

- a. Gjendjet (*States*): x jam (y)
- b. Aktivitetet (*Activities*): x veproj (mbi y)
- c. Arritjet (*Achievements*): x kthehet [x jam (y)]
- d. Përmbushjet (*Accomplishments*): x shkaktoj [y kthehet [y jam (z)]]

Në klasifikimin katër degësh të foljeve, tri klasa i përkasin grupit të foljeve jokolimtare: *gjendjet*, *aktivitetet* dhe *arritjet*. Foljet e *aktivitetit* janë zakonisht folje joergative ndërsa foljet që shprehin *gjendje* dhe *arritje* janë joakuzative.

Mbi këtë bazë Levin ngre argumentat e veta dhe shprehet se për sa i përket klasave të foljeve jokolimtare, foljet joergative dhe ato joakuzative formojnë një tërësi me dallime të pakta dhe jo dy klasa të ndryshme. Në studimet e mëvonshme të Levin dhe Rappaport<sup>266</sup> (1989) mund të themi se foljet jokolimtare joergative dhe joakuzative duket se formojnë një tërësi me dallime të pakta. P.sh. foljet e *vrapimit* dhe foljet e *rrotullimit* (sipas ndarjes së Levin) janë në të njëjtën kohë folje të lëvizjes dhe folje që tregojnë mënyrën e lëvizjes. Ndryshe nga foljet e mbërritjes, kuptimi i të cilave shpreh një drejtim specifik lëvizjeje të brendshme, foljet e *vrapimit* dhe të *rrotullimit* nuk shprehin një drejtim të brendshëm.

Megjithatë, nga ana konceptuale është e mundur që foljet e lëvizjes të shprehin dy komponentë kuptimesh, një që i referohet lëvizjes në vetvete dhe një tjetër që i referohet drejtimit që ndjek lëvizja. Pavarësisht se si komponenti i lëvizjes edhe ai i drejtimit janë përfshirë në të gjitha foljet e lëvizjes, Levin dhe Rappaport mendojnë se foljet e lëvizjes variojnë duke pasur parasysh se cili komponent ka në fakt precedencë në raport me tjetrin. Foljet e *vrapimit* i japin më peshë lëvizjes se drejtimit dhe *vice versa*; kjo ndodh sepse argumenti i vetëm në foljet e lëvizjes është zakonisht një frymor (+ Fr), ndryshe nga rasti i foljeve të drejtimit, argumenti i vetëm i të cilave është zakonisht jofrymor (- Fr). Në këtë mënyrë mund të themi se foljet e *vrapimit* kanë tendencën të sillen si folje që shprehin aktivitet.

Për këtë arsye, ato janë folje joergative, por në prani të një sintagme që shpreh qëllim, ato shprehin përmbushje dhe sillen si folje joakuzative siç e përmendëm edhe më lart.

Nga ana tjetër, foljet e *rrotullimit* kanë tendencën të sillen si folje të *arritjes*, d.m.th joakuzative. Statusi i tyre i dyanshëm në fjali që shprehin *arritje* dhe *aktivitete* paraqitet si më poshtë:

---

<sup>265</sup> *Po aty*, referuar nga Vendler, Zeno (1957) *Vepër e cituar ...*

<sup>266</sup> *Po aty*, referuar nga Levin, Beth and Malka Rappaport (1989) "An Approach to Unaccusative Mismatches," Proceedings of NELS 19, 314-328

- a. The ball rolled (down the stairs) in a second. konfigurim joakuzativ  
Topi u rrotullua (poshtë shkallëve) në një sekondë.
- b. The ball rolled for ten minutes. konfigurim joergativ  
Topi u rrotullua për dhjetë minuta.

Pra, mund të themi se nuk mund të heqim një vijë të prerë për sa i takon dallimit ndërmjet foljeve joergative dhe joakuzative duke qenë se foljet e *lëvizjes* janë diku në mes, duke përcjellë e realizuar më shumë sjellje nga klasa joergative dhe foljet e *rrotullimit* përcjellin e realizojnë më shumë sjellje nga klasa joakuzative.

### **5.5 Raste të diskutueshme me sintagmat e foljeve jokalimtare**

Duke analizuar materialin e vjelë mbi foljet jokalimtare të shqipes hasim shpeshherë sintagma foljore të cilat përveç argumentit të jashtëm të shprehur me një SE në funksionin e kryefjalës marrin edhe fjalë plotësuese, për të cilat është vështirë të thuhet nëse janë plotësorë ose adjunkte. Këto fjalë në më të shumtën e rasteve kanë kuptim lokativ. Në përdorimin e këtyre foljeve këto lokative janë të domosdoshëm për sintagmën foljore SF. Mungesa e lokativit do ta bënte të porealizuar thënien/fjalinë e për më tepër vetëm brenda një konteksti të përmendur më herët do të mund të gjenim/dallonim sintagmën foljore të këtij grupi të përdorur me një argument. Folje të tilla quhen **folje me predikativitet të paplotësuar**<sup>267</sup>. Folje të tilla zakonisht shprehin idenë e të qenit, të dukurit, të shfaqjes etj.

Kështu në grupin e foljeve jokalimtare *rrëmij* (kur përdoret si jokalimtare), *rrëmoj*, *mbes* (kur shpreh vendndodhje), përveç argumentit të parë (kryefjalës) folësi ka nevojë të përdorë edhe plotësorin e dytë që fjalja të ketë kuptim dhe të jetë e pranueshme në ligjërim. Le ta ilustrujmë me shembujt e mëposhtëm:

- (1) Agimi rrëmih **këtu/ nëpër arkiva**.  
Ai rrëmoi **thellë/ në xhepa/në bibliotekë**.  
Mbeta **këtu/ në mes të rrugës**.

Në fjalitë e mësipërme kemi të përdorur foljet jokalimtare me plotësorët përkatës. Në rastin e plotësit të dytë, pra *këtu/ nëpër arkiva*, *thellë/ në xhepa/në bibliotekë*, *këtu/ në mes të rrugës* mendojmë se përdorimi i domosdoshëm i tyre i jep të drejtën të quhen plotësorë/komplementë të domosdoshëm; mungesa e tyre do të krijonte një ngërç kuptimor në ligjërimin e fjalive, përveç rastit kur ky ligjërim kryhet në një kontekst të përmendur më herët nga folësi. Le të analizojmë:

---

<sup>267</sup> Iman A. Hanafy, *English Grammar 2*, tërhequr në 21. 07. 2014 nga <http://www.olc.bu.edu.eg/olc/images/fart/122.pdf>

- (2) \* Agimi **rrëmi**  
\* Ai **rrëmoi**  
\* **Mbeta** por “Ora **mbeti**.”

Duket qartë që në të tria fjalitë e mësipërme mungesa e plotësorit (në këtë rast lokativ /rrethanor vendi) sintagmë parafjalore SP, sintagmë ndajfoljore SN i bën këto fjali jo gramatikore. Folje të tilla të ngjashme janë: *banoj, anoj, aderoj, qëndroj, buron (kur shpreh vendndodhje), dal, depërtoj, figuroj, gërmoj (kur përdoret si jokalimtare), hyj, imigroj, jetoj (me kuptimin banoj, rroj), kontribuoj (përveç si plotës vendi, gjithashtu dhe si kundrinë e zhdrejtë me parafjalë), ndesh (si jokalimtare me kuptimin përplasem, më del përpara, më zë rrugën), ndërhyj, operoj (kur përdoret si jokalimtare), prek (si jokalimtare me kuptimin has në diçka), pres<sub>1</sub> (si jokalimtare me kuptimin kaloj drejt a mospërmes për shkurt, i bie) etj.*

Nga materiali i vjelë mbi foljet jokalimtare hasim grupin e foljeve *bashkëekzistoj, bashkëbanoj, bashkëjetoj, bashkësundoj, bashkëudhëtoj, bisedoj (kur përdoret si jokalimtare), dialogoj, dyluftoj, fjalëtoj, fjaloj, fjalos, fqinjësoj, jetoj (me kuptimin bashkëjetoj), komunikoj (si jokalimtare, me kuptimin hyj në lidhje me dikë), kooperoj, ngjan, ngjas, ngjasoj, përngjas, përngjaj, përngjasoj, të cilat në rastet më të shpeshta kërkojnë një kundrinor të drejtë me parafjalë (ose kundrinor të zhdrejtë ose plotës mënyre) për t’u plotësuar; pa vendosjen e këtij plotësori fjalia do të ishte e paqartë, e paplotësuar e si rrjedhim gramatikiht jo korrekte.*

- (3) **Bashkëjeton** me prindërit.  
**Komunikojnë** me lexuesin.  
**Ngjasin** njëri me tjetrin.  
khr. \* **Bashkëjeton**.  
khr. \* **Komunikojnë**.  
khr. \* **Ngjasin**.

Folja *tingëllon* me kuptimin *shfaqet ose del ashtu si na pëlqen ose jo, jep një mbresë a një ndjenjë të caktuar, bën një përshtypje* plotësohet me një argument plotës mënyre.

- (4) Kjo fjalë **tingëllon** bukur.  
Ajo që bëre, **tingëllon** keq.  
**Tingëllon** me dashuri / me dhemshuri.  
khr. \* Kjo fjalë **tingëllon**.  
khr. \* Ajo që bëre, **tingëllon**.  
khr. \* **Tingëllon**.

Kemi rastin e foljes *punoj* e cila në ndërtimet si folje jokalimtare e gjejmë të plotësohet me rrethanorë vendi, kohe, mënyre, përkatësisht si sintagma parafjalore SP, sintagma emërore SE, sintagma ndajfoljore SN e ilustruar si më poshtë:

(5) **Punon** në uzinë / arë / minierë / ndërtim / arsim.

**Punon** mirë.

**Punon** si mësues. ose i njëjti rast për foljen *shërbej* –

**Shërben** si mësues

khr. \* **Punon**.

khr. \* **Shërben**.

Biblioteka **punon** gjithë ditën.

Institucionet **nuk punojnë** të dielën.

khr. \* Biblioteka **punon**.

khr. \* Institucionet **nuk punojnë**.

**Punon** me këmbëngulje / me mish e me shpirt / me ndërgjegje

khr. \* **Punon**.

Në të tria rastet e shënuara me yll (\*) sintagma foljore SF është e saktë nga ana gramatikore, pra brenda një konteksti të caktuar ne i dëgjojmë dhe i pranojmë shpesh këto fjali të përdoren, por jashtë kontekstit kuptimi i tyre është i paplotësuar, e si rrjedhim gramatikisht jo i saktë; pra mund të themi se plotësimi i tyre me plotësorin përkatës do t'i bënte fjalitë gramatikisht korrekte.

## KREU VI

### SINTAGMA FOLJORE ME FOLJE KALIMTARE

Sintagmat foljore kanë lidhje të ngushtë me konceptin e kalimtarësisë e jokalimtarësisë, për arsye se ato kanë në strukturën e tyre folje me kuptim kalimtar ose jokalimtar. Të qenit folje me kuptim kalimtar ose jokalimtar është një veti ose aftësi e brendshme e këtyre foljeve, pra ajo nuk diktohet nga ndonjë mjet gramatikor ose jogramtikor. Këto dy kuptime kanë karakteristikat e tyre.

#### *6.1 Kalimtarësia – karakteristika të përgjithshme*

Sipas Gramatikës së Gjuhës Shqipe<sup>268</sup> (2002), quhen kalimtare ato folje, të cilat emërtojnë veprime, që nuk mbeten tek ai që i kryen, por shkojnë e bien mbi një person a send tjetër, që në fjali shprehet me anë të një emri, përemri a çdo fjale tjetër të emëruar në rasën kallëzore pa parafjalë. Folje kalimtare, pra, quhen ato që kanë mundësi të marrin kundrina.

Kalimtarësia është trajtuar si karakteristikë e një sintagme të tërë, ku një veprim është kryer ose transferuar nga një veprues te një pësues. Kalimtarësia në këndvështrimin tradicional domosdoshmërisht përfshin të paktën dy pjesëmarrës, dhe një veprim i cili është EFEKTIV në një farë mënyre.

Në gramatikën gjenerative studime të thelluara mbi kalimtarësinë janë kryer nga Paul J. Hopper dhe Sandra A. Thompson (ndër të tjerë), të cilëve do t'i referohemi gjerësisht në këtë kapitull. Hopper dhe Thompson<sup>269</sup> kanë identifikuar parametrat e

---

<sup>268</sup> *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Vëllimi I – Morfologjia, Tiranë, 2002, fq. 265

<sup>269</sup> Paul J. Hopper, Sandra A. Thompson “Transitivity in Grammar and Discourse”, *Language*, Vol. 56, No. 2. (Jun, 1980), fq. 252, e tërhequr më datë 02. 12. 2013 nga [http://www.romanistik.unifreiburg.de/raible/Lehre/2006/Materialien/Hopper\\_Thompson.pdf](http://www.romanistik.unifreiburg.de/raible/Lehre/2006/Materialien/Hopper_Thompson.pdf)

mëposhtme të kalimtarësisë ku secili prej tyre sugjeron një shkallë, në bazë të së cilës sintagma mund të renditet.

	<b>I LARTË</b>	<b>I ULËT</b>
<b>A. Pjesëmarrësit</b>	2 ose më shumë pjesëmarrës A dhe O	1 pjesëmarrës
<b>B. Lëvizshmëria</b>	veprore	jo veprore
<b>C. Kryerja</b>	i kryer	i pakryer
<b>D. Përpikëria</b>	i menjëhershëm	jo i menjëhershëm
<b>E. Qëllimi</b>	i qëllimshëm	i paqëllimshëm
<b>F. Sjellja</b>	pohore	mohore
<b>G. Mënyra</b>	reale	joreale
<b>H. Veprimi</b>	A me fuqi të lartë	A me fuqi të ulët
<b>I. Ndikimi i O</b>	O tërësisht i ndikuar	O i pandikuar
<b>J. Individualizimi i O</b>	O shumë i individualizuar	O i painedividualizuar

Tabela 1: *Parametrat e kalimtarësisë*

Sipas tyre është e lehtë të tregojmë se çdo komponent i kalimtarësisë përfshin një aspekt të ndryshëm të efektivitetit ose intensitetit me të cilin veprimi kalon nga një pjesëmarrës në një tjetër:

**(A) Pjesëmarrësit:** Asnjë veprim nuk mund të zhvillohet nëse nuk janë të përfshirë të paktën dy pjesëmarrës.

**(B) Lëvizshmëria:** Veprimet mund të transferohen nga një pjesëmarrës në një tjetër, por nuk mund të themi të njëjtën gjë për gjendjet. Kështu do të kemi një transferim/kalim veprimi në shembullin “*Unë përqafova Selin*”, por s’mund të themi të njëjtën gjë për fjalinë “*Unë e pëlqej Selin*” duke qenë se kemi të shprehur një gjendje.

**(C) Kryerja:** Në këtë rast trajtohet çështja nëse veprimi i shprehur është i përfunduar apo i papërfunduar/i pakryer, pra kur një veprim është i kryer atëherë ky veprim ka kaluar nga vepruesi te pësuesi. Në fjalinë “*Unë e hëngram*”, aktiviteti është parë si i përfunduar dhe veprimi është realizuar në tërësinë e tij, por në fjalinë “*Unë jam duke ngrënë*”, “*Po ha*” veprimi është i pakryer dhe aktiviteti është vetëm pjesërisht i përfunduar.

**(D) Përpikëria:** Veprimet e kryera pa pasur nevojë të kalojnë nëpër një proces që të realizohen, pra që s’kanë të dukshme fazën kalimtare mes fillimit dhe përfundimit të veprimit kanë një efekt më të fortë mbi pësuesit e tyre se veprimet të cilat janë në thelb në vazhdim e sipër ose që kërkojnë kohë deri në realizimin e plotë të veprimit të shprehur; krahasojmë p.sh. kuptimin e shprehur në foljet “qëlloj” - (veprim i përpiktë) dhe “mbaj” (veprim jo i përpiktë) në *Ai qëllon qenin* vs. *Ai mbajti qenin*.

**(E) Qëllimi:** Efekti tek pësuesi (O) është zakonisht më i dukshëm kur (A) paraqitet si veprues që mbart një qëllim, p.sh. nëse krahasojmë fjalitë “*Kam shkruar emrin tuaj*” – veprimi është i qëllimshëm dhe fjalinë “*Kam harruar emrin tuaj*” – në këtë rast veprimi është i paqëllimshëm.

**(F) Sjellja:** Ky aspekt ka të bëjë me mënyrën si është përdorur folja, pra nëse ky veprim është pohuar apo mohuar nga përdoruesi si p.sh. *Djali e qëlloi topin vs. Djali nuk e qëlloi topin.*

**(G) Mënyra:** Ky aspekt në transitivitet lidhet me dallimin midis reales dhe jo reales në përcaktimin e veprimeve. Një veprim i cili nuk ka ndodhur ose që paraqitet si aktivitet në një kontekst jo të vërtetë është dukshëm me më pak ndikim se një veprim i cili në fakt realizohet në një kontekst real dhe është i lidhur direkt me një ngjarje të vërtetë si p.sh. *Shpresoj që ai të mund të shënojë në kosh vs. Do të doja që ai të mund të shënonte në kosh.*

**(H) Veprimi:** Është mëse e qartë se pjesëmarrësit me fuqi të lartë veprimi mund të realizojnë transferimin e një veprimi në një mënyrë më të ndjeshme se ata pjesëmarrës me fuqi të ulët veprimi. Kështu, është normale të pranojmë se interpretimi për fjalinë “*Gjergji më trembi mua*” është ai i një ngjarjeje të prekshme, me pasoja të perceptueshme, por rasti i fjalisë “*Ajo foto më trembi mua*” mund të jetë krejtësisht një çështje e një gjendjeje të brendshme të folësit.

Së fundi, do të trajtojmë dy komponentët të cilët i referohen O (kundrinës temë/pësues).

**(I) Ndikimi i O dhe (J) Individualizimi i O:** Shkalla në të cilën një veprim është transferuar në një pësues është në funksion të faktit se sa është prekur apo ndikuar pësuesi, ky cilësim është më i ndjeshëm e i dallueshëm në fjalinë, “*Unë e piva qumështin.*” sesa në fjalinë “*Unë piva pak nga qumështi*”.

Komponenti i **Individualizimit**, i referohet në radhë të parë dallueshmërisë së *Vepruesit* (A) nga *Pësuesi* (O) p.sh në fjalitë *Qeni kafshoi fëmijën vs. Qeni kafshoi veten* efekti i kalimtarësisë kalon më me lehtësi në fjalinë e parë se në fjalinë e dytë; ky komponent i referohet gjithashtu edhe veçanësisë së saj nga vetë konteksti ku zhvillohet veprimi.

Kështu në tabelën si më poshtë, ajo që u referohet emrave me karakteristikat në të majtë është se ato janë më shumë të individualizuara se ajo që u referohet emrave përgjegjës të tyre në të djathtë:

<b>I INDIVIDUALIZUAR</b>	<b>I PAINDIVIDUALIZUAR</b>
I veçantë	I përgjithshëm
Frymor	Jofrymor
Kontrete	Abstrakte
Njëjës	Shumës
I numërueshëm	I panumërueshëm
Referencial, i përcaktuar	Jo referencial, i papërcaktuar

Një veprim mund të transferohet në mënyrë më efektive tek një pësues që është i individualizuar se sa tek një që nuk është i tillë, pra, një pësues/temë (O) i caktuar shihet shpesh si më i prekur/ndikuar se një pësues/temë (O) që është i pacaktuar. Në fjalinë “*Ai piu birrë*”, ka një implikim të mundshëm që ai e përfundoi birrën, por në fjalinë “*Ai piu diçka (nga birra)*”, ky nënkuptim arrihet me vështirësi (p.sh. nëse piu pak birrë, e la pa pirë birrën nga ndonjë arsye).

Të njëjtën gjë mund të themi me pësuesit frymorë dhe jofrymorë: në fjalinë “*Përplasa Agimin*”, ka të ngjarë që Agimi të jetë në qendër të vëmendjes për shkak të efektit të veprimit, apo ndoshta kjo vëmendje mund të bjerë në të dy pjesëmarrësit, por në fjalinë “*Unë përplasa tavolinën*” ka pak mundësi që të ketë një efekt të ndjeshëm mbi tavolinën, dhe për më tepër ka më shumë të ngjarë që efekti mbi vepruesin (A) të jetë më i theksuar.

Kalimtarësia, shihet kështu në mënyrën më konvencionale të mundshme – si një çështje ku ndodh transferimi i një veprimi nga një pjesëmarrës në një tjetër – dhe ku pjesët përbërëse mund të ndahen, secila duke u fokusuar në një aspekt karakterizues për të realizuar kryerjen e veprimit. Në këtë mënyrë, këto karakteristika lejojnë cilësime të tilla si *pak kalimtare* apo *shumë kalimtare*: sa më shumë karakteristika të ketë sintagma në kolonën “*I lartë*” në *IA – J*, aq më kalimtare është ajo – pra është më afër asaj që quhet “*Kalimtarësi Kardinale*” (*Cardinal Transitivity*)<sup>270</sup>. Le të krahasojmë këto shembuj:

- (1) *Agimi pëlqen birrën.*
- (2) *Agimi goditi Mirin.*

Në këtë rast fjalia e dytë është me kalimtarësi më të lartë se fjalia e parë, sepse ajo paraqet karakteristikat e mëposhtme:

*Lëvizshmëria: veprorë*

*Kryerja: e përfunduar*

*Përpikëria: e menjëhershme*

*Ndikimi i O: O tërësisht i ndikuar*

*Individualizimi i O: i lartë, referencial, frymor dhe i veçantë*

Për sa i përket fjalisë së mëposhtme:

- (3) *Nuk ka yje në qiell.*

Kjo fjali mund të jetë me kalimtarësi shumë më të ulët se fjalitë (1) dhe (2) si më lart, meqë nuk i ka karakteristikat në kolonën “*i lartë*”, përveç (*G*) *mënyrës* që paraqitet si *reale*. Ndër folje të tjera që ndajnë karakteristika të ngjashme me foljen *kam* si më sipër

---

<sup>270</sup> Paul J. Hopper, Sandra A. Thompson, *Vepër e cituar*, fq. 253



mund të përmendim: *jetësoj, njoh, rëndo, sëmuro, simbolizoj, shëndetësoj, shfaq, shkolloj, shtetëzoj, trajtoj, universalizoj, vazhdoj, zotëroj* etj.

Lidhur me kalimtarësinë si një tipar i qëndrueshëm, pavarësisht numrit të pjesëmarrësve në veprim, mund ta përqëndrojmë vëmendjen në fjalitë më poshtë: një fjali me folje që kërkon dy pjesëmarrës mund të paraqesë kalimtarësi më të ulët se një fjali me një pjesëmarrës të vetëm. Kështu, duke u bazuar në tiparet e sipërpërmendura, sintagma foljore në (4) ka më shumë karakteristika të kalimtarësisë të lartë se sintagma foljore me dy pjesëmarrës në (5):

- (4) *Mira u largua.*  
*Pjesëmarrësit: një*  
*Lëvizshmëria: veprorë*  
*Kryerja: i kryer*  
*Përpikmëria: i menjëhershëm*  
*Qëllimi: i qëllimshëm*
- (5) *Miri pëlqen birrën.*  
*Pjesëmarrësit: dy*

Hopper dhe Thompson<sup>271</sup> shprehen se ky pohim duket absolutisht i saktë, pavarësisht numrit të pjesëmarrësve në veprim. Ka shumë fjali me dy pjesëmarrës të cilat janë shumë të ulta në kalimtarësi. Kjo ndodh për këtë arsye: prania e një pjesëmarrësi të vërtetë pësues të veprimit është komponent i rëndësishëm i kalimtarësisë, në rastin kur ky pjesëmarrës i dytë nuk mbart vërtet kuptimin e pësuesit (pra që nuk pëson ndonjë veprim) atëherë kalimtarësia do të jetë e ulët. Kështu, pavarësisht se fjalia (5) ka folje kalimtare, sintagma të tilla foljore me të tillë pësues (që nuk pësojnë) janë cilësuar si jokalimtare në shumë gramatika të gjuhëve të tjera.

Kjo do të thotë se karakteristikimet morfosintatike priren të jenë të ndjeshme ndaj kalimtarësisë si një e tërë duke bërë përjashtime për detajet që hasen në praninë apo mungesën e një pjesëmarrësi të dytë.

Në gramatikat e të gjitha gjuhëve ndeshim raste të tilla ku kalimtarësia varion gjerësisht dhe në mënyrë sistematike. Janë këto variacione të cilat na detyrojnë të mendojmë se kalimtarësia krijon një marrëdhënie qendrore në gramatikën e gjuhëve: sa herë që hasim një çiftëzim të detyrueshëm të dy karakteristikave të kalimtarësisë në morfosintaksën dhe semantikën e një sintagme, këto karakteristika janë të vendosura gjithmonë në të njëjtën kolonë në shkallën e kalimtarësisë. Ky vëzhgim i drejton gjuhëtarët<sup>272</sup> drejt formulimit të një vetie/tipari universal të gramatikës, e cila mund të quhet si *Hipoteza e Kalimtarësisë*:

---

<sup>271</sup> Paul J. Hopper, Sandra A. Thompson, *Po aty*, fq. 254

<sup>272</sup> Paul J. Hopper, Sandra A. Thompson, *Po aty*, fq. 255

Nëse dy sintagma (a) dhe (b) në një gjuhë të caktuar ndryshojnë në atë që (a) është më e lartë në kalimtarësi sipas karakteristikave të përcaktuara në kolonën IA-J, dhe nëse do të shfaqej diku tjetër në sintagmë një ndryshim gramatikor ose semantik, atëherë ky ndryshim do të tregojë përsëri që (a) do të jetë më e lartë në kalimtarësi.

E kundërta e kësaj hipoteze, pra se ka një lidhje të ngjashme mes karakteristikave të ulta të kalimtarësisë, është e nënkuptueshme. Sigurisht, hipoteza e kalimtarësisë<sup>273</sup> i referohet vetëm cilësimeve të detyrueshme morfosintaksore dhe interpretimeve semantike, pra, thuhet se ndërvarësia ndodh sa herë që dy vlerat e komponentëve të kalimtarësisë janë domosdoshmërisht të pranishme. Hipoteza në formën e tanishme nuk parashikon kur këto vlera do të shfaqen në strukturë apo kuptim, por në qoftë se ato dalin në sipërfaqe, ato do të vendosen të dyja në vlerën e lartë ose që të dyja në vlerën e ulët.

### **6.1.1 Shkalla e parametrave të kalimtarësisë**

Siç u përmend më lart, studimi i Hopper dhe Thompson ka ndikuar ndjeshëm në qasjen që kalimtarësia të trajtohet si nocion me shumë faktorë e variacione; ky studim është përgjithësisht i pranuar në literaturën funksionale – tipologjike<sup>274</sup>, veçanërisht është e diskutuar hipoteza e tyre, e njohur si Hipoteza e Kalimtarësisë.

Tsunoda (1981, 1985) dhe Lazard (1998)<sup>275</sup> kanë ngritur kundërshimet e tyre, pasi, siç kanë vënë në dukje, jo të gjithë parametrat janë të lidhur dhe për këtë arsye nuk tregojnë një bashkëvariacion sistematik. Në fakt, ndërsa disa prej këtyre parametrave, si *ndikimi* (i lartë) dhe *kryerja* janë plotësisht të lidhur në mënyrë të qartë, disa të tjerë si *qëllimi* dhe *ndikimi* nuk janë.

Këto karakteristika mund të jenë edhe në konflikt si në rastin e foljeve “*shoh*”/ “*shikoj*”, të cilat diskutohen nga Tsunoda (1985) dhe Lazard (1998), ku folja e parë realizohet si pasojë e një rezultati (një objekt, që është imazh vizual, është parë), por jo domosdoshmërisht i vullnetshëm, ndërsa kjo e dyta shpreh një veprim të vullnetshëm, por që nuk ndodh (detyrimisht) si pasojë e një rezultati vizual (ne mund të “shikojmë” diçka pa patur nevojë të përdorim shqisën e të parit).

Lista e parametrave të Kalimtarësisë siç është paraqitur nga Hopper dhe Thompson është mjaft heterogjene: disa nga parametrat kryesisht kanë të bëjnë me objektin e veprimit/ pësuesin O, disa me kryefjalën/ vepruesin A, ndërsa disa të tjera me veprimin e shprehur nga vetë folja. Kjo është nxjerrë në pah edhe nga Givon (1985: 90,

---

<sup>273</sup> *Po aty*

<sup>274</sup> Andrej Malchukov *Transitivity parameters and transitivity alternations* në Case, Valency and Transitivity, Volume 77 Studies in Language Companion Series (SLCS), Leonid Kulikov, Andrej Malchukov and Peter de Swart, John Benjamins B.V., 2006, fq. 333

<sup>275</sup> *Po aty*, referuar nga Tsunoda, T. 1981. “*Split case marking in verb types and tense /aspect /mood*”. *Linguistics* 19: 389–438 dhe Tsunoda, T. 1985. “*Remarks on transitivity*”. *Journal of Linguistics* 21: 385–96 dhe Lazard, G. 1998. *Actancy*. Berlin: Mouton de Gruyter.

106)<sup>276</sup>, i cili në mënyrë të qartë dallon mes Agjentit/Vepruesit, Pësuesit dhe parametrat e lidhura me foljen dhe argumenton kundrejt trajtimit të tyre si një “listë pa hierarkinë përkatëse”.

Në këtë mënyrë Givon ka analizuar parametrat dhe ka dhënë listën e mëposhtme për paraqitjen e tyre:

***Shkalla e Kalimtarësisë***

[frymor/jofrymor]	}	Tiparet – A (kryefjalë)
[qëllimshmëria]		
[lëvizja]	}	Tiparet – V (folje)
[faktizimi]		
[koha/kryerja]		
[ndikimi]	}	Tiparet – O (objekt i veprimit)
[individualizimi (O)]		

Givon shprehet se kjo shkallë ka për qëllim të përfaqësojë përafri semantike mes parametrave individuale duke vendosur parametrat sipas përafrisë së tyre në shkallë. Disa nga këto përafri janë të karakterit semantik, ndërsa disa të tjera janë mjaft pragmatike në natyrë.

Kështu, *qëllimshmëria* nxjerr në pah sa aktiv është argumenti *A*, ndërsa *kryerja* ose *moskryerja* e një veprimi të shprehur nga folje kalimtare nënkupton se objekti i veprimit *O* është plotësisht / pjesërisht i ndikuar.

*Ndikimi* vetë është i lidhur me *individualizimin* e objektit të veprimit *O*, p.sh. në rastin e SE koka e të cilëve është një emër që emërton lëndë të panumërueshme ku ndikimi i pjesshëm ka të bëjë me një pjesë të pacaktuar të substancës (*Piu pak verë*) ose me frymorë të pacaktuar nga grupi (*Takoi disa miq*). Lidhja e ndikimit me faktin e të qenit frymor/jo frymor është më delikate, por siç është argumentuar nga Wierzbicka (1980)<sup>277</sup> objektet/kundrinorët *O* jofrymorë zakonisht nuk interpretohen si të ndikuar, nëse ata pësojnë një ndryshim, si pasojë e një veprimi të shprehur nga një folje kalimtare (krh. *Goditi murin* vs. *Shkatërroi murin*), ndërsa për kundrinorët *O* frymorë ndryshimi i gjendjes kuptohet vetvetiu (*Goditi djalin*).

Tipari *lëvizje* ka të bëjë me “shkallën e aktivitetit fizik të drejtuar në një ngjarje” (Hopper dhe Thompson 1980: 264)<sup>278</sup> dhe është i lidhur me karakteristikat e foljes *F* (dallimi midis veprimeve dhe gjendjeve) nga njëra anë dhe me karakteristikat e *A*

---

<sup>276</sup> T. Givón, *Ergative morphology and transitivity gradients in Newari*. Në *Relational Typology*, F. Plank (ed.), Berlin: Mouton de Gruyter, 1985, 89–107.

<sup>277</sup> Andrej Malchukov, *Vep. e cituar ...* referuar nga Wierzbicka, A. 1980. *The Case for Surface Case*. Ann Arbor: Karoma Publishers

<sup>278</sup> Paul J. Hopper, Sandra A. Thompson “*Transitivity in Grammar and Discourse*”, *Language*, Vol. 56, No. 2. (1980), fq. 252, e tërhequr më datë 02. 12. 2013 nga [http://www.romanistik.unifreiburg.de/raible/Lehre/2006/Materialien/Hopper\\_Thompson.pdf](http://www.romanistik.unifreiburg.de/raible/Lehre/2006/Materialien/Hopper_Thompson.pdf)

(qëllimshmëria ose kontrolli) nga ana tjetër. Malchukov<sup>279</sup> shprehet se ndërsa *qëllimshmëria* është një mjet për të dalluar veprimet nga proceset, vetë veprimet dhe proceset ndryshojnë nga gjendjet sepse ato janë më “konkrete”. Gjendjet janë gjeneruese dhe nuk mund të parashikohen në një moment të caktuar kohe, gjë që i lidh ato me një domen ireal.

Së fundi, është më se e njohur se faktori kohë është i lidhur si në aspektin sinkronik, ashtu dhe në atë diakronik me kohën (e ardhme / jo e ardhme dhe dallimin reale / jo reale) nga njëra anë dhe me kryerjen (krh. e shkuar / jo e shkuar dhe dallimi e kryer / e parkryer) nga ana tjetër. Që kur është pranuar se *Shkalla e Kalimtarësisë* reflekton prirjet semantike mes tipareve individuale të kalimtarësisë, ajo mund të shihet si një hartë semantike e Parametrave të Kalimtarësisë.

## **6.2 Foljet kalimtare me një kundrinë të shprehur me SE**

Mjeti sintaksor me të cilin shprehet një kundrinë e sintagmës foljore SF mund të jetë një sintagmë emërore SE, por mund të jetë edhe një fjali. Siç e përmendëm edhe më lart në bazë të përcaktimit të Gramatikës së Gjuhës Shqipe<sup>280</sup> (2002), quhen kalimtare ato folje, të cilat emërtojnë veprime, që nuk mbeten tek ai që i kryen, por shkojnë e bien mbi një person a send tjetër. Newson<sup>281</sup> shprehet se kryefjala mund të jetë një SE që si argument bart rolin semantik të vepruesit dhe kurse kundrinori të një pësuesi, ose kryefjala mund të jetë përjetues dhe kundrinori një temë. Pësuesi dhe tema, duke gjykuar nga ky këndvështrim, ndryshojnë në bazë të nocionit të ndikueshmërisë: një pësues ndikohet nga veprimi i përshkruar nga folja, ndërsa tema nuk ndikohet p.sh:

- (1) a. **Agimi** preu *drurin*.
- b. **Agimi** pa *drurin*.

Në (1a) kemi rastin e foljes *pres* të realizuar në kohën e kryer të thjeshtë ku *Agimi* është *vepruesi* dhe *druri* është *pësuesi*. Në (1b) kemi rastin e foljes *shikoj* të realizuar në kohën e kryer të thjeshtë ku *Agimi* është *përjetuesi* dhe *druri* është *tema* e cila nuk ndikohet nga ndonjë element tjetër.

Sipas Newson<sup>282</sup> një tjetër aspekt që mund të diskutohet në lidhje me foljet kalimtare është se disa nga këto të fundit mund të analizohen si folje në të cilat paraqitet elementi i shkakut. Duke analizuar shembujt e mëposhtëm mund të themi:

---

<sup>279</sup> Andrej Malchukov, *Vep. e cituar ...* referuar nga Van Valin, R. dhe Lapolla, R. 1997. *Syntax: Structure, Meaning and Function*. Cambridge: Cambridge University Press


<sup>280</sup> *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Vëllimi I – Morfologjia, Tiranë, 2002, fq. 265

<sup>281</sup> Mark Newson etj., *Basic English Syntax with Exercises*, 2006, Bölcsész Konzorcium HEFOP Iroda, fq. 172

<sup>282</sup> Mark Newson etj., *Po aty*, fq. 173

- (2) a. **Agimi** rregulloi krevatin.  
 b. **Agimi** qëllloi Mirin.  
 c. **Agimi** shkroi letrën.

Në të tre shembujt e mësipërm (2a-c) kemi idenë e shkakut, të shprehur nga kryefjala, e cila shkakton veprimin, pra është një veprues i foljes përkatëse. Struktura e përbërësve të kësaj të fundit do të jetë:



Pema 1: SEPT Agimi qëllloi Mirin

Sipas studiuësve<sup>283</sup> ka një lidhje të ngushtë ndërmjet strukturës së sintagmës foljore dhe strukturës së ngjarjeve të përshkruara, në mënyrë që çdo pjesë e sintagmës foljore t'i korrespondojë një nënngjarjeje të caktuar. Por nëse foljet kalimtare përfshijnë një realizim të vepruesit, atëherë ka dy pjesë që e ndërtojnë veprimin e shprehur nga folja, e si rrjedhim kemi dy nënngjarje. Në shembullin *Agimi qëllloi Mirin* nuk do të thotë domosdoshmërisht se *Agimi* kreu një veprim të qëllimshëm, veprim i cili bëri që të qëllohet *Miri*. D.m.th. nuk ka një lidhje direkte (shkaku) ndërmjet veprimit të realizuar nga kryefjala dhe pësimit të realizuar/ të shprehur nga kundrinori. Nëse analizojmë si më poshtë:

- (3) a. Agimi qëllloi Mirin me shuplakë.  
 b. Agimi qëllloi Mirin me shkop.  
 c. Agimi qëllloi Mirin me gur.

<sup>283</sup> Po aty

do të kuptojmë se kemi dy pjesë të ngjarjeve në fjali të cilat renditen në funksion të njëra tjetrës dhe ndodhin si pasojë e lidhjes mes tyre.

- (4)  $n = n_1 \quad n_2 : n_1 = \text{Agimi bëri diçka}$   
 $n_2 = \text{Miri u qëllua}$

Pjesa më e madhe e foljeve kalimtare bëjnë pjesë në këtë grup. Ndër to mund të përmendim: *citoj, copëtoj, copëztoj, çarmatoj, çarmatos, çiftëztoj, çimentoj, çjerr, çmoj, çnderoj, çorganizoj, çorientoj, çrregulloj, daktilografoj, dorovit, decentralizoj, deformatoj, dekoroj, dekretoj, delegoj, dendësoj, denoncoj, depozitoj, detyroj, dëboj, dëfrej, dërgoj, diktoj, disiplinuj, dokumentoj, dorëztoj, dramatizoj, drejtoj, dubloj, dyfishoj, dhuroj, edukoj, eksploroj, forcoj, formatoj, formoj, formuloj, fortifikoj, fotoqrafij, fotokopjoj, frenoj, frekuentoj, fsheh, fshij, furnizoj, gafroj, garantoj, gatuaj, germëztoj, gëlqerizoj, gëlltit, gërshetoj, gropos, grumbulloj, grupoj, gjallëroj, gjej, gjurmoj, harxhoj, helmoj, hulumtoj, ilustruj, importoj, intervistoj, jap, konsumoj, kontrolloj, koordinoj, kopjoj, korrigjoj, krahasoj, krijoj, kruaj, kryej, kushtoj, laj, lexoj, lëkund, lëmoj, lëpij, liroj, lustruj, etj.*

Nëse e kthejmë vëmendjen në foljet e perceptimit, të cilat marrin si kryefjalë një sintagmë emërore SE që bart rolin semantik të përjetuesit, si *dëshiroj, dëshpëroj, dua, emocionoj, fal, falënderoj, harroj, hasmëroj, imagjinoj, lëvdoj, lodh, shoh, dëgjoj, njoh, paragjykoj, parafytyroj, parandiej, parapëlqej, përçmoj, përftytyroj* etj, do të kemi rastet si më poshtë (ndër të tjera):

- (5) a. *Mira pa një fantazmë*  
b. *Agimi dëgjoi lajmet*

Newson etj.<sup>284</sup> shprehin se do të ishte me interes të analizonim strukturën e ngjarjeve të foljeve kalimtare me kryefjalë përjetuese. Në këtë rast nuk ka një marrëdhënie shkakore ndërmjet asaj që shpreh kryefjalë dhe asaj që i ndodh kundrinorit. Kështu në fjalinë *Agimi dëgjon lajmet*, duket qartë që nuk kemi një shkak të ushtruar nga vepruesi që të realizojë një pasojë për kundrinorin. Duket sikur këto fjali shprehin një gjendje të thjeshtë, pa nënngjarje, por në fakt struktura e përjetuesit në foljet kalimtare është e njëjtë me strukturën e vepruesit në fjalitë me folje kalimtare:

- (6)  $n = n_1 : n_1 = \text{Agimi dëgjoi lajmet.}$   
 $n_2 = \text{lajmet u dëgjuan}$

Ka gjithashtu folje të cilat marrin argumentë të cilët bartin rolet semantike të vepruesit dhe përjetuesit si p.sh.: *deh, dëmtoj, dënoj, dërrmoj, diskreditoj, distancoj,*

---

<sup>284</sup> Mark Newson etj., *Po aty*, fq. 179

*divorcoj, djeg, dokëndis, dhunoj, eksitoj, ekzekutoj, eliminoj, entuziazmoj, fajësoj, flak, flakërit, flijoj, fshikulloj, fyej, gremis, grind, gjakos, gjymtoj, kanos, keqkuptoj, kritikoj, lajkatoj, lemeris, lëndoj, tremb, mërzi, zhgënjej, njollos, ofendoj, etj.*

- (7) a. Agimi më *trembi* mua.  
b. Mira *mërzi* djalin.  
c. Miri *zhgënjeu* prindërit.

Nëse analizojmë strukturën argumentore të foljeve (7a,b,c) vërejmë se në (7a) janë paraqitur dy argumentë, përkatësisht, SE *Agimi* që bart rolin semantik të vepruesit dhe sintagma përemërore SE *mua më*, e shprehur me formën me klitik (Cl) dhe formën e plotë të përemrit vetor në rasën kallëzore, që bart rolin semantik të përjetuesit. Në (7b) janë paraqitur dy argumentë, përkatësisht, SE *Mira* që bart rolin semantik të vepruesit dhe SE *djalin* që bart rolin semantik të përjetuesit. Në (7c) janë paraqitur dy argumentë përkatësisht, SE *Miri* me rolin semantik të vepruesit dhe SE *prindërit* që bart rolin semantik të përjetuesit.

### **6.3 Foljet kalimtare me plotësorë fjali të varur kundrinore**

Sipas Gramatikës së Gjuhës Shqipe 2, plotësori ose periudha (siç trajtohet në Gramatikë) me fjali të varur kundrinore është ajo periudhë në një fjali të varur e cila drejtpërdrejt ose tërthorazi kryen një funksion të ngjashëm me atë të një kundrine<sup>285</sup>. Kjo do të thotë se këto fjali, ashtu si dhe SE në funksionin e kundrinës, bashkohen **me foljen** e fjalisë drejtuese, si element i domosdoshëm kuptimor, për të plotësuar kuptimin e saj. Pra ashtu si SE në funksionin e kundrinës, edhe këto fjali janë pjesë e sintagmës foljore ose e grupit foljor të fjalisë drejtuese.

Fjalitë e varura kundrinore bashkohen me foljen e fjalisë drejtuese me:

1. Lidhëza ffilluese të mirëfillta, si **se**, **që**, ose funksionalisht ffilluese kur kallëzuesi i fjalisë së varur është në mënyrën lidhore:

*Rrëfejnë se* në një prej atyre viteve u bë një thatësi e madhe.

*Thuaji të* vijë menjëherë.

2. Përemra lidhorë të pacaktuar:

*Merr kë* ke për të marrë e nisu.

3. Përemra e ndajfolje pyetëse

*E di kush* ma ka fajin mua.

*E merrni* me mend **sa** sa keq më erdhi.

---

<sup>285</sup> *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Vëllimi II – Sintaksa, Tiranë, 2002, fq. 515

Për sa i përket grupimit të foljeve të cilat pranojnë plotësorë të tillë, në Gramatikën e së Gjuhës Shqipe 2<sup>286</sup> është bërë ndarja si më poshtë me folje që tregojnë të kumtuar me disa ngjyrimë kuptimore. Jemi munduar të bëjmë një grupim të përgjithshëm të foljeve, pavarësisht se këto grupe mund të ndahen gjithashtu edhe në nëngrupe më specifike. Ndër to mund të përmendim:

1. Folje që tregojnë ligjërim në mënyrë të përgjithshme: *them, flas, tregoj, rrëfej, dëftoj, lajmëroj, urdhëroj, bërtas, thërras, grind, pëshpërit* etj.

Ne u *themi* se atdheu ynë është i bukur.

2. Folje që tregojnë lidhjen e të kumtuarit me ligjërimin e mëparshëm: *përfundoj, përsërit, shtoj, kundërshtoj, uroj, autorizoj, ndaloj, pyes, hetoj* etj.

Po ta *përsëris*, të kesh më shumë kujdes në të shkruar.

3. Folje që karakterizojnë synimin e kumtimin: *deklaroj, dëshmoj, gënjej, kërcënoj, kritikoj, kujtoj, mohoj, njoftoj, njoh, padit, paralajmëroj, përmend, pohoj, pranoj, provoj, qortoj, raportoj, shënoj, shkruaj, shpall, shpjegoj, theksoj, vërtetoj, kërkoj, miratoj, pranoj, lejoj, këshilloj, propozoj, porosit, rekomandoj, udhëzoj, tregoj* etj.

Kujtova se ti e *dije* këtë.

4. Folje që tregojnë të perceptuar shqisor a mendor: *dëgjoj, ndiej, shoh, vë re, vërej, kuptoj, mësoj, njoh, di, parapëlqej, dëshiroj, dua, ëndërroj,* etj.

Ai e *ndiente* se kishte hyrë në rrugë pa krye.

#### **6.4 Foljet kalimtare me plotësorë fjali të varur kryefjalore**

Në gjuhën shqipe sintagma foljore SF mund të marrë si plotësor edhe një fjali të varur kryefjalore<sup>287</sup>. Në rastin kur fjalia e varur kryefjalore lidhëzore plotëson një folje kalimtare, ajo do të ketë formë joveprore, në vetën e tretë njëjës.

Këto fjali mund të prihen nga lidhëza ffilluese, si p.sh. *se* ose *që*. Kjo do të thotë se fjalitë kryefjalore në këto raste janë pjesë e sintagmës lidhëzore.

(1) *Thuhet se do të bjerë shi*

Folje që plotësohen nga një fjali e varur kryefjalore me lidhëzën *se* tregojnë:

Kumtim: *thuhet, flitet, pëshpëritet, dëftohet, tregohet, pohohet, shënohet*

---

<sup>286</sup> *Po aty*, fq. 516 - 520

<sup>287</sup> *Po aty*, fq. 504



Perceptim: *bie në sy, shihet, vihet re, vihet në dukje, parandihet*  
Të menduar: *besohet, del, dihet, dyshohet, mendohet, kujtohet, kuptohet, merret vesh, nënkuptohet, vetëkuptohet, supozohet,*

Folje që plotësohen nga një fjali e varur kryefjalore me lidhëzën *që* tregojnë:

Kumtim: *thuhet,*  
Perceptim: *duket, parashikohet, ndihet,*  
Të menduar: *kuptohet, shpjegohet, dihet, pritët, pranohet*  
Lejim: *ndalohet, lejohet*

### **6.5 Foljet kalimtare me dy kundrina**

Për sa u përket foljeve kalimtare me dy kundrina, do të mbështetemi kryesisht në studimin e Martin Haspelmath (2006) duke vendosur materialin gjuhësor të shqipes mbi foljet kalimtare me dy kundrina në këndvështrimin gjenerativist.

Ndërtimet me folje me dy kundrina, që në literaturën e huaj njihen me termin folje ditransitive/ bikalimtare janë ndërtimet me tre argumente, me një aktor, një temë dhe një “proto-marrës” (nga greq. – i parë) (Primus 1999)<sup>288</sup>, dmth, një argument që është i ngjashëm me një marrës/ përftues dhe vendoset në një sintagmë me tri argumente. Proto-marrësit përfshijnë rolet e mëposhtme më specifike: pranuesi-zotërues (me foljet “jap”, “dorëzoj”, “dhuroj”), qëllim-zotërues (me foljet “sjell”, “dërgoj”), të adresuarit-dëgjues (me foljet “them”, “shpjegoj”), dhe të adresuarit-shikues (me foljet “tregoj”), si edhe role të tjera të lidhura ngushtë me to.

Sipas Newson<sup>289</sup> shembujt që njihen si ndërtime me dy kundrina janë gjithashtu për t’u përmendur përsa i përket realizimit të plotësorëve në fjalinë me folje kalimtare; folja ka dy kundrina të cilat tradicionalisht njihen si kundrinorë të drejtë dhe të zhdrejtë. Në rastet e fjalive si më poshtë:


- (1) a. Agimi i dha **Mirës** një **dhuratë**.
- b. Agimi i dërgoi **një letër Mirit**.

Do të kishim paraqitjen e fjalisë në strukturën e mëposhme:

---

<sup>288</sup> Martin Haspelmath, *Ditransitive constructions. Towards a new Role and Reference Grammar account?* në *Investigations of the Syntax–Semantics–Pragmatics Interface*, Robert D. Van Valin, Jr. Heinrich Heine University, Düsseldorf & University at Buffalo, The State University of New York, John Benjamins Publishing Company, 2006, fq. 75, referuar nga Primus, B. 1999. *Cases and Thematic Roles: Ergative, Accusative and Active*. Tübingen: Niemeyer

<sup>289</sup> Mark Newson etj., *Vepër e cituar*, fq. 185 - 187



Pema 2: Pema për folje kalimtare me dy kundrina

Në këtë strukturë tema realizohet në pozicionin e plotësorit të foljes si SE (një letër) në rasën kallëzore. Kundrina e zhdrejtë realizohet me një SE (Mirit) në rasën dhanore, e shfaqet në pozicionin e plotësorit. Por në gjuhën shqipe rendi i fjalëve në fjali mund të ndryshojë pa ndikuar në kuptimin e fjalisë, duke qenë se faktori rasë e bën mëse të qartë realizimin e kuptimit të përbërësve të fjalisë. Pra, realizimi i fjalisë:

- (2) Agimi i dha një **dhuratë Mirës**.

është njësoj e pranueshme sintaksorisht. Me fjalë të tjera nëse *Agimi i jep Mirës një dhuratë*, *Agimi* bën diçka e cila shkakton që *dhurata (libri)* të ndryshojë vendndodhje dhe pronësi, e si rezultat ai përfundon tek *Mira*.

Në shqipe këto kundrina realizohen me a) sintagma emërore SE (siç e përmendëm edhe më lart), pra SE + SE *I dha librin Agimit* ose b) me sintagma emërore SE + sintagma lidhëzore SL *I tha Agimit se do vonohej*.

Foljet me më shumë se dy argumentë janë konsideruar si problematike. Si rast i parë i foljeve me shumë plotësorë do të merrnim parasysht foljet e vendit si p.sh.: *mbështet, mbivendos, mbudh, ngul, ngujoj, parkoj, përplas, përzë, populloj, publikoj, rras, rreshtoj, sistemoj, shemb, shkëput, shkoj, shpërngul, shtrij, vë, zhap, vendos, mbaj* etj.

- (3) a. *Agimi vendosi librin në raft.*

b. Mira *mbajti* zogun në kafaz.

Secila nga këto folje realizohet me një veprues, një temë dhe një lokativ. Vepruesi është realizuar si specifikuesi i foljes, tema është pjesë e brendshme e sintagmës foljore dhe lokativi është në pozicionin e plotësorit.

Për sa i përket strukturës së ngjarjes Mark Newson<sup>290</sup> etj. do të shpreheshin se edhe nëse lokativi nuk është i shprehur në fjali, ai do të vetëkuptohet nga konteksti, por jashtë kontekstit lokativi është i domosdoshëm. Struktura e ngjarjes së këtyre foljeve tregon se analiza mund të jetë komplekse. P.sh. po të marrim parasysh se çfarë është përfshirë në “*vendos*” – pra, kemi një veprues i cili kryen një veprim, kemi një temë e cila pëson një ndryshim pozicioni dhe ka një vend ku kjo temë përfundon. Kështu struktura e ngjarjes do të jetë në këtë mënyrë:

(4) Agimi *vendosi* librin në raft.

n = n1 → n2 → n3: n1 = “Agimi bëri diçka”

n2 = “libri ndryshon vendndodhje”

n3 = “libri është në raft”

### **6.5.1 Disa qasje të tjera të ndërtimeve të SF me dy kundrina**

#### **Gramatika relacionale**

Gramatika relacionale u praktikua gjerësisht në 1970 – 1980 (Perlmutter 1980, Blake 1990)<sup>291</sup>, por me kalimin e kohës ndikimi i saj u dobësua. Kjo teori trajtonte kryesisht alternimet e rrjedhës të anglishtes, të cilat ishin shumë të përngjashme me ndërtimet joveprore. Gramatika relacionale përqendrohej në tri marrëdhëniet kryesore gramatikore mes “1” (*kryefjalës*), “2” (*kundrinorit të drejtë*) dhe “3” (*kundrinori i zhdrejtë*) si më poshtë:

- Agimi i dha adresën e tij Mirës.

1                      2                      3

- Agimi i dha Mirës adresën e tij.

1                      3                      2

---

<sup>290</sup> Mark Newson etj., *Vepër e cituar*, fq. 185 - 187

<sup>291</sup> Martin Haspelmath, *Ditransitive constructions Towards a new Role and Reference Grammar account?*, Në *Investigations of the Syntax–Semantics–Pragmatics Interface*, Robert D. Van Valin, Jr. Heinrich Heine University, Düsseldorf & University at Buffalo, The State University of New York, John Benjamins Publishing Company, 2006, fq. 79, referuar nga Perlmutter, D.M. 1980. *Relational grammar*. Në *Current Approaches to Syntax [Syntax and semantics 13]*, E.A. Moravcsik & J.R. Wirth (Eds), 195–229. New York NY: Academic Press dhe Blake, B.J. 1990. *Relational Grammar*. London: Routledge

Zhvendosja e formës në rrjedhore në ndërtimin më sipër na përball me veprimin e zhvendosjes 3 – në – 2 (*kundrinor i zhdrejtë – kryefjalë*) duke e kthyer SE “*adresën e tij*” në një *chômeur* – termi vjen nga frengjishtja (i papunë) dhe është veçanërisht i përdorur në gramatikën relacionale nga gjuhëtarja Colette Craig (1978)<sup>292</sup>. Ky term nënkupton një marrëdhënie të veçantë të SE e cila rëshket/zhvendoset në fjali duke përfunduar në skaj të saj, veçanërisht është e hasur në ndërtimet joveprore.

- Agimi i dha Mirës adresën e tij.  
          1                2        chômeur

Për sa i përket përdorimit të këtij termi në materialin gjuhësor të shqipës mund të themi se ky term është një cilësim thjesht rastësor duke qenë se shqipja është një gjuhë eptimore dhe kjo i jep mundësi të ndajë më së miri përdorimin e rasave në ndërtimet me kundrinorë të drejtë e të zhdrejtë.

Paralelisht sjellim shembullin e një ndërtimi jovepror për të konkretizuar termin *chômeur* në ndërtimin me formën joveprore:

- Agimi kritikoi Mirën.  
          1                2
- Mira u kritikua nga Agimi.  
          2                                1  
          1                                chômeur

Sipas Haspelmath<sup>293</sup> problemet në këtë qasje u bënë menjëherë të dukshme. Në fakt, një nga problemet ishte se kjo qasje e përbërë nga marrëdhënia universale mes pikave 1, 2, 3 (*kryefjalës, kundrinorit të drejtë, kundrinorit të zhdrejtë*) nuk pranonte apo analizonte dot dublikimin e marrëdhënieve gramatikore të rasteve me shtrirje neutrale, ku përfutusi dhe argumentat temë kishin të njëjtat veti/karakteristika sintaksore.

Një tjetër problem ngrihet me ndërtimet e shtrirjes dytësore (Dryer 1986) të cilat pranojnë vetëm zhvendosjen e detyruar 3 – në – 2 (*kundrinor i zhdrejtë në kundrinor të drejtë*), siç propozohet nga Aissen (1983, 1987)<sup>294</sup> për gjuhët Tzotzil (gjuhë meksikane mayan). Në këtë rast shton Dryer është njësoj si të pranojmë ergativitetin vetëm në ndërtimet joveprore, një qasje që u pranua gjerësisht në shekullin e 19, por në gramatikën e sotme nuk përdoret më.

---

<sup>292</sup> Colette G. Craig, 1978, *On the promotion of instrumentals in Mayan Languages* tërhequr në dt. 29. 07. 2014 nga [http://splc.ddl.ish-lyon.cnrs.fr/fulltext/Grinevald/Grinevald\\_1978\\_Mayan%20Language.pdf](http://splc.ddl.ish-lyon.cnrs.fr/fulltext/Grinevald/Grinevald_1978_Mayan%20Language.pdf)

<sup>293</sup> Martin Haspelmath, *Vepër e cituar*, fq. 79

<sup>294</sup> Po aty referuar nga Dryer, M.S. 1986. *Primary objects, secondary objects, and antidative*. Language 62: 808–45 dhe Aissen, J. 1983. *Indirect object advancement in Tzotzil*. Në *Studies in Relational Grammar*, 1, D. Perlmutter (Ed.), 272–302. Chicago IL: University of Chicago Press. Aissen, J. 1987. *Tzotzil Clause Structure*. Dordrecht: Reidel

***Gramatika funksionale***

Gramatika funksionale sipas Dik (1989, 1997)<sup>295</sup> është një teori e cila është më pranë Gramatikës së Rolit dhe Referencës nga ana e arkitekturës themelore, por funksionet e saj semantike i përgjigjen më shumë shtrirjes 2 – në – 3 (*kundrinor i drejtë në kundrinor të zhdrejtë*) të Gramatikës Relacionale dhe funksionet sintaksore i përgjigjen më shumë zhvendosjes 3 – në – 2 (*kundrinor i zhdrejtë në kundrinor të drejtë*) të po kësaj gramatike.

Çdo argumenti i caktohet një funksion semantik dhe njëkohësisht çdo argumenti i caktohet gjithashtu dhe funksionet sintaksore të kryefjalës dhe kundrinorit. Në përgjigje të shtrirjes 2 – në – 3 (*kundrinor i drejtë në kundrinor të zhdrejtë*) të Gramatikës Relacionale do të kemi përkatësisht termat veprues/agent, pësues dhe përfutës; në përgjigje të zhvendosjes për 1 dhe 2 do të kemi kryefjalë dhe kundrinor. Për sa i përket termit *chômeur*, gramatika funksionale përdor argumentat veprues/agent dhe pësues pa i caktuar një funksion sintaksor. Kjo është ilustruar si më poshtë:

- Agimi i dha adresën e tij Mirës.  
Vep.            Pës.            Përf.  
Kryef.            Kundr.
- Agimi i dha Mirës adresën e tij.  
Vep.            Përf. Pës.  
Kryef.            Kundr.

Përkundrejt përdorimit në anglisht:

- Pedro gave Aisha his e-mail address.  
Vep.            Përf.            Pës.  
Kryef.            Kundr.

Për më tepër gramatika funksionale ka të njëjtat probleme me gramatikën referenciale për sa i përket shtrirjes neutrale dhe dytësore në ndërtimet bikalimtare duke mos mundur të japë zgjidhje për përdorime të tilla.

***Gramatika leksikore dekompozuese***

---

<sup>295</sup> Dik, S.C. 1989. *The Theory of Functional Grammar*. Dordrecht: Foris. Dhe Dik, S.C. 1997. *The Theory of Functional Grammar*, Vol. 1–2. Berlin: Mouton de Gruyter

Gramatika leksikore dekompozuese (Wunderlich 1997, 2006)<sup>296</sup> është një përpjekje tjetër ambicioze në analizimin e karakteristikave të argumenteve të foljeve nga një perspektivë ndërgjuhësore.

GLD operon me karakteristikat e marrëdhënieve gramatikore të argumentave siç ilustron për rastin e foljes “vras” në gjermanisht (töten). Në këtë rast kemi të bëjmë me dekompozimin në anën e djathtë ku “x” është vepruesi dhe “y” është pësuesi; për më tepër dy argumentat e shënuar me lambda mbartin karakteristikat [ $\pm$  lartë] (ka rol të lartë/nuk ka rol të lartë) dhe [ $\pm$  ulët] (ka rol të ulët/nuk ka rol të ulët). Karakteristika [+ lartë] i korrespondon pësuesit dhe [+ ulët] i korrespondon vepruesit (Wunderlich 2006: 65).

Töten	y	x
	+ lartë	- lartë
	- ulët	+ ulët
	kund.drej	kryefjalë

Në rastin e përdorimit të foljes “vras” për gjuhën shqipe do të përftonim një vendosje ndryshe të parametrave si më poshtë:

x	vras	y
- lartë		+ lartë
+ ulët		- ulët
kryefjalë		kund.drej

Por çfarë ndodh me ndërtimet bikalimtare? Është analizuar folja “jap”. Sipas dekompozimit “x” vepron dhe si rrjedhim “y” pronëson “z”. Më poshtë janë treguar të tre argumentet të shënuar me “ ” lambda (Wunderlich 2006: 65).

Jap:	x	y	z
	- lartë	+ lartë	+ lartë
	+ ulët	+ ulët	- ulët
	kryefjalë	kund.zhdrej	kund.drej
	Unë	Mirit	librin

Kundrinori i zhdrejtë është vendosur ndërmjet kryefjalës dhe kundrinorit të drejtë në hierarkinë e roleve, kështu që merr të dyja karakteristikat [+ lartë] dhe [+ ulët] duke qenë se rasia dhanore është morfologjiksht më e shënuar se kallëzorja.

---

<sup>296</sup>Wunderlich, D. 1997. *Cause and the structure of verbs*. *Linguistic Inquiry* 28: 27–68. Dhe Wunderlich, D. 2006. *Towards a structural typology of verb classes*. Në *Advances in the Theory of the Lexicon*, D. Wunderlich (Ed.), 57–166. Berlin: Mouton de Gruyter

Sipas Haspelmath<sup>297</sup> gramatika leksikore dekompozuese ka të njëjtat kufizime si GR dhe GF për sa i përket shtrirjes neutrale dhe Wunderlich nuk i diskuton fare raste të tilla. Për më tepër, ka rezerva në lidhje me analizimin e shtrirjes dytësore. Me sa duket fakti që gjuhët evropiane e kanë të theksuar përdorimin e ndërtimeve të zhdrejta ka ndikuar në formulimin e këtyre teorive.

---

<sup>297</sup> Martin Haspelmath, *Vepër e cituar*, fq. 81-82

## KREU VII

### SINTAGMA FOLJORE ME FOLJE QË PËRDOREN SI KALIMTARE DHE JOKALIMTARE

Pjesa më e madhe e gjuhëve paraqesin alternime gjatë përdorimit të foljeve në kalimtarësi. Modeli më tipik në lidhje me grupimin e foljeve, i gjetur në gramatikat<sup>298</sup> e shumë gjuhëve i ndan foljet në: (a) folje të cilat janë rreptësisht jokalmtare, të cilat realizohen vetëm në sintagma jokalmtare (me një *S* (*kryefjalë veprues/përjetues*) si argument bazë) p.sh. foljet *leh, marshoj, mbes, mbretëroj* etj. (b) folje të cilat janë rreptësisht kalimtare, të cilat realizohen vetëm në sintagma kalimtare (me *A* (*kryefjalë veprues/përjetues*) dhe *O* (*kundrinë pësues/temë*) si argumentë bazë) p.sh. foljet *mbuloj, mburr, ndërtoj, pastroj* etj. dhe (c) disa folje janë karakterizuar si ambitranzitive ose ambikalimtare (nga lat. *ambi-*, *ambo-* që pozicionohet në të dyja anët) të cilat realizohen si në sintagma kalimtare ashtu dhe në ato jokalmtare në varësi të kuptimit të argumentëve bazë në ndërtimet ku realizohen p.sh. foljet *çliroj, çoj<sub>1</sub>, dalloj, darkoj, degëztoj, degjeneroj, dekonspiroj, demonstroj, deponoj, derdh, dëgjoj, dëshmoj, dështoj, di, dikoj, diplomoj, diskutoj, dittoj, djersij, dredh, drekoj, drithëroj, druaj, duartrokas, duroj, ëndërroj, fajtoj, fantazoj, fërfëlloj, filloj, firoj, fishkëllej, fitoj, flas, fle, flluskoj, fryj, frytëztoj, gabo, gdhij, gënjej, gërmoj, gërthas, gulçoj, gjëmoj, gjuaj, gjykoj, ha, hap, has, hedh, heq, hezitoj, hipi, humb, kaloj, kap, kapërcej, katandis, këndoj<sub>1</sub>, kërcas, kërcëj* etj.

Sipas përcaktimit të dhënë në Gramatikën e Gjuhës Shqipe 1<sup>299</sup> ka një numër të madh të foljeve në gjuhën shqipe të cilat realizohen në të njëjtën kohë në fjali si folje kalimtare dhe jokalmtare. Nuk ka një kufi të prerë ndërmjet foljeve kalimtare dhe jokalmtare. Përkatësia e një foljeje në grupin e foljeve kalimtare dhe foljeve jokalmtare varet nga kuptimi i saj leksikor në kontekstin ku është përdorur. Duke qenë se shumë folje kanë më shumë se një kuptim, qëllon shpesh që e njëjta folje të përdoret herë si

<sup>298</sup> R.M.W. Dixon, Alexandra Y. Aikhenvald, 2000, *Changing valency: case studies in transitivity* Cambridge University Press, fq. 4

<sup>299</sup> *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Vëllimi I – Morfologjia, Tiranë, 2002, fq. 266



jokalimtare, herë si kalimtare, gjithnjë sipas kuptimit të saj leksikor në këtë ose atë kontekst.

Sipas Lavidas<sup>300</sup>, të gjitha këto alternime në folje të caktuara janë të kushtëzuara kryesisht nga karakteristikat e tyre semantike apo të strukturës së argumentit. Nëse struktura argumentore luan rolin e urës ndërmjet leksikut (semantikës) dhe sintaksës, atëherë strukturat argumentore të foljeve të paraqitura këtu do të hedhin dritë mbi aspektet semantike dhe sintaksore të këtyre ndërtimeve.

Por cilat janë mekanizmat dhe proceset e ndryshimit në leksikon dhe në sintaksë, të cilat kanë të bëjnë me kalimtarësinë e foljeve? Më specifikisht, po japim alternimet në kalimtarësi për foljen *hap*, ku në (1a) ajo përdoret si folje kalimtare dhe në (1b) përdoret si folje jokalistare:

- (1) a. Agimi hapi dritaren.
- b. Hapi qershia/ moti/ dita.

ndryshe nga foljet që nuk mund të përdoren në alternime si në shembujt e mëposhtëm:

(a) folje kalimtare (pa përdorim jokalistar):

- (2) a. Agimi përgatiti leksionet.
- b. \*Leksionet përgatiten (vetë).

(b) folje jokalistare joakuzative që nuk përdoret në alternime:

- (3) a. Lotët shkanë.
- b. \*Agimi shkau lotët.

dhe (c) folje jokalistare joergative:

- (4) a. Agimi erdhi.
- b. \*Autobusi erdhi Agimin në hotel.

Duke u bazuar në studimin e Levin dhe Rappaport Hovav qasja dhe pozicioni kryesor në lidhje me organizimin e leksikonit në alternimet në kalimtarësi dhe ndërveprimin e tij me sintaksën është që të tregohet se kuptimi i foljes ka një efekt mbi sintaksën e foljes (Levin dhe Rappaport Hovav 1995)<sup>301</sup>. Dy çështje kryesore janë ngritur në lidhje me strukturën argumentore:

---

<sup>300</sup> Nikolaos Lavidas, *Transitivity Alternations in Diachrony: Changes in Argument Structure and Voice Morphology*, Cambridge Scholars Publishing, 2009, fq. 1-3

<sup>301</sup> *Po aty*, referuar nga Levin, Beth & Malka Rappaport Hovav 1995. *Unaccusativity. At the Syntax-Lexical Interface*. Cambridge, MA: MIT Press

1- Çështja e parë ngrihet nga studimi/analiza e Hale dhe Keyser (1986)<sup>302</sup> që një folje (pa ndihmën e një koke leksikore shtesë) mund të marrë vetëm një argument (për foljet monokalimtare) ose maksimumi dy argumentë (për foljet bikalimtare me përjashtim të argumentit të jashtëm/kryefjalës). Pjesa më e madhe e teorive mbi strukturën argumentore bazohen në rolet theta.

2- Çështja e dytë e përgjithshme ka të bëjë me ndërveprimin e strukturës leksikore semantike me fjalë të tjera, me kuptimin e foljes siç paraqitet në teorinë moderne me struktura sintaksore, të ndërveprimit të argumenteve (të elementëve që plotësojnë semantikisht foljen) me përfaqësimet sintaksore.

Lavidas<sup>303</sup> shprehet se një përmbledhje të nevojshme për një analizë të plotë mbi (jo) kalimtarësinë duhet të konsistojë në trajtimin e ndryshimeve në lidhje me argumentat dhe adjunktët që plotësojnë strukturat kalimtare d.m.th veprues, shkak/instrument dhe pësues dhe argumentët që plotësojnë strukturat jokalitare, d.m.th. pësues, shkak ose instrument dhe veprues.

Vëzhgimi i mësipërm na çon drejt një pyetje tjetër – në atë se si shprehet më saktë kalimtarësia. Një alternativë është që ta paraqesim atë në mënyrë të konfiguruar në nivelin e foljes duke artikuluar strukturën leksikore (Hale dhe Keyser 1986)<sup>304</sup>. Një tjetër alternativë është që të nxjerrim atë jashtë fushës leksikore të foljes, duke paraqitur projeksione funksionale të (mos)kryershmërisë së veprimit (Borer 2005)<sup>305</sup>. Në fakt ne do të mbështetemi kryesisht në studimin e Hale dhe Keyser dhe si më poshtë do të japim alternativet në kalimtarësi për disa nga klasat e foljeve.

Pavarësisht analizës së përdorur, çështja kryesore është nëse konfigurimi i përmendur mbi kalimtarësinë është universal dhe ka të njëjtën shprehje sintaksore për të gjitha gjuhët. Roussou dhe Tsimpli (2005)<sup>306</sup> shprehen se nga ana tjetër, ajo që duket se është “universale” në këtë kontekst është mundësia për “kalimtarësi”, në kuptimin që pozicioni i kundrinorit të realizohet në mënyrë sintaksore. Mënyra se si kjo karakteristikë paraqitet në mënyrë morfosintaksore është si pasojë e variacioneve parametrike (p.sh. përmes një folje ose një elementi eptimor, të tilla si një klitik ose ndoshta të ndajshesave të disa llojeve). Duke e ndjekur këtë mundësi pak më tej, mund të themi se zgjedhja e strukturave të ndryshme mund të ketë një efekt në interpretimet e mundshme që paraqiten.

---

<sup>302</sup> K. Hale, S.J. Keyser, *Some Transitivity Alternations in English*, fq. 606 tërhequr në 07.08.2014 nga <http://www.ehu.es/ojs/index.php/ASJU/article/viewFile/7793/6987>

<sup>303</sup> Nikolaos Lavidas, *Vepër e cituar*, fq. 3

<sup>304</sup> K. Hale, S.J. Keyser. 1986, *Po aty*

<sup>305</sup> H. Borer, *Structuring Sense*, vol. II: *The normal course of events*. Oxford: Oxford University Press, 2005.

<sup>306</sup> Anna Roussou, Ianthi-Maria Tsimpli, *Clitics and Transitivity*, referuar në *Mediterranean Syntax Meeting*, Rodhos, Greqi, 2005, fq. 3

Për të kryer alternimet në kalimtarësi Hale dhe Keyser<sup>307</sup> kanë propozuar rregullin si më poshtë:

(5) *aA----- -aA*

Sipas terminologjisë të përdorur nga Burzio (1981)<sup>308</sup>, një folje do të mbartë karakteristikën [+A] nëse është e aftë të caktojë rasë kallëzore, pra të marrë një kundrinë të drejtë. Nëse një folje nuk mund të caktojë rasë kallëzore, ajo do të mbartë karakteristikën [-A].

Në bazë të këtij përcaktimi Hale dhe Keyser shprehen se një folje e caktuar në leksikon mbart karakteristikën përkatëse [+A] ose [-A]; rregulli sa më lartë tregon se kjo folje mund të ndryshojë kalimtarësinë duke qenë se mund të caktojë rasë kallëzore. Foljet ergative përgjithësisht mbartin vlerën [+A].

Duke u mbështetur në rregullat e mirëvendosura ata<sup>309</sup> përmendin se teoria e rasës do të kërkojë që një folje ergative ose joakuzative [+ A] të marrë një kundrinë dhe teoria theta me parimin e projeksonit do të kërkojë që një rol theta t'i shënjohe kundrinës së foljes (Chomsky, 1981). Parimi i projeksonit të zgjeruar (Chomsky, 1982) kërkon që një folje të ketë domosdoshmërisht edhe një kryefjalë (ose, siç shprehet Williams, (1981) një “argument të jashtëm”). Duke u mbështetur në këto parime do të mund të thellohemi më tej në alternimet në kalimtarësinë e foljeve ergative. Për më tepër këto folje realizohen në të njëjtën kohë duke mbajtur vlerat [+ A] ose [-A] duke ndjekur parimet e përgjithshme të sipërpërmendura<sup>310</sup>.

Për sa i përket gjuhës shqipe (ndër gjuhë të tjera), ne mendojmë se përveç të tjerash produktiviteti në alternimet në kalimtarësi ka të bëjë gjithashtu edhe me një karakteristikë tjetër: përdorimi i kundrinave klitikë. Duke qenë se përdorimi i klitikëve dhe dallimet në formë me karakteristika eptimore është në masë të madhe në gjuhën shqipe, mendojmë se kalimtarësia është e lidhur shumë me këto vendosje strukturore. Kjo e bën ndryshe nga gjuhë të tjera, si anglishtja për shembull, ku mungesa e morfologjisë së formës dhe klitikëve do të çojë në shprehjen e alternimeve të kalimtarësisë përmes përdorimit të elementeve leksikore.

Si më poshtë do të përshkruajmë alternimet në kalimtarësi duke patur parasysh klasat e ndryshme të foljeve.

---

<sup>307</sup> K. Hale, S.J. Keyser, *Some Transitivity Alternations in English*, fq. 606 tërhequr në 07.08.2014 nga <http://www.ehu.es/ojs/index.php/ASJU/article/viewFile/7793/6987>

<sup>308</sup> *Po aty*, referuar nga L. Burzio, 1981, *Intransitive Verbs and Italian Auxiliaries*, Disertacion për mbrojtjen e titullit “Doktor i Shkencave”, M.I.T., Cambridge, Massachusetts

<sup>309</sup> *Po aty*, referuar nga N. Chomsky, 1981, *Lectures on Government and Binding*, Foris, Dordrecht. Dhe N. Chomsky, 1982, *Some Concepts and Consequences of the Theory of Government and Binding*, Foris, Dordrecht. Dhe E. Williams, 1981, *Argument Structure and Morphology*, *The Linguistic Review* 1, fq. 81-114

<sup>310</sup> *Po aty*, fq. 606

### **7.1 Klasat e foljeve dhe alternimet në kalimtarësi**

Në gjuhën shqipe vërehet se disa folje shprehin alternime për sa i përket kuptimit kalimtar. Këtë dukuri e ndeshim në të ashtuquajturat folje joakuzative dhe folje joergative. Kjo dukuri lidhet ngushtë me mënyrën e caktimit të roleve semantike.

Alternimet në kalimtarësi në gjuhën shqipe kushtëzohen nga mënyra e caktimit të roleve semantike dhe vërehen disa faktorë, sidomos diateza vetvetore. Përdorimi i foljeve në diateza të ndryshme lidhet ngushtë me aftësinë e foljeve për të caktuar rasë<sup>311</sup>.

#### **7.1.1 Joakuzativet (Ergativet)**

Një grup i veçantë i sintagmave foljore të shqipes ndonëse marrin vetëm një argument, kanë si kokë një folje jokalimtare në formë veprorë ose joveprorë me kuptim kalimtar. Karakteristikë e sintagmave foljore me këto folje është se ato nuk caktojnë rol semantik të jashtëm, por vetëm rol semantik të brendshëm me kuptimin e pësuesit të veprimin. Për pasojë i vetmi argument tyre është argument i brendshëm, i cili në vend të rasës kallëzore, shprehet me një SE në rasën emërore. P.sh.

(1) *Ai u ul në karrige*

SE *ai*, që i referohet këtij argumenti të brendshëm, nuk mund të jetë në pozicionin e plotësorit, sepse folja *ulet* nuk mund t'i caktojë kësaj SE rasën kallëzore. Kjo është arsyeja që këto folje jokalimtare quhen folje joakuzative. Paaftësia e foljes *ulet* për të caktuar argument të jashtëm nuk e lejon këtë folje që t'i caktojë rasën kallëzore SE që përfaqëson argumentin e brendshëm. SE *ai*, së cilës nuk mund t'i caktohet rasë kallëzore nga folja, përfaqëson argumentin e brendshëm të kësaj foljeje.

Në gjuhën shqipe folje të tilla dalin p.sh. sidomos në diatezën vetvetore (*niset*, etj) dhe shpjegohen si folje që njëkohësisht e kryejnë dhe e pësojnë veprimin. Por ato mund të kenë edhe formën veprorë (letra *arriti*).

Për paraqitjen e foljeve si më poshtë jemi mbështetur kryesisht në studimin e Hale dhe Keyser (1986)<sup>312</sup> dhe pjesa më e madhe e shembujve janë vjelë nga Fjalori i Gjuhës Shqipe (2006)<sup>313</sup>. Rastet më të shpeshta ku gjejmë alternimet sintaksore në kalimtarësi do të jenë me foljet joakuzative si p.sh:

- (2) a. Gota u thye.  
b. Agimi theu gotën.

---

<sup>311</sup> Ludmila Buxheli, *Modelet e caktimit rasor.*, 2006.

<sup>312</sup> K. Hale, S.J. Keyser, *Vepër e cituar*, fq. 607

<sup>313</sup> *Fjalori i Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, 2006

Siç mund të kuptohet edhe nga shembulli, kemi të bëjmë me një folje kalimtare *thyej*, që përdoret si jokalimtare. Argumenti i vetëm në variantin jokalimtar tregon një pjesëmarrës me rolin semantik të pësuesit të veprimt të shprehur nga folja.

Përveç alternimeve që hasen në grupin e foljeve joakuzative do të përmendim gjithashtu edhe rastin e foljeve aktive jokalimtare, joergative, të cilat në përdorimet e tyre të zakonshme janë monadike dhe argumenti i tyre i vetëm mbart funksionin e kryefjalës në sintaksën e fjalisë. Por, ky argument ndryshe nga argumenti i grupit të parë përfaqëson një pjesëmarrës aktiv, pra një veprues/agjent në terminologjinë e marrëdhënieve semantike.

Mekanizmat gjuhësore që janë përgjegjës për alternimet në rastin e fjalive (2) si më lart përfshijnë ndërveprimin e teorisë së rasës dhe teorisë theta. Për më tepër në mënyrë që të realizohet alternimi në një folje si *thyej*, do të duhej që kjo folje t'i mbartë të dyja vlerat [+A] dhe [-A]. Në këtë mënyrë, p.sh. varianti kalimtar i foljes *thyej* në (2b) është [+A], ndërsa variant jokalimtar është [-A]. Ndër folje të tjera të këtij grupi do të përmendim: *lajthit, rastis, rëndon, rij<sub>1</sub>, rilind, rrëfej (me kuptim joakuzativ), rrok, rrotulloj, skadoj, skuq, sterroj, shajtoj, sharrnjej, sharroj<sub>2</sub>, shijoj, shitoj, shkel, shkoj (me kuptim joakuzativ), shkënd, shkrij, shpërthej, shpëtoj, shquaj, shter, shteroj, shterpëroj, shterpoj, shtie, shtoj, shtrëngo, shuaj, shungulloj, tajit, tartaros, teproj, tërboj, tonit, trashëgoj, trazoj, tregoj, tret, trokas, tuboj, tufoj, tuhat, thaj, tharbëtoi, thyej, ujësoj, valoj, vargëzoj, vargoj, vdes, vështroj (me kuptim joakuzativ), vjell, vloy<sub>1</sub>, volit, vuaj, zgjat, ziej* etj.

K. Hale dhe S.J. Keyser shprehen se përgjithësisht foljet joakuzative janë folje monadike me karakteristikën [+A]. Me këtë nënkuptojmë se, ato caktojnë një rol theta të vetëm, pra një temë; ato janë kalimtare në kuptimin teknik të fjalës, pra që mund të caktojnë një rasë kallëzore. Në përdorimin e tyre kalimtar, foljet kalimtare ergative mbajnë vlerën [+A] dhe argumenti temë realizohet në funksionin e kundrines. Ata shtojnë se përveç parimit të caktimit të roleve do të kishim edhe ndikimin e parimit të projekcionit të zgjeruar.

Nën efektin e këtyre dy parimeve strukturës së argumentit të foljes ergative do t'i shtohet edhe roli i vepruesit, e si rrjedhim kjo folje do të realizohet si dyadike. Vetë roli i vepruesit në fjalinë (2b) nuk konsiderohet si pjesë përbërëse e foljes ergative, por ai realizohet si kërkesë e parimeve të gramatikës. Një folje jokalimtare joakuzative (ergative) si në (2a) nuk kërkon të plotësohet me një veprues. Më specifikisht do të shohim foljet që shprehin ndryshim gjendjeje.

#### ***Alternimet në kalimtarësi të foljeve joakuzative që shprehin ndryshim gjendjeje***

Ndër foljet joakuzative që shprehin ndryshim gjendjeje do të përmendim folje të tilla si *avulloj, hap, mbyll, thyej, djersit, qelb, vjell, shkrij, ngrij, vesit, vesoj, pëlcas* etj. me të cilat mund të realizojmë në të njëjtën kohë një sintagmë kalimtare dhe jokalimtare të ilustruara si më poshtë:

- (3) a. *Dera hapet.*

- b. Era *hapi* derën.
- c. Dera u *hap* me forcë nga era.

Struktura ergative (joakuzative) në (3a) realizohet në formën joveprorë JVEP vetvetore *hapet*, ndryshe nga versioni kalimtar në (3b) i realizuar në formën veprorë VEP. Kjo folje në (3a) merr vetëm një argument që shprehet me një SE në rolin semantik të pësuesit ose objektit të veprimit, dhe që nuk mund të marrë rasë kallëzore. Në (3b) kryefjala mund të jetë ose një veprues (nëse është frymor) ose një shkak (nëse është jofrymor). Forma JVEP është gjithashtu e paraqitur në (3c), duke përdorur ndërtimin pësor sepse dalin dy argumentë: *dera*, *era*. SE *era* është zhvendosur për shkak të pasivizimit të foljes *hap*.

Sipas Tsimpli<sup>314</sup>, interpretimi shkakor në (3b) realizohet nga një SE kryefjalë jofrymore (ose nga një sintagmë parafjalore *nga/prej erës* si në (3c). Me fjalë të tjera nuk ka nevojë të mbivendosim një ndërtim të veçantë për interpretimin shkakor; për më tepër interpretimet e ndryshme mund të rrjedhin si pasojë e karakteristikës +/-frymor të kryefjalës. Për sa i përket ndryshimit të gjendjes, Roussou dhe Tsimpli<sup>315</sup> mendojnë se kjo rrjedh si pasojë e faktorit të jashtëm, p.sh. *era ose Agimi*.

Për sa i përket ndërtimit kalimtar në (3b) mund të themi se ky ndërtim paraqet/shpreh një ndryshim gjendjeje të foljeve si pasojë e një shkakut indirekt, të sjellë nga kryefjala, e cila mund të jetë frymore ose jofrymore. Vëmë re se pavarësisht karakteristikës +/-frymor të kryefjalës, ka një tendencë të fortë për interpretim shkakor si p.sh. në rastin: *na djersiti e përpyeta*.

Një karakteristikë tjetër e tyre është realizimi sintaksor i argumentit të brendshëm, fillimisht si një klitik. Në përgjithësi, formimi i një ndërtimi kalimtar me foljet e grupit jokalmimtare joakuzative realizohet në më të shumtën e rasteve me një klitik si në ndërtime të tilla – *më djersiti*. Por, në momentin që përmendet argument i jashtëm, efekti që marrim është ai i një shkakut indirekt por të fuqishëm.

Për ta përmbledhur mund të themi se të gjitha rastet e mësipërme kërkojnë një interpretim shkakor (të fortë ose të dobët) në versionin e tyre kalimtar. Një qasje e tillë mbështetet në numrin e madh të alternimeve kalimtare, të cilat realizohen si pasojë e një shkakut të caktuar. Kjo mund të trajtohet edhe nga aspekte të tjera. Për shembull, mund të themi se foljet tipike kalimtare si “*laj*” apo “*fotografoj*” nuk janë (domosdoshmërisht) të shoqëruara me një veprim shkakor. Në këtë mënyrë, nocionet e shkakut dhe kalimtarësi mund të mbahen të ndara, pavarësisht se kanë lidhje në disa raste. Gjithsesi, në lidhje me këtë aspekt, është e nevojshme të kryen studime më të thelluara për rastet e gjuhës shqipe.

---

<sup>314</sup> Anna Roussou, Ianthi-Maria Tsimpli, *Clitics and Transitivity*, referuar në *Mediterranean Syntax Meeting*, Rodhos, Greqi, 2005, fq. 7

<sup>315</sup> Anna Roussou, Ianthi-Maria Tsimpli, *Po aty*, 2005.

Së dyti, nga materiali i gjuhës shqipe mund të kuptojmë se kalimtarësia mund të paraqitet edhe nga një element eptimor (klitiku), dhe jo (domosdoshmërisht) i realizuar pranë një foljeje që ka nevojë për një interpretim shkakor.

### **7.1.2 Joergativet (Jokalimtare aktive)**

Përveç foljeve jokalmtare me kuptim joakuzativ, në gjuhën shqipe një grup më vete formojnë edhe foljet jokalmtare me kuptim joergativ. Që të dy këta tipa foljesh jokalmtare kanë vetëm një argument të realizuar me një SE në funksionin e kryefjalës në rasën emërore. Dallimi ndërmjet këtyre dy grupeve qëndron në rolin semantik që folja i cakton të vetmit argument. Foljet jokalmtare të tipit joergativ, ndryshe nga folje jokalmtare joakuzative, dallohen kuptimisht sepse argumentit të vetëm i caktojnë rolin semantik të vepruesit.

Pjesa më e madhe e këtyre foljeve tregon lëvizje në kuptimin e gjerë të fjalës. Ashtu si joakuzativet, ato janë përgjithësisht monodiake, por ato ndryshojnë nga joakuzativet sepse argumenti i tyre i vetëm bart rolin semantik të vepruesit<sup>316</sup>.

Megjithatë, nëse do të vendosim folje të këtij grupi sipas rregullit të sipërpërmendur në (5) ku  $aA \rightarrow -aA$ , atëherë do të realizonim variantin kalimtar nga varianti bazë jokalmtar, ku kryefjala të shndërrohej në kundrinë. Kështu, nëse do të merrnim për shembull foljet: *lakmoj, lakoj, leqoj, lëviz, lëvroj, lips, loz, luaj, luftoj, llap, llapëtij, manovroj, mashtroj, mbizotëroj, mbrodh, mendoj, mërgoj, mërzej, mësoj, mësyj, mëshoj, mrizoj, ndaj, ndaloj (me kuptim joergativ), ndez (me kuptim joergativ), ndërroj, ndiej, ndikoj, ndriçoj, ndryshoj, ngel (me kuptim joergativ), ngroh, nis<sub>1</sub>, numëroj, nxitoj, ofshaj, operoj, paguaj, pandeh, parakaloj, paraprij, patrolloj, pëgëj, përcëlloj, përgjëroj, përndrit, përsiat, përralloj, pëshpërit, pështyj, pikturoj, platit, pranoj, predikoj, prek (me kuptim joergativ), premtoj, pres<sub>1</sub>, pres<sub>2</sub>, prij, procedoj, psonis, pshurr, punoj, pyes, qesëndis, qesh, qeveris, qëmtoj, zbres, fluturoj, kaloj, etj.* ato do të paraqiten me karakteristikën [+A] dmth veprues. Kjo do të bënte që këto folje të marrin një argument kundrinë. Nëse u bashkangjitem parimeve të mësipërme edhe parimin e projektimit të zgjeruar atëherë fjalja do të kërkonte të realizohej edhe me një kryefjalë. Pra, zgjidhja për këtë do të ishte një argument i jashtëm duke qenë se argumenti i foljes nuk mund të marrë funksionin e kryefjalës, por të kundrinës, pavarësisht natyrës “vepruese/ agjente”.

- (1) a. Ai *zbriti* nga detyra.
- b. Letra *fluturoi* nga dritarja.
- c. Peri *kaloi* në gjilpërë.

Varianti kalimtar do të paraqitet në fjalitë si më poshtë:

---

<sup>316</sup> K. Hale, S.J. Keyser, *Vepër e cituar*, fq. 609

- (2) a. Atë e *zbritën* nga detyra  
b. E *fluturoi* letrën nga dritarja.  
c. E *kaloj* perin në gjilpërë.

Alternimi në kalimtarësi duket se është produktiv në rastet e foljeve të lëvizjes. Më specifikisht do të shohim si më poshtë foljet joergative që shprehin lëvizje.

***Alternimet në kalimtarësi i foljeve joergative të lëvizjes***

Ndër foljet joergative të shqipes që provojnë kalime të jokalmimtarësisë në kalimtarësi dallohen ato me kuptimin e lëvizjes. K. Hale dhe S.J. Keyser<sup>317</sup> theksojnë se SE në funksionin e kryefjalës dhe të kundrinës në fjalitë (2a,b,c) më lart, u korrespondojnë pjesëmarrësve aktivë në struktura konceptuese sipas kuptimit të foljeve – këto argumente janë të dy “veprues” në kuptimin intuitiv që përcillet nga folja. Kjo rrjedh drejtpërdrejt nga fakti se argumenti i mëparshëm/ bazë kishte natyrë vepruese, si në rastin e (1 a,b,c), e njëjta gjë vlen edhe për argumentin e caktuar, pra një veprues. Të tilla janë: *lako*, *lëviz*, *lëvroj*, *zbres*, *fluturoj*, *kaloj*, *lips*, *loz*, *luaj*, *manovroj*, *mërgoj*, *mësyj*, *mëshoj*, *nis*, *nxitoj*, *parakaloj*, *paraprij*, *patrulloj*, *prek* (me kuptim joergativ), *prij* etj.

Këto folje ndryshojnë nga varianti kalimtar i foljeve joakuzative, nëse këto të fundit do të realizojnë një kundrinë, ajo do të jetë plotësisht pasive. Nëse do ta ilustronim idenë me shembullin si më poshtë, pra me një folje joakuzative:

- (3) E *rrëshqas* vajzën në dysheme.

Pavarësisht se në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (2006), folja *rrëshqas* nuk jepet me shembuj në kalimtare, përsëri është me vlerë të përmendet duke qenë se raste të tilla janë të përdorshme në gjuhën e përditshme shqipe. Në këtë rast SE kundrinë me rolin semantik të pësuesit, pavarësisht faktit që pësuesi është një frymor ose më saktë ka karakteristikën [+ HUMAN], e pavarësisht që mund të kuptohet/përcillet si aktive në fjalinë jokalmimtare përkatëse:

- (4) a. Vajza *rrëshqiti* në dysheme  
b. Makina *rrëshqiti* në rrugën me lagështirë.

Natyra pasive e argumentit kundrinë në fjalinë (4) rrjedh si pasojë e karakteristikave leksikore bazë të foljeve joakuzative – argumenti i tyre i vetëm është një temë, jo një veprues. Në këtë mënyrë, p.sh. fjalia (4) nuk mund të kishte kuptim nëse thoshim se \**Vajza rrëshkiti veten në dysheme*. Ajo që mund të shpjegohet është se pse kryefjala përcjell një interpretim veprues në (4)?

Në vazhdim Hale dhe Keyser do të shprehin se veprimi/aksioni në këtë rast është një karakteristikë e brendshme e kryefjalës. Për sa i përket fjalisë (4a) kryefjala ka

---

<sup>317</sup> *Po aty*,



karakteristikën [+ FRYMOR/HUMAN], pra një veprues i zakonshëm. Ky kombinim faktorësh të jep përshtypjen ose favorizon një interpretim veprues. Megjithatë pavarësisht këtij interpretimi, kryefjala në (4a) është në thelb një temë, jo një veprues.

Duke u bazuar në studimin e Hale dhe Keyser (1993, 2002), Roussou dhe Tsimpli<sup>318</sup> do të theksonin se foljet jokalmtare joergative janë version i fshehur i foljeve kalimtare me një kundrinor, i cili mund të përfshihet në bazën leksikore të foljes. Në Gramatikën e Akademisë këto lloj kundrinash quhen kundrina tautologjike<sup>319</sup> dhe në ligjërimin popullor është shumë i kufizuar numri i foljeve jokalmtare që mund të marrin një kundrinë të tillë si p.sh. *fle, jetoj, flas, veroj, luftoj, ëndërroj* e ndonjë tjetër. Sipas kësaj qasjeje, foljet e kësaj klase nuk janë me të vërtetë jokalmtare. Mundësia e përfshirjes së një kundrinori është paraqitur në shembullin si më poshtë:

- (5) a. *Kërçyen* (një valle).  
b. E *kërçyen* (vallen) / (me Agimin)

Megjithatë në (5b) aty ku kundrina realizohet nga klitiku / trajta e shkurtër kallëzore, vëmendja nuk është domosdoshmërisht te kundrina e drejtë e nënkuptuar, por mund të jetë mbi një kundrinë të zhdrejtë me parafjalë (*me Agimin*).

I njëjti model mund të gjendet me folje të tjera të kësaj klase, të tilla si *këndo, udhëtoj, shëtis, qesh, kërcej etj.* Është e qartë se kundrinorët e drejtë janë në çdo rast në dispozicion të kuptimit të foljes përmes ndërvendosjes/nënkuptimit që i bën vetë folja, lind një problem me kundrinorët e drejtë me parafjalë, të cilët nuk mund të nënkuptohen, sepse janë thjesht plotës.

Alternimet në kalimtarësi mund të jenë me variacione të ndryshme (që kanë lidhje me të dyja format joakuzative dhe joergative), duke sugjeruar se një pozicion sintaksor i lidhur me kalimtarësinë është në parim, i mundshëm, d.m.th. mund të realizohet në mënyrë sintaksore. Në studimet e fundit, kjo është formuluar si *Kërkesë e Kalimtarësisë (Transitivity Requirement)*<sup>320</sup>. Kërkesa e Kalimtarësisë përngjason me Parimin e Projektimit të Zgjeruar dhe është ngushtësisht e lidhur me karakteristikat e foljes për realizimin e kundrinorit<sup>321</sup>.

Raste të alternimit të jokalmtarësisë në kalimtarësi e ndeshime edhe në folje të tjera jokalmtare joergative të cilat si kalimtare mund të gjenden me kundrinorë të tjerë jo të nënkuptuar si në rastin e mëposhtëm:

- (6) a. Unë **qesha** me të madhe (joergative)  
b. (E) *qesha* (djalin). (kalimtare)

---

<sup>318</sup> Anna Roussou, Ianthi-Maria Tsimpli, 2005, *Clitics and Transitivity*, Referuar në *Mediterranean Syntax Meeting*, Rodhos, Greqi fq. 2

<sup>319</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe, II*, 2002, fq. 254

<sup>320</sup> Yves Roberge, *Transitivity Requirement Effects and the EPP* tërhequr në 27.08.2014 nga <http://homes.chass.utoronto.ca/~roberge/pdf/WECOL02.pdf>

<sup>321</sup> A. Roussou ... *Vepër e cituar*.

Folja *qesh* në (6b) ka si kundrinor të shprehur ose të nënkuptuar, një SE *djalin*. Në këtë rast folja *qesh* është sinonim me foljet *tallem*, *përqesh* – pra kemi një përdorim tjetër kuptimor. Një tjetër fakt që duhet përmendur ka të bëjë me realizimin sintaksor të kundrinorit si klitik; një rast të ngjashëm e gjejmë edhe në shembujt me kundrinorë përjetues (KndP)/temë të cilët shprehin një ndryshim të brendshëm të gjendjes. Nga shembulli i dhënë më lart mund të bëjmë gjithashtu edhe një tjetër vëzhgim për sa i përket interpretimit të klitikut kallëzor. Le ta ilustrojmë me shembujt si më poshtë:

- (7) a. E *shëtite* mendjen.  
b. E *shëtite* vajzën.  
a.1 *Shëtite* mendjen.  
b.1 *Shëtite* vajzën.

Nga shembujt e mësipërm e duke u bazuar në studimin e Roussou dhe Tsimpli<sup>322</sup> për ndërtime të ngjashme në greqisht, vlerësojmë se realizimi ose mungesa e klitikut kallëzor edhe në gjuhën shqipe sjell ndryshime të ndjeshme në kuptimin e fjalisë për sa i përket kryerjes ose mos kryerjes së veprimit. Pavarësisht faktit nëse kundrinori i shprehur është frymor ose jofrymor, realizimi i klitikut në (7 a/b) e bën kuptimin e shprehur nga folja të përfunduar/ të kryer, nga ana tjetër mungesa e klitikut kallëzor në (7 a.1/b.1) e bën kuptimin e shprehur nga folja të papërfunduar/të pakryer, pavarësisht kohës dhe mënyrës në të cilën zhvillohet veprimi.

## **7.2 Ndërtimet me dy plotësorë**

Për sa u përket foljeve dyadike që mbartin rolet theta të veprues – pësues, ose veprues – temë kemi rastin e dekalimtarësisë d.m.th kur tipi i foljeve kalimtare është baza për kalimtarësi, si më poshtë mund të përmendim disa nga foljet si p.sh. *batis*, *brej*, *brumbulloj*, *buthtoj*, *cekoj*<sub>1</sub>, *cërit*, *cirkoj*, *çaj*, *çaprashit*, *çartoj*, *çel*, *çem*, *çepelit*, *çikëloj*, *çliroj*, *çokanis*, *dalloj*, *datoj*<sub>2</sub>, *demonstroj*, *dështoj*, *djallëzoj*, *dredh*, *dreqnoj*, *pres*, *ndaj*, *mbush*, *mbledh*, *vras*, *vendos*, *shkarkoj*, *shkel*, *shkelmoj*, *shkrep*, etj. përfshijnë dy pjesëmarrës, një aktiv dhe tjetri pasiv dhe vetëkuptohet që caktohen dy role theta përkatësisht.

Pjesëmarrësi aktiv përfaqësohet si zakonisht nga roli theta i vepruesit dhe pjesëmarrësi pasiv përfaqësohet nga roli theta i pësuesit ose temës. Këto folje mbartin karakteristikën [+A] dhe, në bazë të parimeve të mirëvendosura, roli i vepruesit realizohet në funksionin e kryefjalës dhe roli i objektit të veprimit, temës, në funksionin e

---

<sup>322</sup> *Po aty*, fq. 11-12

kundrinës<sup>323</sup>. Le ta ilustron teorinë e rregullit të mësipërm (5) pra  $aA \rightarrow -aA$ , me rastin e foljes “*pres*”, p.sh:

(1) Agimi *preu* bukën me lehtësi.

Në fakt, folje të tilla mund të realizohen në alternime të kalimtarësisë; si më poshtë realizohet kjo folje në variantin jokalimtar:

(2) Kjo bukë *pritet* me lehtësi (nga Agimi).

Zbatimi i rregullit për alternimet në kalimtarësi të Hale dhe Keyser<sup>324</sup>  $aA \rightarrow -aA$ , për foljen “*pres*” e shndërron këtë folje në [- A]. Në këtë mënyrë ajo nuk mbetet dyadike për faktin se nuk cakton dy role theta. Ajo që ndodh, në këtë rast është se roli theta i vepruesit është hequr nga struktura argumentore e foljes. Në këtë rast kemi procesin e dekalimtarësisë ku sintagma parafjalore SP nga Agimi nuk është element i domosdoshëm i strukturës argumentore të foljes *pritet* në fjalinë (2).

Manzini<sup>325</sup> shprehet se në rastin e këtyre foljeve kemi të qartë “vepruesin e nënkuptuar”. Ndërtime të tilla e kanë të përfshirë veprimin/aksionin, në kuptimin që struktura konceptuale e përcaktuar nga folja nënkupton një pjesëmarrës aktiv. Në këtë mënyrë, kuptimi i foljes “*vras*” në (3a) si më poshtë dallon nga kuptimi i foljes “*ngordh*” në (3b):

(3) a. Këto pula *vriten* me lehtësi  
b. Këto pula *ngordhin* shpejt.

Pjesëmarrësi i shprehur nga folja “*vras*” nënkupton një veprues, ndërsa pjesëmarrësi i shprehur nga folja “*ngordh*” nuk shpreh një të tillë. Në këtë mënyrë, përshtypja që krijohet se nga folja “*vras*” në fjalinë (3a) nuk caktohet roli theta i vepruesit nuk do të thotë se vepruesi ose pjesëmarrësi aktiv në strukturën konceptuale të foljes mungon. Hale dhe Keyser shtojnë se në këto ndërtime, pavarësisht se folja nuk e cakton rolin e vepruesit, në strukturën e ngjarjes së kësaj foljeje nënkuptohet që një veprues është përgjegjës për veprim. Për më tepër folja si njësi leksikore nuk përfshin vetëm strukturën argumentore të saj, por gjithashtu edhe “strukturën leksikore konceptuale” (*lexical conceptual structure*)<sup>326</sup> të kësaj foljeje, që ka të bëjë me tërësinë kuptimore të fjalës.

(4) Këto pula *vriten* me lehtësi nga njerëzit.

---

<sup>323</sup> K. Hale ... *Vepër e cituar*, fq. 610-611

<sup>324</sup> K. Hale, S.J. Keyser, *Some Transitivity Alternations in English*, fq. 606 tërhequr në 07.08.2014 nga <http://www.ehu.es/ojs/index.php/ASJU/article/viewFile/7793/6987>

<sup>325</sup> *Po aty* referuar nga Keyser, S.J., T. Roeper, 1984 "On the Middle and Ergative Constructions in English", *Linguistic Inquiry* fq. 407

<sup>326</sup> *Po aty*, fq. 612

## KREU VIII

### SINTAGMA FOLJORE ME KLITIKE

#### *8.1 Një vështrim i përgjithshëm i klitikëve në shqipe*

Buxheli<sup>327</sup> shprehet se klitikët në gjuhësinë bashkëkohore shihen si elemente hibride, teorikisht mjaft të ndërlikuara për t'u shpjeguar, sepse qëndrojnë midis përemrit dhe ndajshitesës formëformuese. Kështu që me gjithë përpjekjet për të krijuar një teori të vetme, për interpretimin e tyre, mendimet janë nga më të ndryshmet, qoftë për pozicionin strukturor, qoftë për kuptimin, qoftë edhe për funksionin<sup>328</sup>. Një ndër problemet më të diskutueshme, që shfaqet edhe në gjuhën shqipe (ndër të tjera), është interpretimi i tyre ose si mjete përshtatjeje ose si sintagma determinative që përfaqësojnë një argument. Kështu, në shqipe<sup>329</sup>, prania e kundrinës së drejtë dhe të zhdrejtë pa parafjalë shenjohet zakonisht nga trajta e shkurtër e përemrit vetor, që vihet para ose pas foljes, në kushte të caktuara edhe midis temës e mbaresës vetore të foljes.

Sipas Demirajt<sup>330</sup> faktori kryesor, që i ka dhënë shkas rimarrjes së kundrinave të shprehura nëpërmjet trajtave të shkurtra të përemrave vetorë të vetës së tretë, pra e thënë ndryshe klitikëve, në zanafillë do të ketë qenë dëshira e folësit për ta konkretizuar e për ta përcaktuar më mirë përmbajtjen kuptimore të atyre përemrave, të cilët kanë një kuptim

---

<sup>327</sup> Ludmila Buxheli, *Foljet Njëvetore në Gjuhën e Sotme Shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2011, fq. 157, referuar Cecile De Cat, French subject clitics are not agreement markers, 2005, *Lingua* 115:1195-1219 (Elsevier – or in PDF), f. 26.

<sup>328</sup> *Po aty* referuar nga E. Agnostopoulou, Clitic doubling, PDF f. 519-581; A. Cardinaletti, Clitic position in Italian, (2005); Smith, J. Ch. (1992) Circumstantial complements and direct object in the romance languages: configuration, Case, and thematic structure. Në *Linguistic Models*; 16, Thematic structure: its role in grammar, (I.M.Roca ed. Berlin; New York, f. 293-32; A. Spencer, *Morphological Theories*, f. 437, 441; Cecile De Cat, French subject clitics are not agreement markers.

<sup>329</sup> *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Vëllimi I – Sintaksa, Tiranë, 2002, fq. 258

<sup>330</sup> Shaban Demiraj, *Gjuhësi Ballkanike*, Libraria Digitale “Dielli”, tërhequr në 02.09.2014 nga <http://www.dielli.net/pdf/historia/GjuhesiBallkanike.pdf>, fq. 122

shumë të pacaktuar. Për më tepër ai shprehet se duke qenë se rimarrja e kundrinave të shprehura nëpërmjet formave të patheksuara të përemrave vetorë të dy vetave të para është përfutur në kushte sintaksore të ndryshme nga ato të rimarrjes së vetorëve të vetës së tretë, vetvetiu lind pyetja nëse këto dy dukuri janë përfutur në mënyrë të pavarur dhe në kohë të ndryshme, apo janë përfutur në të njëjtën kohë si shfaqje të një faktori të përbashkët.

Në rastin e parë do të duhej të përcaktohej edhe se cila nga këto dy dukuri është më e hershme dhe nëse ka ushtruar ndonjë ndikim në shfaqjen e dukurisë tjetër. Mungesa e një dokumentimi shkrimor më të hershëm të gjuhës shqipe e bën shumë të vështirë sqarimin e këtyre pyetjeve. Megjithatë, duke u mbështetur në të dhënat e shqipes së dokumentuar, mund të jepen disa mendime edhe për këto pyetje.

Në studimin e tij Demiraj shprehet se ka mjaft të ngjarë që këto dy dukuri të mos kenë zënë fill në të njëjtën kohë. Por cila prej tyre është përfutur më parë, kjo është shumë e vështirë të përcaktohet me saktësi. Po të nisemi nga përgjithësimi më i hershëm i rimarrjes së kundrinave të shprehura nëpërmjet vetorëve të dy vetave të para, gjë që ka shërbyer si një mjet ridondance për të vënë në dukje sa më shumë remën (pra, kur rimarrja e kundrinës së drejtë shprehet me anë të formave të theksuara të përemrave vetorë të dy vetave të para), atëherë mund të anohet, natyrisht me rezervë, nga mendimi që pikërisht këtu është shfaqur më parë kjo dukuri.

Ai vazhdon se faktori kryesor, që i ka dhënë shkas rimarrjes së kundrinave të shprehura nëpërmjet përemrave vetorë të dy vetave të para, me sa duket, ka qenë synimi i folësit për të vënë në dukje sa më shumë këtu gjymtyrën plotësuese kryesore të kallëzuesit, kur ajo përbënte gjënë e re të kumtimit, remën. Por rruga se si është përfutur në zanafillë kjo dukuri, nuk është e qartë, duke qenë se në gjendjen e sotme të dijes nuk mund të thuhet asgjë me siguri se në ç'topikë ajo është shfaqur në krye të herës. Po të kihet parasysh fakti që në ndërtimet e zakonshme (jo-emfatike) rema nuk vendoset nga fillimi i fjalisë, si edhe fakti tjetër që inversioni në gjuhën shqipe përdoret jo rrallë edhe për arsye emfatike, atëherë mund të mendohet që dukuria në shqyrtim është përfutur në fillim nëpër fjali emfatike, ku kundrinat vendoseshin para foljes kallëzues. Në të mirë të këtij mendimi do të dëshmonte edhe fakti që tek autorët tanë më të vjetër (Buzuku, Budi, Matrënga) rastet e rimarrjes së kundrinave të shprehura me anë të përemrave vetorë të dy vetave të para ndeshen më fort pikërisht në këtë topikë.

Megjithatë, nuk duhet përjashtuar mundësia që një dukuri e tillë të jetë përfutur në fillim edhe nëpër fjali, ku kundrina vendosej rregullisht pas foljes kallëzues, si p.sh. nëpër fjali urdhërore dhe pyetëse. Sido që të ketë qenë zanafilla e kësaj dukurie sintaksore, në këtë rast kemi të bëjmë me një nga pasojat e prirjes relativisht të hershme të gjuhës shqipe për një përdorim ridondant të mjeteve gjuhësore.

## **8.2 Klitikët në sintagmën foljore**

Siç e përmendëm edhe në kapitujt e mësipërm alternimet e kalimtarësisë mund të paraqiten në mënyra sintaksore të ndryshme, në varësi të qasjes së ndjekur në lidhje me strukturën argumentore. Për shembull, në qasjen konfiguruese të Hale dhe Keyser (1993, 2002)<sup>331</sup>, struktura argumentore është pjesë e projeksionit ose projeksioneve leksikore të foljes. Në rastin e një foljeje si *thyej*, struktura jokalimtare (ergative) përbëhet nga një kokë foljore dhe nga argumenti i brendshëm (i cili lëviz/zhvendoset më pas në pozicionin e kundrinorit për të realizuar një alternativ kalimtar). Kur *thyej* përdoret si folje kalimtare, struktura leksikore e foljes – F, shtresëzohet nën një tjetër nivel F (F1); kjo i jep mundësi të realizojë edhe një tjetër argument duke e lënë argumentin e mëparshëm (tashmë i realizuar si kundrinor) *in situ*; dy konfigurimet e mundshme janë paraqitur si më poshtë:

- (1) a. [SE era [SF F [SE gotën [F thyen ]]]]] (Kalimtare)
- b. [SE gota [SF F [SE gota E [F thyhet ]]]]] (Jokalimtare)

Duke qenë se struktura argumentore si më lart përcaktohet si pjesë e projeksionit leksikor të foljes, në një rast të tillë karakteristikat eptimore – ndër të tjera edhe klitikët, mbartin një rol të rëndësishëm në përcaktimin e kalimtarësisë, duke qenë se ato paraqiten jashtë fushës leksikore<sup>332</sup>.

Nëse analizojmë pozicionin e argumentit kundrinor, i cili është realizuar fomalisht, do të kemi parasysh analizën e bërë nga Sportiche (1995)<sup>333</sup> por gjithashtu edhe nga Manzini dhe Savoia (2004, 2007)<sup>334</sup>; këto qasje trajtojnë projeksione të klitikëve që i referohen strukturës argumentore. Manzini dhe Savoia në veçanti përqendrohen në karakteristikat morfologjike të klitikëve dhe si këto ndërthurren me kategoritë sintaksore (dhe pozicionet) në strukturën e sintagmës.

Në analizën e tyre, pozicioni i klitikut është vendosur në mënyrë hierarkike duke zenë një vend të caktuar. Vendi në i lartë është caktuar për klitikun e kryefjalës i cila shënohet me D (ose EPP duke iu referuar Chomskit (1995)). Vendi më i ulët i caktohet klitikut të kundrinorit (sipas tyre i shënuar me N); pozicionet në mes të tyre rezervohen për plotësit Lokative (Loc), Veta (1rë /2të), Shumësi (Q), apo klitikë të veçantë (R).

---

<sup>331</sup> Hale, K., S.J. Keyser. *On argument structure and the lexical expression of syntactic relations*. 1993. Në K. Hale, S.J. Keyser, (eds.), *A view from Building 20*. Cambridge, MA: MIT Press, fq. 53-109. Dhe K. Hale, S.J. Keyser. *Prolegomenon to a theory of argument structure*. Cambridge, MA: MIT Press, 2002.

<sup>332</sup> Anna Roussou, Ianthi-Maria Tsimpli, *Clitics and Transitivity*, Mbajtur në *Mediterranean Syntax Meeting*, Rodhos, Greqi, 2005, fq. 17 version PDF


<sup>333</sup> Po aty referuar nga Sportiche, D. *Clitic constructions*. Në Rooryck, J. & Zaring, L. (eds.), *Phrase Structure and the lexicon*. Dordrecht: Kluwer, 1995, fq. 213-276

<sup>334</sup> Po aty referuar nga Manzini, M.R., L. Savoia. *A unification of morphology and syntax. Investigations into Romance and Albanian dialects*. London: Routledge, 2007.

Duke ndjekur këta gjuhëtarë Roussou dhe Tsimpli (2006)<sup>335</sup> e kufizojnë vëmendjen në pozicionet e kryefjalës si argument i jashtëm dhe të kundrinorit si argument i brendshëm. Për lehtësi paraqitjeje këto pozicione janë emërtuar CL1 dhe CL2 përkatësisht, të paraqitura si më poshtë në (2a): (2b) është vendosja e klitikut në analizën e bërë nga Manzini dhe Savoia (2004, 2007):

- (2) a. [ CL1 – [ CL2 ]  
b. [ D – [R – Q – P – Loc – N ]

Gjithashtu për ta shprehur më qartë pozicionin e klitikut të realizuar në sintagmë e paraqesim në pemën<sup>336</sup> si më poshtë:



Pema 1: Pema strukturore me klitikë

Roussou dhe Tsimpli<sup>337</sup> shprehen se pozicionet e klitikëve mund të leksikalizohen nga sintagma me forma të plota, në këtë mënyrë sigurojnë të dhëna edhe për variacionet në rendin e fjalëve në fjali. Sipas kësaj qasjeje, lidhja e foljes me seicilin nga pozicionet e klitikëve sjell edhe karakterizimin aspektor (veprim i përfunduar/ i papërfunduar) të këtij të fundit, duke na drejtuar drejt interpretimeve kuptimore në lidhje me karakteristikat leksikore të foljes.

Duke pasur parasysh analizën e mësipërme, do të trajtojmë karakteristikat e klitikut kundrinor në shqip dhe rolin e tij në alternimet në kalimtarësi. Gjuha shqipe nuk ka klitikë për të shprehur kryefjalën dhe si rrjedhim mbeten vetëm dy alternativa për D (ose CL1): ose do të jetë e leksikalizuar nga një formë e plotë ose do të mbetet e paeralizuar. Kjo e fundit është e lidhur me natyrën pro-drop të shqipes, duke qenë se marrëveshja me foljes i siguron në çdo rast një realizim indirekt të pozicionit të kryefjalës.

<sup>335</sup> Anna Roussou, Ianthi-Maria Tsimpli, *On Greek VSO again!* Journal of Linguistics 42: 2006, fq. 317-354

<sup>336</sup> Elena Anagnostopoulou, *Clitic doubling*, BCTI 14, 2005, fq. 532

<sup>337</sup> Anna Roussou, Ianthi-Maria Tsimpli, *Clitics and Transitivity*, Mbajtur në *Mediterranean Syntax Meeting*, Rodhos, Greqi fq. 2005, 19 version PDF

Për sa i përket ndërtimit të tyre (specifikimit leksikor), klitiku kundrinor mund të identifikohet si element D. Por nga ana tjetër ato shkrihen në CL2, në pozicionin që lidhet me argumentin e brendshëm të foljes, dhe në këtë mënyrë ndryshe nga CL1 nuk i afrohet dhe aq pozicionit D. Mund të shtojmë më tej se kombinimi i specifikimeve të tyre leksikore (struktura e brendshme) dhe shpërndarja e jashtme i lejon ata të kenë një status të dyfishtë, pra si D dhe si N: ata madje mund të vendosen në një formë komplekse të foljes, si në rastin e sintagmave frazeologjike, ku ato nuk kanë karakteristika referenciale. Sipas kësaj qasjeje mund të themi se shkrirja në klitik vs. formë e plotë mund të sjellin efekte të ndryshme sintaksore dhe interpretuese.

Gjithashtu idenë mund ta mbështesim edhe në qasjen e ngjashme të sjellë nga Dechaine dhe Wiltschko (2002)<sup>338</sup>, të cilët shprehen se klitikët e kallëzores kanë një status të ndërmjetëm dhe sillen në të njëjtën kohë si argument ose si plotës (SE).

A. Spencer<sup>339</sup> vëren se për një pjesë të studiuesve trajta e shkurtër e dhanores është një formë përshtatjeje. Sipas Gramatikës së Akademisë së Shkencave<sup>340</sup> kjo trajtë e shkurtër, si gjithë trajtat e shkurtra, interpretohet si një fjalë e patheksuar, që nga ana sintaksore në fjali shërben si shënjuese e kundrinës së zhdrejtë.

Për Buxhelin<sup>341</sup> lënda gjuhësore e shqipes tregon se trajtat e shkurtra më/të/i/na/ju/u në ndërtimet e tipit *më flihet* shërbejnë si mjete përshtatjeje në dy drejtime: nga njëra anë shërbejnë si treguese të përshtatjes anaforike, sepse kuptimisht interpretohen nëpërmjet emrit në dhanore, nga ana tjetër shërbejnë si treguese të përshtatjes gramatikore me vetën, numrin dhe rasën e kryefjalës logjike, të shprehur me një SE koka e së cilës mund të jetë, sipas rastit, emër ose përemër vetor në rasën dhanore.

Buxheli vazhdon se interpretimi kuptimor i këtyre klitikëve nga emri në dhanore e bën të mundshëm pranimin e tyre si argument foljor. Karakteristikë e foljeve të tipit *më flihet* është paraqitja e personalizuar e veprimit të emërtuar prej tyre, gjë që mundësohet nëpërmjet emrit/përemrit vetor me ndihmën e trajtës së shkurtër që përshtatet gramatikisht me emrin ose përemrin vetor, por pa u përshtatur në asnjë tipar gramatikor me foljen, e cila mbetet gjithmonë në vetën e tretë njëjës. Në strukturat me foljet e tipit (*mua*) *më flihet* SE me emrin në dhanore, i cili ka tiparin [+HUMAN], si bartës i një roli semantik të caktuar dhe si argument foljor, mund të bjerë d.m.th. të përfaqësojë një pro-drop, nëse nuk ka nevojë të theksohet kur bëhet i qartë nga situata ose konteksti, kurse trajta e shkurtër, është gjithmonë e pranishme si element i domosdoshëm, për të treguar praninë e kryefjalës logjike që ka rënë. Kjo do të thotë se trajta shkurtër në dhanore ka funksionin e interpretueses kuptimore të kësaj kryefjale.

Megjithatë, në foljet e tipit *më rrihet*, prania e emrit në dhanore së bashku me trajtën e shkurtër nuk mendojmë se nënkupton që folja *flihet* në këto raste cakton dy

---

<sup>338</sup> Po aty referuar nga Dechaine, R.-M. & M. Wiltschko. 2002. *Decomposing pronouns*. *Linguistic Inquiry* 33: 409-442

<sup>339</sup> A. Spencer, *Morphological Theory*, fq. 437, 441

<sup>340</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe I*, 2002, fq. 222-223; *Gramatika e gjuhës shqipe II*, 2002, fq. 258.

<sup>341</sup> Ludmila Buxheli, *Foljet Njëvetore në Gjuhën e Sotme Shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2011, fq. 157-158



argumente e dy role semantike, një për SE *mua* dhe një për klitikun *më*. Arsyeja është se folja asnjëherë nuk mund të caktojë të njëjtin rol semantik në dy argumente të ndryshme. Nëse trajta e shkurtër *më* do të merrej si argument më vete, e për pasojë folja *flihet* t'i caktonte asaj një rol semantik, ky rol semantik do të duhej të ishte i ndryshëm nga roli semantik i përemrit *unë/mua*, ashtu siç ndodh p.sh. me përemrat anaforikë. Krahaso p.sh.

(1) **Petríti dëmtoi veten.**

Në këtë fjali SE *Petríti* interpreton kuptimisht përemrin anaforik *veten*. Megjithatë, të dyja këto sintagma emërore, shërbejnë si dy argumente të veçanta të foljes *dëmtoj*, sepse bartin dy role semantike të ndryshme, përkatësisht të vepruesit (SE Petríti) dhe të pësuesit (veten).

Kjo dukuri nuk ndeshet në foljet e tipit *më flihet*. Trajtat e shkurtra të ndërtimeve të tipit *më flihet* ndonëse shërbejnë si shenjuese të përshtatjes anaforike me emrin në dhanore, ndryshe nga përemrat anaforikë, nuk mund të jenë argumente foljore, sepse kanë të njëjtin rol semantik me emrin të cilit i referohen. Kuptimisht këto elemente kanë ngjashmëri me përemrat që shoqërojnë emrat si fjalë përcaktuese dhe që interpretohen kuptimisht prej tyre. Krahaso p.sh. *ky djalë, kjo vajzë*.

Nga ana tjetër, ashtu si mbaresat vetore të foljeve punoj, punon, punojmë etj., të cilat janë shenjuese gramatikore të përshtatjes në vetë, numër dhe rasë me kryefjalën në rasën emërore, këto trajta të shkurtra kanë ngjashmëri edhe me morfemat ndajshesore formëformuese foljore, si mjete të përshtatjes gramatikore në vetë, numër dhe rasë.

### **8.2.1 Ergativet dhe foljet që shprehin përjetim: roli i klitikut**

Duke u bazuar kryesisht në studimin e Roussou dhe Tsimpli<sup>342</sup> do të trajtojmë si më poshtë rolin sintaksor të klitikut në alternimet në kalimtarësi duke u përqëndruar kryesisht në format ergative. Duhet të kemi parasysh se në bazë të semantikës së ngjarjeve ka raste kur klitiku është i domosdoshëm dhe ka të tjera ku ai shërben si plotës për të përforcuar rolin e argumentit të brendshëm të shprehur me formë të plotë kundrinori.

Roussou dhe Tsimpli shprehin se nëse marrim parasysh alternimet shkakore për foljet që ndryshojnë gjendje do të shohim se si folje që plotësohen vetëm me një argument, ato e vendosin këtë të fundit në pozicionin e kryefjalës (CL1). Duke qenë se gjuha shqipe është një gjuhë pro-drop, SE shpesh nuk është e shprehur fonetkisht, meqë karakteristikat e foljes mbarten në çdo rast nga marrëveshja e mbaresë - folje. Me fjalë të tjera, CL1 është e realizuar në mënyrë indirekte si pjesë e eptimit foljor. Në rastin e përdorimit të tyre si folje me dy argument, këto të fundit i shfrytëzojnë të dyja pozicionet

---

<sup>342</sup> Anna Roussou... *Vepër e cituar*, fq. 20

CL: CL1 për kryefjalën dhe CL2 për kundrinorin; ky i fundit mund të realizohet si formë e plotë ose si klitik.

Duke risjellë edhe njëherë sistemin e Borer-it<sup>343</sup>, mund të themi se dy strukturat e mundshme për klasën e foljeve *thyej* janë si më poshtë: në versionin jokalimtar, dhe në versionin kalimtar. Pra mund të themi se, në versionin jokalimtar, “*xhami u thye*”, argumenti i vetëm, SE e realizuar si kryefjalë formon një varësi me foljen. Nëse e interpretojmë në të njëjtën kohë si “origjinë” dhe si “kryefjalë”, mund të themi se me foljen e dhënë një SE e vetme mjafton për të leksikalizuar të dyja CL1 dhe CL2. Nëse kemi të pranishme një tjetër SE, atëherë të dyja pozicionet interpretohen leksikalisht si të pavarura, siç është në fakt rasti i versionit kalimtar, p.sh. *Agimi theu xhamin*:

- (1) a. [CL1 xhami [CL2 (~~x~~hami) [F thye]]] (Jokalimtare)  
b. [CL1 Agimi [CL 2 xhamin [F e theu]]] (Kalimtare)

Në çdo rast, ideja është që CL2 është i realizuar meqë kuptimi leksikor i këtyre foljeve kërkon projektimin e një argumenti të brendshëm.

Çështja tjetër është që në formimin e ndërtimit kalimtar vetë sintaksa e fjalisë kërkon që të shprehë karakteristikat formale që janë të nevojshme për të treguar që CL2 mund të leksikalizohet në mënyrë të pavarur (realizimi minimal). Me fjalë të tjera, aktivizimi i pozicioneve përkatëse përcaktohet në mënyrë eptimore. Duke qenë se klitikët janë shprehje të karakteristikave formale, ngrihet pyetja se si përcaktohet formalisht kalimtarësia.

Siç e përmendëm edhe më përpara foljet e përjetimit kanë gjithashtu si kryefjalë një sintagmë emërore SE që bart rolin semantik të përjetuesit të veprimit, dhe në fakt mendohet se këto folje mund të paraqiten vetëm kështu duke qenë se ato shprehin një gjendje psikologjike të parashikuar për kryefjalën. Nëse Anagnostopoulou (1999)<sup>344</sup> ka të drejtë në komentin e bërë se kundrinorët përjetues janë një version i veçantë i kryefjalëve, atëherë mund të kemi shpjegimin se përse klitikët duhet të përdoren. Për më tepër meqë CL1 leksikalizohet në mënyrë të pavarur, na mbetet që CL2 të plotësohet me praninë e klitikut.

Ne mendojmë se përdorimi i klitikëve mund të shihet si pjesë e mbetur e një ndërtimi të mëparshëm/të përmendur me dy pjesë. Nga ana tjetër, në ato raste kur shtimi i një argumenti të brendshëm është një risi, përdorimi i një klitiku është hapi i parë drejt shprehjes sintaksore të një ndërtimi kalimtar.

### **8.2.2 Foljet joergative jokalimtare**

---

<sup>343</sup> *Po aty*

<sup>344</sup> *Po aty* referuar nga Anagnostopoulou, E. 1999. *On experiencers*. Në Alexiadou, A., Horrocks, G. Stavrou, M. (eds.), *Studies in Greek syntax*. Dordrecht: Kluwer, fq. 67-93

Ka dy çështje që duhen trajtuar për sa i përket kësaj klase. E para ka të bëjë me realizimin e klitikut në gjuhë si shqipja, në ndryshim nga anglishtja. Nëse një kundrinor realizohet si klitik, ka mundësinë të shoqërohet me referentë të ndryshëm. Në rastin e foljeve jokalmtare joergative, p.sh realizmi i klitikut në rastin e foljes *e kërcyen*, interpretimi do të jetë ai i kundrinorit të nënkuptuar, d.m.th *e kërcyen poganishten (vallen)*. Çështja e dytë ka të bëjë me përdorimin e shpeshtë të kundrinorit të nënkuptuar në anglisht, ndryshe nga përdorimi i kufizuar në shqipe:

- (1) a. He smiled a stupid smile.  
b. Buzëqeshi \* një buzëqeshje prej budallai.

Këto dy vëzhgime pohojnë se realizimi i kundrinorit (klitik ose formë e plotë) në gjuhën shqipe realizohet në kallëzore në pozicionin CL2, ndryshe nga anglishtja e cila në mungesë të këtyre karakteristikave has kufizime leksikore në semantikën e foljeve për të paraqitur realizimin e kundrinorit. Me fjalë të tjera, paraqitja e strukturës së argumentit nuk shprehet në të njëjtën mënyrë si në shqipe.

Ky formulim lejon të mbështesim qasjen e Hale dhe Keyser (1993, 2002)<sup>345</sup> për joergativet jokalmtare si kalimtare të fshehura, në kuptimin që ka një pozicion kundrinori (të shpehur N sipas tyre) i cili kur shprehet në mënyrë leksikore në anglisht realizohet si kundrinor i nënkuptuar.

Në gjuhën shqipe, megjithatë, një analizë e tillë kërkon përpunim të mëtejshëm. Në veçanti, foljet si *kërcej* dhe *këndoj* të cilat lejojnë që të realizohet një kundrinor i nënkuptuar në të dyja gjuhët duket sikur kanë realizim e interpretim si foljet kalimtare të tipit *shkruaj / lexoj*. Për folje të tjera, p.sh. foljet e tipit *qesh* ose *buzëqesh* apo folje të lëvizjes si *eci* tregojnë një ndryshim të theksuar ndërgjuhësor.

Në fakt pohimi i mësipërm bën që klasa e foljeve joergative të mos ketë shpjegime me kaq bazë universale sa pretendohej. Disa gjuhëtarë<sup>346</sup> e mbështesin dallimin mes dy llojeve të foljeve jokalmtare joergative duke e ilustruar me shembullin e mëposhtëm:

- (2) a. Kërcente (vallen).  
b. Ecte (\*qytetin/ \*vajzën).

Ndërsa në (2a) kundrinori i mundshëm mund të jetë vetëm ai i nënkuptuari, në rastin e (2b) nuk mund të ketë një kundrinor të nënkuptuar, as të brendshëm apo të

---

<sup>345</sup> Po aty referuar nga K. Hale, S.J. Keyser. 1993. *On argument structure and the lexical expression of syntactic relations*. Në K. Hale, S.J. Keyser, (eds.), *A view from Building 20*. Cambridge, MA: MIT Press, fq. 53-109. Dhe K. Hale, S.J. Keyser. *Prolegomenon to a theory of argument structure*. Cambridge, MA: MIT Press, 2002.

<sup>346</sup> Anna Roussou, Ianthi-Maria Tsimpli, *Clitics and Transitivity*, Mbajtur në *Mediterranean Syntax Meeting*, Rodhos, Greqi, 2005, fq. 25 version PDF

mundshëm. Raste të tilla të dallimeve mes gjuhëve kërkojnë analiza e përpunime të mëtejshme gramatikore.

Në vëzhgim të rolit të klitikut në procesin e kalimtarësisë do të thoshim se në një alternim kalimtar realizimi i klitikut është i preferuar për karakteristikat formale të tij. Realizimi i klitikut është i preferuar sepse prezenca e tij mjafton për të dhënë minimumin e karakteristikave të kërkuara për shprehjen e kalimtarësisë. Megjithëse, ndërkohë që struktura e fjalisë bëhet më e plotë, kërkesa për prezencën e klitikut dobësohet, në favor të formës së plotë, e cila jo në të gjitha rastet është e dublikuar nga klitiku. Duke ju referuar sa më sipër realizimi ose mos realizimi i klitikut mund të ndikojë në masën e kryerjes ose pranimit të veprimit të ilustruara si më poshtë:

- (3) a. *E* shëtitën djalin/mendjen.
- b. Shëtitën djalin/mendjen.

Pra, në rastin e fjalisë (3a) të krijohet përshtypja e një veprimi të përfunduar ose të një veprimi më të theksuar në favor të kundrinës së drejtë, ndërsa në (3b) do të kemi një mungesë të kësaj nuance semantike të shprehur më lart.

Pavarësisht së kjo është një çështje që kërkon një investigim empirik, është një tregues i rolit sintaksor të klitikut në kalimtarësinë në shqip.

### **8.3 Rimarrja e kundrinës së drejtë me klitikë**

Demiraj shprehet se po ta vështrojmë dukurinë e rimarrjes së kundrinës në veprat e autorëve tanë të vjetër<sup>347</sup>, vëmë re se rimarrja e kundrinës së drejtë në funksionin e remës vetëm me anë të formës së theksuar të përemrave vetorë të dy vetave të para është e kufizuar (sidomos tek Budi). Ndryshe qëndron puna, kur kundrina e drejtë shprehet me fjalë të tjera (përveç përemrave vetorë të dy vetave të para). Në këtë rast, kur ajo përfaqëson temën e kumtimit, atëherë shprehet ose vetëm nëpërmjet formës së patheksuar të përemrit vetor të vetës së tretë, njëjës apo shumës (e,i), ose njëkohësisht edhe me formën e plotë të saj, që mund të jetë një emër, një togfjalësh emëror a një fjali e nënrenditur, apo një përemër çfarëdo (përrjashtuar vetorët e dy vetave të para).

Kur situata e ligjëritit e bën të panevojshëm edhe përdorimin e formës së plotë të kundrinës së drejtë, atëherë në këtë funksion përdoret vetëm forma përemërore e patheksuar e vetës së tretë *E bleva*. Por, duke qenë se kjo formë e patheksuar e rasës kallëzore (ndryshe nga ato të dy vetave të para) kuptimisht është shumë e pacaktuar, në mjaft raste ndihet nevoja që kuptimi i saj të konkretizohet nëpërmjet përdorimit të formës së plotë të kundrinës, që ajo përfaqëson. Anasjelltas, kur kundrina e drejtë (e shprehur jo

---

<sup>347</sup> Shaban Demiraj, *Gjuhësi Ballkanike*, Libraria Digitale “Dielli”, tërhequr në 02.09.2014 nga <http://www.dielli.net/pdf/historia/GjuhesiBallkanike.pdf>, fq. 119 referuar nga Buzuku, Budi në Demiraj: 1986, 585 v

nëpërmjet vetorëve të dy vetave të para) përfaqëson remën e kumtimit, atëherë ajo nuk rimerret nëpërmjet formës së patheksuara të rasës kallëzore (e, i) *Bleva një libër*.

Edhe rimarrja, përkatësisht mosrimarrja e kundrinës së drejtë nëpërmjet formave të patheksuara të përemrave vetorë të vetës së tretë, ashtu si në rastin e dy vetave të para, në shkrimet e autorëve të vjetër shqiptarë, në vija të përgjithshme, kushtëzohet nga po ato rregullsi, që u vunë në dukje për shqipen e sotme<sup>348</sup>

Për të dhënë një këndvështrim gjenerativist në lidhje me realizimin e klitikëve jemi mbështetur kryesisht në studimin e Dalina Kallullit<sup>349</sup> *mbi realizimin e klitikut të kundrinorit të drejtë në shqipe dhe greqishte*. Ndërtimet me klitikë janë nga natyra mbetje të forta të ndërtimeve me kundrinorë. Kallulli shprehet se pavarësisht modeleve të klitikëve në shqip dhe ngjashmërisë me fenomenin e marrëveshjes me kundrinorin, përsëri këto të dyja nuk mund të zëvendësojnë njëra tjetën në përdorim. Mendimi që klitikët e kundrinorit të drejtë e shënjojnë SE që dublikohet me (-Fokus) mund të interpretohet më së miri me anë të programit minimalist (Chomsky 1995) apo me anë të analizës së Sportiche (1992)<sup>350</sup> se klitikët kryesojnë projektimet e tyre maksimale dhe që klitikët e kundrinorit të drejtë në veçanti janë kokë me karakteristika operatore.

Në shqipe, ato mund të paraprijnë, ndjekin ose të jenë të bashkëvendosura në mënyrën urdhërore. Ndoshta karakteristika më e veçantë e përdorimit të klitikut në shqipe është se ky përdorim nuk korrespondon me rregullin e Kayne<sup>351</sup>, i cili shprehet se përdorimi i klitikëve është i mundur sa herë që një SE mund t'i caktohet rasë me anë të elementëve jo foljorë që kanë karakteristika rasë caktuese, si p.sh. parafjalët.

Por në fakt shembujt në shqipe tregojnë se kemi rastin e SE të cilat nuk paraprihen nga parafjalë dhe për më tepër që kemi rastin e kundrinorëve me parafjalë të cilët nuk shoqërohen me klitikë. Kallulli thekson se ndryshimi i rendit të brendshëm të kundrinorëve (të drejtë e të zhdrejtë) nuk ndikon aspak në realizimin e klitikut, duke u paraqitur njësoj në të dyja rastet. P.sh.

- (1) a. Ia pëlqeu dhuratën Agimit.  
b. Ia pëlqeu Agimit dhuratën.

Kallulli shprehet se në shqipe, ndryshe nga gjuhët latine, realizimi i kundrinorit të drejtë si klitik nuk kufizohet nga karakteristikat [+frymor], [+human] ose [+ të shquar] të SE.

- (2) a. Do t-a pija me kënaqësi një uiski.

---

<sup>348</sup> *Po aty*, fq. 120 për më shumë shiko Demiraj 1986, 593 v

<sup>349</sup> Dalina Kallulli, *Comparative Syntax of Balkan Languages*, Maria Luisa Rivero dhe Angela Ralli, Oxford University Press, 2001 (version PDF, fq. 127-129)

<sup>350</sup> *Po aty*

<sup>351</sup> Richard S. Kayne, *The Antisymmetry of Syntax*, Linguistic Inquiry Monograph 25, M.I.T. Press, Cambridge, Mass, 1994

Ajo gjithashtu thekson se për sa u përket kundrinorëve të drejtë të shquar apo të pashquar është rasti të tregojmë se jo gjithmonë mund të realizohet një ndërtim me klitik, p.sh fjalia më poshtë paraqet një rast të SE të caktuar e cila nuk mund të dublikohet me një klitik.

- (3) Nuk shkoj në këmbë, (\*e) marr autobus-in.

Për më tepër ajo paraqet rastin e SE të pashquara dhe ndikimin që kanë treguesit e trajtës së pashquar *një* dhe *ca* në dublikimin ose jo me një klitik. Kështu në fjalitë si më poshtë:

- (4) a. Ana nuk zjeu **fasule**.  
b. \* Ana nuk *i* zjeu **fasule**.  
c. Ana nuk zjeu ca **fasule**.  
d. Ana nuk *i* zjeu ca **fasule**.

Do të ishte gramatikisht jo i saktë dhe i papranueshëm përdorimi me klitik në (4b) duke qenë se emri **fasule** nuk shoqërohet me treguesin e trajtës së pashquar. Raste të tilla të SE Kallulli i quan *shumësi i zhveshur* (bare plurals); të njëjtin argumentim do të përdornim edhe për emrat e pashquar në numrin njëjës të cilët kanë karakteristikën *njëjës i zhveshur* (bare singular), pra që nuk realizohen me tregues të trajtës së pashquar në numrin njëjës. Kështu në shembujt si më poshtë do të gjejmë:

- (5) a. Ana donte *ta* blinte *një* **fustan**.  
b. \* Ana donte *ta* blinte **fustan**.

ku fjalia (5b) është e papranueshme gramatikisht për shkak të mungesës së treguesit të pashquarsisë *një*.

Klitiku i kundrinorit të drejtë në shqipe realizohet në mënyrë të detyrueshme në ndërtimet me kryefjalë +K (Kush) dhe gjithashtu në pyetjet që përgjigjen po/jo të ilustruara si më poshtë përkatësisht në (6) dhe (7):

- (6) Kush (e) pa femijë-n?  
(7) (A) (e) pe Agim-in?

Sipas Shaban Demiraj<sup>352</sup> në gjuhën shqipe rimarrja e kundrinës së drejtë është bërë një dukuri e përgjithësuar, kur ajo shprehet me anë të formave të theksuara të përemrave vetorë të dy vetave të para, pavarësisht nga topika e tyre para apo pas foljes kallëzues. Në këtë përdorim kundrina e drejtë përfaqëson remën e kumtimit. Kurse në

---

<sup>352</sup> Shaban Demiraj, *Gjuhësi Ballkanike*, Libraria Digitale “Dielli”, tërhequr në 02.09.2014 nga <http://www.dielli.net/pdf/historia/GjuhesiBallkanike.pdf>, fq. 119

rolin e temës së kumtimit në këtë rast ajo shprehet rregullisht vetëm nëpërmjet formave të patheksuara të përemrave vetorë të dy vetave të para në rasën kallëzore: *më, të, na, ju* (dikur *u*) P.sh., Demiraj paraqet shembujt: a) *Më merr (a merrmë) edhe mua. Unë të thirra ty dhe jo atë.* b) *Nëna më (të) do, prandaj më (të) qorton.*

#### **8.4 Rimarrja e kundrinës së zhdrejtë me klitikë**

Gjithashtu Kallulli<sup>353</sup> ka tërhequr vëmendjen edhe për sa i përket kundrinorëve në dhanore dhe realizimit të klitikut në to duke i ilustruar me shembujt si më poshtë:

- (1) a. Ben-i (i) dërgoi një vajze lule.
- b. Ben-i (i) dërgoi lule një vajze.

Pra, pavarësisht ndryshimit të rendit të kundrinorëve, si pozicioni i klitikut, si kuptimi i vetë fjalisë nuk ndryshojnë. Hubbard<sup>354</sup> e ka vendosur klitikun e kundrinorit të zhdrejtë të shqipes në kuadrin e gramatikës relacionale sipas modelit të sjellë nga Perlmutter dhe Postal (1978). Bazuar në këtë teori ai shprehet se klitiku i kundrinorit të zhdrejtë në shqipe mund të trajtohet në dy aspekte; së pari në lidhje me marrëdhëniet gramatikore që realizon dhe në lidhje me nivelet sintaksore të nevojshme në përshkrimin strukturor duke qenë se ai nuk mund të përcaktohet thjesht nga rendi, rasa apo nga kuptimi duke qenë se është një dublikim i vetë formës së plotë në dhanore.

Sipas tij ka të paktën pesë mënyra për të interpretuar klitikun e rasës dhanore në shqipe.

- 1) Klitiku si kundrinor i zhdrejtë logjik
  - a. Agimi ia dha Halitit librin.  
Kry Cl F KZhdr KDrej
  - b. I flas Dritës.  
Cl F KZhdr
- 2) Klitiku si kryefjalë logjike
  - a. Ngjarja nuk i besohet drejtorit.  
Kry Cl F KZhdr
  - b. Nuk më shkohet.  
Cl F
- 3) Klitiku si pronar

---

<sup>353</sup> *Po aty*, fq. 135

<sup>354</sup> Philip L. Hubbard, *Dative Clitics in Albanian: Evidence for Syntactic Levels*, Proceedings of the Seventh Annual Meeting of the Berkeley Linguistics Society, 1981, fq. 82-92

- a. Qeni i pa macen Agimit.  
Kry Cl KDrej KZhdr
- b. Bilbili më këndon mua mirë.  
Kry Cl F KZhdr
- 4) Klitiku si përftues
- a. Agimi ju bleu një biçikletë.  
Kry Cl F KDrej
- b. Drita i vishet Agimit si nuse.  
Kry Cl F KZhdr
- 5) Klitiku si narrativ
- a. Na ishte një fshatar dhe një ari.  
Cl F Kry
- b. Agimi më fluturoi në shtëpi dje.  
Kry Cl F

Demiraj<sup>355</sup> shprehet se për sa i takon rimarrjes së kundrinës së zhdrejtë, ajo është përgjithësuar në gjuhën shqipe, jo vetëm kur shprehet nëpërmjet përemrash vetorë të dy vetave të para, por edhe kur shprehet me anë të një përemri vetor të vetës së tretë, ose të një përemri tjetër çfarëdo, ose nëpërmjet një emri a një togfjalëshi emëror.

Kundrina e zhdrejtë në shqipen e sotme rimerret pavarësisht nga topika e saj para apo pas foljes kallëzues. Në këtë përdorim ajo përfaqëson remën e kumtimit, kur shprehet nëpërmjet përemrave vetorë të dy vetave të para, p.sh *Po të flas ty (e jo atij), Ty po të flas*. Por, kur shprehet me anë përemrash të tjerë, ose me anë të një emri a të një togfjalëshi, rimarrja e kundrinës së zhdrejtë në shqipen e sotme bëhet jo vetëm kur përfaqëson remën, por edhe kur përfaqëson temën e kumtimit. P.sh. të krahasohen: a) Këtë libër jep-j-a vetëm *Agimit...* (remë). b) *Agimit i* thamë, por nuk pati mundësi të vinte (temë). Madje, rimarrja e saj në krye të herës në rastin e fundit duhet të jetë përftuar pikërisht kur ajo përdoret në funksionin e temës. Në këtë funksionin e fundit ajo mund të shprehet edhe vetëm me anë të formave të patheksuara të përemrit vetor të vetës së tretë në rasën dhanore, ashtu siç ndodh edhe me vetorët e dy vetave të para p.sh *Të tha gjë? - Jo, s'më tha gjë. - A i dhe përgjigje (mësuesit)? - I dhashë. - A u dhe për të ngrënë (fëmijëve)? - U dhashë. etj.*

Demiraj mendon se kundërvënia e krijuar në të shprehurit e sintagmave emërore SE si kundrina të drejta e të zhdrejta në shqipen e dokumentuar përfaqëson evolucionin e mëtejshëm të një dukurie sintaksore, që kishte nisur të shfaqej qysh në periudhën

---

<sup>355</sup> Shaban Demiraj, *Vepër e cituar*, fq. 120



parashkrimore të kësaj gjuhe. Po të kemi parasysh se dukuria në shqyrtim paraqitet si një zhvillim i barabartë si tek Buzuku ashtu edhe tek autori më i vjetër i arbëreshëve të italisë, Matrënga (1592), atëherë zanafilla e saj duhet kërkuar, të paktën, qysh disa shekuj para shekullit XVI të e.r. Kuptohet vetiu që, para se të zinte fill kjo dukuri sintaksore, në gjuhën shqipe kundërvënia *remë ~ temë* në të shprehurit e kundrinave realizohej nëpërmjet formave të theksuara të përemrave vetorë të dy vetave të para, apo nëpërmjet një emri a togfjalëshi emëror etj., përkatësisht nëpërmjet formave të patheksuara të përemrave vetorë për të tri vetat. Këto të fundit në një fazë edhe më të hershme kanë pasur një përbërje fonetike më të plotë. Por pikërisht për arsye të theksimit të tyre gjithnjë e më të dobët ato kanë pësuar prej kohësh reduktime të mëdha fonetike.

## KREU IX

### SINTAGMA FOLJORE ME FOLJE MODALE

#### *9. Modaliteti në kuptimin e gjerë*

Modaliteti është një kategori e kuptimit leksikor e cila ka të bëjë me shprehjen e mundësisë dhe domosdoshmërisë. Modaliteti dhe koha janë dy nga përbërësit bazë të “zhvendosjes”, siç shprehet Hockett dhe Altmann <sup>374</sup> mbi karakteristikat skicore të gjuhës njerëzore; kjo i jep mundësi gjuhës natyrore të flasë për çështje përtej të tashmes në vend e në kohë. Portner<sup>375</sup> (2009: 1) e ka përcaktuar modalitetin në këtë mënyrë:

*Modaliteti është një fenomen gjuhësor gramatika e të cilit të lejon të flasësh në bazë të situatave të cilat mund të mos jenë reale. Ndoshta nuk është përcaktimi më i drejtë për modalitetin, por sa më sipër të jep një karakterizim të arsyeshëm mbi modalitetin si fenomen semantik. (Portner, 2009)*

Butler<sup>376</sup> shprehet se modaliteti është një kontribut i domosdoshëm për sintaksën dhe semantikën sa herë shfaqet.

#### *9.1 Llojet e kuptimit modal*

---

<sup>374</sup> Charles F. Hockett, Stuart A. Altmann, *A note on design features*, Në *Animal Communication: Techniques of Study and Results of Research*, edited by Thomas A. Sebeok, Indiana University Press, 1968, fq. 61–72.

<sup>375</sup> Paul Portner, *Modality*, Oxford University Press, 2009.

<sup>376</sup> Jonny Butler, *Phase structure, Phrase structure, and Quantification*, Punim Doktorature, Departamenti i Gjuhëve dhe Shkencës së Gjuhësisë, Universiteti i York, 2004, fq. 151 (Version PDF)

Kategoritë e modalitetit kanë një rëndësi të veçantë në studimin e gjuhëve natyrore. Sipas Kai von Fintel<sup>377</sup> mund të dallohen disa lloje të kuptimit modal: aletik, epistemik, denotik, bouletik, i situates, telelologjik.

Modaliteti aletik (nga greqishtja *αἰετός*, e vërteta), shpesh e gjejmë edhe me termin modaliteti logjik ose metafizik që ka të bëjë me atë që është e mundur ose e nevojshme në kuptimin e gjerë të fjalës. Është në fakt e vështirë të gjejmë shembuj<sup>378</sup> bindës të modalitetit aletik në gjuhët natyrore dhe për më tepër përfshirja në këtë listë/renditje bëhet kryesisht për shkaqe historike.

Sipas Butler<sup>379</sup> (2004: 154) modaliteti aletik mund të vlerësohet si modaliteti logjik “i pastër”; pra në këtë rast modaliteti nuk lidhet me përkatësinë në një kontekst të veçantë por gjykimi është në mënyrë objektive. *Asgjë nuk mund të lëvizë më shpejt se drita* [është ligj i natyrës].

Modaliteti epistemik (nga greqishtja *ἐπιστημολογία*, njohja/shkenca) që ka të bëjë me atë që është e mundur ose me atë çka është e nevojshme të jepet, me atë që njihet dhe fakti i dhënë në lidhje me të. *Duhet të ketë rënë shi*. [pasi shohim njerëz që hyjnë brenda me çadra të lagura; modalitet epistemik]

Modaliteti deontik (nga greqishja, *δεδουλευμένος*, punë/detyrë) që ka të bëjë me atë që është e mundur, e nevojshme, e lejuar ose e detyrueshme duke u bazuar në ligj apo parime morale. *Vizitorët duhet të largohen në orën gjastë të mbrëmjes*. [rregullore e spitalit; modalitet deontik]

Interpretimet deontike janë analizuar në këtë mënyrë nga Butler<sup>380</sup> (2004: 155). Modalja do të zgjidhet në bazë të disa kriterëve, në varësi të faktit se çfarë ka për qëllim të shprehet në një kontekst të veçantë të ligjërit. Për interpretimet deontike, duhen të vendosen në një botë ideale ku detyrimi më kryesor është përmbushur ose leja është dhënë etj.

Modaliteti bouletik, që ka të bëjë me atë që është e mundur ose e nevojshme, duke u bazuar në dëshirat e individit. *Ti duhet të shkosh në krevat për dhjetë minuta*. [fjala e babait; modalitet bouletik]

Modaliteti i situatës, ose ndryshe i quajtur modaliteti dinamik, që ka të bëjë me atë që është e mundur ose e nevojshme duke u bazuar në një sërë situatash. *Më duhet të pi ujë*. [në rast etjeje; modalitet i situatës].

Modaliteti telelologjik (nga greqishja *τελεολογία*, qëllimi) që ka të bëjë me mjetet e nevojshme ose të mundshme për të arritur një qëllim të caktuar dhe kryerjen/përfundimin e veprimit. *Për të mbërritur në kohë, ti duhet të marrësh një taksì*. [modalitet telelologjikal]. Megjithatë, në analizën deskriptive mbi modalitetin është vërrejtur një klasifikim që i tejkalon këto dallime thelbësore.

---

<sup>377</sup> Kai von Fintel, “Modality and Language”. Në Encyclopedia of Philosophy – Botim i dytë nga Donald M. Borchert. Detroit: MacMillan Reference USA, 2006. tërhequr nga versioni online <http://web.mit.edu/fintel/fintel-2006-modality.pdf> në 19.09.2014

<sup>378</sup> Kai von Fintel, *Po aty*, fq. 2

<sup>379</sup> J. Butler, *Po aty*, fq. 154

<sup>380</sup> J. Butler, *Po aty*, fq. 155

Në analizën për modalitetin kryesisht jemi mbështetur në studimin e semantologes Angelika Kratzer (1981, 1991)<sup>381</sup>. Sipas saj modaliteti shpreh një sasi të caktuar në njësi të caktuar. Llojet e ndryshme të kuptimit të modaleve i korrespondojnë sasive të ndryshme në modalitet. P.sh. ajo na përcjell termin modalitet epistemik ka të bëjë me atë çka është e njohur me një fakt të mundshëm. Modaliteti deontik i korrespondon sasisë së modalitetit të kërkuar nga parimet ose ligjet. Modaliteti bouletik ka të bëjë më atë që kërkohet apo dëshiron një individ etj.

### **10.2 Varësia nga konteksti dhe specializimi leksikor**

Kratzer (1981, 1991) shprehet në studimin e saj, se kuptimi i modaleve nuk duhet të shihet si një rast i polisemisë (aksidentale), por duhet parë si një rezultat i varësisë nga konteksti. Me fjalë të tjera, shprehjet modale kanë një kuptim skeletor i cili merr vlerë vetëm në kombinim me kontekstin, ku sintagma modale merr një hije të veçantë të kuptimit (si epistemike ose deontike). Ajo e bën të qartë bazën e bashkëbiseduesit.

- (1) Sipas rregullores së spitalit, vizitorët *duhet* të largohen në orën gjashtë.
- (2) Duke gjykuar nga të dhënat mbi motin, *duhet* të bjerë shi.

Në mungesë të treguesve gjuhësorë, folësit duhet të mbështeten në të dhëna kontekstuale dhe të argumentojnë qëllimet e bashkëbiseduesve për të përcaktuar se çfarë kuptimi modal ka për qëllim të shprehë një fjali në një kontekst të caktuar.

Disa modale nuk janë mjete të cilat realizohen plotësisht sipas kontekstit, por imponojnë nuanca kuptimore në bazë të asaj që duhet shprehur. P.sh. në anglisht folja modale “might” (mund) në pjesën më të madhe të rasteve realizohet si epistemike (me përjashtime të pakta si në rastin *Ti mund ta vendosësh çelësin në këtë vend*, që mbart nuancën e sugjerimit).

Rasti i foljeve modale përbën një bagazh të gjerë për studime gjuhësore e ndër gjuhësore. Për më tepër modalet kanë një përmbajtje përtej kuptimit *e vërtetë – kusht*.

Brennan<sup>382</sup> (1997) e ka përqëndruar vëmendjen në modalet epistemike të cilat kanë sjellje të ndryshme semantike në kontekste të veçanta. Ajo vazhdon duke i karakterizuar modalet epistemike si modale Fjali. Këto cilësime janë përcaktuar si kushte në analizën e saj; kushte të cilat janë të motivuara nga ana empirike. Ajo argumenton duke dhënë sjelljen e modaleve në sintagma (të cilat ajo i quan) me folje simetrike.

*Marrëdhëniet simetrike janë ato të cilat realizohen sipas formulës:*

$R(x,y) \rightarrow R(y,x)$ .

(Brennan 1997: 190)

---

<sup>381</sup> Angelika Kratzer, *Vepër e cituar*

<sup>382</sup> Virginia Brennan, *Modalities*, Vanderbilt University, Nashville, Tennessee, 1997.

Brennan shton se sintagmat me folje modale simetrike të cilat realizohen me formulën e mësipërme janë të vlefshme vetëm për modalet epistemike duke e argumentuar me shembujt si më poshtë:

- (3) a. Arturi ngjan si Suzana.  $\rightarrow$  Suzana ngjan si Arturi.  
b. Arturi duhet/mund të ngjajë si Suzana.  $\rightarrow$  Suzana duhet/mund të ngjajë si Arturi. (modalitet epistemik)

Sipas Brennan është e qartë që në (3 a), kalimi nga  $R(x,y)$  (ku  $R =$  ngjan,  $x =$  Arturi, dhe  $y =$  Suzana) në  $R(y,x)$  kalon në mënyrë të drejtpërdrejtë. Gjithashtu në mënyrë të ngjashme në (3 b), nëse bëjmë një hamendësim të nevojshëm/ të mundshëm që Arturi të ngjajë si Suzana, atëherë duhet të kemi dhe hamendësimin që Suzana të ngjajë si Arturi gjithashtu. Në (3 c), megjithatë, nëse Arturit i kërkohet të ngjajë si Suzana (p.sh në rastin se ai duhet të kalojë si ajo në mënyrë të paligjshme), atëherë në këtë rast nuk shprehet një kërkesë/nejvojë që edhe Suzana gjithashtu të ngjajë si Arturi. Ose nga ana tjetër, nëse Arturi është në gjendje të ngjajë si Suzana për shkak të aftësive të tij personalizuese, kjo nuk do të thotë se duhet të marrim të mirëqenë se edhe Suzana është e aftë të përdorë këto aftësi për të ngjarë si Arturi.

Modaliteti epistemik nuk duhet të ndikojë në mënyrën se si kombinohen një folje dhe një argument, duke qenë se ato janë tashmë të kombinuara.

Kratzer<sup>383</sup> (1991) shprehet se për të përcaktuar shkallën e modalitetit – pra nëse kemi të bëjmë me një modale mundësie ose me një modale nevojë/ domosdoshmërie – do të na duhet t’u përmbahemi dy parametrave të dallueshmërisë, të cilat janë: baza modale dhe burimi urdhëruar. Baza modale është një grup me situata të mundshme që kanë lidhje me vlerën e modalitetit. Në një nga shembujt e Kratzer, një burrë i quajtur Girgl është vrarë dhe për oficerin e policisë të gjitha hamendësimet si më poshtë janë të arsyeshme (ndër të tjera).

- (4) a. Michl duhet të jetë vrasësi.  
b. Michl është ndoshta vrasësi.  
c. Michl mund të jetë vrasësi.  
d. Është një mundësi që Michl të jetë vrasësi.  
e. Është një mundësi që Michl të mos të jetë vrasësi.  
f. Michl ka më shumë mundësi të jetë vrasësi sesa Jakl.  
(Kratzer 1991: 643)

Duke qenë se oficeri i policisë nuk ka informacion të saktë për vrasjen, atëherë të gjitha hamendësimet e tij shërbejnë si një “grup botësh” – që ndër të tjera – një prej tyre mund të jetë e vërteta. Të gjitha këto “botë” janë të pranueshme nga ana epistimike (Kratzer 1991: 643) dhe ato formojnë *bazën modale*.

---

<sup>383</sup> A. Kratzer, *Vepër e cituar*, fq. 643

Pjesa e dytë e kufizimit modal është *burimi urdhërues*; ky kufizim i vendos një urdhër grupit të situatave/botëve të mundshme në fjalë (pra bazës modale). Është pikërisht burimi urdhërues, i cili lejon modalitetin të gradohet në shkallë të ndryshme të domosdoshmërisë apo mundësisë.

Nëse oficeri i policisë përdor hamendësimin në (4 a) ose (4 c) nuk varet nga baza modale, duke qenë se në të dyja rastet ky hamendësim do të përmbajë nuanca apo situata ku Michl vrau Girgl dhe situata ku nuk e vrau; kjo varet nga fakti se si burimi urdhërues drejton situatën në bazën modale. Nëse hamendësimi është më i pranueshëm dhe drejtohet në situatën ku Michl është vrasësi, atëherë (4 a) është e saktë; nëse drejtimi orientohet drejt (4 c) atëherë ajo situatë bëhet më e pranueshme.

### *10.3 Sintagma modale në këndvështrimin gjenerativ*


Në gjuhën shqipe dallohen disa tipa sintagmash modale. Nëse e vendosim sintagmën modale në kuadrin e teorisë X-bar, atëherë do të shohim se kjo sintagmë edhe në gjuhën shqipe përbëhet nga një kokë – e cila është folja modale dhe plotësohet me një plotësor që është vetë sintagma foljore SF. Tipat e sintagmës modale SM në shqipe janë: *mund+lidhore, duhet+lidhore/folje e pashtjelluar, do+pjesore, kam/jam+formë e pashtjelluar*.

Folja gjysmëndihmëse *mund* shpreh kuptimin modal të mundësisë ose të lejimit. Ajo përdoret me një formë të ngurosur, sa herë që e gjithë sintagma ku ajo bën pjesë, ka vlerën e kohës së tashme, të së ardhmes ose të së pakryerës<sup>384</sup> si p.sh. *E kuptoni sa dëm të madh mund të kemi. Që të mund të arrihen këto qëllime, është e nevojshme që .... Që të mund të arriheshin ato qëllime, ishte e nevojshme që ...*

Nëse e vendosim sintagmën modale *mund të arriheshin* në një pemë strukturore, do të përftojmë pemën si më poshtë:

---

<sup>384</sup> Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002, fq. 262




Pema 1: SM mund të arriheshin

Kur nuk ndiqet nga një folje tjetër në mënyrën lidhore, folja *mund* nuk ka vlerë modale, por përdoret si një folje e zakonshme me kuptim leksikor të plotë, si p.sh. *Nga koha kur romakët **mundën** Teutën....*

Folja gjysmëndihmëse *duhet* shpreh kuptimin modal të detyrimit ose të domosdosë. Ajo mund të ndiqet nga mënyra lidhore ose nga pjesorja e, në rastin e fundit, mund të përdoret në vetën e tretë njëjës dhe në vetën e tretë shumës<sup>385</sup>, p.sh. *Marrëveshja **duhet të mbetet** midis nesh. Ata djem të mirë **duhen ndihmuar***. Në fjalinë *Duhet të vij* forma modale *duhet* plotësohet me sintagmën foljore SF *të vij* e cila shërben si plotësor i sintagmës modale:

---


<sup>385</sup> Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002, fq. 263



Pema 2: SM duhet të vij

Kur nuk ndiqet pandërmjetshëm nga një folje tjetër në mënyrën lidhore ose në pjesore, por nga një emër a përemër që shërben si kryefjalë e saj, folja *duhet* nuk ka vlerë modale, por përdoret si një folje me kuptim leksikor të plotë. Si e tillë ajo mund të përdoret jo vetëm në vetën e tretë njëjës, por edhe në vetat e tjera si p.sh. *Tashti më duheshin ca mjete pune.*

Folja me vlerë modale *do* shpreh kuptimin modal të detyrimit<sup>386</sup>. Ajo përdoret vetëm në kohën e tashme, në vetën e tretë njëjës e ndjekur nga pjesorja e foljes themelore si p.sh. *Vrulli i tyre do drejtuar* .... Nëse analizojmë këtë fjali në pemë strukturore do të përftonim pemën si më poshtë:




Pema 3: SM do drejtuar

<sup>386</sup> Po aty, fq. 264



Me vlerë modale në gjuhën shqipe përdoren edhe foljet *jam* dhe *kam*<sup>387</sup>, të cilat, të ndjekura nga forma e pashtjelluara e tipit *për të larë*, shprehin gjithashtu kuptimin modal të detyrimit, por në një formë më të zbutur se foljet *duhet* dhe *do* si p.sh. *Mënyra me të cilën u fitua beteja e Nartës, është për të vënë re*. Pjesa e sintagmës modale do të paraqitet në pemën strukturore si më poshtë:



Pema 4: *SM është për të vënë re*

Në gramatikën akademike<sup>388</sup> të gjuhës së sotme shqipe foljet modale *duhet* +*pjesore*, *do* + *pjesore*, *duhet* + *lidhore* janë përfshirë në foljet njëvetore (përkatësisht pavetore), si më poshtë:

- (1) a. *Duhet punuar* me kujdes.
- b. *Duhet të punohet* me kujdes.
- c. *Duhet të agojë* pas pak.
- d. *Do pasur* kujdes.

P.sh.: *Është një padrejtësi ndaj së cilës nuk duhet heshtur!* (T. Laço, *Të gjithë lumenjtë rrjedhin*, f. 258). *Kështu, kështu që duhet kthyer atje.* (F. Balliu, *Zemra ime është në mal*, f. 123), *Duhet biseduar me Nexhatin – tha* (T. Laço, *po aty*, f. 458). *Duhej ecur më shpejt* (A. Abdihoxha, *Dueli i madh*, f. 25); *Tingëllonte naive, megjithatë duhej arsyetuar për ta hedhur poshtë pandehmën.* (I. Kadare, *Koha e shkrimeve*, f. 112).

Megjithatë, Buxheli<sup>389</sup>, shprehet se ndërtime të tilla janë njëvetore jo për shkak të foljes modale, pra nuk është folja modale ajo që i bën këto struktura si njëvetore pa kryefjalë të shprehur ose të nënkuptueshme, por është folja në pjesore ose në lidhore, e cila bart dhe kuptimin leksikor kryesor. Kjo dukuri nuk del qartë në gramatikën akademike, sepse shembujt me to si njëvetore, përkatësisht pavetore, mungojnë.

<sup>387</sup> *Po aty*

<sup>388</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe, 1*, 2002, fq. 268 dhe 263

<sup>389</sup> Ludmila Buxheli, *Foljet Njëvetore në Gjuhën e Sotme Shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2011, fq. 151

Këto folje, ndryshe nga foljet vetore *dua, jam* dalin me kuptim leksikor të zbehur dhe thjesht shprehin kuptimin modal të detyrimit ose të domosdosë, dmth. nëpërmjet tyre veprimi i emërtuar nga folja kryesore paraqitet si i detyrueshëm ose si i domosdoshëm.

Ndërtimet me foljet modale të mësipërme duhen dalluar nga ndërtimet e mëposhtme (2a) dhe (2b), në të cilat folja modale prihet nga një SE në rasën emërore:

- (2) a. Unë [pro-ekspl. *duhet* të punoj] vs.  
b. Ne [pro-ekspl. *duhet* të punojmë].

Në (2a) dhe (2b) duket qartë që përemrat *unë* dhe *ne* janë argumente të foljes në lidhore dhe jo të foljes modale *duhet*. Kjo e fundit nuk përshtatet në vetë dhe numër me përemrat e vetës së parë *unë* dhe *ne*, sepse informacioni semantik i foljes njëvetore modale *duhet* nuk kërkon rol semantik të jashtëm, për pasojë, as argument të jashtëm të realizuar fonetikisht. Folja modale *duhet* si njëvetore ka në pozicionin e kryefjalës një përemër ekspletiv, të porealizueshëm fonetikisht, kurse përemrat *unë* dhe *ne* janë kryefjalë e foljes në lidhore, të zhvendosur në krye për shkak të theksimit ose të topikës dhe jo për shkak të mungesës së caktimit rator në strukturën e varur me lidhore<sup>390</sup>.

Buxheli vazhdon se kjo lloj zhvendosjeje e përemrave *unë, ne* në funksionin e kryefjalës në fjalitë (2a), (2b) njihet edhe me termin Lëvizja A-bar dhe nënkupton gjithmonë zhvendosjen e një SE në një strukturë më lart, i cili nuk është pozicioni i caktimit të rasës së kryefjalës. Në gjuhën shqipe lëvizja A-bar e një SE-je në rasën emërore mund të ndeshet edhe në ndërtimet me foljet modale *mund* ose *duhet* kur përdoren si njëvetore<sup>391</sup>. Karakteristikë e këtyre foljeve është se ato nuk përdoren me kuptimin e tyre fillestar, por si modale.

Folja *mund*, ndryshe nga strukturat me *mundem* si folje kontrolli, kuptimisht është sinonime me shprehjen foljore pavetore ka mundësi, është e mundshme, e lejueshme<sup>392</sup>. Buxheli mendon se këtu përfshihet edhe folja *duhet*, kuptimisht sinonime me shprehjen foljore *është e detyrueshme, e domosdoshme*, e ndjekur nga një lidhore. Këto dy folje, duke mos qenë folje kontrolli, nuk kërkojnë që folja e varur të përshtatet me to në vetë dhe numër.

Gjithashtu, ato nuk mund të përshtaten në vetë dhe numër me kryefjalën e realizuar fonetikisht dhe nuk mund t'i japin asaj rol semantik. Për pasojë, ato kanë formë të ngurosur dhe nuk mund të marrin as mbaresa vetore. Këto folje, ndryshe nga folja e kontrollit *mundem*, janë pjesë përbërëse e sintagmës foljore dhe, sipas studiuesit R. Memushaj<sup>393</sup>, kanë vlerën e specifikuesit të kësaj sintagme.

Folje të tilla kanë prirje për ta zbehur kuptimin, duke u shndërruar në folje gjysmëndihmëse. Shembujt e mëposhtëm e provojnë këtë:

---

<sup>390</sup> L. Buxheli, *Modelet e caktimit rator në gjuhën shqipe*, Nerida, Tiranë, 2006, fq. 134

<sup>391</sup> *Po aty* fq. 151 referuar nga G. Turano, *Dipendenze sintattiche in albanese*, 1995, fq. 136.

<sup>392</sup> *Po aty* fq. 151 referuar R. Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*, Tiranë, 2003, fq. 132

<sup>393</sup> *Po aty*

- (3) a. *Ne<sub>i</sub> mund (ka mundësi) të fitojmë KZ<sub>i</sub> / fitonim KZ/ të kemi fituar KZ.*  
b. *Fëmijët<sub>i</sub> mund (ka mundësi) të fitojnë KZ<sub>i</sub> /të kenë fituar.*

Të njëjtën gjë vërejmë edhe me foljen *duhet*:

- (4) a. *Ne<sub>i</sub> duhet të fitojmë KZ<sub>i</sub> / të kemi fituar.*  
b. *Fëmijët<sub>i</sub> duhet të fitojnë KZ<sub>i</sub> / të kenë fituar.*  
c. *Fëmijët<sub>i</sub> duhej të fitonin KZ<sub>i</sub>.*

Buxheli<sup>394</sup> shprehet se për pranimin ose mospranimin e foljeve modale si njëvetore/pavetore në literaturën gjuhësore nuk ka një mendim të njëjtë. Në literaturën e huaj ekzistojnë dy mendime për këtë çështje. Disa studiues<sup>395</sup> mendojnë se foljet gjysmëndihmëse modale nuk mund të merren si folje me përdorim pavetor.

Disa të tjerë<sup>396</sup> foljet modale, të ndjekura nga pjesorja e lidhorja, në kushte të caktuara sintaksore i marrin si folje me përdorim pavetor. Ky qëndrim i dytë është mbajtur edhe nga studiuesit tanë. Si të tilla janë pranuar vetëm foljet modale *duhet, do dhe është*.

---

<sup>394</sup> L. Buxheli, *Foljet Njëvetore...* fq. 153

<sup>395</sup> *Po aty* fq. 153 referuar nga M. Heriau, *Les verbes impersonnel en français moderne*, I, 1980, fq. 121

<sup>396</sup> *Po aty* fq. 153 referuar nga E. M. Galkina-Fedoruk, *Bjezličnye prelozhenye v sovremjenom russkom jazyka*, 1958, fq. 134

## PËRFUNDIME

1) Deri aty nga fillimi i shek. XIX, gjuhësia, ashtu si shumë disiplina të tjera, përfshihej në gjirin e filozofisë. Statusin e një disipline autonome gjuhësia arriti ta siguronte falë punës së një numri gjuhëtarësh të shquar, të cilët, duke zbatuar në kërkimet e tyre metoda të rrepta shkencore arritën të formulonin parime mbi të cilat, edhe sot, mbështeten shumë studiuues për të përpiluar analizat gjuhësore, të cilat përpunohen, përshtaten e shpesh sfidojnë njëra tjetrën nga dekada në dekadë, duke zgjeruar dijen tonë mbi gjuhësinë si shkencë.

Kur flitet për gjuhësinë si shkencë e njohjes njerëzore kuptohet që gjuhësia studion gjuhën si një veçori specifike që e ka vetëm njeriu, kjo gjuhë karakterizohet nga rregulla të cilat zotërohen ose njihen nga njeriu në mënyrë të pavetëdijshme. Detyra e gjuhëtarit është t'i zbulojë këto rregulla që gjenerojnë fjali dhe t'i bëjë të vetëdijshëm folësit e një gjuhe për mënyrën sesi funksionon gjuha. Ky është edhe thelbi i gjenerativizmit, i rrymës sunduese në gjuhësinë e sotme botërore. Kjo rrymë u themelua nga Noam Chomsky nga mesi i viteve '50 të shekullit të kaluar.

Rregullat dhe parimet që janë formuluar në lidhje me një gjuhë të caktuar përbëjnë gramatikën e kësaj gjuhe. Gramatika e një gjuhe është një sistem parimesh që janë baza e fjalive gramatikore të një gjuhe. Vetë gramatika gjeneron fjalitë e një gjuhe. Kërkesa e parë që i shtrohet gramatikës është të karakterizojë gjuhën që përshkruan, d.m.th gramatika duhet të jetë në gjendje të dallojë ato grupe fjalësh që formojnë fjali nga ato të cilat nuk formojnë fjali në gjuhën përkatëse.

Chomsky, me anë të gjenerativizmit, ka motivuar kërkimin gjuhësor për rreth pesëdhjetë vitet e fundit duke përfutur në të njëjtën kohë edhe shumë rezultate sfiduese. Për më tepër, ky program gjuhësor është në zhvillim e sipër, duke pasur gjithmonë si qëllim përfundimtar jo përshkrimin e detajuar të një gjuhe të caktuar, por formulimin e parimeve të cilat përcaktojnë gramatikën e gjuhëve njerëzore. Këto gramatika janë përfaqësime të njohurive gjuhësore të folësve të cilët i përkasin gjuhëve të caktuara.

Gjuhëtarët gjenerativë do të përpiqen të karakterizojnë njohuritë për një gjuhë, duke u fokusuar në dy pika: (i) duke përcaktuar cilat karakteristika të gjuhës përkatëse janë universale; dhe (ii) duke përcaktuar se cilat karakteristika janë specifike për një gjuhë dhe si lidhen ato me gramatikën universale. Duke u bazuar në këto dy pika mund të

themi se analiza për studimin e gjuhëve në gramatikën gjenerative është një analizë krahasuese.

2) Në vijim të rrugës së nisur nga Chomsky dhe të pasuar nga idhtarët e tij si Jackendoff, Baker, Burzio, Levin etj. mendojmë se gjenerativizmi është formuar tashmë si disiplinë gjuhësore, me objektin, me lëndën e me metodat e veta. Analizat e konstatimet e këtyre gjuhëtarëve kanë shërbyer si bazë për studimet e deritanishme të gramatologjisë shqiptare në fushën e sintaksës gjenerative, një fushë që parashtron detyra e sfida për zbatimin e metodologjisë gjenerative në materialin gjuhësor të shqipes.

Të gjitha fjalët e një gjuhe grupohen në pjesë ligjërata sipas veçorive të përbashkëta. Kriteri për përcaktimin e pjesëve të ligjëratës nuk mbështetet vetëm në kuptimin leksikor të fjalëve, por në përndarjen/distribucionin e tyre dhe të pjesëve përbërëse të strukturës së tyre. Folësi i një gjuhe do të ketë të ngulitur dy lloje distribucioni në përcaktimin e njësive të ligjërimit, atë morfologjik dhe atë sintaksor.

Fjalët, si pjesë ligjërata, luajnë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e fjalisë. Kjo ndodh sepse ato bartin një informacioni leksikor të caktuar. Informacioni leksikor është burimi i një sërë dukurive gjuhësore. Një leksikon për një gjuhë është një listë me njësitë leksikore të asaj gjuhe, të organizuara dhe të strukturuara me anë të kriterëve të përshtatshme. Gjuhëtarët shprehen se folësit e një gjuhe janë të pajisur me një “fjalor” të brendshëm të gjuhës, i cili mund të quhet edhe leksikoni mendor ose leksikoni, që përmban të gjithë informacionin që ata zotërojnë në lidhje me fjalët e gjuhës amtare. Ky leksikon mendor përmban ndër të tjera edhe informacionin për njësitë sintaksore.

Gramatika e strukturës së sintagmës është një version i shprehjes së informacionit duke përdorur rregullat e “ri – shkrimit”. Në këtë model gjuhëtari formalizon gramatikën me anë të rregullave gjenerative të cilat caktojnë strukturën e saktë të konstituentit në fjali. Këto sisteme janë quajtur thjesht *gramatika e strukturës së sintagmës*. Ky model gramatike tregon jo vetëm elementët fundorë apo konstituentët e një strukture lineare, por gjithashtu kjo gramatikë specifikon nënjësitë dhe nivelin në të cilin këto njësi formojnë grupe të natyrshme. Në këtë mënyrë gjuhëtari përqëndrohet në: a) Modelin që përcjell fjalia dhe konstituentët dhe b) mjetet sintaksore të përdorura për të lidhur konstituentët dhe mënyrat në të cilat lidhen pjesë të ndryshme me njëra tjetrën.

Pa një aksiomë të përcaktuar, do të përballeshim me një numër të pakufizuar të rregullave. Rregullat e strukturës së sintagmës të gramatikës gjenerative janë një grupim i ndarjes kryefjalë – folje dhe i sistemeve të ndarjes së fjalëve në kategori.

3) Sintagmat janë mjete që realizohen në vende të përcaktuara nga gramatika, ato shërbejnë për të formuar fjali dhe emërtohen në bazë të funksioneve gramatikore që caktojnë. Për të bërë dallimin ndërmjet tyre na vijnë në ndihmë *testet e konstituentëve* që verifikojnë në mënyrë efektive që një grup i caktuar fjalësh kryen në kompleksitetin e vet një funksion të përbashkët, si rrjedhim përfaqëson një njësi sintaksore.

4) Për sa i përket sintagmës foljore në gjuhën shqipe dolëm në përfundimin se gjuhësia jonë është ende në fillimet e zbatimit të konceptit të sintagmës në sintaksën e gjuhës shqipe. Për analogji me konceptin *sintagmë foljore* në gramatikën tradicionale është përdorur termi *togfjalësh foljor*. Togfjalëshi ka hyrë në gjuhësinë shqiptare si një

kategori e ndërmjetme midis kategorisë fjalë dhe kategorisë fjali. Vihet në dukje termi togfjalësh i lirë ose togfjalësh i lirë sintaksor, i cili është objekt i sintaksës, për ta dalluar nga togfjalëshi i qëndrueshëm, nga togjet e fjalëve me drejtim leksikor, nga togjet e leksikalizuara ose frazeologjizmat, të cilat janë objekt i leksikologjisë.

Termi gjuhësor togfjalësh është krijuar për t'iu përgjigjur termave të ndryshëm gjuhësorë të huaj midis të cilëve edhe termi “syntagme” (sintagmë) të Saussure-it, por përbërja nocionore që i është dhënë është e ndryshme nga ajo e sintagmës. Për rrjedhojë, për lidhjen, grupin apo kombinimin e fjalëve shqipja rezulton me dy terma gjuhësorë, por me përmbajtje të ndryshme.

Sintagma është një njësi që kryen një funksion sintaksor, po në përputhje me natyrën e shqipes funksion sintaksor mund të realizojë edhe një sintagmë e zgjeruar e përbërë nga më shumë se një sintagmë. Pra, analiza e fjalisë në sintagma u përgjigjet elementeve funksionale të saj ose analizës së saj në gjymtyrë të cilat kryejnë funksione të caktuara. Për më tepër, analiza në togfjalësha është një skemë horizontale e rrafshët, që shënon bashkimet dyshe të fjalëve në mënyrë mekanike, pa zbuluar strukturën e brendshme të njëpasnjëshme të bashkimit të tyre. Kurse analiza në sintagma zbulon vendosjen hierarkike të fjalëve në mënyrë më të hollësishme, duke zbuluar kombinimet reale të mundshme të tyre; p.sh struktura e argumentit apo ndarja e roleve semantike të folja, e bën më të thjeshtë dhe të qartë rendin e përbërësve në fjali dhe rëndësinë e interpretimit kuptimor të fjalëve.

Janë nxjerrë në pah karakteristikat e foljes në shqipe duke u mbështetur në teorinë e sintagmës dhe mundësinë për të përfshirë në sintagmën foljore të shqipes jo vetëm plotësorë emra, por edhe plotësorë fjali; në këtë mënyrë tregohet dhe natyra gjithëpërfshirëse e sintagmës.

5) Sipas përcaktimit të dhënë në Gramatikën Relacionale, sintagma foljore në fjalitë me folje jokalimtare ndahet në dy kategori, përkatësisht *joergative* dhe *joakuzative* duke vendosur materialin e foljeve jokalimtare të gjuhës shqipe në këtë kuadër. Ndryshimi sintaksor ndërmjet foljeve joergative dhe joakuzative mendohet se qëndron në ndryshimin e tyre semantik. Foljet joergative zakonisht përshkruajnë veprime të qëllimshme apo të vullnetshme dhe roli semantik i kryefjalëve të këtyre foljeve është ai i një vepruesi ose përjetuesi ndërsa foljet joakuzative përshkruajnë ndryshimin e gjendjes apo vendndodhjen dhe roli semantik i kryefjalës së tyre është ai i një pësuesi. Dalim në përfundimin se dallimi joergative-joakuzative është shënuar në mënyrë sintaksore në bazë të kuptimit leksikor të foljes.

6) Për sa i përket kalimtarësisë, materiali i foljeve kalimtare në gjuhën shqipe është vendosur në kuadrin literaturës funksionale – tipologjike, e përkatësisht analizuar sipas hipotezës së kalimtarësisë duke dalë në përfundimin se sintagma foljore në fjalitë me folje kalimtare të gjuhës shqipe mund të analizohet sipas parametrave të tilla si *pjesëmarrësit, lëvizshmëria, kryerja, përpikëria, qëllimi, sjellja, mënyra, veprimi, ndikimi dhe individualizimi*. Kalimtarësia, shihet kështu në mënyrën më konvencionale të mundshme – si një çështje ku ndodh transferimi i një veprimi nga një pjesëmarrës në një

tjetër – dhe ku pjesët përbërëse mund të ndahen, secila duke u fokusuar në një aspekt karakterizues për të realizuar kryerjen e veprimit.

7) Ka një numër të madh të foljeve në gjuhën shqipe të cilat realizohen në të njëjtën kohë në fjali si folje kalimtare dhe jokalmimtare. Nuk ka një kufi të prerë ndërmjet foljeve kalimtare dhe jokalmimtare. Përkatësia e një foljeje në grupin e foljeve kalimtare dhe foljeve jokalmimtare varet nga kuptimi i saj leksikor në kontekstin ku është përdorur. Duke qenë se shumë folje kanë më shumë se një kuptim, qëllon shpesh që e njëjta folje të përdoret herë si jokalmimtare, herë si kalimtare, gjithnjë sipas kuptimit të saj leksikor në këtë ose atë kontekst.

8) Për sa i përket gjuhës shqipe (ndër gjuhë të tjera), ne mendojmë se përveç të tjerash produktiviteti në alternimet në kalimtarësi ka të bëjë gjithashtu edhe me një karakteristikë tjetër: përdorimi i kundrinave klitikë. Duke qenë se përdorimi i klitikëve dhe dallimet në formë me karakteristika eptimore është në masë të madhe në gjuhën shqipe, ne mendojmë se kalimtarësia është e lidhur shumë me këto vendosje strukturore. Kjo e bën ndryshe nga gjuhë të tjera, si anglishtja për shembull, ku mungesa e morfologjisë së formës dhe klitikëve do të çojë në shprehjen e alternimeve të kalimtarësisë përmes përdorimit të elementeve leksikore.

Një ndër problemet më të diskutueshme, që shfaqet edhe në gjuhën shqipe (ndër të tjera), është interpretimi i tyre ose si mjete përshtatjeje ose si sintagma determinative që përfaqësojnë një argument. Është analizuar roli sintaksor i klitikut në alternimet në kalimtarësi duke u përqëndruar kryesisht në format ergative. Duhet të kemi parasysh se në bazë të semantikës së ngjarjeve ka raste kur klitiku është i domosdoshëm dhe ka të tjera ku ai shërben si plotës për të përforcuar rolin e argumentit të brendshëm të shprehur me formë të plotë kundrinori.

9) Modaliteti është një kontribut i domosdoshëm për sintaksën dhe semantikën sa herë shfaqet. Flitet për modalitetin në kuptimin e gjerë, llojet e kuptimit modal e sintagma modale në këndvështrimin gjenerativ, ku jepen tipat e sintagmave modale SM në shqipe: *mund + lidhore, duhet + lidhore/folje e pashtjelluar, do + pjesore, kam/jam + formë e pashtjelluar*.

10) Përfundimet e mësipërme në lidhje me sintagmat foljore në gjuhën shqipe vërtetojnë teorinë e gjenerativistëve mbi universalitetin e parimeve të përgjithshme gramatikore. Analiza tregon se në bazë të sistemit të tyre gramatikor qëndrojnë të njëjtat parime absolute që realizohen në parametra të veçantë në secilën gjuhë, duke ruajtur veçoritë e tyre.

## **PROPOZIME**

Në bazë të përfundimeve të arritura, bëjmë propozimet e mëposhtme:

T'i jepet më shumë rëndësi përfshirjes së konceptit të sintagmës në librat e gjuhës shqipe me qëllim që folësit e shqipes të njohin më mirë veçanësitë e gjuhës amtare.

T'i kushtohet më shumë rëndësi mësimdhënies së sintaksës gjenerative në kuptimin e gjerë.

Të bëhen përpjekje për unifikimin e terminologjisë gjenerative në studimet gjuhësore shqiptare.

Të ndërmerren studime krahasuese në fushën e sintaksës gjenerative, që do të nxjerrin në pah të përbashkëtat dhe veçoritë ndërmjet gjuhëve, periudhave etj.



## BIBLIOGRAFI

- Abney, Steven. 1995, *Chunks and Dependencies: Bringing Processing Evidence to Bear on Syntax*. Në Computational Linguistics and the Foundations of Linguistic Theory, CSLI
- Abney, Steven. 1987, *The English Noun Phrase in its Sentential Aspect*. Doctoral dissertation, MIT.
- Adger, David. 2003, *Core Syntax: A Minimalist Approach*, Oxford University Press
- Agalliu, Fatmir. 1972, *Mbi pjesët e ligjëratës në gjuhën shqipe*, “Çështje të fonetikës dhe gramatikës së shqipes së sotme”, Tiranë
- Alexiadou, Artemis., Anagnostopoulou, Elena., Schafer. Florian, 2006, *The properties of anti causatives cross linguistically*, në M. Frascarelli (ed.), *Phases of Interpretation*. Berlin: Mouton de Gruyter
- Agnostopoulou, Elena. 2005 *Clitic doubling*, BCTI 14. f. 519-581
- Ball, Jerry T., *Towards a Semantics of X-bar Theory*, e tërhequr më 13.03.2012 nga <http://www.doublertheory.com/SemanticsOfXBarTheory.pdf>
- Baker, C. M. 2008, *The Syntax of Agreement and Concord*, Cambridge University Press
- Baker, C. M. 2003, *Lexical Categories, Verbs, Nouns and Adjectives*. Cambridge Studies in Linguistics 102. Cambridge University Press
- Baker, Mark. 1988 *Incorporation: a Theory of Grammatical Function Changing*. Chicago: University of Chicago Press
- Bloomfield, Leonard. 1933, *Language*. New York: Henry Holt, Rinehart dhe Winston Inc.
- Borer, Hagit. 2005, *Structuring Sense*, vol. II: *The normal course of events*. Oxford: Oxford University Press
- Borer, Hagit. 1998. *Deriving passive without theta roles*. Në Steven G. Lapointe, Diane K. Brentari, Patrick M. Farrell (eds.) *Morphology and its Relation to Phonology and Syntax*, Stanford: CSLI Publications
- Bourke, James Mannes. *The grammar we teach*, tërhequr më 12.12.2014 nga <http://nus.edu.sg/celc/publications/BourkeVol4.pdf>
- Brennan, Virginia. 1997. “*Modalities*”, Vanderbilt University, Nashville, Tennessee
- Bresnan, Joan., Mchombo, Sam A. 1987. “*Topic, pronoun, and agreement in Chichewa*”, *Language* 63: 741–782

- Bornkessel, I. 2002. *The Argument Dependency Model: A Neurocognitive Approach to Incremental Interpretation* [MPI-Series in Cognitive Neuroscience, 28]. Leipzig.
- Burzio, Luigi. 1986, *Italian Syntax: A Government Binding Approach*. Dordrecht: Reidel.
- Butler, Jonny. 2004, *Phase structure, Phrase structure, and Quantification*, disertacion për marrjen e titullit Doktor i Shkencave, Departmenti Shkencave Gjuhësore, Universiteti i York
- Buxheli, Ludmila. 2007, *Modelet e Caktimit Rasor në Gjuhën e Sotme Shqipe*, Botimet Neraida
- Buxheli, Ludmila. 2011, *Foljet Njëvetore në Gjuhën e Sotme Shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë
- Buxheli, Ludmila. 2011, *Përsëri për profilin e Cipos si gjuhëtar e gramatikan*, SF, 3-4, 2012
- CAS LX 500 Topics: Language Universals Fall 2010, September 27, e tërhequr në dt.07.11.2013 nga <http://ling-blogs.bu.edu/lx500f10/files/2010/09/lx500univf10-05a-erg-handout.pdf>
- Carnie, Andrew. 2011, *Modern Syntax*, A Coursebook, Cambridge University Press,
- Carnie, Andrew. 2006, *Syntax: a Generative Introduction, Second Edition*, Blackwell Publishers Ltd
- Casadio, Claudia. *Minimalism and the logical structure of the lexicon*, tërhequr në 18.06.2014 nga <http://citeseer.uark.edu:8080/citeseerx/viewdoc/summary;jsessionid=99C6B85D18D7C7D94E5814AF329950A6?doi=10.1.1.27.2110>
- Chomsky, Noam. 1981, *Lectures on government and binding: The Pisa Lectures*, Foris Publications, Dordrecht
- Chomsky, Noam. 1982, *Some Concepts and Consequences of the Theory of Government and Binding*. Massachusetts Institute of Technology
- Chomsky, Noam. 2002, *Syntactic Structures*. Mouton de Gruyter (formerly Mouton, The Hague) is a Division of Walter de Gruyter GmbH & Co. KG, Berlin
- Chomsky, Noam. 1965, *Aspects of the Theory of Syntax*. The Massachusetts Institute of Technology
- Chomsky, Noam. 1970, *Remarks on Nominalization*. Në: R. Jacobs and P. Rosenbaum (eds.) *Readings in English Transformational Grammar*, Waltham, Mass.: Ginn, pp. 184-221 tërhequr në 18.06.2014 nga <http://citeseer.uark.edu:8080/citeseerx/viewdoc/summary;jsessionid=99C6B85D18D7C7D94E5814AF329950A6?doi=10.1.1.27.2110>
- Chomsky, Noam, 1993 *Language and Thought* Wakefield, RI: Moyer Bell,
- Chomsky, Noam. 1986 *Knowledge of Language*. Praeger, New York, NY
- Chomsky, Noam. 1986. *Barriers. Linguistic Inquiry Monograph Thirteen*. Cambridge, MA and London: The MIT Press
- Chomsky, Noam. 1980, *Rules and representations*. Oxford: Basil Blackwell
- Chomsky, Noam. Lasnik Howard, *Filters and Control, Linguistic Inquiry*, Vol. 8, No. 3 (Summer, 1977), The MIT Press, Reading in English Transformational Grammar, 184-221. Waltham: Ginn.

## Bibliografi

---

- Clair St. Robert N., *X-Bar Syntax*, tërhequr në 13.03.2012 nga <http://epistemic-forms.com/ps-xbar.html>
- Covington Michael A., 2001, *A Fundamental Algorithm for Dependency Parsing*, Proceedings of the 39th Annual ACM Southeast Conference, ed. John A. Miller and Jeffrey W. Smith, pp. 95–102. e tërhequr më 02.06.2014 nga <http://www.stanford.edu/~mjkay/covington.pdf>
- Cook V. J., Mark Newson, *La grammatica universale - introduzione a Chomsky*, 1996
- den Dikken Marcel, *Particles On the Syntax of Verb-Particle, Triadic, and Causative Constructions*, 1995, Oxford University Press
- Croft, William. 1990, 'Possible verbs and event structure', in S. L. Tsohatzidis (ed.), *Meanings and Prototypes: Studies on Linguistic Categorization*. London: Routledge
- Croft William, 2003, *Typology*, në *The Handbook of Linguistics*-Mark Aronoff – Blackwell
- Craig, Colette G. 1978, *On the promotion of instrumentals in Mayan Languages* tërhequr në dt. 29. 07. 2014 nga [http://splc.ddl.ish-lyon.cnrs.fr/fulltext/Grinevald/Grinevald\\_1978\\_Mayan%20Language.pdf](http://splc.ddl.ish-lyon.cnrs.fr/fulltext/Grinevald/Grinevald_1978_Mayan%20Language.pdf)
- Çepani, Anila. 2011, *Dorëshkrimi doktorate "Anafora në gjuhën shqipe"*, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Departamenti i Gjuhës Shqipe, Universiteti i Tiranës
- Demiraj, Shaban. *Gjuhësi Ballkanike*, Libraria Digitale "Dielli", tërhequr në 02.09.2014 nga <http://www.dielli.net/pdf/historia/GjuhesiBallkanike.pdf>
- Demiraj, Shaban. 1983, *Rreth rimarrjes së kundrinave në gjuhën shqipe*, Studime Filologjike, Nr. 3, Tiranë
- De Hoop, Helen., Lamers, Monique. 2006, *Case, Valency and Transitivity* nga Leonid Kulikov, Andrej Malchukov dhe Peter de Swart, (Studies in Language Companion Series, issn 0165–7763 ; v. 77)
- Dixon, R.M.W., Aikhenvald, Alexandra Y. 2000, *Changing valency: case studies in transitivity* Cambridge University Press
- Dhima, Thoma. 2007, *Probleme të njëjësive sintaksore (Togfjalëshi dhe Sintagma)*, Studime Filologjike 3 - 4, Tiranë
- Dhima, Thoma. "Mbi klasifikimin e foljeve sipas valencës", Artikull mbajtur në Seminarin XXI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë 19.08 – 01. 09. 2002
- Dhima, Thoma. 2010, *Gjuha Shqipe - Sintaksa*, Gjirokastër
- Dixon M.W.Robert, 1972. *The Dyirbal Language of North Queensland*. Cambridge: Cambridge University Press
- Dixon M.W.Robert – Aikhenvald, Y. A. 2000, *Changing valency: case studies in transitivity*. Cambridge University Press
- Dik, S.C. 1989. *The Theory of Functional Grammar*. Dordrecht: Foris. Dhe Dik, S.C. 1997. *The Theory of Functional Grammar*, Vol. 1–2. Berlin: Mouton de Gruyter
- Doron, Edit. 2003 'Agency and voice: the semantics of the Semitic templates', *Natural Language Semantics* 11(1)

- Dowty, David. 1979, *Word Meaning and Montague Grammar: The Semantics of Verbs and Times in Generative Semantics and in Montague's PTQ*. Dordrecht: Reidel
- Dowty, David. 1991, 'Thematic proto roles and argument selection', *Language* 67, 547, 619
- Dras, Mark., Chiang, David., Schuler, William., On *Relations of Constituency and Dependency Grammars*, tërhequr më 02. 06. 2014 nga <http://web.science.mq.edu.au/~madras/papers/jlac.pdf>
- Duffley, P. J. 2006, *The English Gerund-Participle, a comparison with the Infinitive*, *Berkeley Insights in Linguistics and Semiotics* 61, Peter Lang Publishing, Inc., New York
- DuBois John W., Lorraine E. Kumpf, William J. Ashby 2003, *Preferred argument structure: Grammar as architecture for function*, John Benjamins B.V
- Fjalori i Gjuhës Shqipe*, 2006, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë Tiranë
- Featherston, Sam. *The finite verb and the clause: IP*, tërhequr në 22. 01. 2015 nga <http://www.sfs.uni-tuebingen.de/~sam/teach/IntroGenLing/handouts/syn6HO.pdf>
- Filip, Hana. 2005, 'The telicity parameter revisited'. *Semantics and Linguistic Theory (SALT) XIV*, Ithaca. CLC Publications, Department of Linguistics, Cornell University
- Filip, Hana. 2000, 'The quantization puzzle', in C. Tenny and J. Pustejovsky (eds.), *Events as Grammatical Objects, from the Combined Perspectives of Lexical Semantics, Logical Semantics and Syntax*. Stanford: CSLI Press
- Fillmore, Charles. 1968, 'The case for case', in E. Bach and R. Harms (eds.), *Universals in Linguistic Theory*. New York, Holt, Rinehart and Winston
- Fillmore, Charles J. 1977b. "The case for case reopened". Në P. Cole (ed.), *Syntax and semantics vol. 8: Grammatical Relations*. New York: Academic Press
- Floqi, Spiro. 1968, *Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*, Studime Filologjike Nr. 1, Tiranë
- Foley, William., Van Valin, Robert D., Jr. 1984. *Functional Syntax and Universal Grammar*. Cambridge: Cambridge University Press
- Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II*, 1976, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë,
- Frege, Gottlob. 1879 [1960]. "Begriffsschrift: A formalized language of pure thought modelled upon the language of arithmetic". Në P. Geach and M. Black (eds), *Translations From the Philosophical Writings of Gottlob Frege*. Oxford: Blackwell, 1–20
- Gaifman, H. 1965, *Dependency Systems and Phrase-Structure Systems*. *Information and Control*, 8, fq. 304–337, Hays D. (1964) *Dependency Theory: A Formalism and Some Observations*. *Language*, 40, fq. 511–525
- Gibson, Ted. *Psycholinguistics: Syntax II*, e tërhequr më 13.03.2012 nga [http://ocw.mit.edu/courses/brain-and-cognitive-sciences/9-59j-psycholinguistics-spring-2005/lecture-notes/0208\\_syntax\\_2.pdf](http://ocw.mit.edu/courses/brain-and-cognitive-sciences/9-59j-psycholinguistics-spring-2005/lecture-notes/0208_syntax_2.pdf)
- Givón, T. 1985. "Ergative morphology and transitivity gradients in Newari". Në *Relational Typology*, F. Plank (ed.), 89–107. Berlin: Mouton de Gruyter
- Graffi, Giorgio. 2008, *Ç'është gramatika gjenerative*, Botimet Toena

## *Bibliografi*

---

- Graffi, Giorgio. 1994, *Sintassi*, il Mulino
- Gramatika e gjuhës shqipe* 2002, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Vëllimi I – Morfologjia, Tiranë
- Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, 1957, Sintaksa, Tiranë
- Gramatika e Gjuhës Shqipe* 2002, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Vëllimi II – Sintaksa, Tiranë
- Gruber, Jeffrey. 1976, *Lexical Structures in Syntax and Semantics*. Amsterdam. North Holland Publishing Company
- Grosu, Alexander. 1979, *Review of N. Chomsky "Essays on form and interpretation"* Journal of Linguistics, 15
- Haegeman, Liliane. 1998, *Introduction to Government and Binding Theory*, Botim i Dytë, Blackwell Publishers Ltd
- Hale, K., Keyser, S.J. 1993, *On argument structure and the lexical expression of syntactic relations*. Në Hale, K. & Keyser, S.J. (eds.), *A view from Building 20*. Cambridge, MA: MIT Press, 53-109.
- Hale, K. & S.J. Keyser. 2002. *Prolegomenon to a theory of argument structure*. Cambridge, MA: MIT Press
- Hale, K., Keyser, S.J. *Some Transitivity Alternations in English*, e tërhequr në 07.08.2014 nga <http://www.ehu.es/ojs/index.php/ASJU/article/viewFile/7793/6987>
- Halliday Michael, *On Grammar*, Vol. 1 in *The Collected Works of M.A.K. Halliday*. London: Continuum. 2002
- Harley, Heidi. 2005, *On the causative construction*, University of Arizona
- Haspelmath, Martin. 1993, *More on the typology of inchoative/causative verb alternations*, Në B. Comrie and M. Polinsky (eds.), *Causatives and Transitivity*. Amsterdam: John Benjamins
- Haspelmath, Martin. 2006, *Ditransitive constructions. Towards a new Role and Reference Grammar account?* në *Investigations of the Syntax–Semantics–Pragmatics Interface*, Robert D. Van Valin, Jr. Heinrich Heine University, Düsseldorf & University at Buffalo, The State University of New York, John Benjamins Publishing Company
- Hays, David G. 1964, *Dependency theory: a formalism and some observations*. Language 40:511–525, (1966) *Readings in Automatic Language Processing*. New York: American Elsevier, Sgall, Peter (1994) *Dependency-based formal description of language*. In *The Encyclopedia of Language and Linguistics*, ed. R. E. Asher, vol. 2, 867–872. Oxford: Pergamon Press
- Hanafy, Iman A. *English Grammar 2*, tërhequr në 21. 07. 2014 nga <http://www.olc.bu.edu.eg/olc/images/fart/122.pdf>
- Heim I. – Kratzer, A. 2000, *Semantics in Generative Grammar*. Blackwell Publishers Ltd
- Herbst, Th. – Votteler, G. K. 2007, *Valency - theoretical, descriptive and cognitive issues*. Trends in Linguistics Studies and Monographs 187. Walter de Gruyter GmbH & Co.
- Hopper, Paul J., Thompson, Sandra A. "Transitivity in Grammar and Discourse", *Language*, Vol. 56, No. 2. 1980, fq. 252, e tërhequr më datë 02. 12. 2013 nga

- [http://www.romanistik.unifreiburg.de/raible/Lehre/2006/Materialien/Hopper\\_Thompson.pdf](http://www.romanistik.unifreiburg.de/raible/Lehre/2006/Materialien/Hopper_Thompson.pdf)
- Hornstein, Norbert. 1977, S and X-bar convention. *Linguistic Analysis* 3: 137-176.
- Hockett, F. Charles, Altmann, A. Stuart, 1968, *A note on design features*, Në *Animal Communication: Techniques of Study and Results of Research*, Thomas A. Sebeok, Indiana University Press
- Hubbard, Philip L. 1981, *Dative Clitics in Albanian: Evidence for Syntactic Levels*, Proceedings of the Seventh Annual Meeting of the Berkeley Linguistics Society, fq. 82-92
- Hurford, R. J. – Heasley, B. – Smith, B. M. 2007, *Semantics. A coursebook*. Second Edition. Cambridge University Press.
- Huddleston, R. – Pullum, K. G. 2002, *The Cambridge Grammar of the English Language*. Cambridge University Press
- Hung, Toni Tong Ning. 2003. *How linguistics can contribute to the teaching of grammar*. Në J.E. James (Ed.), *Grammar in the language classroom* (pp. 41-61). Singapore: SEAMEO Regional Language Centre
- Hyska, Hysnie. 2009, Punim Masteri, Dorëshkrim “*Sintagma Emërore në Gjuhën Shqipe*”, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Departamenti i Gjuhës Shqipe, Tiranë
- Jackendoff, Ray. 1977, *X-bar syntax: a study of phrase structure*. Cambridge MA: MIT Press.
- Jackendoff, Ray. 1983, *Semantics and Cognition*. Cambridge, MA: MIT Press
- Jackendoff, Ray. 1996, ‘The proper treatment of measuring out, telicity, and perhaps even quantification in English’, *Natural Language and Linguistic Theory* 14: 305-54
- Jong-Bok Kim, Peter Sells, *Chapter 4: Head, Complements, and Modifiers*, e tërhequr më 13.03.2012 nga <http://web.khu.ac.kr/~jongbok/teaching/eng-syn-class/chap4-slide.pdf>
- Kallulli, Dalina. 2001, *Comparative Syntax of Balkan Languages*, Maria Luisa Rivero dhe Angela Ralli, Oxford University Press (version PDF)
- Kayne, Richard S. 1994, *The Antisymmetry of Syntax*, Linguistic Inquiry Monograph 25, M.I.T. Press, Cambridge, Mass
- Karapinjalli, Mustafa. 1989, *Foljet e diatezës pësore dhe përdorimet e tyre në gjuhën e sotme letrare shqipe*, Studime Filologjike Nr. 2, Tiranë
- Kenny, Anthony. 1963, *Action, Emotion, and Will*. London: Routledge
- Klingvall, Eva. 2005, *A secret in the middle?*, fq. 1 tërhequr në 23.09.2014 nga <http://www.sol.lu.se/fileadmin/media/forskning/workingpapers/engelska/vol05/klingvall-wp05.pdf>
- Koleci, Flora. – Turano, Giussepina. 2011, *Hyrje në Sintaksën Gjenerative të Shqipes*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë
- Krifka, Manfred. *Predicates, Modifiers, Definite NPs, X-bar Theory, and Types*, e tërhequr më 13.03.2012 nga [http://amor.cms.hu-berlin.de/~h281\\_6i3x/Lehre/2000\\_Semantics/Semantics I-05.pdf](http://amor.cms.hu-berlin.de/~h281_6i3x/Lehre/2000_Semantics/Semantics I-05.pdf)
- Krifka, Manfred. 1998, ‘*The origins of telicity*’, në S. Rothstein (ed.), *Events and Grammar*, Dordrecht: Kluwer Academic Publishers

## *Bibliografi*

---

- Kratzer, Angelika. 1991, *Modality*, Në A. Von Stechow & D. Wunderlich (eds.) *Semantics: International Handbook of Contemporary Research*, Berlin: de Gruyter, 639–650
- Kratzer, Angelika. 2004, *The event argument*, University of Massachusetts [www.semanticsarchive.net](http://www.semanticsarchive.net)
- Kulikov, L. – Malchukov, A. – Swart de, P. 2006, *Case, Valency and Transitivity*. Studies in Language Companion Series 77, John Benjamins Publishing Company
- Lagji, Klara. 2004, *Rreth ndërtimëve mesore në gjuhën shqipe*, Studime Filologjike, Nr. 1-2, Tiranë
- Lavidas, Nikolaos. 2009, *Transitivity Alternations in Diachrony: Changes in Argument Structure and Voice Morphology*, Cambridge Scholars Publishing
- Lamb Sydney M., *Outline of Stratificational Grammar*. Washington DC: Georgetown University Press, 1966
- Lasnik Howard, tërhequr më 30. 05. 2014 nga [http://www.blackwellpublishing.com/content/BPL/Images/Content\\_store/Sample\\_chapter/9780631199878/Lasnik\\_sample%20chapter\\_A%20course%20in%20minimalist%20syntax.pdf](http://www.blackwellpublishing.com/content/BPL/Images/Content_store/Sample_chapter/9780631199878/Lasnik_sample%20chapter_A%20course%20in%20minimalist%20syntax.pdf)
- Lasnik Howard, Uriagereka J. *A Course in GB Syntax: Lectures on Binding and Empty Categories*. MIT Press 1988
- Lasnik Howard, Uriagereka Juan, Boeckx Cedric, *Minimalist Expectations Preliminary Assumptions, with a Review of Some Familiar Notions*
- Levin, Beth. 1993, *English Verb Classes and Alternations. A Preliminary Investigation*. University of Chicago Press
- Levin, Beth, Malka Rappaport Hovav. 2005 *Argument Realization*. New York: Cambridge University Press
- Levin Beth, Malka Rappaport Hovav, 1995 *Unaccusativity: At the Syntax-Lexical Semantic Interface*. Cambridge, MA: MIT Press
- Likaj, Ethem. 1970, *Disa çështje të kategorisë gramatikore të diatezës në gjuhën shqipe*, Studime Filologjike Nr. 4, Tiranë
- Malka Rappaport Hovav, Doron Edit, Sichel Ivy, 2010 *Lexical Semantics, Syntax, and Event Structure*, Oxford University Press Inc., New York
- Malchukov, Andrej. 2006 *Transitivity parameters and transitivity alternations në Case, Valency and Transitivity*, Volume 77 Studies in Language Companion Series (SLCS), Leonid Kulikov, Andrej Malchukov and Peter de Swart, John Benjamins B.V.
- Melcuk I., Pertsov N. 1987 *Surface Syntax of English: A Formal Model within the Meaning-Text Framework*. John Benjamins, Amsterdam, The Netherlands
- Meyers Adam, Macleod Catherine, Grishman Ralph, *Standardization of the Complement/Adjunct Distinction*, tërhequr më, 26.06.2014 nga [http://www.euralex.org/elx\\_proceedings/Euralex1996\\_1/018\\_Adam%20Meyers,%20Catherine%20Macleod%20&%20Ralph%20Grishman%20-standardization%20of%20the%20Complement%20Adjunct%20Di.pdf](http://www.euralex.org/elx_proceedings/Euralex1996_1/018_Adam%20Meyers,%20Catherine%20Macleod%20&%20Ralph%20Grishman%20-standardization%20of%20the%20Complement%20Adjunct%20Di.pdf)
- Melcuk I. 1988, *Dependency Syntax: Theory and Practice*. State University of NY Press, Albany

- Memushaj, Rami. 2008, *Hyrje në Gjuhësi*, Botimet Toena, Tiranë
- Memushaj, Rami. 2008, Dorëshkrim “*Bukuria e gjuhës 2*”
- Memushaj, Rami. 2003, *Gjuhësia gjenerative*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë
- Miçoni Harallamb, Disertacion për marrjen e gradës shkencore Doktor, “*Rreth Frazologjisë së Gjuhës Shqipe Krahasuar me Greqishten*”, Tiranë 2013
- Nida Eugene, *A Synopses of English Grammar*, Instituto Linguistico de Verano, 1964 dhe
- Rulon S. Wells, *Immediate Constituents*, *Language*: 23. 1947, fq. 81–117
- Newson Mark et. al., 2006, *Basic English Syntax with Exercises*, Bölcsész Konzorcium HEFOP Iroda
- Odlin, Terence. 1994, *Perspectives on pedagogical grammar*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Ostler, Nicholas. 1979, *Case Linking: A Theory of Case and Verb Diathesis Applied to Classical Sanskrit*. PhD thesis. MIT
- Parsons, Terrence. 1990, *Events in the Semantics of English: A Study in Subatomic Semantics*. Cambridge, MA: MIT Press
- Paul, Vendler, Zeno. 1967, *Linguistics in Philosophy*. Ithaca, NY: Cornell University Press
- Perlmutter David M., 1978. *Impersonal passives and the unaccusative hypothesis*. BLS
- Perlmutter David M., Paul M. Postal. 1984, *The I-advancement exclusiveness law*. Në David M. Perlmutter dhe Carol Rosen (eds.), *Studies in relational grammar 2*, 81–125. Chicago: University of Chicago Press
- Pike Kenneth L., *Language in relation to a unified theory of the structure of human behavior*. Vol. 3 në *Janua Linguarum, Series Maior*. The Hague: Mouton 1967
- Phillips Colin, Wagers Matthew, *Constituent Structure and the Binding Problem* tërhequr më 02.06.2014 nga <http://ling.umd.edu/~colin/research/papers/phillips2005-bbs.pdf>
- Përnaska, Remzi. 1972, *Diskutim për kumtesën e S. Floqit*, Studime Filologjike, Nr.1, Tiranë
- Përnaska, Remzi. 1983, *Çështje të kundrinorit në gjuhën shqipe*, Studime Filologjike, Nr. 4, Tiranë
- Portner, Paul. 2009. *Modality*. Oxford University Press
- Prada Massimo, *Annotazioni di sintassi generativa*, tërhequr më 05.06.2014 nga [http://webcen.di.unimi.it/200203/comdig/lingua\\_italiana2/files/248327.Sintassi%20generativa.pdf](http://webcen.di.unimi.it/200203/comdig/lingua_italiana2/files/248327.Sintassi%20generativa.pdf)
- Prada, Massimo, 2003 *Scrittura e comunicazione*, Milano, Led, Bonomi Ilaria, Andrea Masini, Silvia Morgana, Mario Piotti, 2003 *Elementi di linguistica italiana*, Roma, Carocci
- Prifti, Spiro. 1957, *Sintaksa*, Tiranë
- Pustejovsky, James. 1991, *The syntax of event structure*. *Cognition* 41
- Pylkkanen, Liina. 2008 *Introducing Arguments*. Cambridge, MA: MIT Press, Reinhart, Tanya. 2002, *The theta system an overview*, *Theoretical Linguistics* 28



## Bibliografi

---

- Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G., Svartvik, J. 1985, *A Comprehensive Grammar of English Language*, London, Longman
- Radford, Andrew. 2004, *Minimalist Syntax Exploring the Structure of English*, Cambridge
- Ramchand, Gillian. 2007, *First Phase Syntax*. Cambridge: Cambridge University Press
- Rickheit, Gert., Sichelschmidt, Lorenz. 2007, *Valency and cognition - a notion in transition*, në Thomas Herbst, Katrin Götz – Votteler, *Valency - theoretical, descriptive and cognitive issues*. Trends in Linguistics Studies and Monographs 187.
- Robinson J. 1970, *Dependency Structures and Transformational Rules*. Language, 46/2, fq. 259–285, Vater H. 1975 *Toward a Generative Dependency Theory*. Lingua, 36, fq. 121–145 Textbooks in Linguistics, 2004
- Roberge, Yves. *Transitivity Requirement Effects and the EPP* tërhequr në 27.08.2014 nga <http://homes.chass.utoronto.ca/~roberge/pdf/WECOL02.pdf>
- Roland, Douglas William. 2001, *Verb Sense and Verb Subcategorization Probabilities*, Disertacion për mbrojtjen e titullit Doktor i Shkencave, Departamenti i Gjuhësisë, Universiteti i Colorados
- Roussou, Anna., Tsimpli, Ianthi-Maria. 2005, *Clitics and Transitivity*, Referuar në *Mediterranean Syntax Meeting*, Rodhos, Greqi
- Roussou, Anna. & I.M. Tsimpli. 2006, *On Greek VSO again!* Journal of Linguistics 42: 317-354
- Schneider. Gerold, 1998, *A Linguistic Comparison of Constituency, Dependency and Link Grammar* - Diploma Paper, Institut für Informatik der Universität Zürich
- Smith, Carlota. 1991, *The Parameter of Aspect*. Dordrecht: Kluwer
- Speas, Margaret. 1990, *Phrase Structure in Natural Language*. Kluwer, London, UK
- Spencer, A. 1992, *Morphological theory*, Blakwell, Oxford & Cambridge
- Sportiche, D. *Clitic constructions*, në *Phrase structure and the lexicon*, Johan Rooruck and Laurie Zaring, eds. Kluwer, 1983, f.1. E. Agnostopoulou, *Clitic doubling*, f.519-581; A. Spencer, *Morphological Theories*
- Stowell, Tim. 1989, *Subjects, Specifiers, and X-Bar Theory* Në *Alternative Conceptions of Phrase Structure*, ed. nga M. Baltin & A. Kroch, The University of Chicago Press, Chicago, IL
- Sheperi, Ilija Dilo. 2001, *Gramatika dhe Sindaksa e Gjuhës Shqipe*, ribotim Albin
- Takahashi Naoko, *On Unaccusativity* tërhequr në 01.07.2014 nga [https://www.google.com/search?sourceid=navclient&ie=UTF-8&rlz=1T4ASUM\\_enAL579AL584&q=On+Unaccusativity+Naoko+TAKAHASHI](https://www.google.com/search?sourceid=navclient&ie=UTF-8&rlz=1T4ASUM_enAL579AL584&q=On+Unaccusativity+Naoko+TAKAHASHI)
- Tenny, Carol. 1994, *Aspectual Roles and the Syntax Semantics Interface*. Dordrecht: Kluwer
- Tesniere, Lucien. 1959, *Elements de syntaxe structural*, Paris, Klincksieck
- Totoni, Minella. 1994, *A është togfjalësh struktura e një frazeologjizmi foljor?*, Studime Filologjike nr. 1 – 4, Tiranë
- Verkuyl, Henk. 1989, *Aspectual classes and aspectual composition*, Linguistics and Philosophy

von Fintel, Kai. 2006, *Modality and Language*. Në Encyclopedia of Philosophy – Botim i dytë nga Donald M. Borchert. Detroit: MacMillan Reference USA, tërhequr nga versioni online <http://web.mit.edu/fintel/fintel-2006-modality.pdf> në 19.09.2014

Ue, Noriko. *On Unergative and Unaccusative Verbs in English* tërhequr në 30.12.2013 nga [http://repo.lib.ryukoku.ac.jp/jspui/bitstream/10519/896/1/r-rn\\_473\\_009.pdf](http://repo.lib.ryukoku.ac.jp/jspui/bitstream/10519/896/1/r-rn_473_009.pdf)

Wasow, Thomas. 2001, *The Handbook of Linguistics*, Mark Aronoff, Janie Rees-Miller, Blackwell Publishers Ltd

Wunderlich, D. 1997. *Cause and the structure of verbs*. Linguistic Inquiry 28: 27–68

Wunderlich, D. 2006. *Towards a structural typology of verb classes*. Në Advances in the Theory of the Lexicon, D. Wunderlich (Ed.), 57–166. Berlin: Mouton de Gruyter

### **Website të shfrytëzuara**

<http://jilaniwarsi.tripod.com/ps.pdf>

[http://www.blackwellpublishing.com/content/BPL/Images/Content\\_store/Sample\\_chapter/9780631199878/Lasnik\\_sample%20chapter\\_A%20course%20in%20minimalist%20syntax.pdf](http://www.blackwellpublishing.com/content/BPL/Images/Content_store/Sample_chapter/9780631199878/Lasnik_sample%20chapter_A%20course%20in%20minimalist%20syntax.pdf)

[http://en.wikipedia.org/wiki/Adjunct\\_%28grammar%29#cite\\_note-5](http://en.wikipedia.org/wiki/Adjunct_%28grammar%29#cite_note-5)

<http://www.ling.upenn.edu/~beatrice/syntax-textbook/ch4.html>

*Intransitive elementary trees*, tërhequr në 01.07.2014 nga <http://www.ling.upenn.edu/~beatrice/syntax-textbook/ch4.html>

[http://en.wikipedia.org/wiki/Causative\\_alternation](http://en.wikipedia.org/wiki/Causative_alternation)

*Rezolutë e Kongresit të Drejtshkimit të Gjuhës Shqipe* tërhequr më 17.12.2014 nga <https://sites.google.com/site/drejtshkrimishqip/rezolute>

<http://grammar.about.com/od/mo/g/modterm.htm>

[www.semanticsarchive.net](http://www.semanticsarchive.net)

## FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

Teza: “Sintagma foljore në gjuhën shqipe”

Fusha: Kërkime gjuhësore.

Abstrakt: Në kuadrin e gramatikës gjenerative, sintagma është parë si një njësi e domosdoshme e operacioneve sintaksore. Teoria e sintagmës mundëson vendosjen hierarkike të fjalëve të sintagmë, duke zbuluar kështu edhe marrëdhëniet strukturore e gramatikore të krijuara brenda fjalisë. Gjuhësia jonë është ende në fillimet e zbatimit të konceptit të sintagmës në sintaksën e gjuhës shqipe. Duke qenë se teoritë që e përbëjnë atë janë universale dhe të zbatueshme në të gjitha gjuhët natyrore, atëherë ky kuadër gjuhësor mund të zbatohet në materialin e gjuhës shqipe. Folja përbën bërthamën e fjalisë. Edhe kur folja mungon në fjali, ajo nënkuptohet, kështu që kallëzuesia realizohet, dmth. nuk ka fjali pa kallëzuesi. Bazuar në gramatikën gjenerative, folësit e një gjuhe duhet të kenë njohjen e brendshme për të dalluar llojin e foljes dhe përbërësit e sintagmës foljore SF, pra është pjesë e vetë njohjes leksikore të tyre. Duke pasur parasysh këtë pohim, në gramatikën gjenerative është pikërisht folja, që duke u nisur nga interpretimi kuptimor i saj, u cakton përbërësve të tjerë të sintagmës rolet semantike që do të mbartin dhe strukturën e tyre; kjo mundëson analizën në mënyrë hierarkike e zbulon kombinimet të mundshme të mundshme të sintagmës foljore.

Fjalë kyç: sintagma, folje, argument, rol semantik, gjenerativizm, Chomsky

---

## FACULTY OF HISTORY AND FILOLOGY

Thesis: “Verb phrase in Albanian”

Field: Linguistic research.

Abstract: The phrase is an essential unit of the syntactic analyses in the frame of the generative grammar. The theory of phrase structure places emphasis on the hierarchy of the words in a phrase, discovering as such the grammatical relations within the sentence. Albanian linguistics is taking the first steps in the application of the concept of phrase in the syntax of Albanian language. Considering that the linguistic theories part of generativism are universal and applicable to all natural languages, it is taken for granted that this linguistic frame to be applied to the material of Albanian language.

The verb is the main element of the sentence. It can be easily understood even when not literally stated, so predication is completed thus, in this sense there is no sentence without predication. Taking into consideration the generative grammar, the speaker of a language has the innate linguistic knowledge to distinguish the kind of verb stated and the constituents needed in order to form a verb phrase VP, since this is due to the prior knowledge humans have about the structure of language in general. Thus it is the verb that assigns the semantic roles and the structure to other constituents based on its semantic interpretation; this enables the hierarchal analysis and presents the possible combinations of the verb phrase.

Key words: phrase, verb, argument, semantic role, generativism, Chomsky